

# EUR MEDITERRANEAN

**Nr. 10**  
Qershor 2016

DIPLOMACIA EKONOMIKE. VEPRIMTARIA DHE PRAKTIKAT.  
DIPLOMACIA EKONOMIKE NE KORNIZEN E OKB ..... 50

STUDIM PËR VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË PARIMEVEBAZË TË  
TRASHËGIMISE ZGJEDHORE EUROPIANE NË LEGJISLACIONI  
ZGJEDHOR SHQIPTAR ..... 113

MARRËVESHJA E TREGTISË SË LIRË NDËRMJET SHBA DHE BE.  
RËNDËSIA E SAJ PËR VËNDET E BALLKANIT PERËNDIMOR ..... 157

BOTIM I UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

# EUROMEDITERRANEAN

Revistë periodike shkencore

10

Qershor 2016

EUROMEDITERRANEAN  
Revistë shkencore

Botim i UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË  
Nën Drejtimin e Akad.Asoc. Prof. Dr Anastas ANGJELI

**Bordi i Nderit**

Prof.Dr.Arben Puto  
Prof.Dr.Artistotel Pano  
Prof.Dr.Sabah Hilmija Prof.Dr.Ilia Kristo  
Prof.Dr.Emin Riza  
Prof.Dr.Vasil Tole

**Kryeredaktor**

MA. Ilir HEBOVIJA

**Redaktorë Shkencore**

MA.Nevila RAMA  
MA.Kriton KUÇI

**Bordi Drejtues-Shkencor -Editorial**

Kryetar

Prof.Dr.ANASTAS ANGJELI Akademik i Asoc.

Anëtarë Prof.Dr.Kosta Bajraba

Prof.Dr Ilia Kristo

Prof.Dr. Esmeralda Uruçi

Prof.Dr. Stefan Çapaliku

MA. Ben Blushi

Prof.Asoc. Mimoza Manxhari

Prof.Dr.Orfea Dhuci

Dr. Hysen Çela

Dr. Altin Hoti

Dr. Fatos Ibrahim

Dr.Skender Demaliaj

MA. Gjergj Teneqexhi

MA. Ardian Petollari

MA. Nevila Rama

MA Jona MARASHI

MA. Ilir Aliaj

MA.Besnik Leskaj

MA. Kriton Kuci

MA. Etleva Vertopi

MA.Merita Myftari

MA. Emilio Cika

Art design: Dafina Stojko

© UMSH PRESS

Shtypyr: "CLASSIC PRIN"

## PËRMBAJTJA

### EVROPA JUGLINDORE DREJT BASHKIMIT EVROPIAN. IMPLIKIMET LIGJORE, POLITIKE DHE SOCIALE. MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE TË EVROPËS JUGLINDORE. SFIDAT E PËRBASHKËTA DHE TË VECANTA

EMIGRIMI DHE REMITANCAT. RASTI I SHQIPERISE	
Brikena Balli.....	7
ROLI I POLITIKES SE BRENDSHME NE ERJEN E POLITIKES SE JASHTME: REFUZIMI I SHQIPERISE PER SHKATERRIMIN E ARMEVE KIMIKE TE SIRISE	20
Mentor Beqa.....	
SITUATA AKTUALE E SISTEMIT GJYQESOR NE EVROPEN JUGLINDORE. SFIDAT	
Erina Caka.....	34
DIPLOMACIA EKONOMIKE. VEPRIMTARIA DHE PRAKTIKAT. DIPLOMACIA EKONOMIKE NE KORNIZEN E OKB	
Emilio Çika.....	50
FAKTORET SUBJEKTIVE SI ELEMENT I VRASJES ME PARAMENDIM	
Alketa Elezi.....	62
E DREJTA ZAKONORE DHE PROCESI PENAL	
Ferdinand Elezi.....	73
DIPLOMACIA KINEZE, BALLKANI DHE PERSPEKTIVA SHQIPTARE	
Dritan Hoti.....	83
KEQKUPTIMET ME DEMOKRACINË EDHE PAS 25 VITESH TRANZICION DEMOKRATIK SHOQËRIA SHQIPTARE KA KEQKUPTIME SERIOZE ME DEMOKRACINË.	
Përparim Kabo.....	89
ANGAZHIMI NDËRKOMBËTAR NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT	
Luljeta Kodra.....	96
STUDIM PËR VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË PARIMEVEBAZË TË TRASHËGIMISE ZGJEDHORE EUROPIANE NË LEGJISLACIONI ZGJEDHOR SHQIPTAR	
Andon Kume.....	113

KRIMI I VAZHDUAR NE TE DREJTEN PENALE ITALIANE Arben Prifti.....	123
MARRËVESHJA E TREGTISË SË LIRË NDËRMJET SHBA DHE BE. RËNDËSIA E SAJ PËR VËNDET E BALLKANIT PERËNDIMOR Redi Shtino.....	143
MARRËVESHJA E TREGTISË SË LIRË NDËRMJET SHBA DHE BE. RËNDËSIA E SAJ PËR VËNDET E BALLKANIT PERËNDIMOR Fatmir Zanaj .....	157
RËNDËSIA E TTIP PËR RINGJALLJEN E PARTNERITETIT BE-SHBA Enian Lamce, Alketa Dumani.....	170

## HYRJE

Ky numër i ri i revistës shkencore EUROMEDITERRANEAN përmbledh punimet shkencore të prezantuara në sesionet tematike të Konferencës Ndërkombëtare Shkencore “South East Europe as a Common Market” e organizuar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë dhe Unioni i Universiteteve Euroaziatike EURAS në datat 14-15 mars 2015.

Dita e parë e konferencës konsistonte në seanca plenare ku merrnin pjesë akademikë, politikanë, profesorë vendas dhe të huaj, studiues, student dhe të ftuar të tjerë. Në sesionin e parë të seancës plenare mbajtën referate mbi çështjet thelbësore të konferencës Kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama, themeluesi i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë Prof. Dr. Anastas Angjeli, Presidenti i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve Prof. Dr. Felix Unger, Presidenti i EURAS Prof. Dr. Mustafa Aydin si dhe Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Prof. Dr. Muzafer Korkuti. Në dy sesionet e tjera të Seancës Plenare referuan Professore nga Universitete të ndryshme të rajonit, të Evropës dhe të Azisë.

Konferenca në seancën plenare dhe në sesionet tematike analizoi realitetin ekonomik, politik, social të rajonit të Evropës Juglindore, e parë nga një këndvështrim rajonal dhe jo kombëtar. Konferenca trajtoi situatën ekonomike e financiare të rajonit kushtet e periudhës së post krizës globale në përgjithësi dhe asaj të Eurozonës në veçanti, sfidat aktuale dhe të së ardhmes, perspektivën e zhvillimit të rajonit në këndvështrimet e reja ekonomike si dhe perspektivën evropiane të vendeve që nuk janë ende anëtare të Bashkimit Evropian.

Në Konferencë u trajtuann raste nga të gjitha vendet e rajonit, u krahasuan përvojat kombëtare dhe u dhanë rekomandime për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik rajonal, për rritjen e shkëmbimeve tregëtare ndërmjet vendeve të rajonit si dhe për intensifikimin e dialogut politik dhe social ndërmjet vendeve të rajonit.

Në ditën e dytë të Konferencës, në ambjentet e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë u zhvilluan sesionet tematike ku u referuan temat e përzgjedhura nga komisioni shkencor i Konferencës.

**EVROPA JUGLINDORE DREJT BASHKIMIT EVROPIAN.  
IMPLIKIMET LIGJORE, POLITIKE DHE SOCIALE.  
MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE  
TË EVROPËS JUGLINDORE.  
SFIDAT E PËRBASHKËTA DHE TË VECANTA**

## EMIGRIMI DHE REMITANCAT. RASTI I SHQIPERISE

**Brikena Balli**

University of Tirana  
ballibrikena@gmail.com

### ABSTRACT

*Albania was the most isolated country of the former communist block. For about four decades immigration from Albania was banned by the communist government in power. The collapse of the communist system in the early 1990s, along with the transition from a centrally-planned to a market economy unleashed large scale waves of immigration from Albania to the countries of Western Europe, in particular Greece, and Italy. As a result of these, about 33 percent of Albanians live abroad. This paper examines the relationship between Albanian migration and migrant financial remittances. It focuses on the size, their use and their impact on Albanian economy, and people's daily lives. It also explores the Albanian government policies with regard to this issue. In addition, the article raises the question of the need to explore the issue of the social remittances, as one of the gaps in the literature of Albanian migration in particular, and that of migration in general*

**Keywords:** migration, remittances, Albania

### HYRJE

Rënia e regjimit komunist, dhe kalimi nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu çoi në emigracionin masiv të njerëzve nga Europa Lindore në Europën Perëndimore. Ky fenomen ka qënë mjaft i dukshëm në rastin e Shqipërisë, kur brenda një kohe prej dy dekadash, vendi është transformuar nga një vend pa emigracion ndërkombëtar në një vend ku rreth 33 për qind e popullsisë jetojnë dhe punojnë si emigrantë në vende të ndryshme. Gjatë katër dekadave të komunizmit (1945-1990), qeveria autoritare e Shqipërisë imponoi një nga kontrollat më të rrepta të emigracionit në të gjithë ish bllokun komunist, dhe ndoshta në botë. Një situatë e tillë do të mbaronte në vitet 1990,

me përmbysjen e regjimit diktatorial të Shqipërisë. Rrënia e këtij regjimi inicioi ikjen në mënyrë masive të shqiptarëve drejt vendeve Perëndimore. Në vitet që do të vinin, një numër i madh i shqiptarëve do të ikte nga Shqipëria dhe do të shkonte drejt vendeve Perëndimore, veçanërisht Greqisë, ku shqiptarët janë grupi më i madh i emigrantëve, dhe Itali.

### **Emigracioni nga Shqipëria: Pas viteve 1990**

Ashtu siç u përmend dhe më sipër, emigracioni shqiptar kontemporar, ashtu si në vendet e tjera të Europës Lindore, është i rrënjosur në procesin e transformimeve strukturale nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu. Gjatë katër dekadave të komunizmit (1945-1990), qeveria autoritare e Shqipërisë imponoi një nga kontrollat më të ashpra të emigracionit në të gjithë ish bllokun komunist, dhe ndoshta edhe në botë. Çdo përpjekje për të ikur nga vendi pa autorizimin e autoriteteve në pushtet, që ishte e pamundur për shumicën dërmuese të shqiptarëve, do të kishte pasoja të rënda, duke përfshirë burgim dhe punë të detyruar nga dhjetë deri në njëzet e katër vjet, dhe në disa raste edhe dënim me vdekje (Hein 1998: 224). Kjo situatë do të mbaronte në vitet 1990, me përmbysjen e regjimit diktatorial të Shqipërisë. Rënia e këtij regjimi inicioi ikjen në mënyrë masive të shqiptarëve drejt vendeve perëndimore. Në vitet që do të vinin, një numër shumë i madh i shqiptarëve do të ikte nga Shqipëria dhe do të shkonte drejt vendeve të industrializuara të Perëndimit. Numri më i madh i emigrantëve në Greqi, ku shqiptarët përbëjnë grupin më të madh të emigrantëve, dhe Itali. Përveç këtyre dy vendeve, një pjesë tjetër e emigrantëve zgjodhën vendet e tjera të Europës Perëndimore, si dhe SHBA, Kanadanë.

### **Valët emigratore pas rënies të regjimit komunist**

Numri i emigrantëve shqiptarë është produkt i disa valëve emigratore, duke filluar me vitin 1990.<sup>1</sup>

**Vala e parë: Viti 1990:** Ky është viti i atyre që quhen “emigrant të ambasadave”. Në 2 korrik, 1990, rreth 5000 persona, të frustruar nga situata asokohe në vend, mësynë ndërtesat e ambasadave të huaja, përkatësisht të Italisë, Francës, Greqisë, Çekosllovakisë, Polonisë, Hungarisë dhe Turqisë. Më në fund, autoritetet e qeverisë shqiptare, të gjendur dhe nën trysninë e presionit nga jashtë, vendosën t’u jepnin pasaporta azil kërkuesve dhe u lejuan të iknin nga Shqipëria dhe të vendoseshin në vendet përkatëse (Hein 1998: 221). Në të njëjtën kohë, shumë shqiptarë të tjerë po iknin drejt Greqisë, duke kaluar kufirin në mënyrë ilegale. Megjithatë numri i lëvizjeve midis Shqipërisë dhe

1 Seksioni mbi valët emigratore të emigracionit shqiptar mbështetet tek artikulli nga Pavlov et al., (2014) (seksioni mbi Shqipërinë (ff: 54-56)

Greqisë është vështirë të dokumentohet në mënyrë ekzakte, mund të thuhet se deri në fillim të vitit 1991, rreth 20,000 shqiptarë kishin lënë Shqipërinë. Duhet thënë se kjo është një shifër e përafërt, dhe jo ekzakte (Barjaba and King 2005; Vullnetari 2007).

**Vala e dytë emigratore: Viti 1991:** eksodi nëpërmjet anijeve drejt Italisë dhe emigrimi masiv drejt Greqisë. Në fillim të marsit 1991, rreth 25 mijë shqiptarë rrëmbyen anijet në portin e Durrësit dhe Vlorës dhe udhëtuan nëpërmjet Adriatikut drejt Italisë. Në gusht të të njëjtit vit, në mes një situatë ekonomike që përkëqesohej vazhdimisht, dhe një rritje të mungesës së ushqimeve, rreth 20,000 shqiptarë të tjerë, të hipur në anije u lejuan të zbarkonin në portin e Barit në Itali. Megjithatë shumica e tyre u kthyen në Shqipëri (Barjaba and King 2005; King 2003: 288; Hall 1994: 189). Paralelisht me këtë, kemi zhvillimin e një emigracioni masiv drejt Greqisë, por shumë më pak i dokumentuar, duke qënë së shumë nga lëvizjet midis Greqisë dhe Shqipërisë bëheshin në mënyrë ilegale, përmes maleve. Si rezultat i kësaj, këto lëvizje janë shumë të vështira për t'u llogaritur (King 2003; King and Mai 2002: 164). Nga mezi i viteve 1990-të, rreth 20 per qind e popullsisë të Shqipërisë kishte emigruar (King & Vullnetari 2003).

**Vala e tretë: Viti 1997:** "kriza piramidale" –Gjatë pranverës së vitit 1997, një sërë skemash të investimeve informale, të cilat kishin filluar në vitin 1993, të njohura si "skema piramidale", ramë dhe miliona shqiptarë humbën kursimet e tyre që kishin bërë gjatë gjithë jetës. Rrënia e skemave piramidale shkaktuan protesta, trazira, si dhe grabitje të arsenalit ushtarak, duke çuar në këtë mënyrë në shthurjen e rendit, si dhe në rrëniën e vendit në një gjendje anarkie. Kjo situatë krijoi një valë tjetër emigracioni, e cila arriti nivele dramatike (King 2003: 288).

**Pas vitit 1999 deri në vitin 2000:** kriza në Kosovë. Në vitin 1999, rreth gjysëm milion shqiptarë nga Kosova arritën në Shqipëri duke i shpëtuar spastrimit etnik të regjimit të Millosheviçit. Kriza e refugjatëve kosovarë destabilizoi ekonominë e brishtë shqiptare si dhe situatën demografike, veçanërisht në veri të Shqipërisë. Ndërsa shqiptarët e Kosovës shkuan drejt vendeve Europiane në kërkim të azilit politik, shumë qytetarë nga Shqipëria u paraqitën si shqiptarë nga Kosova (Vullnetari 2012: 68). Si rezultat i këtyre zhvillimeve, nënjë periudhe prej më shumë se njëdekade, Shqipëria, nga një vend pa emigracion ndërkombëtar, u kthye në një vend ku rreth 1.4 dhe 1.5 milionë e shqiptarëve ose rreth 33 për qind e popullsisë shqiptare jeton në emigracion.<sup>2</sup> Asnjë vend në botë nuk i afrohet këtij profili emigracioni të arritur në 20 vjet (King, Uruçi & Vullnetari 2011: 269). Si u përmend dhe më sipër, dy vendet kryesore me numrin më të madh të emigrantëve shqiptarë janë Greqia

dhe Italia. Sipas të dhënave, rreth 800 mijë shqiptarë janë në Greqi<sup>3</sup>, dhe rreth 482 mijë shqiptarë jetojnë në Itali.<sup>4</sup> Një grup tjetër shqiptarësh emigruan drejt vendeve të Europës perëndimore, si ato të Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Zvicrës, Francës, si dhe ShBA-së dhe Kanadasë. Numuri i shqiptarëve në këto vende është rreth 200 mijë<sup>5</sup>, megjithëse duhet thënë se kjo është një shifër e përafërt, sepse burimet për këto nuk janë shumë të sakta.

Këto nivele emigracioni vazhduan të ishin të larta deri në fund të dekadës, por më pas pësuan një rrënie. (Barjaba & King 2005: 19; Carletto et al. 2004: 18). Kjo situatë është rezultat i disa faktorëve, si përshembull: përmirësimi i ekonomisë shqiptare, kontrolle më të rrepta të emigracionit, veçanërisht në Greqi dhe Itali (Gedeshi and de Zwager 2012: 239), si dhe legalizimeve në vendet e destinacioneve (Vullnetari 2012). Përshembull, ndërsa në vitin 2000 rreth 50,000 shqiptarë emigruan në vitin 2004 vetëm 25,000 persona u larguan. (Azzarri and Carletto 2009: 409).

Duhet thënë se në fillim të viteve 1990, tendenca e emigracionit ishte emigrimi për punë, veçanërisht e djemve të rinj. Nga fundi i viteve 1990- të, pas programeve të legalizimit, bashkimi familjar ishte motivi kryesor i emigracionit (Gedeshi and Jorgoni 2012: 7-8). Përveç kësaj, një nga karakteristikat unike të emigracionit shqiptar është emigracioni i njerëzve të arsimuar: duke filluar me vitin 1990, rreth 50 për qind e lektorëve të universitetit, kërkuesve, dhe personave të kualifikuar kanë lënë vendin.<sup>6</sup>

### **Remitancat Financiare të Emigrantëve Shqiptarë**

Remitancat e emigrantëve kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në mbijetesën e shumë familjeve shqiptare. Remitancat ishin një nga forcat shtytëse të ekonomisë shqiptare që me rrëniën e regjimit autoritar. Sasia e remitancave të dërguara nga emigrantët ka variuar. Sipas studimeve remitancat e emigrantëve shqiptarë“ arritën pikun në vitin 2007 duke arritur shifrën prej 1,305 milionë USD (e barabartë me 952 milionë Euros), nga 150 million USD në 1992, e cila përfaqësonte rreth 12.5% të GDP (Gedeshi dhe Jorgoni 2012: 14) duke ju referuar Bank of Albania 2012: 14). Si për qindje e GDP-së, në vitin 2009, Shqipëria radhitej në 20 vendet në krye të vendeve që marrin remitancë nga emigrantët (World Bank and Facts 2011: p. 14).

Në një periudhë të mëvonshme këto remitancë rranë, kryesisht si rezultat i krizave ekonomike dhe financiare. Greqia dhe Italia, dy vendet kryesore të

3 Albanian Center of Studies for Emigration, Tirane, 2011.

4 Immigrazione, Dossier Statistico, Caritas Migrantes, 2011.

5 Albanian Center of Studies for Emigration, Tirane, 2011.

6 From Brain Drain to Brain Gain: Mobilizing Albania's Skilled Diaspora. UK, Tirana, April 2011.

destinacionit të emigrantëve shqiptarë ishin vendet që u goditën më shumë nga kriza ekonomike globale. Sipas Gedeshit dhe Jorgonit(2012) “remitancat arritën shifrën 915 million USD në 2010 (baraz me 690 milionë Euro). Si përqindje e GDP-së, kontributi i remitancaveka rënë nga 22% in 1993 në më pak se 9% in 2010(15-16).

### **Përdorimi i Remitancave të Emigrantëve**

Sasia e remitancave që dërgojnë emigrantët është e rëndësishme për vendet e origjinës. Megjithatë, përdorimi i remitancave është edhe më e rëndësishme për këto vende për vendet e origjinës. Studime të ndryshme cilësore dhe sasiore tregojnë se remitancat janë përdorur në mënyrë të ndryshme, si në nivelin mikro dhe në nivelin makro.

Në nivelin mikro, fillimisht remitancat janë përdorur nga marrësit e remitancave kryesisht për të përmbushur nevojat e perditshme, si përshebull për blerjen e ushqimeve, rrobave dhe artikuj të tjerë të ngjashëm me këta. Pasi marrësit e remitancave përmbushin këto nevoja, ata i përdorin të ardhurat për të blerë mobilje si dhe pajisje të ndryshme për shtëpinë. Së fundmi, remitancat përdoren për ti bërë shtesa një shtëpi ekzistuese apo për të ndërtuar një shtëpi të re (Gedeshi and de Zwager 2012). Përveç këtyre, një pjesë e remitancave përdoren për të organizuar ngjarje të rëndësishme familjare dhe shoqërore, si dasma, pagëzime, apo funerale (Gedeshi and de Zwager 2012; Vullnetari 2012). Gjithashtu, një pjesë e vogël mund të depozitohet në banka, apo të mbahen si kursime në lek në shtëpi (De Zwager et al., 2005; Vullnetari 2007).

Studimet tregojnë se investimi në ndërtim është një nga investimet më të zakonshme që bëjnë emigrantët. Këto studime tregojnë se remitancat kanë nxitur sektorin e ndërtimit i cili ka patur një zhvillim të vrullshëm pas viteve 1990, veçanërisht në korridorin Tiranë-Durrës. Duke cituar shifrat e Bankës Botërore (2007), Vullnetari (2012) shkruan se ndërtimi ka qënë një nga sektorët me ritme më të shpejta tërritjes tëekonomisë në vitet që pasuan rrënie e komunizmit. Në fakt, edhe në vitin 2004, ky sektor akoma i kontribuonte rreth 10 për qind të GDP-së së vendit. Megjithatë, duhet thënë se shifrat e investimeve totale në ndërtime mungojnë, duke qënë se shumica e ndërtimeve janëbërëjashtë ekonomisë formale të vendit, të ndërtuara pa leje në zonat peri-urbane, veçanërisht në zonën Tiranë-Durrës. Përveç kësaj, remitancat e investuara në ndërtim kanë krijuar mundësi punësimi për një numër të madh shqiptarësh, kryesisht për emigrantët që vijnë nga zonat rurale (Vullnetari 2012:222).

Vetëm një pjesë e vogël e remitancave janë përdorur në aktivitetet ekonomike, kryesisht mikro-ndërmarrje, brenda sektorit të shërbimeve (De Zwager, Gressmann, and Gedeshi 2010). Shumica dërmuese e këtyre investimeve

janë bërë në sektorin e shitjeve me pakicë dhe turizmit shtëpiak (Vullnetari 2012). Në shumicën e kohës këto lloj biznesesh janë replika të bizneseve në të cilat ata punonin kur ishin emigrantë (Mai and Paladini 2013; Lambrianidis and Hatziprokopiou 2005; Nicholson 2001).

Bizneset e vogla mbështeten shumë tek remitancat e huaja (EBRD 2006). Ato japin mundësi punësimi për familjet e emigrantëve, dhe në raste të tjera edhe për familjet jo emigrante. Megjithatë, një problem i vazhdueshëm është fakti që shumica e produkteve që shiten në dyqanet e shitjeve me pakicë, duke përfshirë këtu dhe ato të ndërtimit, nuk prodhohen në vend, por importohen nga jashtë. Pjesët e importuara, gjysëm të mbaruara janë gjithashtu pjesë e materialeve të përdorura në fabrikat e industrisë së lehtë. Shumica e tyre janë biznese nga vende si Italia dhe Greqia që janë në gjendje të përfitojnë nga kostot e ulëta në Shqipërinë pas-socialiste (Labrianidis et al. 2004 found in Vullnetari 2012: 222). Si rezultat i këtyre zhvillimeve, remitancat kanë përmirësuar kushtet e jetesës për shumë familje në Shqipëri, por kanë luajtur një rol të kufizuar në zhvillimin e vazhdueshëm apo në krijimin e vendeve tëpunës (Gedeshi and de Zwager 2012: 248).

Bujqësia, nga ana tjetër, është një sektor që nuk ka tërhequr remitancat e emigrantëve, megjithëse ky sektor është sektori më i rëndësishëm i punësimit në Shqipëri sepse jep rreth 60 përqind të punësimit të popullsisë aktive të gjithë vendit. Përveç kësaj, bujqësia siguron gjysmën e tëardhurave shtëpiake për familjet në zonat rurale, si dhe kontribuon 25 përqind të GDP-së të vendit (McCarthy et al. 2006: 4; World Bank 2007 cituar tek Vullnetari 2012: 222). Arsyeet për këtë janë të ndryshme: produktiviteti i ulët, bazuar kryesisht mbi punën e anëtarëve të familjes, pronësia e tokës, që është pjesërisht e trashëguar nga reformat komuniste të konfiskimit të tokës në 1946 dhe kolektivizimi që pasoi atë, dhe pjesërisht i krijuar gjatë procesit të privatizimit dhe të shpërndarjes në vitin 1992. Përveç kësaj, një tjetër problem është fakti se toka është e ndarë në ngastëra të vogla, që e bën të vështirë aplikimin e mekanizimit modern, dhe investimet në tokë. Si rezultat i kësaj, bujqësia nuk është parë si një sektor tërheqës për investime, të paktën në afat të mesëm apo afat të gjatë (Vullnetari 2012: 222). Në fakt, studimi nga Vullnetari (2012), në të cilin autorja intervistoi persona që jetonin në zonat rurale, si dhe ata që jetonin në zona urbane por që ishin me origjinë nga zonat rurale, tregoi se të intervistuarit ishin shumë pesimistë për të ardhmen e bujqësisë në Shqipëri. Ata thanë se bujqësia thjesht ju kishte dhënë mundësinë njerëzve të mbijetonin, dhe se ajo ishte më shumë një nevojë sesa një zgjedhje. Në fakt, emigracioni dhe remitancat ju kishin dhënë mundësinë e tyre për t'u larguar nga bujqësia dhe të emigronin drejt qyteteve (223).

## Politikat Qeveritare Mbi Remitancat

Duhet thënë që për një periudhë të gjatë kohe, qeveria shqiptare nuk ishte përfshirë fare në emigracionin e shqiptarëve. Ajo qëndroi larg jetës së emigrantëve. Shqiptarëve iu desh të mbështeteshin nëlidhjet e tyre shoqërore dhe të ishin në mëshirë të shteteve dhe politikave qeveritare të vendeve pritëse. Vetëm në vitin 2004, qeveria shqiptare mundi të miratojë një Strategji Kombëtare të emigracionit (Barjaba 2008; National Strategy of Migration 2006). Qëllimi i Strategjisë Kombëtare për Emigracionin 2005-2010 ishte që të sillte në të njëjtën linjë manaxhimin e emigracionit, zhvillimin e vendit me proceset e integritit në Komunitetin Europian.

Përveç kësaj, u formulua dhe një Plan Veprimi Kombëtar për Emigracionin. Ky plan konsistonte në 66 masa konkrete që qeveria shqiptare dhe partnerët e tjerë duhej të ndërmerrenin. Sipas Gëdeshit and Jorgonit (2012: 35), kjo ishte një politikë më holistike bazuar mbi manaxhimin e emigracionit përmes zhvillimit. Strategjia dhe Plan Veprimi ishte përpjekja e parë nga qeveria e Shqipërisë të vendoste një lidhje direkte midis manaxhimit të emigracionit dhe zhvillimit. Strategjia e vinte theksin mbi krijimin e një ambienti të tillë që emigrantët potencialë të qëndronin dhe të punonin në vend, ndërsa ata që ishin emigrantë jashtë vendit të ktheheshin dhe të investonin paratë e tyre në vend. Ky plan gjithashtu adresonte disa çështje të tilla si lufta kundër emigracionit ilegal, arsyet e emigracionit, arsyet e emigrantëve të kthyer, lidhjen midis emigracionit dhe zhvillimit, mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve jashtë vendit, remitancat dhe orientimin e tyre drejt zhvillimit të bizneseve, mobilizimin e komunitetit të shqiptarëve jashtë vendit, politikat e dhënies së vizave dhe shërbimet konsullore, si dhe çështjet e ikjes së trurit (Gëdeshi and Jorgoni 2012: 35). Megjithatë, një vlerësim i Strategjisë Kombëtare të Emigracionit dhe Planit Kombëtar të Veprimit tregon se zbatimi i tyre ishte mjaft i dobët. Përveç kësaj, zbatimi pati shumë problem me koordinimin e aktiviteteve (Onorato, Keta, and Totozani 2007).

Gjithashtu, kishte dhe një Plan Veprimi Kombëtar mbi remitancat që u aprovua nga qeveria në Nëntor të vitit 2007, si pjesë e Strategjisë Kombëtare të Emigracionit. Në fakt, sipas studiuesve (Nikas and King 2005), kjo ishte përpjekja e parë për të përdorur këtë burim financiar kaq të rëndësishëm. Megjithatë, të dyja dokumentet e strategjisë nuk adresonin dy faktorë kryesorë të lidhjes midis remitancave dhe zhvillimit; përmirësimi në nivelin makro e lidhur me 'dhënie fund të klikave politike dhe zgjerimit të besimit shoqëror mes popullsisë' si dhe infrastrukturën si rrugët, telekomunikimet, si dhe vendosjen e ligjit (Nikas & King 2005: 257). Përveç kësaj këto strategji nuk morrën në konsideratë gjininë si një kategori analitike, pavarësisht faktit që

edhe organizatat ndërkombëtare ishin të përfshira në këtë proces (Nixon 2006).

Në vijim të këtyre politikave, duhet përmendur dhe një strategji të quajtur Strategjia për Riintegrimin e Qyetetarëve Shqiptarëve të Kthyer 2010-2015 dhe Planin e Veprimit që u aprovua me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 461, në Qershor 9, 2010. Kjo ishte pjesëekuadrit strategjik kombëtar mbi emigracionin. Kjo strategji do të mbështeste një kthim të vazhdueshëm për emigrantët përmes procesit të riintegrimit, pavarësisht nga mënyra e kthimit. Megjithatë edhe kjo strategji u hartua brenda një kohe shumë të shkurtër dhe nuk pati konsultime me aktorët e shoqërisë civile, ekspertët të pavarur dhe palëve të interesuara. Si rezultat i kësaj, kjo strategji nuk kishte instrumentat e duhura për të adresuar manaxhimin e emigracionit dhe dinamikën e riintegrimit (Pavlov et al., 2014).

## REMITANCAT SOCIALE

Një numër i konsiderueshëm studimesh janë fokusuar mbi remitancat financiare, duke lënë jashtë fokusit të studimit remitancat sociale. Në fakt, studimet mbi remitancat ju japin privilegje remitancave financiare mbi ato sociale Megjithatë, ekonomia nuk është gjithshka, sepse emigrantët mbartin dhe transmetojnë ide, praktika sociale dhe narracione dhe këto mundësojnë mobilitetin dhe forma të ndryshme anëtaresimi në grupe shoqërore (Levitt and Lambda 2011: 4).

Remitancat sociale, sipas studiuesve të këtij fenomeni të veçantë përbëhen nga idetë, sjelljet, idenditetet dhe kapitali social që burojnë nga vendet pritëse dhe shkojnë drejt vendeve dërguese të emigrantëve (Levitt 1999: 927). Peggy Levitt (2011), në librin e saj "Fshatarët Transnacionalë", identifikoi rreth katër lloj remitancash sociale: idenditetet, normat, praktikat sociale dhe kapitalin social. Këto remitanca qarkullojnë midis komuniteteve të vendeve dërguese të emigrantëve dhe komuniteteve emigrante në vendet pritëse. Më specifikisht, autorja hodhi dritë mbi qarkullimin e këtyre remitancave midis Miraflores, një qytet në Republikën Domenikane, dhe Fusha e Xhamaikës, një lagje në Boston, ku shumë emigrantë nga Republika Domenikane janë vendosur. Këto lloj remitancash, sipas autores, qarkullojnë në disa mënyra: kur emigrantët kthehen për të jetuar apo vizitojnë vendet e origjinës, kur ata që nuk janë emigrantë vizitojnë të afërm, miq dhe shokët e tyre emigrantë në vendet pritëse; apo përmes internetit, videove, e-mail-eve, telefonave, letrave apo blogjeve. Nga ana tjetër, llojet e tjera të remitancave sociale, si përshebull, ato mbi gjininë, politikën, fenë, dallohen nga format e tjera, por në të njëjtën kohë ato përforcojnë dhe përforcohen nga forma të tjera të qarkullimit global kultural. Përshebull, kur njerëzit navigojnë internetin, apo shikojnë televizorin, ata

gjithashtu ekspozohen ndaj vlerave dhe sjelljeve të ndryshme (Levitt dhe Lamba-Nieves 2010).

Remitancat socialezakonisht ekzistojnë në dy forma: individuale dhe kolektive. Në formën individuale, individët i komunikojnë idetë dhe praktikat e tyre njëri tjetrin në rolet e tyre si anëtarë të familjes, miq, të afërm, dhe fqinjë. Përveç kësaj, individët i komunikojnëremitancat sociale në kapacitetin e tyre si anëtarë të shoqatave, partive politike apo anëtarë të një institucioni fetar (Levitt dhe Lamba-Nieves 2011: 5).

Remitancat sociale kanë efekte positive dhe negative në vendet e origjinës së emigrantëve. Sipas Levitt dhe Lamba-Nieves (2010), remitancat sociale kanë efekte positive në aspektet e ndryshme të jetës. Përshembull, një pjesë e madhe e studimeve tregojnë se remitancat sociale tronditin dinamikat e marrëdhënieve gjinore dhe ato mes brezave në mënyrë të tillë që sjellin përfitime për gratë. Emigrantët dhe emigrantet nga Amerika Latine apo Azia, të cilët punojnë së bashku dhe ndajnë përgjegjësitë për mirëmbajtjen e shtëpisë dhe kujdesin për fëmijët, kur kthehen në vendet e tyre të origjinës, apo komunitetet e tyre, flasin ndryshe për modele të marrëdhënieve gjinore kur ata vizitojnë vendet e tyre apo kur ata kthehen në komunitetet e tyre. Remitancat sociale gjithashtu kanë efekt mbi shëndetin. Njerëzit që kanë jetuar si emigrantë bëhen më të ndërgjegjshëm për shëndetin (Levitt dhe Lamba-Nieves 2010).

Gjithashtu, remitancat sociale mund të sfidojnë idetë e njerëzve mbi demokracinë dhe mbizotërimin e ligjit. Përshembull, emigrantët dërgojnë modele dhe ide mbi organizimin politik, procesin pjesëmarrës dhe demokratik (Skeldon 1997 cituar tek Vullnetari 2012: 52). Përveç këtyre, emigrantët që punojnë si sipërmarrës apo në profesione të statusit të lartë dërgojnë në vendet e origjinës jo vetëm teknologji dhe aftësi, por edhe ide se si të administrojnë bizneset.

Remitancat sociale kanë dhe efektet e tyre negative. Përshembull, sipas Levitt dhe Lamba-Nieves (2011), shumë individë dhe udhëheqës të komuniteteve janë të shqetësuar se emigrantët importojnë vlera që dobësojnë familjen, dhe adhurojnë konsumerizmin. Gjithashtu, remitancat sociale krijojnë një "kulturë emigracioni" e cila shtyn më shumë njerëz drejt emigracionit, të cilët nuk janë të kënaqur me mundësitë ekonomike dhe sociale në vendin e tyre, dhe marrin rrugën e emigracionit për të realizuar ëndërat e tyre. Gjithashtu, emigrantët, si dhe të tjerët shprehin shqetësimet e tyre mbi ata persona që deportohen të cilët kanë kryer krime në vendet pritëse dhe vazhdojnë të kenë problem dhe kur kthehen(34).

Studimi i remitancave sociale në emigracionin shqiptar është injoruar nga studiuesit. Deri tani nuk ka studim të kryer në këtë fushë të caktuar. Kjo përbën një hendek në literaturën e emigracionit shqiptar.

## PËRFUNDIME

Ky punim fokusohet mbi marëdhëniet midis emigracionit dhe remitançave. Më specifikisht, studimi fokusohet mbi këtë marëdhënie në kontekstin shqiptar. Për rreth katër dekada, emigracioni nga Shqipëria ishte i ndaluar nga qeveria komuniste që ishte në pushtet. Ashtu si në vendet e tjera të ish-blokut socialist të Europës Lindore, rrënia e këtij regjimi çoi në emigracionin masiv të njerëzve nga Shqipëria drejt vendeve të Europës Perëndimore, veçanërisht Greqi dhe Itali. Brenda një kohe prej dy dekadash, Shqipëria u transformua nga një vend ku pothuajse nuk kishte fare emigracion, në një vend ku rreth 33 përqind e popullsisë jeton jashtë shtetit.

Remitancat e emigrantëve kanë qënë një pjesë e rëndësishme e këtij emigracioni, si dhe një pjesë vitale e ekonomisë shqiptare prej gati dy dekadash. Ato kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në mbijetesën e shumë familjeve shqiptare, dhe ishin një nga forcat që i dhanë shtytje ekonomisë shqiptare që me rrënimin e regjimit autoritar. Si përqindje e GDP-së, në vitin 2007, Shqipëria ishte e radhitur në 20 vendet kryesore mes vendeve që marrin remitanca financiare në botë. Megjithatë, si rezultat i krizës globale ekonomike, këto remitanca kanë rrënuar.

Një numër i konsiderueshëm studimesh fokusohen mbi përdorimin e remitançave të emigrantëve shqiptarë. Ashtu si dhe për vende të tjera dërguese emigrantësh, përdorimi i remitançave nga shqiptarët është i fokusuar në disa sektorë: fillimisht remitancat përdoren nga marrësit e tyre për të përmbushur nevojat bazë të konsumit, dhe për të investuar në disa sektorë, kryesisht atë të ndërtimit e cila ka qënë sektori i ekonomisë që ka pasur ritmet më të shpejta të rritjes, megjithëse një përqindje e konsiderueshme e tij ka qënë në sferën e informalitetit. Sipërmarrjet e vogla dhe të mesme si fast food, shitjet me pakicë, restorantet, etj, kanë qënë një sektor tjetër i ekonomisë ku janë investuar remitancat. Bujqësia, megjithë rëndësinë që ka në Shqipëri, duke qënë që ka një seri problemesh, është lënë jashtë sferës së investimeve.

Për një kohë të konsiderueshme, qeveria shqiptare nuk ishte pjesë e emigracionit të shqiptarëve. Duke filluar me vitin 2004, me miratimin e një Strategjie Kombëtare të emigracioni, qeveria shqiptare ka miratuar një sërë strategjish dhe plane veprimi. Megjithatë implementimi i këtyre është karakterizuar nga probleme të ndryshme dhe nuk ka dhënë rezultatet e duhura. Në fakt, me të drejtë duhet thënë se qeveritë e një pasnjëshme shqiptare e kanë humbur mundësinë për të shfrytëzuar një pjesë të remitançave të emigrantëve për të çuar përpara zhvillimin ekonomik dhe human të vendit (Vullnetari 2012: 225).

Përveç remitançave financiare, një pjese tjetër e rëndësishme janë

remitancat sociale që dërgojnë emigrantët, që përfshijnë identitetet, normat, praktikat sociale dhe kapitalin social. Ndërsa shumë studime kanë ekzaminuar remitancat financiare, remitancat sociale janë një dimension shumë pak e studiuar në fushën e emigracionit në përgjithësi. Përsa i përket emigracionit shqiptar, studimet e remitancave sociale mungojnë dhe kjo përbën dhe një hendek në fushën e studimeve të emigracionit shqiptar. Është koha e duhur për të filluar studimet mbi këtë dimension të rëndësishëm të emigracionit.

## BIBLIOGRAFIA

- Azzarri, Carlo; Carletto, Calogero. 2009. *Modeling Migration Dynamics in Albania : A Hazard Function Approach*. World Bank. Policy Research Working Paper. <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/4138/WPS4945.pdf?sequence=1> (aksesuar 22 Korrik 2014)
- Barjaba, Kosta and Russell King. 2005. Introducing and theorizing Albanian Migration. In: Russell King, Nicola Mai and Stephanie Schwandner-Sievers (eds.) *The New Albanian Migration*. Brighton: GB, Portland, OR: Sussex Academic Press, pp. 1-28.
- Calogero Carletto, Benjamin Davis, Marco Stampini and Alberto Zezza. 2006. A Country on the Move: International Migration in Post-Communist Albania. *International Migration Review*, 40: 767-785.
- De Zwager, Nicolaas Wolfgang Gressmann and Ilir Gëdeshi. 2010. Market Analysis: Albania - Maximizing the Development-Impact of Migration-related Financial Flows and Investment to Albania, Vienna.
- De Zwager, Nicolaas, Ilir Gedeshi, Etleva Germenji and Christos Nikas. 2005. Competing for remittances. International Organization for Migration (IOM) Tirana. <http://www.iomtirana.org.al/Remittance/en/Competing%20for%20Remittances%20June%202005.pdf>
- European Bank for Reconstruction and Development. Transition report 2006.
- Gëdeshi, Iliri and Nicolaas de Zwager. 2012. "Effects of the Global Crisis on Migration and Remittances in Albania", in *Migration and Remittances during the Global Financial Crisis and Beyond*, ed. Ibrahim Sirkeci, Jeffrey H. Cohen and Dilip Ratha. Washington D.C.: The World Bank, 2012: 237-255.
- Gëdeshi, Ilir and Elira Jorgoni. 2012. Social Impact of Emigration and Rural-Urban Migration in Central and Eastern Europe. Albania. available at: [ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=8818&langId=en](http://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=8818&langId=en).
- Hein, Christopher. 1998. "Migration of Albanians to Italy." Pp. 221-234 in *Regulation of Migration: International Experiences*, edited by Anita Bocker, Kees Groenendijk, Tetty Havinga, and Paul Minderhoud. Amsterdam: Het

- Spinhuis Publishers.
- King, Russell and Nicola Mai. 2002. Of Myths and Mirrors: Interpretations of Albanian Migration. *Studi Emigrazionem* 39 (145): 161–199.
  - King, Russell, Esmeralda Uruçi, and Julie Vullnetari. 2011. Albanian migration and its effects in comparative perspective. *Balkan and Near Eastern Studies* 13(3): 269–86.
  - King, Russell and Julie Vullnetari. 2003. Migration and Development in Albania. Working Paper C5. Sussex Center for Migration Research. Retrieved from:
  - [http://www.migrationdrc.org/publications/working\\_papers/WP\\_C5.pdf](http://www.migrationdrc.org/publications/working_papers/WP_C5.pdf), Accessed in October 12, 2012.
  - Lambrianidis, Lois and Panos Hatziprokopiou. 2005. 'The Albanian Migration Cycle: Migrants Tend to Return to Their Country of Origin After All'. In: Russell King, Nicola Mai and Stephanie Schwander-Sievers (eds.) *The New Albanian Migration*. Brighton: Sussex Academic Press, 93–117.
  - Levitt, Peggy. 1999. 'Social Remittances: A Local-Level, Migration-Driven Form of Cultural Diffusion', *International Migration Review*, Vol. 32(124): 926–949.
  - Levitt, Peggy and Deepak Lamba-Nieves. 2011. "Social Remittances Revisited" *Journal of Ethnic and Migration Studies*. 37 (1): 1-22.
  - Levitt, Peggy and Deepak Lamba-Nieves. 2010. "'It's Not Just About the Economy, Stupid' - Social Remittances Revisited." Retrieved from Migration Policy Institute
  - <http://www.migrationpolicy.org/article/its-not-just-about-economy-stupid-social-remittances-revisited>
  - Levitt, Peggy. 2001. *The Transnational Villagers*. California: University of California Press:
  - Mai, Nicola and Cristiana Paladini. 2013. Flexible Circularities: Integration, Return and Socio-economic Instability within Albanian Migration to Italy. In: Triandafyllidou, Ana (ed.) *Circular Migration Between Europe and its Neighbourhood*. Oxford : Oxford University Press
  - McCarthy, N., Carletto, G., Davis, B., and Maltsoğlu, I. 2006. *Unlocking the Potential of Agriculture in Albania: The Role of Migration*. (unpublished manuscript).
  - Nicholson, Beryl 2001. "From migrant to micro-entrepreneur: do-it-yourself development in Albania." *South-East Europe Review*, 3: 39-41
  - Nikas, Christos and Russell King. 2005. "Economic growth through remittances: lessons from the Greek experience of the 1960s applicable to the Albanian case." *Journal of Southern Europe and the Balkans*, 7 (2): 235-58.
  - Onorato, Marta, Marine Keta dhe Igli Totozani. 2007. *Raport Mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin*. Tirana: Instituti Europian i Tiranës
  - Pavlov, Tanja, Jelena Predojević-Despić, Svetlana Milutinović Brikena Balli, Eldisa Zhebo. 2014. *Transnational Networks, Transnational Entrepreneurship And The Role Of The State: The Cases Of Serbia*

And Albania. Monograph. Group 484 and Institute Of Social Sciences, Belgrade: Serbia [http://www.rrpp-westernbalkans.net/en/News/News-Archive/2014/Research-Results--Transnational-Networks--Transnational-Entrepreneurship-and-the-Role-of-the-State--the-Cases-of-Serbia-and-Albania/mainColumnParagraphs/0/text\\_files/file/Transnational%20Networks%20Serbia%20Albania.pdf](http://www.rrpp-westernbalkans.net/en/News/News-Archive/2014/Research-Results--Transnational-Networks--Transnational-Entrepreneurship-and-the-Role-of-the-State--the-Cases-of-Serbia-and-Albania/mainColumnParagraphs/0/text_files/file/Transnational%20Networks%20Serbia%20Albania.pdf)

- Vullnetari, Juli.2007. Albanian Migration and Development: State of the Art Review. IMISCOE Working Paper No. 18. Amsterdam: Institute for Migration and Ethnic Studies. Retrieved from International Migration, Integration, and Social Cohesion.
- Vullnetari, Julie. 2012. Albania on the Move: Links between Internal and International Migration. Amsterdam: Amsterdam University Press.
- World Bank, Migration and Remittances. Factbook, 2011. 2nd ed. Washington DC.

# ROLI I POLITIKES SE BRENDSHME NE ERJEN E POLITIKES SE JASHTME: REFUZIMI I SHQIPERISE PER SHKATERRIMIN E ARMEVE KIMIKE TE SIRISE

**Mentor Beqa**

Universiteti European i Tiranës  
mentorbeqa@hotmail.com

## ABSTRACT

*This paper's aim is to analyze the ways how foreign policy of a country is formulated and conducted and the extent of the influence of the domestic politics, media and public opinion in defining foreign policy. The case study of this paper is the decision making process in the case of Albania's rejection of the proposal made by the US to accept the destruction of Syria's chemical weapons. This paper argues that there existed a discrepancy on the perception of national interest between the government and the general public and that the foreign policy formulation in an age of open societies is heavily influenced by the later. In this case it is demonstrated the primacy of domestic politics over the structural constraints in the process of foreign policy decision-making.*

**Keywords:** foreign policy, domestic policy, Albania

## HYRJJE

Refuzimi i Shqipërisë për t'u bërë pjesë e koalicionit ndërkombëtar për shkatërrimin e armëve kimike të Sirisë është vendimi më i rëndësishëm në politikën e jashtme të Shqipërisë që nxori në pah një diferencë të madhe ndërmjet qeverisë dhe opinionit publik. Shqipëria që prej mbarimit të Luftës së Ftohtë ka marrë një sërë vendimesh të rëndësishme me implikime në politikën e jashtme që kanë sjellë riorientimin tërësor të politikës së jashtme të vendit,

rikonfigurimin e aleancave dhe ripërcaktimin e objektivave dhe prioriteteve, ndërsa në politikën e brendshme sollën ndryshimin e sistemit socio-politik duke kaluar nga një organizim politik i modelit njëpartiak në një model politik demokratik dhe nga një model socio-ekonomik monist dhe i centralizuar në një model plural dhe me ekonomi tregu. Përgjatë dy dekadave të fundit ka pasur një konsensus të përgjithshëm politik dhe shoqëror për të gjitha këto ndryshime dhe për drejtimit themelore në politikën e jashtme dhe çështjet më të rëndësishme të politikës së brendshme me implikime në politikën e jashtme të vendit. Të dhënat tregojnë se ka pasur një mbështetje përgjithësisht të gjerë për procesin e integritit euro-atlantik, rreshtimin e Shqipërisë në koalicione lufte dhe paqeruajtëse të drejtuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Afganistan dhe Irak, deri tek aspekte dytësore të politikës së jashtme të Shqipërisë e cila është kujdesur të konsultohet në vijimësi me SHBA-në. Pavarësisht kostove diplomatike, Shqipëria duket se ka qenë e gatshme që për hir të aleancës me SHBA dhe partnerët e tjerë euroatlantikë, por edhe besimit në një rend të ri ndërkombëtar të bazuar mbi vlerat liberale, të bëjë zgjedhje politike që nuk kanë favorizuar marrëdhënien e saj me shumë vende të tjera. Thyerja e parë në këtë traditë 20-vjeçare të zhvillimit të politikës së jashtme erdhi me refuzimin e kërkesës së SHBA-ve për pjesëmarrje të Shqipërisë në procesin e shkatërrimit të armëve kimike të Sirisë. Pavarësisht këmbënguljes së SHBA-ve, aleati kryesorë i Shqipërisë në dy dekadat e fundit, dhe vullnetit politik të elitës politike drejtuese, Shqipëria nuk ishte në gjendje të angazhohej në këtë proces ndërkombëtar për shkak të rezistencës së organizuar të qytetarëve, të cilët nuk u pajtuan me këtë kërkesë dhe me vullnetin politik të qeverisë shqiptare për ta pranuar atë. Ky studim identifikon arsyet e kësaj zgjedhje politike dhe implikimet teorike në realizmin neoklasik.

### **Qëllimi dhe objektivat e studimit**

Qëllimi i studimit është i dyfishtë: Së pari synon shpjegimin e arsyeve se përse Shqipëria nuk arriti të bëjë pjesë e operacionit ndërkombëtar të shkatërrimit të armëve kimike të Sirisë. Së dyti, shqyrtimi dhe analizimi i implikimeve teorike për realizmin neoklasik duke përdorur gjetjet e këtij rasti studimor. Objektivi i studimit është kontributi në pasurimin e kornizës analitike të realizmit neoklasik në analizimin e politikës së jashtme, duke tërhequr prej gjetjeve empirike të rastit studimor.

### **Aspekte Metodologjike**

#### **Pyetja kërkimore**

Cilët janë variablat ndërhyrës më të rëndësishëm që përcaktuan refuzimin nga Shqipëria të kërkesës së SHBA-së për t'u bërë pjesë e operacionit

të shkatërrimit të armëve kimike të Sirisë?

### **Hipoteza**

Refuzimi nga ana e Shqipërisë i pjesëmarrjes në shkatërrimin e armëve kimike të Sirisë erdhi për shkak të shkallës së ulët të autonomisë së shtetit vis-a-vis me shoqërinë dhe mungesës së kapacitetit mobilizues të publikut rreth vendim-marrjes së saj nga ana e qeverisë shqiptare.

### **Metodologjia e Punimit**

Modeli epistemologjik do të jetë retroduksioni që kombinon deduksionin, pra zbritjen nga parimet e përgjithshme teorike tek pohimet specifike dhe induksionin, pra ngjijtjen nga gjetjet empirike drejt pohimit të parimeve të përgjithshme teorike. Aspekti empirik i kërkimit fokusohet në analizimin e deklaratave dhe sjelljes së aktorëve kryesorë të përfshirë në këtë çështje. Informacionet janë marrë nga media dhe burimet zyrtare të institucioneve përkatëse. Aspekti teorik është një përpjekje për të plotësuar kornizën analitike të Realizmit Neoklasik nëpërmjet shqyrtimit të gjetjeve empirike dhe përpjekjes për t'i përgjithësuar ato në nivel teorik. Për të realizuar këtë merrren në shqyrtim pohimet teorike të realizmit neoklasik dhe pohime që vijnë nga tradita të tjera teorike që mund të jenë përplotësuese për kornizën analitike të realizmit neoklasik.

## **Analiza**

### **Sfondi Historik**

Egjipti, Izraeli dhe Siria dyshoheshin prej kohësh për fshehjen e stoqeve me armë kimike. Mospranimi nga ana e tyre për t'ju bashkuar Konventës për Armët Kimike (CWC) vjen për shkak të lidhjes së politikës në Lindjen e Mesme me besimin se armët kimike mund të shërbejnë si frenues për arsenalin bërthamor të Izraelit.<sup>7</sup> Dhuna e luftës civile që përfshiu Sirinë që prej vitit 2011-të solli në vëmendje përdorimin e mundshëm të armëve kimike prej qeverisë Siriane ose prej forcave rebele që do të mund të merrnin zonat ushtarake. Informacione për sulme në Siri që mund të përfshinin edhe përdorimin e armëve kimike filluan të dalin në dhjetor të vitit 2012 dhe vijuan përgjatë verës së vitit 2013. Raporti përfundimtar i konferencës për monitorimin e CWC në prill të vitit 2013 shprehu shqetësimin e thellë se armët kimike mund të jenë përdorur në Republikën Arabe të Sirisë dhe nënvizoi se përdorimi i armëve kimike nga cilido dhe në çfarëdo rrethanash do të ishte i dënueshëm dhe krejtësisht në kundërshtim me normat ligjore e standardet e komunitetit ndërkombëtar.<sup>8</sup>

7 Paul F. Walker, "Syrian Chemical Weapons Destruction: Taking Stock and Looking Ahead". [http://www.armscontrol.org/ACT/2014\\_12/Features/Syrian-Chemical-Weapons-Destruction-Taking-Stock-And-Looking-Ahead](http://www.armscontrol.org/ACT/2014_12/Features/Syrian-Chemical-Weapons-Destruction-Taking-Stock-And-Looking-Ahead)

8 OPCW Conference of the States Parties, "Report of the Third Special Session of the

Gjithsesi, çështja e përdorimit të armëve kimike nuk e tërhoqi vëmendjen e opinionit ndërkombëtar deri më 21 Gusht 2013, kur një sulm masiv me agjentin nervor sarinë u zhvillua gjatë natës në Ghouta në lindje të Damaskut, zonë kjo e mbajtur nga rebelët. Raportet fillestare nga forcat rebele flisnin për 1400 të vrarë përfshi disa qindra fëmijë të mbuluar nga re të një avulli të verdhë. Fotot e viktimave tregonin shkumë në gojë të tyre dhe asfiksi, por nuk kishte plumba të dukshëm apo plagë bombash që shkaktohen nga sulmet ajrore apo ato me artileri.<sup>9</sup> OKB me kërkesë të qeverisë siriane mbledhi një ekip ekspertësh dhe i dërgoi në Damask për të hetuar lidhur me akuzat e përdorimit të armëve kimike. Raporti konfirmoi më 13 shtator se “armët kimike ishin përdorur në konfliktin ndërmjet palëve në Republikën Arabe të Sirisë, edhe ndaj civilëve përfshirë këtu fëmijët në një masë të madhe”.<sup>10</sup> Siria depozitoi një ditë më pas instrumentin e hyrjes në Konventën e Armëve Kimike. Përgjithësisht si rezultat i ndërhyrjes politike të Rusisë, kjo lëvizje politike pasoi kërcënimin e SHBA-ve për ndërhyrje ushtarake kundër programit të armëve kimike të Sirisë. Ndërkohë SHBA dhe Rusia njoftuan një marrëveshje kornizë për eliminimin e arsenalit të armëve kimike të Sirisë.<sup>11</sup> Këtu fillon kërkimi i vendeve të përshtatshme për shkatërrimin e armëve kimike të Sirisë, pasi ishte marrë vendimi që ato për arsye sigurie të mos eliminoreshin në Siri. Asnjë vend nuk iu përgjigj pozitivisht kësaj kërkesë. Shumica e tyre morën si shkas kërkesat mjedisore dhe normat e brendshme rregullatore që i ndalonin të arrinin afatin kohor të përcaktuar nga Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike dhe marrëveshja kornizë. Veçse Finlanda, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar deklaruan vullnetin e tyre për të pranuar sasi të kufizuara të prekursorëve kimikë. Shqipëria ishte propozuar si një vend i mundshëm për pranimin e tyre sepse në vitet 2006-2007 kishte shkatërruar 15 tonë metrik agjentë mustard të deklaruar.<sup>12</sup> Nuk ka informacion të saktë se kur i është bërë Shqipërisë propozimi për t’u përfshirë në këtë projekt madhor që përfshinte fuqitë më të mëdha të botës në zgjidhjen e një konflikti civil që po merrte mijëra jetë njerëzore. Mendohet se propozimi

---

Conference of the States Parties to Review the Operation of the Chemical Weapons Convention,” RC-3/3, April 19, 2013.

- 9 Paul F. Walker, “Syrian Chemical Weapons Destruction: Taking Stock and Looking Ahead”
- 10 United Nations Mission to Investigate Allegations of the Use of Chemical Weapons in the Syrian Arab Republic. Report on the Alleged Use of Chemical Weapons in the Ghouta Area of Damascus on 21 August 2013. [http://www.un.org/disarmament/content/slideshow/Secretary\\_General\\_Report\\_of\\_CW\\_Investigation.pdf](http://www.un.org/disarmament/content/slideshow/Secretary_General_Report_of_CW_Investigation.pdf)
- 11 Joint National Paper by the Russian Federation and the United States of America. [https://www.opcw.org/index.php?eID=dam\\_frontend\\_push&docID=16707](https://www.opcw.org/index.php?eID=dam_frontend_push&docID=16707)
- 12 Paul F. Walker, “Syrian Chemical Weapons Destruction: Taking Stock and Looking Ahead”

fillestar i është bërë kryeministrit të Shqipërisë gjatë takimeve të tij në Nju Jork me Sekretarin Amerikan të Shtetit z. John Kerry dhe Ministrin e Jashtëm të Federatës Ruse, z. Sergei Lavrov gjatë punimeve të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara në shtator të vitit 2013. Gjithsesi, deri në fund të tetorit të vitit 2013 nuk kishte ende ndonjë informacion të saktë për përfshirjen e Shqipërisë në këtë proces, kohë kur media ndërkombëtare filloi të përmendte Shqipërinë si destinacionin për arsenalin e armëve kimike të Sirisë.<sup>13</sup> Kjo ide mori trajtë zyrtare kur vetë ministri i jashtëm i Shqipërisë z. Ditmir Bushati konfirmoi për gazetën *Le Monde* më 5 Nëntor 2013 se kishte një kërkesë nga SHBA-të për përfshirjen e Shqipërisë në këtë operacion.<sup>14</sup> Ndërkohë në Shqipëri, media kishte filluar ta trajtonte problemin me përparësi ndërsa shoqëria civile të organizonte lëvizjen për ta kundërshtuar një vendim të mundshëm të qeverisë shqiptare për të pranuar stoqet e armëve kimike siriane brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ekspertë të mirënjohur ndërkombëtarë pohuan me bindje se një marrëveshje me qeverinë e Republikës së Shqipërisë për pranimin e tyre ishte arritur.<sup>15</sup> Reagimi në Shqipëri ishte shpërthyes. Mijëra qytetarë filluan të grumbullohen në sheshet e Tiranës, ndërsa media sociale, kryesisht Facebook, ishte shndërruar në një platformë të shkëmbimit të informacionit dhe lidhjes së të rinjve në këtë angazhim qytetarë.<sup>16</sup> Frika dhe paniku u përhap me shpejtësi ndërsa qytetarët i perceptonin armët kimike si rrezikun më të madh ndaj sigurisë së tyre dhe të vendit në tërësi. Qeveria dukej e pamundur për të organizuar një kundërfushatë për të shpjeguar avantazhet e Shqipërisë nëse do t'i bashkohej këtij operacioni ndërkombëtar dhe përpjekjet e saj në këtë drejtim ishin pothuajse të papërfillshme. Afati që Shqipëria të dilte me një vendim përfundimtar po afronte, por dukej gjithnjë e më e qartë se qeverisë nuk i kishte mbetur më asnjë zgjedhje përpos se të refuzonte pranimin e tyre. Negociatat në këto kushte u ngritën në nivelet më të larta. Sekretari Amerikan i Shtetit i telefonoi Kryeministrit Edi Rama në një përpjekje të fundit për të bindur

13 “Syrian Chemical Weapons Seen Likely to Ship to Albania for Destruction” <http://www.nti.org/gsn/article/syrian-chemical-weapons-seen-likely-ship-albania-destruction/>

14 “Washington presse l’Albanie d’accueillir pour destruction l’arsenal chimique syrien.” [http://www.lemonde.fr/europe/article/2013/11/04/les-etats-unis-sollicitent-l-albanie-pour-la-destruction-de-l-arsenal-nucleaire-syrien\\_3507912\\_3214.html?xtmc=ditmir\\_bushati&xtr=1](http://www.lemonde.fr/europe/article/2013/11/04/les-etats-unis-sollicitent-l-albanie-pour-la-destruction-de-l-arsenal-nucleaire-syrien_3507912_3214.html?xtmc=ditmir_bushati&xtr=1)

15 “Paul Walker, në Al Jazera: Armët Kimike Siriane në Shqipëri. Vendimi Publikohet të Premten.” <http://www.panorama.com.al/pol-walker-interviste-ne-al-jazera-armet-kimike-siriane-do-asgiesohen-ne-shqiperi-vendimi-eshte-marre-publikohet-te-premten/>

16 “Protesta për lëndët kimike dhe revolucionin e mediave sociale.” <http://al.ejo-online.eu/1665/mediat-e-reja-dhe-web-2-0/protesta-per-lendet-kimike-dhe-revolucioni-i-mediave-sociale>

Shqipërinë të bëhej pjesë e operacionit<sup>17</sup>, ndërkohë që pak më parë Presidenti i SHBA-ve Barack Obama i kishte dërguar një letër kryeministrit të Shqipërisë ku e ftonte për një vizitë të kushtëzuar në Washington nëse operacioni do të finalizohet.<sup>18</sup> Protestat në Tiranë ishin masive dhe të rinjtë kishin vendosur të mos largoheshin nga sheshi deri në momentin që Kryeministri të bënte me dije një vendim në përputhje me kërkesat e tyre. Opozita kishte dalë me një vendim të qartë kundër pranimit të armëve kimike në territorin e Shqipërisë duke u fokusuar kryesisht tek mungesa e transparencës në menaxhimin e kësaj çështje nga qeveria shqiptare. Zëra brenda shumicës qeverisëse kishin filluar të flisnin kundër, ndërkohë që aleati kryesor në qeverisje i Partisë Socialiste, Kryetari i Kuvendit Ilir Meta kishte siguruar protestuesit që kjo nuk do të ndodhte. Në një përpjekje të fundit për të bindur publikun, ndër më dashamirësit e SHBA-ve ndër vite por që ky operacion kishte filluar të krijonte ndjenja të përziera, ambasadori i SHBA-ve në Tiranë në një intervistë televizive një ditë përpara vendimit foli edhe për detyrimet që Shqipëria kishte ndaj këtij partneriteti dhe implikimet diplomatike që do të sillte refuzimi i mundshëm.<sup>19</sup> Në kushtet e krijuara, fjalimi i shumëpritur i Kryeministrit Edi Rama ishte i parashikueshëm. Ai refuzoi përfshirjen e Shqipërisë në një operacion ndërkombëtar që ishte përtej mundësive dhe kapaciteteve të saj.<sup>20</sup> Ky vendim u prit me ovacione nga të rinjtë protestues përpara pallatit të Kryeministrit, të cilët u shpërndanë qetësisht pas një jave të ngjeshur me protesta. Pas mbylljes së këtij kapitulli një tjetër shqetësim kishte mbërthyer elitën politike të vendit: cili do të ishte tashmë raporti Shqipëri-SHBA? Departamenti Amerikan i Shtetit nxitoi për t'u deklaruar se e respektonte vendimin e Shqipërisë dhe se kjo nuk do t'i ndryshonte marrëdhëniet ndërmjet vendeve,<sup>21</sup> gjithsesi raporti dukej e vështirë të ishte si më parë.

17 “Armët e Sirisë, bisedë Rama-Kerry”.

<http://www.zeriamerikes.com/content/siri-rama-kerry-bushati-arme-kimike/1786560.html>

18 “Lëndët kimike, Rama: Po, mora letër nga Obama, por nuk e bëra publike” <http://www.gazetadita.al/arsenali-kimik-sirian-rama-po-mora-leter-nga-obama/>

19 “Arvizu: Do të na zhgënjente “Jo”-ja”.

<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=267590>

20 “Rama: Shqipëria, të pamundur operacionin e armëve”. <http://shqiptarja.com/home/1/rama-shqip-ria-t-pamundur-operacionin-e-arm-ve-kimike-187164.html>

21 “DASH: Vendimi nuk ndikon marrëdhëniet me SHBA”. <http://www.panorama.com.al/ambasada-e-shba-respektojme-vendimin-e-rames-do-te-vazhdojne-te-mbeshtesim-qeverine/>

### Analiza Teorike

Graham Allison<sup>22</sup> shkruan se “çdo lëvizje horizontale në fushë ndaj një kundërshtari ndërkombëtar lëvizë njëkohësisht një pjesë në fushën vertikale të politikës së brendshme. Ndërsa gabimet në fushën e shahut ndërkombëtar mund të kenë pasoja të mëdha për botën, gabimet në fushën e shahut të brendshëm mund ta heqin liderin në fjalë krejtësisht nga të dyja lojëjt.”<sup>23</sup> Ajo që Allison nënkupton është një lidhje e pandërprerë ndërmjet politikës së brendshme dhe politikës së jashtme të një shteti. Por vërtetimi i kësaj marrëdhënie nuk mund të merret *a priori* në nivel empirik, ndërsa sjell komplikime të mëdha në nivel teorik. Kenneth N. Waltz, autori i veprës së shquar *Teori e Politikës Ndërkombëtare* (1979) thotë se pa ndërtuar autonominë e politikës ndërkombëtare, një teori e politikës ndërkombëtare është e pamundur. “Duke përkufizuar strukturën e sistemeve politike ndërkombëtare, neorealizmi krijon autonominë e politikës ndërkombëtare dhe që kështu bën të mundur një teori mbi të”.<sup>24</sup> Por teksa nëpërmjet autonomisë bëhet e mundur një teori për politikën ndërkombëtare, kjo nuk do të ndihmonte shumë për ndërtimin e një teorie të politikës së jashtme. Waltz pohon se një teori e politikës ndërkombëtare nuk është një teori e politikës së jashtme. “... Një teori neorealiste e politikës ndërkombëtare shpjegon se si forca të jashtme modelojnë sjelljen e shteteve, por nuk thotë asgjë për ndikimin e forcave të brendshme... një teori e politikës ndërkombëtare nuk është e mjaftueshme dhe nuk mund të bëhet e mjaftueshme për bërjen e parashikimeve të qarta për politikën e jashtme.”<sup>25</sup> Shkolla neorealiste merret me trajtimin e rezultateve në politikën ndërkombëtare dhe jo me zgjedhjet specifike politike të aktorëve. Diferenca ndërmjet rezultatit në politikën ndërkombëtare, e cila është rezultat i ndërveprimit të tërësisë së aktorëve, dhe politikës së jashtme të një shteti specifik qëndron në pamundësinë e një shteti që vepron individualisht për të ndryshuar strukturën e politikës ndërkombëtare, përpos rasteve kur kemi të bëjmë me një rend unipolar ku vullneti i hegjemonit mund të përkthehet në aftësi materiale për ta ndryshuar strukturën. Ndërkohë që zgjedhjet në politikën e jashtme të një vendi mund të

22 Graham Allison është autori i veprës së mirënjohur “*Essence of Decision: Explaining the Cuban Missile Crisis*,” (1971), e cila me tre modelet e propozuara përbën një ndër kontributet më të rëndësishme teorike për Analizën e Politikës së Jashtme.

23 “The Cuban Missile Crisis Revisited.” *Foreign Affairs*. 8 Mar. 2015. Web. 8 Mar. 2015. <http://www.foreignaffairs.com/articles/138175/james-a-nathan-and-graham-allison/the-cuban-missile-crisis-revisited>>

24 Kenneth N. Waltz, “*The Origins of War in Neorealist Theory*”, *Journal of Interdisciplinary History*, Volume 18, Issue 4, *The Origins and Prevention of Major Wars*, (Spring, 1988) 615-628, fq. 616.

25 Kenneth N. Waltz, “*International Politics is not Foreign Policy*”, *SECURITY STUDIES* 6, no. 1 (autumn 1996): 54-57, fq. 57.

ndikohen nga shumë forca të brendshme, rezultati në politikën ndërkombëtare është i kushtëzuar nga forca strukturore. Waltz parashtroi disa koncepte themelore që do të shpjegojnë dhe parashikojnë sjelljen e një shteti në kushtet e mbijetesës së tij, por gama e zgjedhjeve në politikën e jashtme të një vendi nuk kufizohet vetëm këtu, ajo është shumë më e gjerë dhe *Teori e Politikës Ndërkombëtare* nuk mund të ndihmojë për shpjegimin e tyre. Shmangja nga analiza e forcave të brendshme nuk e dobëson teorinë e politikës ndërkombëtare të Waltz-it, ndryshe nga çfarë konstatojnë shumë studiues përfshi edhe realistët neoklasikë, sepse objekti i saj studimor nuk është politika e jashtme. “Teoritë e sistemeve shpjegojnë se përse njësi të ndryshme sillen në mënyrë të njëjtë ... struktura politike prodhon njëtrajtshmëri në proces dhe performancë për aq sa struktura të zgjasë”.<sup>26</sup> “Strukturat nuk na thonë asnjëherë atë që duam të dimë. Por na tregojnë një numër të vogël gjërash të mëdha dhe të rëndësishme. Ato e fokusojnë vëmendjen tonë tek ato përbërës dhe forca që zakonisht zgjasin për një periudhë të gjatë”.<sup>27</sup> Kritikët e neorealizmit e akuzojnë Waltz-in për primitivizmin e aktorit shtet duke e marrë të mirëqenë si një aktor unitar dhe racional e që kështu duke e shndërruar në një kuti të zezë.<sup>28</sup> Përkundër qasjes strukturore tradita Analizës së Politikës së Jashtme i identifikon shkaqet e sjelljes së shtetit në politikën e jashtme tek forca të brendshme. Në përmbledhje të një gjysmë shekulli analizë të politikës së jashtme mund të thuhet se dy tradita kanë luajtur një rol vendimtar dhe vijojnë të bëjnë të njëjtën gjë. E para është më e vështirë për tu përmbledhur sepse përmban një gamë të gjerë qasjesh të ndryshme dhe të shpërndara që përfshijn shqyrtimin e faktorëve psikologjikë dhe konjitivë, politikën burokratike dhe neoinstitucionale, sjelljen në kriza, implementimin e politikave, proceset e vendim-marrjes në grup dhe marrëdhëniet transkombëtare. Vetëm për shkak të mungesës së ndonjë termi më të përshtatshëm mund t’i referohemi kësaj tradite në terma të parësisë që u jepet rolit të faktorëve të brendshëm - *Innenpolitik* - në shpjegimin e politikës së jashtme.<sup>29</sup> “Ka shumë variante të kësaj qasje, ku secili favorizon një variabël të ndryshëm të pavarur të brendshëm - por të gjitha ndajnë një pandehmë të përbashkët - që politika e jashtme kuptohet më mirë si produkt i dinamikave të brendshme të vendit. Për të kuptuar se përse një vend po sillet në një formë

26 Keneth N. Waltz, “*Theory of International Politics*”, (1979) fq.72, 87.

27 Keneth N. Waltz, “*Reflections on Theory of International Politics: A Response to My Critics*” in Robert O. Keohane “*Neorealism And Its Critics*”, (Columbia University Press, 1986) fq. 329

28 Shih Robert O. Keohane dhe John Ruggie tek Robert O. Keohane “*Neorealism And Its Critics*”, (Columbia University Press, 1986).

29 “*Handbook of International Relations*”, ed. Walter Carlsnaes, Thomas Risse-Kappen, Beth A Simmons. (SAGE Publication, 2002) fq. 334.

të caktuar, duhet të futesh brenda kutisë së zezë për të shqyrtuar preferencat dhe konfigurimin e aktorëve kryesorë të brendshëm”.<sup>30</sup> Me fjalë të tjera, nëse qasjet sistemike neglizhojnë forcat që gjenden në politikën e brendshme dhe e shndërrojnë shtetin në *kuti të zezë*, po ashtu qasjet që i gjejnë faktorët vendimtarë në politikën e brendshme, neglizhojnë forcat strukturore duke e shndërruar shtetin po në *kuti të zezë* por në të anasjellën, atë të izolimit të tij nga ndikimi i forcave sistemike. Për të rikuperuar këtë handikap teorik, realizmi neoklasik<sup>31</sup> kombinon analizën në nivel strukturor dhe në nivel aktori duke konsideruar parësinë e forcave strukturore dhe shqyrtuar ndikimin e forcave që gjenden në nivelin e shtetit si variabla ndërhyrës. Pra, lëvruesit e realizmit neoklasik marrin nga saktësia teorike e neorealizmit të Keneth Waltz, Robert Gilpin dhe të tjerëve pa sakrifikuar shqyrtimet praktike mbi politikën e jashtme dhe kompleksitetin e fuqisë shtetërore që gjendet në realizmin klasik të Hans J. Morgenthau, Henry Kissinger, Arnold Wolfers dhe të tjerëve.<sup>32</sup> Për realizmin neoklasik variabëli i pavarur është struktura ndërkombëtare; variablat ndërhyrës janë një sërë faktorësh brenda shtetit si institucionet, marrëdhënia shtet-shoqëri, perceptimi publik, ideologjia, etj; ndërsa variabëli i varur është politika e jashtme.<sup>33</sup> Realizmi neoklasik vijon prej neorealizmit në pohimin e parësisë së strukturës dhe qëndrimit brenda parimeve të politikës së fuqisë, por ndryshon në një sërë elementesh të tjerë të rëndësishëm. “Në vend që të supozojnë se shtetet kërkojnë siguri, realistët neoklasik pandehin se shtetet i përgjigjen paqartësive të anarkisë ndërkombëtare duke kërkuar të kontrollojnë dhe modelojnë mjedisin e tyre të jashtëm... për të kuptuar se si shtetet i përgjigjen mjedisit të jashtëm duhet shqyrtuar se si trysnitë ndërkombëtare përkthehen nëpërmjet variablave ndërhyrëse të nivelit të njësisë si perceptimet e vendim-marrësve dhe struktura e brendshme e shtetit”.<sup>34</sup> Keneth Waltz e kishte përshkruar vetë më parë pamundësinë e shpjegimit të politikës së jashtme pa një shqyrtim integral të forcave në të tre nivelet e analizës. “Imazhi i tretë përshkruan kornizën e politikës botërore, por pa imazhin e parë dhe të dytë nuk mund të ketë njohje të forcave që përcaktojnë politikën; imazhi i parë

30 Gideon Rose, “Neoclassical Realism and Theories of Foreign Policy”, World Politics, Vol. 51, No. 1 (Oct., 1998), pp. 144-172, fq 148.

31 Termi realizmi neoklasik është formuluar nga Gideon Rose në artikullin “Neoclassical Realism and Theories of Foreign Policy”.

32 Steven E Lobell; Norrin M. Ripsman; Jeffrey W. Taliaferro, eds., “Neoclassical Realism, the State, and Foreign Policy” (Cambridge University Press, 2009), fq. 4.

33 Sten Rynning. Review of Lobell, Steven E.; Ripsman, Norrin M.; Taliaferro, Jeffrey W., eds., Neoclassical Realism, the State, and Foreign Policy. H-Diplo, H-Net Reviews. July, 2009. [www.h-net.org/reviews/showrev.php?id=24339](http://www.h-net.org/reviews/showrev.php?id=24339)

34 Gideon Rose, “Neoclassical Realism and Theories of Foreign Policy”, World Politics, Vol. 51, No. 1 (Oct., 1998), pp. 144-172, fq 152.

dhe i dytë përshkruajnë forcat në politikën botërore, por pa imazhin e tretë është e pamundur të vlerësohë rëndësinë e tyre apo të parashikosh rezultatin e tyre.”<sup>35</sup> Por teksa pohonte këtë, Waltz ishte i vetëdijshëm se një teori e madhe që do të përfshinte në një kornizë të tre imazhet ishte e pamundur. “Për fat të keq as nuk ka sugjeruar dikush se si një teori e tillë e madhe mund të ndërtohet, për të mos folur që ta ketë zhvilluar... Studiuesit e politikës ndërkombëtare do të bënin mirë të përqendrohen dhe të përdorin teori të ndara të politikës së brendshme dhe politikës ndërkombëtare derisa dikush të gjejë një mënyrë për t’i bashkuar.”<sup>36</sup> Rose është kontradiktore teksa pretendon se “një teori e realizmit neoklasik ... lidh qartë në një zinxhir shkakësor variablat e veçantë të pavarur, ndërhyrës dhe të varur”<sup>37</sup>, pasi më parë shkruante se “...analistët e politikës së jashtme nuk kanë alternativë tjetër veçse të shqyrtojnë në detaje se si politikëbërësit e çdo vendi e kuptojnë në fakt situatën e tyre”.<sup>38</sup> Pra për hir të fuqisë shpjeguese të politikës së jashtme të vendeve specifike, sakrifikohet aftësia përgjithësuese e teorisë. Në analizë të fundit, realizmi neoklasik është një agjendë kërkimore elastike e orientuar drejt shpjegimit të politikës së jashtme të vendeve specifike dhe si e tillë përbën një zhvillim progresiv si program kërkimor, në termat e Lakatos-it. Ai kërkon të shpjegojë përse, si dhe në çfarë kushtesh karakteristikat e brendshme të shteteve – kapacitetet ekstraktive dhe mobilizuese të institucioneve politike-ushtarake, ndikimi i aktorëve të brendshëm shoqëror dhe grupeve të interesit, shkalla e autonomisë së shtetit nga shoqëria dhe niveli i kohezionit shoqëror ose të elitës – ndërhyjnë ndërmjet vlerësimit të udhëheqësve për rreziqet ndërkombëtare dhe mundësi të politikave diplomatike, ushtarake e ekonomike që ndjekin këta udhëheqës. “Realizmi neoklasik parashtron një “rrip transmetimi” të papërsosur ndërmjet stimujve e kufizimeve sistemike në një anë dhe politikave të jashtme ekonomike, ushtarake dhe diplomatike që zgjedhin shtetet, në anën tjetër. Në afatgjatë, rezultatet e politikës ndërkombëtare përgjithësisht pasqyrojnë në fakt shpërndarjen e fuqisë ndërmjet shteteve. Gjithsesi në afatshkurtër politikën që ndjekin shtetet janë rrallë objektivistisht eficiente ose të parashikueshme bazuar në analiza plotësisht sistemike”.<sup>39</sup> Si përmbledhje, realizmi neoklasik ruan

35 Kenneth N. Waltz, “*Man, the State and War*” (New York: Columbia University Press, 1959), fq. 238.

36 Kenneth N. Waltz, “*International Politics is not Foreign Policy*”, SECURITY STUDIES 6, no. 1 (autumn 1996): 54-57, fq. 57

37 Gideon Rose, “*Neoclassical Realism and Theories of Foreign Policy*”, World Politics, Vol. 51, No. 1 (Oct., 1998), pp. 144-172, fq. 167.

38 Gideon Rose, “*Neoclassical Realism and Theories of Foreign Policy*”, World Politics, Vol. 51, No. 1 (Oct., 1998), pp. 144-172, fq. 152.

39 Steven E. Lobell; Norrin M. Ripsman; Jeffrey W. Taliaferro, eds., “*Neoclassical Realism, the State, and Foreign Policy*” (Cambridge University Press, 2009), fq. 4

parime të rëndësishme të realizimit strukturor si pozita që zë një shtet i caktuar në sistemin ndërkombëtar dhe mjedisi ndërkombëtar që e rrethon atë duke e konsideruar këtë si variabël të pavarur, ndërkohë që propozon qasje më elastike që në bazë të rasteve studimore të nënvizohet parësia rast pas rasti e variablave ndërhyrës që përmendëm më sipër.

### **Shpjegimi i rastit studimor**

Siç e shqyrtuam më sipër, mjedisi ndërkombëtar në të cilin Shqipëria zgjodhi të refuzojë kërkesën për përdorimin e territorit të saj si stacion për shkatërrimin e arsenalit të armëve kimike të Sirisë është variabëli i pavarur, në kuptimin që ai mjedisi nuk mund të influencohej nga vendimi i Shqipërisë, por edhe në kuptimin e kufizimit të vendim-marrjes së Shqipërisë. Fakti që kërkesa kishte ardhur nga SHBA-të, aktori më i rëndësishëm i sistemit ndërkombëtar dhe aleati strategjik më i rëndësishëm i Shqipërisë dhe pavarësisht këmbënguljes së këtij vendi për ta ndikuar Shqipërinë ta pranonte këtë propozim, rezultati ishte refuzimit i kërkesës nga ana e qeverisë shqiptare, të bën të mendosh se forcat që gjenden në nivel strukturor nuk janë një faktor vendimtar në zgjedhjen politike të Shqipërisë. Ky do të ishte një shqyrtim i përciptë i atyre që quajmë forca strukturore dhe mënyrës se si ato veprojnë mbi një shtet. Kërkesa e SHBA-së e marrë veçmas nuk përbën mjedisin ndërkombëtar në të cilin Shqipëria do të merrte një vendim me implikime në politikën e jashtme të saj. Forcat sistemike që do të imponoheshin mbi Shqipërinë do të mund të ishin të lexueshme vetëm në rast se zgjedhja e Shqipërisë për refuzimin e armëve kimike do të krijonte një çarje të fortë dhe të parikuperueshme me SHBA-në çka do të vështirësonte realizimin e objektivave të Shqipërisë në politikën ndërkombëtare duke krijuar një rrezik serioz për sigurinë e saj. Shqipëria nuk gjendej përpara një zgjedhjeje të tillë dhe vendim-marrësit politik ishin të ndërgjegjshëm për shkallën e kostove që do të merrte Shqipëria duke refuzuar kërkesën. Në këtë kuptim, mjedisi strategjik ndërkombëtar krijonte kushte që Shqipëria të zgjidhte ndërmjet dy zgjedhjeve të mundshme pa vendosur në rrezik pozicionin e saj në sistemin ndërkombëtar, përfshi këtu edhe aleancat strategjike dhe realizimin e objektivave kombëtarë. Gjithsesi, me anë të analizës në nivel strukturor ne nuk kemi shpjeguar asgjë rreth shkaqeve se përse Shqipëria zgjodhi ta refuzonte kërkesën e SHBA-ve dhe jo ta pranonte atë. Arsyet e refuzimit gjenden në politikën e brendshme; shkallën e autonomisë së shteti ndaj shoqërisë, kapacitetin mobilizues të lidërshiptit, dëshira e lidërshiptit politik për të qëndruar në pushtet, diferencat në vlerësimin e përfitimit dhe rrezikut, medias dhe opinionit publik, organizatave joqeveritare dhe shoqërisë civile. Faktori vendimtar i neglizhuar në literaturën e realizimit neoklasik është shkalla e autonomisë së shtetit ndaj shoqërisë që nuk lidhet veçse me strukturën socio-politike të shtetit, por edhe me një sërë faktorësh të tjerë që kontribuojnë në raste

specifike për zgjerimin ose ngushtimin e kësaj autonomie. Ajo që interpretohet gabimisht në shumicën e literaturës së realizmit neoklasik dhe traditave të tjera është fakti se një shtet në një sistem të demokracisë liberale ka për shkak të vetë natyrës së tij një shkallë më të vogël autonomie në raport me shoqërinë. Ajo që ndodhi në rastin e vendimit të Shqipërisë për refuzimin e armëve kimike tregon se janë faktorë të tjerë që krijojnë autonominë e shtetit ndaj shoqërisë në raport me formulimin e politikës së jashtme dhe këtu mund të përmendim: nivelin e besimit të opinionit publik tek institucionet dhe lidhshipi politik, kohezioni politik dhe social, niveli i transparencës së qeverisë me publikun dhe kapaciteti i institucioneve për të formuluar interesin kombëtar në përputhje me pritshmërinë e publikut. Në rastin konkret, në të gjitha pikat e sipërpërmendura qeveria shqiptare shfaqti një deficit të konsiderueshëm, kjo edhe për shkak se u gjend e papërgatitur për tu përballur me një situatë të tillë në kushtet kur ajo sapo kishte marrë përsipër drejtimin e vendit. Shqipëria për shkaqe historike trashëgon një nivel shumë të ulët besimi të publikut tek institucionet dhe për këtë arsye publiku shqiptarë e kishte shumë të vështirë të besonte se qeveria po bënte një zgjedhje që ishte në shërbim të interesave të tyre. Qeveria nuk arriti të krijojë një konsensus të gjerë politik duke e monopolizuar negociimin e përfshirjes në këtë operacion në duart e Kryeministrit dhe Ministrit të Jashtëm, duke përjashtuar nga procesi institucione si Kuvendi, Presidenca dhe opozita. Niveli i transparencës në raport me këto institucione dhe me publikun e gjerë ishte i papërfillshëm, çka krijoi kushtet që sigurizimi i rrezikut prej armëve kimike të arrinte në atë nivel sa ta bënte qeverinë të pamundur për të marrë masa desigurizimi të rrezikut nëpërmjet shpjegimit të përfitimeve të Shqipërisë nga përfshirja në këtë proces. E vetmja mënyrë për të desigurizuar rrezikun mbeti refuzimi i përfshirjes në proces. Një faktor tjetër i rëndësishëm janë konsideratat e brendshme politike të Kryeministrit. “Çdo lider politik përballet me sfidën se si të qëndrojë në detyrë. Politika mbrapa mbijetesës në zyrë është thelbi i të gjithë politikës... Ne e konsiderojmë aksiomatike që çdokush në pozitën e autoritetit dëshiron ta mbajë atë autoritet dhe lëvizjet për ta mbajtur atë janë themelore për politikën në çdo regjim. Kur themi se janë themelore, mendojmë se çdo veprim që ndërmerret nga liderët politikë synohet prej tyre të jetë i përputhshëm me dëshirën për të mbetur në pushtet”<sup>40</sup> Edhe rasti konkret nuk del jashtë kësaj aksiome. Çdo vendim që do të binte ndesh me kërkesën e publikut vinte seriozisht në rrezik qëndrimin në pushtet të kryeministrit. Një tjetër faktor i rëndësishëm është aftësia e kufizuar e qeverisë për të mobilizuar opinionin publik rreth vendimeve që në perceptimin e saj i shërbejnë interesin kombëtarë.

40 Bruce Bueno de Mesquita, Alastair Smith, Randolph M. Siverson, James D. Morrow, eds, “*The Logic of Political Survival*”, (The MIT Press, 2004) fq. 8.

## 1. Konkluzione

Pra, duke i qëndruar kornizës analitike të realizmit neoklasik mund të dalim në përfundimin se Shqipëria refuzoi kërkesën për t'ju bashkuar operacionit ndërkombëtar për shkatërrimin e armëve kimike të Sirisë sepse: 1) mjedisi ndërkombëtar ia lejonte një zgjedhje të tillë pa vendosur në rrezik pozicionin e saj në sistemin ndërkombëtar dhe aleancat strategjike që garantojnë sigurinë e saj kombëtare. 2) politika e brendshme si një variabël ndërhyrës është përcaktues për modelimin e zgjedhjes politike të Shqipërisë në rastin në shqyrtim. 3) Shkalla e ulët e autonomisë së shtetit ndaj shoqërisë është një faktor shumë i rëndësishëm në pamundësinë e qeverisë për të marrë një vendim që nuk aprovohej nga opinioni publik. 4) Dëshira e lidërshiptit politik për të mbajtur pushtetin është faktor i pashmangshëm në analizimin e vendimit të marrë. 5) Diferenca ndërmjet opinionit publik dhe qeverisë në perceptimin e interesit kombëtar në rastin e armëve kimike u krijua nëpërmjet sigurizimit të një rreziku deri diku të pavërtetueshëm mbi baza objektive e për shkak të mungesës së transparencës dhe pamundësisë së qeverisë për të marrë masa adekuate për desigurizimin e rrezikut të perceptuar. Implikimet teorike për realizmin neoklasik që përftohen prej rastit të shqyrtuar janë: 1) Parimet themelore analitike të parësisë së strukturës dhe pashmangshmërisë së forcave që gjenden në nivelin e shtetit krijojnë shtratin teorik për një shpjegim koherent dhe shterues të fenomenit në shqyrtim. 2) Pretendimi i realistëve neoklasik për një teori të politikës së jashtme është polemik pasi paravendosja e parësisë së variablave ndërhyrës është i pamundur përtej rastit konkret që merret në shqyrtim. 3) Shkalla e autonomisë së shtetit ndaj shoqërisë është një variabël ndërhyrës me rëndësi themelore në shpjegimin e politikës së jashtme. Kërkimi në këtë drejtim duhet të fokusohet më drejtë tek arsyet e kësaj autonomie dhe jo tek pohimi *a priori* se ajo është karakteristikë e shoqërive të hapura. 4) Roli i lidërshiptit politik dhe institucioneve shtetërore në mobilizimin e opinionit publik në mbështetje të vendimeve është themelor në kuptimin dhe shpjegimin e vendim-marrjes së një shteti në politikën e jashtme.

## BIBLIOGRAFIA

- Andrew K. Hanami, ed, "Perspectives on Structural Realism", (Palgrave Macmillan, 2003)
- Bruce Bueno de Mesquita, Alastair Smith, Randolph M. Siverson, James D. Morrow, eds, "The Logic of Political Survival", (The MIT Press, 2004)
- Gideon Rose, "Neoclassical Realism and Theories of Foreign Policy", World Politics, Vol. 51, No. 1 (Oct., 1998)

- Fareed Zakaria, *“From Wealth to Power: The Unusual Origins of America’s World Role”* (Princeton University Press, 1999)
- Jack Donnelly, *“Realism and International Relations”*, (Cambridge University Press, 2000)
- Jeffrey W. Taliaferro, *“Security Seeking under Anarchy: Defensive Realism Revisited”*, *International Security*, Vol. 25, No. 3 (Winter, 2000-2001).
- Kenneth N. Waltz, *“Theory of International Politics”*, (1979)
- Kenneth N. Waltz, *“Reflections on Theory of International Politics: A Response to My Critics”* in Robert O. Keohane *“Neorealism And Its Critics”*, (Columbia University Press, 1986)
- Kenneth N. Waltz, *“International Politics is not Foreign Policy”*, *SECURITY STUDIES* 6, no. 1 (autumn 1996)
- Kenneth N. Waltz, *“The Origins of War in Neorealist Theory”*, *Journal of Interdisciplinary History*, Volume 18, Issue 4, *The Origins and Prevention of Major Wars*, (Spring, 1988)
- Kenneth N. Waltz, *“Man, the State and War”* (New York: Columbia University Press, 1959)
- Randall Schweller, *“Deadly Imbalances”*, (Columbia University Press, 1998)
- Richard K. Ashley, *“The Poverty of Neorealism”*, *International Organization*, Vol. 38, No. 2, (Spring, 1984)
- Steven E Lobell; Norrin M. Ripsman; Jeffrey W. Taliaferro, eds., *“Neoclassical Realism, the State, and Foreign Policy”* (Cambridge University Press, 2009)
- Sten Rynning. Review of Lobell, Steven E.; Ripsman, Norrin M.; Taliaferro, Jeffrey W., eds., *Neoclassical Realism, the State, and Foreign Policy*. H-Diplo, H-Net Reviews. July, 2009
- Walter Carlsnaes, Thomas Risse-Kappen, Beth A Simmons, eds, *“Handbook of International Relations”*, (SAGE Publication, 2002)

## SITUATA AKTUALE E SISTEMIT GJYQESOR NE EVROPEN JUGLINDORE. SFIDAT

Erina Caka

Mediterranean University Of Albania  
erina.caka@umsh.edu.al

### ABSTRACT

*Judicial system, as one of the three most important column of power, that owns the authority to interpret and apply the law, adjudicate legal disputes, and otherwise administer justice. During the presentation and the analysis of judicial systems, of South East European countries, will reflect the features of each of them, forms the exercise of this power, the means and mechanisms used for the operation of this power, as well and their problems.*

*Each state has its own organization of the judiciary, which with minor changes, in general are and based on same principles and rules. What problematic issue, seen enforcement of these principles and rules de facto, which are far away from legal prevision. Among the main challenges of the judicial systems in South Eastern Country remains corruption, judicial connection with politics, or the difficulty of its secession from external influences, terms of trials etc. The European Union is exerting pressure on new members and candidate countries to root out corruption, in order to help the functioning of their judiciaries. These counties made less progress in the judicial fields than in most of other areas of institutional reforms.*

**Keywords:** judicial system, problems, reforms, South East Europe

### 1. H Y R J E

Bashkimi Europian gjithmonë e më shumë po shfaqet si një sistem unik (*sui generis*) dhe është më shumë se thjesht një organizatë ndërkombëtare. Bashkimi Europian është përshkruar edhe si “bashkim i plotfuqishëm ekonomik dhe politik” apo edhe si mbrojtësi më i madh i demokracisë.

Si rezultat i faktit se shpesh konsiderohet edhe si mbrojtës i demokracisë, funksionimi i saj është vëzhguar gjërësisht nga euroskeptikët ose jo, në lidhje me mekanizmat që ajo përdor për të qënë një tërësi demokratike. Si i tillë, ky entitet, për vendet aspiranate, ka parashtruar kushtet e tilla, ndër të tjera, pasja e një sistemi të drejtësisë të mbështetur në legjislacion.

Ky punim, në përmbatje të tij fillimisht do të merret me parashtrimin e sistemit gjyqësor në Bashkimin Evropian dhe raportin e tij me gjykatat kombëtare të shteteve anëtare. Më pas, do të analizohen sistemi gjyqësor i Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, si shtete të cilat kanë një strukturë të ngjashme të gjyqësorit, dhe që aspirojnë të bëhen anëtare të kësaj familje të madhe. Në sajë të kësaj analize do të evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre si dhe të sugjerohen përmirësimet e mundshme.

## **I. Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin gjyqësor të Bashkimit Evropian**

### **Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED)**

Çdo sistem ka vazhdimësi vetëm nëse rregullat e tij mbikëqyren nga një autoritet i pavarur. Për më tepër, në një bashkim shtetesh, siç është edhe Bashkimi Evropian, rregullat e përbashkëta (nëse i nënshtrohen kontrollit nga Gjykatat kombëtare) interpretohen dhe zbatohen në mënyrë të ndryshme nga njëri shtet në tjetrin. Mirëpo, po të veprohej në këtë mënyrë do të rrezikohej zbatimi uniform i rregullave, parimeve dhe të drejtës së Bashkimit Evropian në përgjithësi. Këto vërejtje çuan në krijimin e Gjykatës Komunitare të Drejtësisë, në vitin 1952, pas krijimit të Komunitetit të KEQC. Më pas në vitin 1957, kjo Gjykatë u kthye në organ gjyqësor edhe për dy Komunitetet e tjera KEE dhe i BE-së dhe e realizon veprimtarinë e saj në tre nivele :

- *Gjykata e Drejtësisë, si shkalla më e lartë në rendin juridik të Komunitetit.*
- *Gjykata e Përgjithshme.*
- *Gjykata e Specializuara, që mund të caktohen nga Gjykata e Përgjithshme për të vendosur për çështje në fusha të veçanta.*

Sipas Traktatit të Lisbonës, Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian përfshin Gjykatën e Drejtësisë, Gjykatën e Përgjithshme dhe gjykatat e specializuara. Kështu, termi “Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian” zyrtarisht cakton dy nivelet e juridiksionit të marra së bashku. Organi më i lartë është quajtur “Gjykata e Drejtësisë”, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë është emërtuar “General Court”, por përbërja e tyre aktuale dhe detyrat nuk janë ndryshuar<sup>41</sup>.

41 Neni 19 TEU, Neni I-29, Kushtetuta BE-së

Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga një gjyqtar prej secilit shtet anëtar. Gjykata Përgjithshme përfshin të paktën një gjyqtar për çdo shtet anëtar, që do të thotë se numri i gjyqtarëve të Gjykatës Përgjithshme mund të jetë më i madh se numri i shteteve anëtare. Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë dhe gjyqtarët e Gjykatës së Përgjithshme janë zgjedhur nga personat pavarësia e të cilëve është jashtë çdo dyshimi dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit European. Ata emërohen me marrëveshje të përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare për gjashtë vjet.

## II. Bashkëveprimi ndërmjet të drejtës së Bashkimit European dhe të drejtës kombëtare

Marrëdhënia e varësisë ndërmjet të drejtës së Bashkimit European dhe të drejtës kombëtare reflektohet si në shtetet anëtare të BE ashtu dhe në shtete të cilat aspirojnë të jenë anëtare të Bashkimit Evropian, siç janë një pjesë e vendeve të Evropës Juglindore. Marrëdhënia e varësisë e përmendur më sipër buron nga neni 4 i TBE, në të cilin parashikohet se interesi i komunitetit, pra i Bashkimit European në këtë rast duhet të qëndrojë mbi interesin kombëtar të një shteti anëtar të caktuar. Kjo do të thotë se në momentin kur një shtet vendos të anëtarësohet në Bashkimin European, duke punuar për të plotësuar kushtet dhe kriteret e vendosura nga Institucionet më të larta të BE-së, atëherë ai është i detyruar të heqë dorë nga një pjesë e pushtetit të tij kombëtar në të mirë të komunitetit. Por gjithsesi, sistemi juridik i Bashkimit European nuk është një rend juridik autonom, por bazohet në mbështetjen e sistemeve kombëtare për funksionimin e tij.

Prandaj të treja degët e pushtetit; legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori, duhet të pranojnë që rendi juridik i BE-së nuk është sistem i "huaj". Bashkimi European nuk është një komunitet i bazuar vetëm mbi interesa, por është një komunitet i bazuar mbi ndihmën dhe mbështetjen reciproke, dhe një fryme mjaft të fortë solidariteti.

Kjo marrëdhënie ndërvarësie ndërmjet të drejtës së Bashkimit dhe të drejtës kombëtare, mbulon ato fusha ku këto dy sisteme plotësojnë njëri tjetrin. Në nenin 4 të TBE-së është parashikuar shprehimisht se : *"Në bazë të parimit të bashkëpunimit të sigurtë, Bashkimi dhe shtetet anëtare, në respektim të ndërsjelltë, të ndihmojnë njëri tjetrin në kryerjen e detyrave që rrjedhin nga traktatet. Shtetet anëtare marrin masat e duhura, të përgjithshme ose të posaçme, për të siguruar plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga traktatet ose aktet e institucioneve të Bashkimit, dhe heqin dorë nga çdo masë, e cila do të vinte në rrezik arritjen e objektivave të Bashkimit"*<sup>42</sup>.

Ky sanksionim në këtë nen parashikon se interesi i komunitetit, pra i Bashkimit European në këtë rast duhet të qëndrojë mbi interesin kombëtar të një shteti anëtar të caktuar. Kjo do të thotë se në momentin kur një shtet vendos të anëtarësohet në Bashkimin European, duke punuar për të plotësuar kushtet dhe kriteret e vendosura nga Institucionet më të larta të BE-së, atëherë ai është i detyruar të heqë dorë nga një pjesë e pushtetit të tij kombëtar në të mirë të komunitetit. Por gjithsesi, rendi juridik i Bashkimit European nuk është një rend juridik i pavarur, por bazohet në mbështetjen e sistemeve kombëtare për funksionimin e tij. Prandaj të treja degët e pushtetit; legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori, duhet të pranojnë që rendi juridik i BE-së nuk është sistem i "huaj". Bashkimi European nuk është një komunitet i bazuar vetëm mbi interesa, por është një komunitet i bazuar mbi ndihmën dhe mbështetjen reciproke, dhe një fryme mjaft të fortë solidariteti.

Nga kjo rezulton se, nga autoritetet kombëtare kërkohet që jo vetëm që të respektojnë traktatet e Bashkimit European, por duhet dhe t'i zbatojnë apo t'i vënë në praktikë ato. Në fushën e gjyqësorit, bashkëpunimi ndërmjet dy sistemeve ndërthuret përmes procedurës së vendimmarrjes, sipas të cilës, gjykata kombëtare mund t'i drejtohen GJED-së duke i drejtuar pyetje për interpretimin dhe vlefshmërinë e së Drejtës së BE-së. Vendimet e GJED-së mund të jenë vendimtare për zgjidhjen e konfliktit. Dy gjëra janë të qarta:

**Së pari** Gjykatave kombëtare të shteteve anëtare u kërkohet të respektojnë dhe të zbatojnë të drejtën e Bashkimit European, gjatë vendimmarrjes së tyre.

**Së dyti** Interpretimi i të drejtës së Bashkimit European dhe deklaratat për vlefshmërinë e saj janë kompetencë kryesore e GJED-së<sup>43</sup>.

Ndërvarësia e të drejtës së BE-së dhe të drejtës kombëtare të shteteve anëtare ilustron me tej dhe me atë që ndodh kur duhet të plotësohen boshllëqet në të drejtën e BE-së. Ndodh që e Drejta e BE-së mund t'i referohet normave ekzistuese të së Drejtës kombëtare të shteteve anëtare, për të plotësuar normat që përcakton vetë ajo. Por parimi më i rëndësishëm i zbatimit të së Drejtës së BE-së është që zbatimi i saj të jetë i njëjtë për gjithë, pa diferencime.

Por raporti midis së Drejtës së BE-së dhe të Drejtës kombëtare mund të qëndrojë në nivele diametralisht të kundërta, dhe këto janë dhe rastet ku ndeshen përplasje midis këtyre dy sistemeve. Situata të tilla krijohen kur nga e Drejta e BE-së mbarten të drejta dhe detyrime që nuk janë të parashikuar në legjislacionin e brendshëm të një shteti anëtar.

---

43 Maja Brkan, "The relationship between EU law and the national legal order"

### III. Sistemi gjyqësor në Republikën e Maqedonisë FYROM

Gjykatat në Republikën e Maqedonisë gjykojnë në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe sigurojnë zbatimin e të drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Gjykimi nëpërmjet këtyre gjykatave nuk duhet të bjerë ndesh me parimet kryesore të së drejtës të sansionuara në Kushtetutë, apo në marrëveshjet ndërkombëtare.

Objektivat dhe funksionet e gjyqësorit përfshijnë kryesisht zbatimin dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe parimet kryesore që kanë të bëjnë me zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor. Konkretisht, gjykimi i çështjeve nga sistemi gjyqësor maqedonas, në thelbin e funksionimit të tij mbështetet zbatimin e paanshëm të së drejtës, pa marr parasysh pozitën dhe cilësinë e palëve; përparimin e mbrojtjes dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut; sigurinë juridike dhe krijimin e kushteve për çdo njeri që të jetojë i sigurt në kuadër të zbatimit të së drejtës.

Në sistemin unitar gjyqësor, pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat themelore, gjykatat e apelit, Gjykata Administrative dhe Gjykata e lartë e RM-së<sup>44</sup>. Gjykatat themelore i shqyrtojnë konfliktet gjyqësore në shkallë të parë, të cilat bëjnë pjesë në juridksionin dhe kompetencat e tyre, përveç sa nuk parashikohet ndryshe me ligj të veçantë. Në total, në Maqedoni janë krijuar gjithësej 23 gjykata themelore, të vendosura në qytete të ndryshme.

Gjykatat e Apelit, janë gjykata të cilat gjykojnë çështjet në shkallë të dytë, të cilat regjistrohen mbi bazën e ankimit të palëve të pakënaqura me vendimet gjyqësore të gjykatave themelore. Në Republikën e Maqedonisë ekzitojnë katër (4) Gjykata Apeli më seli në Shkup, Manastir, Gostivar dhe Shtip. Sa i takon Gjykatave administrative, ato janë krijuar për të gjykuar mbi mosmarrëveshjet e palëve private me shtetin apo ndërmjet institucioneve shtetërore, në të cilat kundërshtohen akte të caktuara administrative, ligjshmëria, forma e nxjerrjes së tyre etj<sup>45</sup>.

Me Ligjin "Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat", (Nr.35/2008), themelohet Gjykata e Lartë Administrative ,më seli në Shkup që ushtron pushtetin gjyqësor në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Problemet në lidhje me gjyqësorin në Maqedoni duket të jetë mungesa e efikasitetit gjyqësor që reflektohet me: procedurat e ngadalta dhe paarritshmëri e drejtësisë; Zbatimi i vështirë dhe i zgjatur i vendimeve përfundimtare në rastet civile; mbingarkesa e institucioneve gjyqësore etj. Gjendja e varfër ekonomike e gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatës<sup>46</sup>.

44 Ligji mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë ,neni 22.

45 Ligji mbi Gjykata në Republikën e Maqedonisë, neni 34

46 The Reform of the Judicial System in the Republic of Macedonia, Skopje

Ndërsa problematikat e lidhura me përgjegjshmërinë e gjyqësorit janë të lidhura me mungesën e një sistemi të konsoliduar edukimi të vazhdueshëm të gjyqtarëve, sjellje jo profesionale dhe korrupsioni.

#### IV. Sistemi gjyqësor në Republikën e Kosovës

Kosova, është një nga shtetet më të reja, në Europë dhe më gjerë, dhe njëkohësisht një nga Republikat më të brishta. Siç botërisht dihet, arsyet e kësaj brishtësie lidhen si me faktin se është një shtet i krijuar rishtaz, por gjithashtu dhe pasojavë që ka mbajtur mbi supe, dhe për të cilat ka vuajtur me vite, siç janë luftërat. Çdo shtet, i cili ka pas shpine një histori të vështirë, si pasojë e sistemeve politike të përjetuara, apo një histori luftrash, janë shtete të cilat e kanë shfaqur shumë vonë rimëkëmbjen dhe ende sot vuajnë pasojat e këtyre vështirësive të kaluara.

Këto probleme apo vështirësi reflektohen në të gjithë sektorët jetësorë, institucional, dhe një gjë e tillë është vënë re edhe në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës. Pas luftës, në Kosovë u vendos Administrata e Kombeve të Bashkuara në Evropë, UNMIK. Si hap të parë në sistemin gjyqësor në Kosovë, UNMIK ndoqi rrugën e krijimit të të ashtuquajturës "Sistemi emergjent gjyqësor", i cili konsistonte në krijimin e gjykatave në disa qytete të Kosovës, gjykatat e qarqeve, gjykata komunale, apo dhe gjykata të kundravajtjeve<sup>47</sup>, krijimi i Këshillit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës<sup>48</sup>.

Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës më datë 17.02.2008, u ligjëruan në Kushtetutën e RK shumë institute të të drejtës, dhe u sanksionuan një sërë parimesh, të drejtash dhe detyrimesh. Në këtë Kushtetutë, zë një vend të veçantë kreu 7 i tij, dhe konkretisht nenet 102-108, në të cilat janë sanksionuar parimet e përgjithshme të sistemit të drejtësisë.

Kështu, në korrik të 2010 është miratuar dhe ligji Nr.03/L-199 në të cilën është përcaktuar sistemi gjyqësor në Republikën e Kosovës dhe në përmbajtje të këtij ligji është sanksionuar se pjesë përbërëse të këtij sistemi të ishin: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme dhe Gjyqtarët e EULEX.

Funksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX, është i rregulluar me ligj të posaçëm Nr.03L-053<sup>49</sup>. Sa i takon Gjykatave themelore, janë gjykata të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në disa qytete të Kosovës, dhe është i organizuar në departamente. Konkretisht, në Kosovë ka gjykata themelore në qytetet e Prishtinës, Gjiçan, Prizreni, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Pejë. Gjithashtu,

47 Marr nga website i Gjykatës Supreme të Kosovës [www.gjykatasupreme-ks.org](http://www.gjykatasupreme-ks.org)

48 Ky këshill bënte përzgjedhjen e kadidaturave për gjyqtarë dhe prokurorë, shqyrtonte aplikimet e tyre dhe bënte rekomandime për emërimet.

49 Marr nga website i Gjykatës Supreme të Kosovës [www.gjykatasupreme-ks.org](http://www.gjykatasupreme-ks.org)

secila nga këto gjykata themelore gjykon në departamente të veçanta, të ndara në

- Departamenti për çështjet ekonomike që vepron në Gjykatën Themelore të Prishtinës për gjithë territorin e Kosovës.

- Departamenti për çështje Administrative që vepron në Gjykatën Themelore të Prishtinës për gjithë territorin e Kosovës.

- Departamenti për Krimet e Rënda.

- Departamenti i Përgjithshëm që vepron në selinë e secilës gjykatë themelore.

- Departamenti për të mitur, që vepron në kuadër të gjykatave themelore<sup>50</sup>

Ditët e fundit në Kosovë, janë bërë disa amendime kushtetuese, në favor të krijimit të një Gjykate të re të ashtuquajtur "Gjykata Speciale". Kjo gjykatë do të krijohet për të gjykuar veprat penale, të pretenduara se janë ushtruar nga ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ky konsiderohet si një nga vendimet më të rëndësishme përsa i përket sistemit gjyësor në Kosovë. Kjo gjykatë do të ketë një mandat 5 vjeçar.

## V. Sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë

Pushteti gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ushtrohet vetëm nga Gjykatat të cilat janë Institucione të cilat krijohen vetëm në Respektim të Kushtetutës dhe me ligj të posaçëm. Kushtetuta e RSH në përmbajtje të saj, i kushton një vëmendje të veçantë parashikimeve mbi Gjykatat. Kushtetuta aktuale shqiptare merret me gjykatat (përveç Gjykatës Kushtetuese) në Pjesën e Nëntë (nenet 135 -147) dhe me Gjykatën Kushtetuese në Pjesën e Tetë (nenet 124 - 134). Konkretisht në nenin 135 pika 1 është parashikuar se : " *Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj*".

Ndërsa Neni 124 parashikon se :

*" 1. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutë si dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës"*

Gjithashtu, organizimi dhe funksionimi i pushtetit gjyqësor në RSH, rregullohet me një ligj të posaçëm, dhe konkretisht ligji Nr. Nr. 9877, datë 18.2.2008 "Për Organizimin E Pushtetit Gjyqësor Në Republikën E Shqipërisë". Ky ligj përcakton krijimin, organizimin dhe kompetencat e gjykatave, kushtet dhe procedurat për emërimin e gjyqtarëve, të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve, masat disiplinore dhe shkarkimin

e tyre, si dhe çështje të tjera të lidhura me funksionimin e gjykatave<sup>51</sup> Kështu, sistemi gjyqësor në vendin tonë është i përbërë nga :

- Gjykatat e Rretheve Gjyqësore

E cila është e organizuar në dy dhoma: Dhoma Civile dhe Dhoma Penale

- Gjykata e Apelit

- Gjykata e Lartë

- Gjykata për fusha të veçanta

- Gjykata Kushtetuese

Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, gjykojnë çështjet civile midis palëve ndërgjyqëse, në shkallë të parë. Gjykatat e Rretheve Gjyqësore kanë kompetencë të gjykojnë të gjitha mosmarrëveshjet civile si dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në Kodin e Proçedurës Civile e në ligje të tjera, si dhe veprat penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së Gjykatës Ushtarake. Këto të fundit gjykojnë ushtarakët për veprat penale ushtarake, robërit e luftës dhe persona tjerë të caktuar me ligj<sup>52</sup>. Në total, në të gjithë territorin janë 29 Gjykata të Rretheve.

Gjykatat e Apelit funksionojnë në zona të caktuara dhe gjykojnë në shkallë të dytë ankimet kundër vendimeve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore. Gjykatat e Apelit gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Aktualisht, në Shqipëri funksionojnë gjashtë Gjykata Apeli dhe konkretisht Gjykata e Apelit në, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.

Gjykata e Lartë, është shkalla e tretë e gjyqësorit në Republikën e Shqipërisë organizimi dhe funksionimi i së cilës rregullohet në bazë të Kushtetutës dhe Ligj Nr. 8588, Datë 15.3.2000 “Për Organizimin Dhe Funksionimin E Gjykatës Së Lartë Të Republikës Së Shqipërisë”. Kjo Gjykatë është me seli në Tiranë, është shkalla më e lartë e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Misioni i saj kryesor është rishikimi, me kërkesën e palëve, i vendimeve të gjykatave të shkallëve më të ulta. Nëpërmjet këtij procesi, ajo merr në shqyrtim çështjet e zbatimit të ligjit pa gjykuar faktet duke garantuar me anë të jurisprudencës së saj zbatimin uniform të ligjeve<sup>53</sup>.

Gjykatat për Fusha të Veçanta

1. Gjykata e Krimeve të Rënda

Kjo gjykatë është krijuar në bazë të ligjit nr. 9110, datë 24.07.2003, “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda”. Ky ligj ka për qëllim organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda, me synim rritjen e efektivitetit të luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të

51 Neni 1 Ligji Nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për Organizimin E Pushtetit Gjyqësor Në Republikën E Shqipërisë”

52 [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al)

53 [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al)

rënda, si dhe përmirësimin e cilësisë së gjykimit të tyre. Gjykatat për krime të rënda dhe gjykatat e apelit për krime të rënda janë hallka të sistemit gjyqësor, që shqyrtojnë në shkallë të parë dhe të dytë krimet me rrezikshmëri të lartë, të caktuara me ligj. Numri i gjykatave për krime të rënda, i gjykatave të apelit për krime të rënda, i gjyqtarëve të tyre, si dhe kompetenca tokësore e tyre caktohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, pasi të jetë marrë mendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë<sup>54</sup>.

## 2. Gjykatat Ushtarake

Sistemi gjyqësor ushtarak në Shqipëri ushtrohet nga Gjykatat ushtarake, të cilat organizohen dhe funksionojnë brenda sistemit gjyqësor sipas kompetencave të përcaktuara në ligj. Gjykatat Ushtarake përbëhen nga Gjykatat e Shkallës së Parë dhe të Apelit. Kjo e fundit shqyrton në shkallë të dytë ankimet kundër vendimeve të Gjykatave Ushtarake të Shkallës së Parë.

## 3. Kolegji Zgjedhor

Me miratimin e Kodit Zgjedhor<sup>55</sup>, u krijua një trup i ri gjyqtarësh në Gjykatën e Apelit në Tiranë, i cili do të shqyrtojë çështjet zgjedhore. Funksionimi i këtij Kolegji të posaçëm Zgjedhor përshkruhet në Pjesën 11 të Kodit Zgjedhor. Ndonëse Kolegji Zgjedhor është vendosur në godinën e Gjykatës së Apelit në Tiranë, ai nuk funksionon si një Gjykatë e mirëfilltë Apeli. Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit, Tiranë përbëhet nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur me short nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë<sup>56</sup>.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nuk bën pjesë në sistemin gjyqësor të zakonshëm por ajo përbën një juridiksion të veçantë, e ngarkuar të kontrollojë kushtetutshmërinë e ligjeve dhe të akteve të tjerë normative.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese fiton një pozitë të rëndësishme institucionale. Pjesa e tetë e Kushtetutës së Shqipërisë i kushton një vëmendje të veçantë kësaj gjykate. Nenet 124 deri 134 të Kushtetutës i kushtohen Gjykatës Kushtetuese si juridiksion kushtetues i pavarur. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës (neni 124 i Kushtetutës). Këto dispozita përcaktojnë edhe përbërjen, emërimin dhe statusin e gjyqtarëve e të Kryetarit të saj, tipin dhe shtrirjen e kompetencave të kontrollit kushtetues, subjektet që mund ta venë në lëvizje atë, forcën detyruese dhe zbatimin e vendimeve të saj.

Sipas nenit 131/f të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka statusin e shkallës më të lartë të apelit të vendimeve për individët, të cilët ngrenë

54 Neni 2 ligji nr. 9110, datë 24.07.2003, “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda”

55 Kodi Zgjedhor është krijuar në vitin 2003, dhe mw pas ligji Nr.10 019, datë 29.12.2008 (ndryshuar me ligjin nr.74/2012).

56 Neni 146/1 Ligji 74/2012 Kodi Zgjedhor

pretendimet e shkeljes të së drejtës për proces të rregullt, pas shterjes së të gjitha mekanizmave në dispozicion<sup>57</sup>. Gjykata Kushtetuese ka kompetencat për të kontrolluar pajtueshmërinë e ligjeve të miratuara nga Kuvendi dhe vendimet normative të autoritetet qendrore dhe lokale të administratës me Kushtetutën, por edhe me marrëveshtjet ndërkombëtare të ratifikuara.

Ligji “Për Organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili parashikon për herë të parë në Shqipëri krijimin e gjykatave të specializuara administrative. Me anë të këtij ligji, tashmë i hapet rrugë garantimit të mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive të individëve, të personave fizikë dhe juridikë dhe interesave të ligjshëm të tyre nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor, efektiv, të pavarur, dhe të zhvilluar brenda afateve ligjore të arsyeshme. Me anë të këtij ligji, synohet krijimi i kushteve të përshtatshme për një shqyrtim efektiv duke vënë në vend të drejtat e cënuara nga veprimet dhe/ apo aktet administrative të nxjerra nga organet publike.

Hartimi i një ligji të tillë ka ardhur ndër të tjera si rezultat i nevojës për shmangjen e zvarritjes së proceseve gjyqësore mes biznesit dhe shtetit, apo edhe qytetarit dhe shtetit, në kuadër të parimeve dhe rekomandimeve të Këshillit të Europës, si dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në shumicën e çështjeve kundër shtetit shqiptar ka konstatuar një cënim të procesit të rregullt ligjor.

Për qëllim të respektimit të parimit të një procesi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, ligji parashikon afate të shpejta përsa i përket shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e shkallës së parë Administrative dhe Gjykata e Apelit Administrative, me qëllim reduktimin e ndjeshëm të zvarritjes së proceseve gjyqësore me objekt gjykimi aktet/veprimet administrative. Gjithashtu në kuadër të këtij parimi, ligji i ka kushtuar një rëndësi edhe parashikimeve ligjore

---

57 Neni 131 Gjykata Kushtetuese vendos për: a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122; b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre; c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare; ç) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore; d) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të kësaj Kushtetute; dh) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij; e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës dhe të deputetëve, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre; ë) kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij; f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave

përsa i përket përshpejtimin dhe efektivitetin të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, si pjesë e pandashme e procesit të rregullt ligjor. Për më tepër, Ligji garanton mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të personave nëpërmjet detyrimit që u vihet organeve publike në provimin e ligjshmërisë të formës dhe të përmbajtjes së veprimit administrativ të nxjerrë prej tyre. Në pjesën urdhëruese të vendimit përfundimtar gjykata duhet të përcaktojë afatin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit përkatës. Përsa i përket procedurës së ekzekutimit, ligji parashikon rregullat konkrete që do të ndiqen për vënien në ekzekutim të vendimeve të gjykatave administrative dhe sanksionet përkatëse për moszekutimin e vendimit apo urdhrin të gjykatës, duke aplikuar ndaj titullarëve të institucioneve, të cilët nuk ekzekutojnë vendimin, masa të tilla si gjopa apo masa të tjera specifike të parashikuara në ligj, duke vënë dhe afate konkrete<sup>58</sup>.

## VI. Situata Aktuale. Problematikat dhe Sfidat

Gjatë analizës së sistemeve gjyqësore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, vihet re se në përgjithësi këto shtete kanë pothuajse, një organizim të ngjashëm të gjyqësorit. Kështu gjykimi në shkallë të parë ushtrohet nga gjykatat e rretheve, ose themelore. Kjo përbënte shkallën e parë të gjykimit të konflikteve gjyqësore.

Së dyti sa i takon gjykimit në shkallë të dytë, në të treja këto shtete ushtrohen nga Gjykatat e Apelit, të cilat ishin vendosur kryesisht në qytetet e mëdha të këtyre vendeve, duke e shtrirë juridiksionin e tyre. Këto gjykata gjykojnë mbi bazën e ankimeve të palëve të pakënaqura me vendimin e shkallës së parë. Gjykimi në shkallë të tretë ushtrohet nëpërmjet Gjykatës së Lartë, organizimi dhe funksionimi i të cilave kryesisht rregullohet me ligj të posaçëm.

Kohët e fundit, në Republikën e Shqipërisë, u bë një reform e rëndësishme në sistemin e drejtësisë nëpërmjet ligjit të posaçëm Nr.49/2012, është krijuar dhe një institucion i ri për vënien e drejtësisë, në një fushë tjetër, në atë administrative. Kështu, nëpërmjet këtij ligji, u krijua dhe Gjykata Administrative, institucion të cilin e vumë re edhe në Republikën e Maqedonisë, ndërkohë që mungon në Republikën e Kosovës. Përveç problematikave në funksionimin e saj, krijimi i Gjykatës Administrative në Shqipëri ka ndikuar në shtrirjen e ngarkesës që kishin gjykata e rretheve të cilat ndër të tjera gjykonin dhe konfliktet administrative. Me krijimin e kësaj gjykate, vihet re përshpejtimi i gjykimit të çështjeve administrative. Ndaj mund të shihet si e nevojshme të themelohet

<sup>58</sup> Help | Këshilli i Europës “Hyrja në fuqi e ligjit 49/2012 dhe ndikimi në procesin e rregullt ligjorë”

edhe gjykata e veçantë për gjykimin e çështjeve administrative, ashtu siç ekziston në Maqedoni dhe Shqipëri.

Funksionimi i pushtetit gjyqësor, është i mbështetur në disa parime universale, zbatimi i të cilave garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, apo sigurimi i të mirë të përgjithshme siç është e drejta, e bazuar në ligj dhe në Kushtetutë. Evidentimi i këtyre parimeve, vetvetiu reflektojnë dhe problematikat, pasi për shkak të mosrespektimit të këtyre parimeve, vijnë dhe defektet kryesore të sistemit të drejtësisë.

**Parimi i pavarësisë së gjyqësorit**, që është një nga parimet kryesore, realizohet nëpërmjet disa instituteve të parashikuara nga Kushtetutat e secilit prej shteteve të cilat janë analizuar në këtë material.. Ai shoqërohet edhe me një varg të drejtash-parime të funksionit gjyqësor, siç janë: e drejta e çdo subjekti për të pasur një gjykim të drejtë; e drejta për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë; gjykimi nga një anëtar i paanshëm; e drejta e mbrojtjes gjatë gjithë procesit gjyqësor; detyrimi i arsytimit të vendimeve gjyqësore, etj.

Edhe pse parimi i pavarësisë së gjyqësorit, është ndër parimet kryesore, kjo ka pasqyruar dhe problemin kryesorë. Sistemi gjyqësorë, kryesisht në vendet e Europës Juglindore, për shkak edhe të demokracisë së brishtë për të cilën karakterizohen këto shtete, ka problem të theksuara në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit. Kjo për shkak të pamundësisë për të penguar ndikimet e "jashtme".

Ndërhyrjet politike, ekzekutive dhe jo vetëm, në sistemin e drejtësisë nuk janë fenomen i ri. Në fakt, raportet e vazhdueshme të progresit të Komisionit Evropian, drejtuar vendeve të Europës Juglindore, si dhe shumë studime tjera të organizatave ndërkombëtare, e kanë cekur interferimin politik si një nga sfidat kryesore për forcimin e sundimit të ligjit në garantimin dhe sigurimin e drejtësisë së tyre.

Parimi i eliminimit të sistemit të varësisë hierarkike në gjyqësor, do të thotë që, secili gjyqtar duhet ta ushtrijë detyrën e tij, në varësi të legjislacionit në fuqi, dhe parimeve dhe bindjeve personale, mbi bazën e një arsytimi llogjik dhe ligjor. Për të garantuar autonominë e marrjes së vendimeve të gjyqtarëve, janë krijuar dhe gjykatat e instancave më të larta, të cilat, përveç garantimit të të drejtës së ankimit palëve, bëjnë dhe një vlerësim të veçantë mbi vendimin e marrë. Mirëpo shpesh mund të interpretohet si mbikëqyrje e punës së gjyqtarit të një shkalle më të ulët, dhe kjo sjell kompleksimin e gjyqtarit. Por kjo problematikë, shfaqet sigurisht në vende me demokraci ende në zhvillim dhe vende në tranzicion, si vendet e europës Juglindore, për shkak të mangësive në konsolidimin e këtyre parimeve të rëndësishme të sistemit të drejtësisë.

**Kushtetuta i ka siguruar gjyqtarëve të zakonshëm një pozitë autonome e të pavarur në raport me organet e tjera përmes disa instituteve në të cilat**

**kjo autonomi e pavarësi realizohet. Kështu është bërë i mundur eliminimi i sistemit hierarkik tek gjyqtarët; gjyqtarët dallohen midis tyre vetëm nga ndryshimi i funksioneve që kryejnë dhe nuk kanë asnjë varësi nga njëri tjetri**

Falë mentalitetit të së kaluarës, mungesës së guximit dhe mungesës së etikës profesionale, shumë prokurorë e gjykatës bien pre e vetcenzurës apo nënshtrimit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre<sup>59</sup>, që njihet dhe si fenomeni i “nënshtrimit të Gjyqësorit”.

Kjo problematikë mund të superohet nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarët. Programet e trajnimit duhet të përqendrohen tek ajo që i nevojitet shërbimit gjyqësor dhe të plotësojnë arsimin universitar. Në to duhet të përfshihen aspekte të etikës, aftësi komunikuese, aftësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, aftësi drejtuese dhe aftësi të hartimit të teksteve ligjore<sup>60</sup>. Gjithashtu gjyqtarët dhe prokurorët duhet të trajnohen duke vëzhguar gjyqësinë në vende të tjera duke takuar gjyqtarë dhe avokatë të huaj dhe për të mësuar rreth metodave të sistemeve të ndryshme juridike. Gjithashtu, trajnimet duhet të jenë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me punën e tyre me ligjin shqiptar dhe duhet të drejtohet nga juristë shqiptarë ose të paktën nga ata që janë të familiarizuar me jurisprudencën shqiptare<sup>61</sup>.

Nevojat dhe kërkesat për rregullimin e kornizës legislative në fushën e drejtësisë varen kryekëput nga ekzekutivi dhe vullneti i tyre politik për të përfshirë ligjet e kësaj fushe në agjendën legislative. Duke qënë se funksionimi i sistemit gjyqësorë shtë i lidhur direct dhe indirektme politikën, është e pamundur që në vendet në tranzicion, si ato të Europës Juglindore, ti shpëtojnë ndikimeve të politikës. Për shkak se emërimet, transferimet apo ngritjet në detyrë, përveç performancës personale në detyrë, janë objekt edhe i vlerësimeve të politikës, nuk mund të mos mendohet se politika nuk ndikon në vendimmarrjen e gjyqësorit. Për zgjidhjen e kësaj problematike, nevojitet që vetëvullneti politik, të jetë i shkëputur nga vendmmarrja e gjyqësorit. Cënimi i dhënies së drejtësisë, duke përdorur mekanizma degradues, nuk sjellin zhvillim, përkundrazi.

Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, Nils Muižnieks, gjatë vizitës së tij në Shqipëri u shpreh se niveli i lartë i korrupsionit në sistemin gjyqësor pengon seriozisht funksionimin e duhur të sistemit të drejtësisë. Pra,

59 Pushteti i pandashëm; Analizë e pavarësisë së pushtetit gjyqësorë në Kosovë. Botimi i Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave.

60 Rekomandimet E Kievit Për Pavarësinë E Gjyqësorit Në Evropën Lindore, Kaukazin Jugor Dhe Azinë Qendrore -Administrimi gjyqësor, përzgjedhja dhe përgjegjshmëria Kiev, 23-25 qershor 2010

61 Analizë e sistemit ligjorë në Shqipëri, OSBE

korupsioni është dhe një nga plagët më të thella që kanë në sistemin e drejtësisë vendet e rajonit. Siç e kam theksuar më sipër, kjo mbase vjen se vendet e Europës Juglindore, me përjashtim të Greqisë, Kroacisë, kanë një demokraci të dobët, dhe si rezultat krijon ngërçe. Një ndër to është zgjedhja e një rruge jo ligjore për të fituar. Por e drejta me joligjoren nuk mund të qëndrojnë bashkë, pasi janë antidote të njëra tjetrës. Një ndër mënyrat që do të sugjeroja për luftimin e korupsionit është rritja e vlerësimit të njërëzve që japin drejtësi, siç është paga. Kështu në rast se do të kishin një nivel të mirë page, për këta profesionistë, do të kufizonin tundimet e tyre poër të marrë përfitime të jashtëligjshme, të cilat domosdoshmërisht do të çonin në shtrëmbërimin e drejtësisë.

Besimi i publikut tek sistemi ligjor duhet të përmirësohet. Me një sistem ligjor mosfunksionues, në përgjithësi, njerëzit ndihen të pasigurt. Elementi themelor për krijimin e besimit të publikut, është bindja se rregullat për të cilat bihet dakord në një mënyrë demokratike, zbatohen nga e gjithë shoqëria nga strukturat shtetërore dhe sigurisht nga sistemi i drejtësisë..

## KONKLUZIONE

- Gjykata e Drejtësisë përcakton parimin e përgjithshëm të bashkëpunimit të drejtë, si bazë ligjore për interpretimin e të drejtës kombëtare në përputhje me të drejtën e Bashkimit European. Gjykata Europiane e Drejtësisë ka detyrimin që të unifikojë praktikat gjyqësore në rast përplasje ndërmjet normave ligjore të Komunitetit dhe normave ligjore kombëtare, si dhe në rastet kur legjislacioni i Bashkimit European është i paqartë.

- Shtetet anëtare duhet të marrin të gjitha masat e duhura, të përgjithshme ose të veçanta për të siguruar plotësimin e detyrimeve që lindin nga Bashkimi European. Gjithashtu shtetet anëtare dhe institucionet përkatëse, duhet të merren me interpretimin e normave ligjore të BE-së, dhe në këtë moment del roli i Gjykatave Kombëtare si Gjykata Europiane, në kuptimin që ato sigurojnë zbatimin e drejtë dhe respektimin e të drejtës Komunitare.

- Si përfundim mund të konkludohet se, në kuadër të interesit të përbashkët për t'u bërë pjesë e familjes evropiane, është e dosmosdoshme marrja e masave për të reduktuar problematikat.

- Kështu bashkëveprimi midis 3 pushteteve, ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësorë, është i nevojshëm, duke rrajuar dhe autoniminë e gjithësecilit, për të realizuar një shtet të së drejtës, të krijuar mbi bazën e normave të shëndosha.

- Gjithashtu, lufta kundër korupsionit, një ndër vështirësitë më të mëdha për t'u kapërcyer, që ka prekur pothuajse çdo fushë jetë të vendeve në tranzicion, por dhe vendin tonë gjithashtu. Është fakt se Bashkimi Evropian

e ka përcaktuar luftën kundër korrupsionit, veçanërisht në drejtësi, si një nga 5 detyrat apo prioritetet kryesore të shtetit shqiptar në procesin e integritetit. Si e tillë, lufta kundrejt këtij “Kanceri” të gjyqësisë, duhet të asgjësohet, duke krijuar mekanizma të posaçëm, duke krijuar zgjidhje se sit ë parandalohet ky fenomen.

- Në mënyrë që të gjënden zgjidhje ndaj këtij problemi, institucionet vendimmarrëse duhet të bashkëpunojnë më shumë me grupet e interes, dhe duke dëgjuar zgjidhjet e propozuara prej tyre, dhe se si mund të luftohet një problem ii tillë. Duhet të punohet që gjyqtarët të rrisin profesionalizmin dhe forcojnë integritetin, si e kundërta e korrupsionit. Lufta ndaj tij duhet të bëjë bashkë të gjitha institucionet e vënies së drejtësisë, institucionet ligjvënese dhe ligjzbatuese, media etj.

- Sa i përket problemit të mbingarkësës së çështjeve gjyqësore, mendoj se një nga zgjidhjet për të ndikuar në uljen e saj janë investimet që duhet të bëhen në zhvillimin e infrastrukturës së Gjyaktës. Më infrastrukturë të Gjykatës I referohem specializimit të stafit, shtimi I ndihmësave ligjorë në të tëra instancat, dixhitalizimi, krijimi I kushteve të favorshme të punës etj.

## BIBLIOGRAFIA

- Maja Brkan *The relationship between EU law and the national legal order*
- World Bank Publications “Judicial Systems in transition economies”.
- Evis Alimehmeti, PhD *The Evolution of the Constitutional System in Albania*
- Msc.Egzzone Osmanaj, Phd st *Pushteti Gjyqësor Në Republikën E Kosovës, Maqedonisë Dhe*
- *Shqipërisë (Aspekte krahasimore).*
- Publikim Task Forca për Integrim Evropian “*Material Diskutimi Për Sistemin E Drejtësisë Në Kosovë*”.
- Komisioni Evropian “*Dokumenti i Punës Së Stafit Të Komisionit Raporti i Progresit 2010 Për Kosovën*” Bruksel, 9 nëntor 2010
- Publikim i OSBE “*Analizë e sistemit ligjorë në Shqipëri*” 2004
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
- Kushtetuta e Bashkimit Evropian
- Ligji mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë
- Leksione, Sistemi gjyqësorë në Kosovë
- Ligji Nr. 9877, datë 18.2.2008 Për Organizimin E Pushtetit Gjyqësor Në Republikën E Shqipërisë.
- Ligji nr. 9110, datë 24.07.2003, "Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda"
- Ligji Nr.10 019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor (ndryshuar me ligjin nr.74/2012).
- Help Këshilli i Europës "Hyrja në fuqi e ligjit 49/2012 dhe ndikimi në procesin e rregullt ligjorë".
- Pushteti i pandashëm; Analizë e pavarësisë së pushtetit gjyqësorë në Kosovë. Botimi i Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave.
- Rekomandimet E Kievit Për Pavarësinë E Gjyqësorit Në Evropën Lindore, Kaukazin Jugor Dhe Azinë Qendrore -Administrimi gjyqësor, përzgjedhja dhe përgjegjshmëria Kiev, 23-25 qershor 2010
- [www.gjykatasupreme-ks.org](http://www.gjykatasupreme-ks.org)
- [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al)
- [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al)

# DIPLOMACIA EKONOMIKE. VEPRIMTARIA DHE PRAKTIKAT. DIPLOMACIA EKONOMIKE NE KORNIZEN E OKB

Emilio Çika

Mediterranean University of Albania  
emiliocika@gmail.com

## ABSTRACT

*This paper has as main objective to analyze the activities of economic diplomacy both by national and international organizations. The main focus is given to the role that the specific bodies of the United Nations are playing in the support of economic development worldwide. The Economic diplomacy besides its political content is a subject of academic study as well. First, it is an activity which is implemented by national and international bodies. It is considered generally as a process rather than as a structure. Second, it is focused mainly on the methods and processes of decision-making and negotiation against the impact exerted by the existing structures.*

*Finally the study concludes with the approach that the United Nations is considered as an international organization which has invested for long time energy and efforts for the discussion of the world economy issues and has supported international cooperation with such determination. Economic issues are considered as an integral part of the discussions and concerns of the United Nations.*

**Keywords:** *Economic Diplomacy, Foreign affairs, Economic Development, International Organizations, United Nations*

## HYRJE

Diplomacia ekonomike përvec përmbajtjes së saj politike nuk është vetëm një subjekt i studimeve akademike. Pikë së pari është një veprimtari e cila zbatohet nga organe shtetërore dhe ndërkombëtare. Është një proces më shumë se sa një strukturë. Përqëndrohet kryesisht në metodat dhe proceset

e marrjes së vendimeve dhe negociatave kundrejt ndikimit që ushtrohet nga strukturat ekzistuese. Kjo do të thotë se vlerësohen dhe merren parasysh me një kujdes të vecantë karakteristika të vecanta, parametra ose të dhëna kohore të cilat mund të ndikojnë në dhënien e fryteve nga diplomacia ekonomike dhe rrjedhimisht në vlera më afatgjate edhe për politikën e jashtme të shtetit ose organizatave ndërkombëtare që e ushtrojnë atë.

Nga ana tjetër sigurisht kjo nuk do të thotë se shpërfillen faktorët tradicional që kanë formatuar marrëdhëniet ndërkombëtare gjatë dekadave të fundit. Përkundrazi roli i tyre vazhdon të jetë i rëndësishëm. Është përbërja e duhur e eksperiencës historike me vlerësimin realist të nevojave të sotme që ngre diplomacinë ekonomike në një pjesë të pandarë të suksesit ose jo të politikës së jashtme të një shteti ose politikave të organizatave ndërkombëtare.

Zbatimi i kuadrit të diplomacisë ekonomike nga vende me përmasa të vogla është shumë e ndryshme nga ato me përmasa të mëdha. Edhe këtu sigurisht diplomacia ekonomike përbën një mori veglash për ushtrimin e politikës së jashtme dhe duhet të jetë në sinkron me objektivat kryesor strategjikë të shtetit që e ushtron atë, në mënyrë që të jetë e suksesshme. Por nga ana tjetër mungesa e peshës së vecantë si edhe vartësia nga burimet nxjerr në pah nevojën e gjetjes së metodave të vecanta dhe proceseve për marrjen e vendimeve si edhe të negociatave dhe lëvizjeve të kujdesshme diplomatike.

Në bazë të kësaj vendet e vogla, të cilat përbëjnë edhe shumicën e vendeve të botës – pasi sot veprimtaria ekzekutive e diplomacisë ekonomike varet në masë të madhe nga veprimtaria e trupit qeverisës – që të mundën të ushtrojnë një diplomaci ekonomike të suksesshme do duhet që me një përqasje të kujdesshme të përballen me tensionet që krijohen prej :

- Përshtatjes së objektivave politik me ato ekonomik
- Përshtatjes së metodave politike me ato ekonomike
- Mënyrës se si qeveritë formatojnë brenda shtetit një pozicion të përbashkët

- Mënyrës se si qeveritë i qasen kërkesës për ligjshmërinë demokratike, kontrollin dhe transparencën nga votuesit në mënyrë që të arrijnë mënyrën më të mirë ndërmjet rezultateve dhe llogaridhënies për pozicionet qëmbështesin dhe të veprimeve që ndërmarrin.

- Mënyrës se si qeveritë veprojnë me tregun dhe biznesin.
- Mënyrës se si qeveritë reagojnë kundrejt kërkesave të organizatave joqeveritare dhe të grupeve të ndryshme të presionit nga shoqëria në përgjithësi.

Diplomacia ekonomike kryesisht ka të bëjë me veprimtarinë shtetërore. Megjithatë përfshin faktorë të një kuadri të gjerë të cilat kapërcejnë Ministrinë e Jashtme të vendeve. Studjon veprimtarinë e të gjithë ministrive të cilat kanë përgjegjësi ekonomike dhe veprojnë në nivel ndërkombëtar. Gjithashtu merr

parasysh kuadrin e gjerë të veprimtarisë së organizatave joqeveritare siguron në shkallën kur këto organizata formojnë dhe ndikojnë në politikat qeveritare në lidhje me përfitimet dhe risqet e procesit të globalizimit dhe atëherë kur përbëjnë çështje qëndrore diskutimi në forumet kryesore ekonomike.

Organizatat ndërkomëtare (Kombet e Bashkuara, FMN, OBT, BB etj) përbëjnë një kuadër qëndror shumë të rëndësishëm negociatash, vendimarrje, diskutimesh etj. Këto të fundit kanë një rol qëndror në marrëdhëniet ndërkombëtare<sup>62</sup>.

### **Përfaqje Historike**

Diplomacia ekonomike deri rishtazi kishte si fushë të saj veprimtari të cilat kryeshin kryesisht prej qeverive të shteteve dhe nga departamente të caktuara të një rëndësie të ulët politike. Rritja e ndërvarjes ekonomike ( economic interdependence ) ndërmjet shteteve trondit autonominë kombëtare ekonomike të shteteve dhe furnizon reagime të formave të ndryshme në shtresa më të gjera sociale, gjatë tridhjet viteve të fundit, duke e vendosur të vështirë dallimin ndërmjet politikës kombëtare dhe asaj ndërkombëtare, objektivave ekonomik dhe atyre social, duke përfshirë më shumë shërbime dhe përfaqësi kombëtare por edhe faktorë jo qeveritar si psh shoqëritë tregëtare multikombëshe, investiture të ndryshëm, faktor të shoqërisë nëpërmjet organizatave jo qeveritare. Realiteti ekonomik zhvillohet me hapa shumë të shpejtë, përcohet në të gjitha nivelet e veprimtarisë njerëzore duke ndikuar në përparësitë dhe drejtimet e zgjedhjeve politike. Rëndësia e vecantë e karakteristikave të tregut sqaron në një farë mënyre dhe natyrën shumëpalëshe të diplomacisë ekonomike mbi bazën e përfshirjes e një numri të madh faktorësh. Me fjalë të tjera kështu shpjegohet se për çfarë arsye qeveritë kanë presion të zhvillojnë një kaudër pune të vecantë të diplomacisë ekonomike e cila bazohet në dinamika dhe procedura të përsëritshme duke marrë parasysh se pikëpyetjet dhe tensionet në marrëdhëniet politike dhe ekonomike në aspektin e ambjentit kombëtar dhe ndërkombëtar lindin natyrshëm.

Pa dyshim fundi i Luftës së Ftohtë vuri në dukje rëndësinë e madhe të diplomacisë ekonomike dhe riformatoi përbërjen dhe objektivat e saj. Deri atëherë funksiononte më shumë si një kuadër ndihmash ekonomike me objektiva politik. Kjo ndihmë ishte për fuqitë kryesuese të botës dy polare një mjet ushtrimi presioni kundrejt shteteve të cilat përfshiheshin në zonat e ndikimit të tyre. Përplasja ekonomike e dy poleve kundërshtarë të sistemit ekonomik ndërkombëtar - edhe pse dallojnë nga filozofia e tyre e adoptuar,

62 Henk- Jn Brinkman, International Economic Diplomacy at the United Nations, James Muldoon Jr.; Joan Fagot Aviel, Richard Reitano, Earl Sullivan (eds), Multilateral Diplomacy and the United Nations today, Westview press, 2005

nga njëra anë ekonomia e tregut dhe sistemi liberal perëndimor dhe nga tjetër sistemi i ekonomisë së përqëndruar sovjetike- nuk përkthehej plotësisht në intereset ekonomike por në pjesën më të madhe të saj kishte lidhje me objektiva sigurie dhe përballjes së kundërshtarit kryesor në bazë të kushteve politike, ushtarake dhe ideologjike të politikës së jashtme tradicionale.

Pas Luftës së Ftohtë përplasja është një letër boshe, komuniteti ndërkombëtar u zgjerua nga hyrja shteteve të reja të pavarura të cilat dëshirojnë të marrin përsipër më shumë iniciativa të mëdha për zhvillimin e tyre. Bota duket më e komplikuar, e pasigurtë dhe aktorët ndërkombëtar aktivizohen në një ambjent me pasiguri më të lartë. Fundi i luftës së ftohtë dhe mungesa e mbështjellës së saj politike kishte si rezultat lindjen e diversiteteve fetare, kombëtare dhe kulturore por edhe të asimterive të zhvillimit ndërmjet shteteve vecanërisht në ish Republikat Ruse, në kontinentin Afrikan, dhe në Amerikën Latine. Këto dallime ekzistonin si rrjedhojë e ndërvarjes së gabuar gjatë 30 viteve të fundit por u shfaqën më me densitet për arsye të depërtimit të shpejtë të globalizimit në shoqëritë e këtyre vendeve. Përplasja e re nuk ka të bëjë me antagonizmin ndërmjet sistemeve politiko ekonomike por e ka bazën në nivelin e zhvillimit ose në aksesin në arenën e shërbimeve financiaro ekonomike ose të teknologjisë së përparuar që janë aktive tashmë brenda një sistemi ekonomik homogjen. Përplasja akoma më shumë ka natyrë Veri-Jug dhe ekonomia e tregut loz një rol qëndror.

Pas goditjes terroriste të 11 Shtatorit dhe për një periudhë kohe të gjatë çështjet ekonomike u zbehën nga axhenda politike duke sjellë në pah çështjen e sigurisë, megjithatë përpjekjet e diplomacisë ekonomike vazhdojnë të jenë të rëndësishme duke marrë parasysh se ka të bëjë me qasje realiste të asyeve të kërcënimeve bashkohore sic është ajo e terrorizmit në vecanti. Dhe vecanërisht për këtë të fundit, lufta kundrejt arsyeve të thella të saj sic janë konstatuar se janë varfëria në tërësi dhe varfëria ekonomike në vecanti, kontribon fuqishëm në përballjen e pasigurisë.

Në një botë ku tregjet financiare shfaqen si të plotëfuqishme dhe kur dështimet e tyre janë të pakontrolluara - shembull tipik këtu është kriza financiare globale e 2008 - aty ku shtetet gjithnjë e më shumë janë të varura nga njëri tjetri, aty ku institucionet kombëtare veprojnë me autonomi ekonomike të cunguar nga mungesa e kufinjve fizik, përdorimi i kuadrit të diplomacisë ekonomike ( si organ shtetëror por edhe brenda organizatave ndërkombëtare ) ashtu si ajo formatohet pas luftës së ftohtë dhe sfidave të mijëvjeçarit të ri, do të mund ti ofroj një mundësi shteteve për arritjen e objektivit të përmbushjes së kërkesave të shoqërive për kombinimin e demokracisë dhe llogaridhënies.

• Diplomacia e re ekonomike përbën për qeveritë kryesisht një kaudër të përbërë ushtrimi të iniciativave brenda së cilit jepet mundësia të jenë më

shumë rezultate në arritjen e kërkesave moderne të shoqërive të tyre si psh mirëqënia e tyre ekonomike.

- Ofron strategji alternative të qëndrueshme për veprimtari ndërkombëtare të koordinuara të cilat përballojnë jo vetëm simptomat e kërcënimeve bashkëkohore por edhe arsyet e tyre të thella. Karakteristikë është shembulli i terrorizmit ndërkombëtar nëpërmjet luftimit të arsyeve të thella si varfëria, sëmundjet dhe bllokada ekonomike. Gjithashtu krizat ekonomike të cilat përhapen dhe transmetohen në sistemin ekonomik ndërkombëtar si rezultat i presioneve fitimprurëse të cilat ushtrohen nga tregjet ndërkombëtare financiare. Diplomacia ekonomike e re nuk ka të bëjë me përballjen ad hoc të problemeve. Kur dikush do të analizoj problemet e vjetra por edhe të reja si psh, luftrat e ndryshme në Ballkan, përplasjet në Afrikë gjatë 1990, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, balancat e ndjeshme në Lindjen e Mesme<sup>63</sup>, marrëdhëniet e ndjeshme Siri - Liban, lufta në Siri, destabilizimi i Irakut për krijimin e Kalifatit Islamik, konflikti Rusi-Ukrainë, e ashtëquajtura Pranvera Arabe dhe duke shkuar tek marrëdhëniet e Bashkimit Europian me aleatët e saj politik dhe ekonomik si Rusia, Japonia, Kina, SHBA, India, sfidat e zhvillimit të shek të 21të për Ballkanin, rastin e kontinetit Afrikan i cili po shkon drejt degradimit nga drejtimi i diktatorëve të përjetshëm dhe nga shfrytëzimi i burimeve të natyrore por edhe çështje si Protokoli i Kiotos për rruajtjen e ambjentit, krimi i organizuar ndërkombëtar, trafiku ndërkombëtar i lëndëve narkotike, emigracioni i jashtë ligshëm, siguria juridike dhe transparencë në tregëtinë ndërkombëtare, aksesin në burimet hidrike, do të dalloj se përbëjnë një mozaik problemesh ndërkombëtare me rëndësi të madhe politike dhe ekonomike të cilat do të shkaktojnë antagonizëm të fortë politik me rezultat përplasjen dhe destabilizimin global.

- Diplomacia e re ekonomike kur është e lidhur ngushtë me përpunimin dhe procesin e marrjes së vendimeve brenda kuadrit shtetëror dhe në institucionet dhe organizatat ndërkombëtare mundet të siguroj përgjigje thelbësore kundrejt pyetjeve dhe kërkesave të komuniteteve sociale dhe atyre ndërkombëtare për më shumë transparencë dhe llogaridhënie të elitave politike të cilat ndikojnë pashmangmërisht në interesat e grupeve të ndryshme.

- Diplomacia e re ekonomike përdor një gamë të gjerë mjetesh dhe mënyrash për arritjen e objektivave të rëndësishme politik dhe ekonomik. Mjetet ose masat në fjalë realizohen brenda kuadreve të cilat varrojnë nga negociata dhe bashkëpunime jo zyrtare deri në ushtrimin e rregullave dhe rregjimeve

63 Konflikti Palestinez është në rendi në ditës pas luftimeve të vazhdueshme ndërmjet shtetit të Izraelit dhe organizatës Hamas ku si pasojë e kësaj përplasjeje kanë ngekur të vdekur dhjetra ose qindra qytetarë të pafajshëm kryesisht fëmijë nga populli Palestinez.

detyruese. Janë ose pozitive si psh, motivime, masa favorizuese tregëtare, kredi, ndihma për zhvillim, tek të cilat çështja themelore është zhvillimi, pa të cilën, si psh, varfëria dhe problemet rregullatore nuk mund të luftohen me sukses. Dmth bazohen kryesisht në bashkëpunimin zhvillues në mënyrë që të krijohet një lloj marrëdhënie ndërmjet investitorëve dhe përfituesve të investimeve në një kuadër bashkëpunimi ekonomik ku ndihma në thelb kërkon një program përshtatje nga shtetet në të cilat investohet nëpërmjet reformave dhe qeverisjes së mirë. Nga ana tjetër kemi edhe masat negative (sanksionet)<sup>64</sup> sic janë, ndërprerja e ndihmës për zhvillim, ngrirjen e shkëmbimeve financiare, bojkotazh, embargo, kuotime etj. Zbatimi i sanksioneve sigurisht që mbështetet në faktin e mbështetjes asimetrike midis shteteve. Një shtet është më i varur se tjetri, i cili nga ana e tij mund të vendosi më me lehtësi sanksione më qëllim shkaktimin e një rezultati politik. Shumë herë është rezultat i perceptimit të ri rreth rolin të kufizuar të mjeteve ushtarake si mjete ushtrimi të presioneve ndoshta për arsye të uljes së shpënzimeve ushtarake. Në bibliografi teknikat e sanksioneve ekonomike përballen si pjesë e një zotësie politike në përpjekjen që të jepen zgjidhje alternative për zëvendësimin e politikave ushtarake me kosto të lartë si edhe të diplomacisë tradicionale.<sup>65</sup> Sigurisht duhet përmendur se nuk është vënë re një marrëdhënie e parashikuar midis presionit ekonomik dhe ndikimit politik. Në këto raste ku sanksionet në thelb vendosen për të goditur rregjimin politik të shtetit-objektiv, bëhen përpjekje që të përkufizohen “sanksionet e zgjuara” ( smarter sanctions) që godasin rregjimin por nuk prekin popullin. Duhet gjithmonë të analizohet marrëdhëniet ndërmjet elitave politike me elitat ekonomike dhe klasat punëtore në mënyrë që të jetë e mundur të krijohet një kuadër ligjshmërie për zbatimin e sanksioneve, akoma dhe atëherë kur kanë si objektiv rrëgjime autoritare. Më shumë përfitime ekzistojnë nga përdorimi i mjeteve të buta të diplomacisë ekonomike. Sigurisht në këto raste objektivi afatgjatë është që shteti –objektiv të jetë një satelit ekonomik në mënyrë që në një kohë të mëvontë të mos të mundet të ushtrojë rezistencë politike.<sup>66</sup> Në një tjetër formë, zhvillimi i mjeteve të sanksioneve ekonomike lind

64 K. Holsti, *International Politics: A framework for Analysis. Economic Instruments of Policy*, Prentice/Hall international, 1974

65 Michael Mastanduno, *Economic statecraft, interpedence and national security: Agenda for research*. Jean- Mare Blanchard, Edward Mansfield, Norrin Rispman (eds) *PoWer and the purse: Economic Statecraft, Interdependence and National security*, Frank Cass.

66 Shembull tipik është politika e përhershme e Rusisë kundrejt shteteve të tjera periferike që ishin dikur nën cadrën e Bashkimit Sovietik. Por një rast i përafërt por në një ideologji tjetër është ndihma e Bashkimit Europian nëpërmjet ndihmës Euro- Mesdhetare e cila kishte si objektiv në thelb të shndërronte realitetin e brendshëm të shtetit që do ishte pritisë I ndihmës me kusht që të shndërrohet në

nga rritja galopante në shkëmbimet tregëtare botërore, të cilat nga ana e tyre shkaktojnë rritje të fërkimeve ndërmjet aktorëve në negociatat institucionale në forumet tregëtare.<sup>67</sup> Zgjedhja ndërmjet tregëtisë dhe armatimeve ushtarake nuk përbën një antagonizëm ndërmjet një objekti ekonomik dhe atij jo ekonomik. Avantazhi i shkëmbimeve tregëtare u ngrit në një faktor vendimtar e cili përcakton tashmë forcën ushtarake dhe politike të një aktori ndërkombëtar.

- Diplomacia e re ekonomike karakterizohet nga natyra e saj shumë dimensionale. Kjo do të thotë se qeveritë, kur marrin përsipër iniciativa, shfrytëzojnë ndërveprimin ndërmjet niveleve të ndryshme në procesin e vendimarrjes, qoftë kur ky ndërveprim ka të bëjë me aktorët - ndërmjet aktorëve shtetëror ose jo, aktorëve kombëtar ose jo apo edhe strukturave periferike- qoftë kur ka të bëjë me zgjedhjen e mënyrës së negocimit ndërkombëtar ku në varësi të rëndësisë politike të tematologjisë përzgjidhet niveli më rezultativ- dypalësh, periferik apo shumëpalësh. Psh në fushën e marrëveshjeve ekonomike me rëndësi politike, përzgjidhet niveli periferik i ndërveprimit për përfitimet nga marrëveshjet periferike me shtetet fqinje në fushat e unifikimit të tregjeve për tregëti dhe investime ose niveli shumëpalësh në kushtet që kanë të bëjnë me temat e mbrojtjes së ambjentit, ku përfshirja e të gjitha shteteve është e domosdoshme. Në çështjen e sanksioneve më rezultative janë ato dypalëshe dhe ato shumë palëshe. Me ndërveprimin shumëpalësh, sanksionet shumëpalëshe rrisin izolimin politik të rregjimit-objektiv pasi shfrytëzojnë shpërndarjen ndërkombëtare homogjene të fuqisë dhe zbatohet nën koordinimin e institucioneve ndërkombëtare brenda një kuadri të përbashkët të rregullave. Në rastet e zbatimit të sanksioneve dypalëshe bëhet e qartë lidhja e ndihmës me politikën e jashtme të shteteve ndihmuese ose mundësisht të ekzistojnë reagime dhe nga realiteti i brendshëm vendit i cili zbaton sanksionet. Nocioni i decentralizimit dhe qeverisjes shumë rafshëshe përshkruan shumë qartë situatën kur qeveritë nuk mundën të monopolizojnë ushtrimin e politikës dhe kërkojnë një rol për të qënë më rezultative. Kjo është vecanërisht e dukshme në kuadrin e Bashkimit E uropian dhe rëndësinë e vecantë që i jep strukturave kombëtare dhe në nivel periferik.

- Diplomacia e re ekonomike kërkon përfshirjen e pashmangshme të shumë aktorëve në ambjentin ndërkombëtar ekonomik. Aktor kombëtar shtetëror, si qeveritë, trupat parlamentare, strukturat periferike dhe lokale, aktor jo shtetëror, grupime tregëtare, organizata konsumatorësh, shoqëritë multikombëshe, organizata ndërkombëtare, komunitete shkencore, të gjithë

---

shtet miqësor kundrejt Bashkimit European.

67 Peter A. G. Van. Bergeijk, Economic Diplomacy trade and commercial Policy. Possitive and negative sanctions in a neë World order. Erdward Elgar Publishing Limited,1994

sa më sipër kërkojnë një rol më aktiv për promovimin e interesave të tyre heterogjene. Kështu krijohet nevoja për kuptimin e kuadrit të diplomacisë ekonomike bashkëkohore brenda së cilës zbatimi i një pune rezultative do të përafroj strategjitë e ndryshme në një emërues të përbashkët. Padyshim rritja e numrit të aktorëve që aktivizohen në diplomacinë ekonomike do të ketë një ndikim të dukshëm në procesin e marrjes së vendimeve. Për arsye të interesave heterogjene procesi i vendimarrjes do të bëhet më pak rezultativ. Nga ana tjetër, ekzistenca e shumë aktorëve do të siguroj më shumë informacion dhe do të shkoj drej procedurave më demokratike me më shumë ligjshmëri dhe llogaridhënie. Aktorët në ambientin ndërkombëtar-kryesisht shtetet-veprojnë në një arkitekturë globale e cila prodhon sfida të reja. Në sfidat e tyre shtetet pa shmangshmërisht hyjnë në procese negocimesh periferike dhe ndërkombëtare duke shfaqur kërkesat e tyre me objektiv përfitime të gjera politike. Vitet e fundit janë shtuar ndër veprimet në fjalë ku në fazën fillestare të tyre kanë dimension ekonomik dhe pasohen me forma menaxhimi diplomatike.

### **Diplomacia Ekonomike në kaudrin e Kombeve të Bashkuara**

Në nenin 55 të Kapitulli i IX të Kartës së Kombeve të Bashkuara përmendet specifikisht:

Kombet e Bashkuara duhet të promovojnë<sup>68</sup>:

1. Standartet e larta të jetesës, punësim të plotë dhe kushte ekonomike, progres social dhe zhvillim;  
Zgjidhje të problemeve ndërkombëtare të ekonomisë, të problemeve sociale, shëndetësore, dhe problemeve të ngjashme dhe bashkëpunimit kulturor, edukativ ndërkombëtar; dhe
2. Respekt universal dhe mbikqyrje për të drejtat e njeriut dhe lirive fundamentale për të gjithë pa dallime në racë, gjini, gjuhë ose besim fetar.

Kapitulli i IX i Kombeve të Bashkuara i është dedikuar Bashkëpunimit Ekonomik dhe Social Ndërkombëtar.

*Në vazhdimësi në nenin 56 specifikohet: Të gjitha vendet anëtare zotohen të ndër marrin masa të përbashkëta ose të vecanta me Organizatën për arritjen e objektivave të vendosura në nenin 55.<sup>69</sup>*

Megjithëse Kombet e Bashkuara njihen gjerësisht si një organizatë e cila i është dedikuar paqes dhe sigurisë, nga sa është përmendur më sipër vihet re një përkushtim i barabartë për zgjidhjen e problemeve globale të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, social, problemeve shëndetësore, kulturore dhe të drejtave të njeriut. Sipas studjuesit të njohur të ekonomisë ndërkombëtare

68 <http://www.un.org/en/documents/charter/chapter9.shtml>

69 ibid

Rahman Mahfuzur: nuk ka as edhe një organizatë ndërkombëtare që të ketë diskutuar kaq shumë dhe për një kohë të gjatë çështje të ekonomisë botërore si edhe të ketë mbështetur bashkëpunimin ndërkombëtar me kaq këmbëngulje se sa Kombet e Bashkuara<sup>70</sup>. Çështjet ekonomike janë një pjesë e pandarë e diskutimeve dhe problematikave të Kombeve të Bashkuara.

Në vazhdim të sa më sipër duhet theksuar se mbi një të tretat e buxhetit të Kombeve të Bashkuara i dedikohen qëllimeve ekonomike dhe mirëqënies sociale. Rrjedhimisht edhe shpërndarja e personelit-të brendshëm ose të jashtëm të kësaj organizate dhe organizmave mbështetës së saj është kundrejt këtyre qëllimeve. Veprimtaria ekonomike, sociale dhe zhvilluese e KB ushtrohet në të gjitha shtetet e botës. Problemet ekonomike me të cilat përballen shtetet në zhvillim kanë ndikimet e tyre edhe në jetën sociale. Kështu që përballja me këto probleme në mënyrë që të kemi rezultate sa më pozitive duhet të jetë në të dyja nivelet, atë ekonomik dhe social. Këshilli Ekonomik dhe Social (ECOSOC) i Kombeve të Bashkuara është i vetmi organizëm i cili është përgjegjës për përballjen, udhëzimin dhe drejtimin e çështjeve në fjalë.

### **Ndërvartësia Ekonomike në Politikat e Kombeve të Bashkuara**

Marrëdhëniet ekonomike midis shteteve nuk përbëjnë një fenomen të ri në arenën ndërkombëtare por pas krijimit të Kombeve të Bashkuara volumi i shkëmbimeve tregëtare është shumë fishuar. Vlera e eksporteve globale (duke vecuar vendet e bllokut komunist dhe Jugosllavisë) nga 63 miliardë dollar në vitin 1948 shkoi në 107 miliardë dollar në vitin 1958 dhe në 280 miliardë dollar në 1968. Deri në 1977 kjo vlera shkoi në 428 miliardë dollar.<sup>71</sup> Megjithatë pas vitit 1973 dhe deri në mesin e viteve 1980 rritja mesatare u ul dhe vlera reale e shkëmbimeve ekonomike rra me rreth 25%. Pas vitit 1985 si vendet e zhvilluara edhe ato në zhvillim ju rikthyen niveleve normale të zhvillimit. Si një prej institucioneve jo pjesmarrëse të Bretton Woods, GATT (General Agreement on Trade and Tariffs) u krijua me objektiv rregullimin e tregëtisë botërore. Zhndërrimi i GATT në vitin 1995 në Organizatën Botërore të Tregëtisë (OBT, WTO) i dha një rëndësi akoma më të madhe këtij institucioni ndërkombëtar. Sidoqoftë duhet përmendur se as GATT dhe as WTO nuk ishin asnjë herë pjesë integrale e Kombeve të Bashkuar por sigurish kishin një lidhje të ngushtë me njëra tjetrën. Nga ana tjetër KB kanë krijuar institucionet e tyre për kontrollin dhe ndihmesën në tregëtinë globale. UNCTAD është organizmi më i rëndësishëm i KB. Institucioni lidhës ndërmjet WTO dhe UNCTAD është ITC (International Trade Council). ITC bashkëpunon me vendet në zhvillim për

70 Rahman Mahfuzur, 2002, "World economic issues at the United Nations: Half a Century of Debate", Boston, Botimet Kluwer, fq xii

71 United Nations Statistical Yearbook, 1978, Table 14, fq 55

krijimin e politikave të suksesshme dhe konsolidimin e programeve zhvilluese.

Një lloj tjetër ndërvartësie ekonomike përbëhet nga marrëdhëniet ndërkombëtare ekonomike dhe financiare. Kështu në Qershor të vitit 1944 u mblodhën në Bretton Woods përfaqësuesit nga dyzet e pesë shtete për të krijuar një system ekonomik dhe financiar. Këto organizata u krijuan në kuadrin e planifikimit të epokës së pas luftës së Dytë Botërore. Kështu Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF) dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) ose thënë ndryshe Banka Botërore (ËB) janë dy organizatat bazë të zhvillimeve financiaro ekonomike në botën e sotme. Vendet e bllokut komunist nuk ishin anëtare të këtyre dy organizatave. Me rënjen e perdes së hekurt edhe Rusia si trashëgimtare e Bashkimit Sovietik edhe vendet e tjera të lindjes u pranuan si vende anëtare në IMF dhe WB duke i shndërruar në organizata me ndikim global.

Gjatë viteve 1945-1947, vendet Europiane shfaqën deficit të lartë dhe kapitalet e FMN dhe BB nuk mjaftonin për të mbulimin e tyre. Gjatë dhjetëvjecarit tjetër dollari u shndërrua në monedhën e qëndrueshme të shkëmbimeve dhe Shtetet e Bashkuara ndoqën një sërë politikash të cilat kishin si qëllim lëvrimin e dollarit për të lehtësuar likuiditetin në shkëmbimet ndërkombëtare.

Sistemi fillestar i Bretton Woods nuk arriti të mbijetoj dhe kësisoj duhej të riformatohej. Në fund të viteve 1960, bankat qëndrore nuk mundën të kontrollojnë rrjedhjen e madhe dhe të paqëndrueshme të shkëmbimeve. Sistemi i qëndrushmërisë të shkëmbimeve tregoi shënja lodhjeje. Kriza e arriti kulmin e saj gjatë presidencës së Niksonit me shpalljen e “Politikës së re ekonomike” pa u këshilluar së pari me vendet europiane dhe Japoninë.<sup>72</sup> Në samitet që ndoqën këtë vendim, u shfaqën ankime të forta rreth politikave që ndiqnin Shtetet e Bashkuara si edhe rreth kundërshtive të saj për të ndërhyrë në tregjet e shkëmbimeve të jashtme. Me rritjen e deficitit ndërkombëtar në tregëtinë ndërkombëtare u prek edhe ekonomia e Shteteve të Bashkuara. Akoma më shumë vihet re një problem edhe më i madh, kriza e borxheve e vendeve në zhvillim gjatë dhjetëvjecarit 1980 rrezikoi të shkaktoi një krizë botërore. Rritmet e zhvillimit ekonomik për vendet në zhvillim gjatë 1980 u zvogëluan dukshëm, gjë e cila nxiti nevojën për lëvrimin e borxheve dhe fondacioneve nga institucionet financiare ndërkombëtare ose në mbikqyrjen e rreptë të tyre. Me kalimin e viteve rritet nevoja për shuarjen e një pjese të mirë të këtyre borxheve, kështu Franca deklaroi shuarjen e një të tretës së borxheve të saj për vendet e Afrikës sub sahariane.<sup>73</sup> Kështu në vitin 1999 u krijua iniciativa

72 Politika e re ekonomike përmbante rrëzimin e rregullin e njësisë matëse më arin dhe vendosjen e rritjes së taksës së importeve me 10%.

73 A. LeRoy Bennett-James K. Oliver, 2006, “ Διεθνείς Οργανισμοί. Αρχές και Προβλήματα”, Botimet Gutenberg, Athens, fq 378

me titull "Jubileu 2000" nga një grup Organizatash jo fitimprurëse me objektiv sensibilizimin e vendeve të zhvilluara për shuarjen e borxheve të Botës së Tretë. Por me gjithë përpjekjet për sensibilizim institucionet e mëdha financiare ose edhe G7, G8, G20 kanë hedhur hapa shumë të ngadaltë për shuarjen e këtyre borxheve. Përpjekjet e tyre me krijim e HIIP (Heavily Indebted Poor Countries) ku përfshihen 41 shtete janë një hap pozitiv por duhet theksuar shumë të ngadalta duke marr parasysh se borxhi i këtyre vendeve është shumë i vogël krahasimisht me borxhin total të vendeve të Botës së Tretë.

Nga ana tjetër një pengesë serioze për implementimin e masave të suksesshme janë edhe rregjimet e dhunshme dhe të korruptuara të shumë prej shteteve në zhvillim. Kështu përballja me varfërinë duhet të kryhet duke marrë një sërë reformash strukturore ekonomike, shoqërore duke investuar në inovacione, shëndetësi, uljen e nivelit të papunësisë, arsim dhe të drejtat e njeriut. Zgjidhja është ende shumë e vështirë për tu gjetur. Përballja me krizat është e vazhdueshme, duke përmendur këtu edhe krizën globale ekonomike financiare të vitit 2008, dhe si zakonisht vendet e varfëra janë ato të cilat kanë impaktin më të madh. Është detyrë e institucioneve ndërkombëtare financiare nën mbikqyrjen e organizatave si OKB që të administrojnë me politika globale këto kriza dhe jo si fenomene të vecanta.

Një tjetër formë ndërvartësie ekonomike ka të bëjë me transmetimin e dijeve teknike nga një vend tek tjetri. Ky transmetim kryhet në të gjitha nivelet e teknologjisë, shkencës etj. Krijimi i ECOSOC dhe rreth dymbëdhjet organizmave të specializuar nën varësinë e OKB shërbejnë për transmetimin e ndihmës teknike tek vendet në zhvillim duke pasur si qëllim primar përmirësimin e nivelit të jetesës. Ndihma teknike mund të transmetohet nga vendet e zhvilluara por edhe nga ato në zhvillim. Transmetimi i teknologjisë përmban gjithashtu edhe pjesmarrjen e organizatave private si edhe atyre publike. Kështu shoqëritë shumëkombëshe shërbejnë si mjete transporti teknologjish në të gjithë botën. Por fatkeqësisht ky transport funksionon më shumë nga shtetet e zhvilluara kundrejt atyre të zhvilluara se sa nga ato të zhvilluara në ato në zhvillim. Shenjat e ndërvartësisë ekonomike u shfaqën me fillimin e krijimit të tregjeve periferike ekonomike dhe rrjedhimisht edhe bankave për zhvillim periferik. Shembulli tipik është Bashkimi Europian ku ekzistenca e kufinjve fizik dhe ekonomik nuk ekziston.

Zhvillimi i shpejtë i kompanive shumëkombëshe ka kontribuar në ndërvartësinë ekonomike duke tejkaluar edhe transportin e teknologjive tej kufinjve kombëtar. Një numër i madh i këtyre kompanive i kanë shpërndarë degët e tyre në vende të ndryshme të botës duke decentralizuar veprimtarinë e tyre. Rrjedha e investimeve, të mirave, teknologjisë, fitimit dhe kontrolleve administrative vihen në lëvizje nga veprimtaria e këtyre kompanive. Kritja e

ndërvartësisë ka shkas edhe uljen e burimeve natyrore, uljes së nivelit të lëndëve të para. Kështu edhe shtete si SHBA në vitet 2000 u detyruan të importojnë më shumë se gjysma e sasisë së lëndëve të para bazë që përdoren për industrinë.<sup>74</sup> Ndërvartësia e ekonomike si rrjedhojë edhe e globalizimit shfaqet në forma, densitet dhe shpejtësi të ndryshme ku rezultatet e saj do të jenë në varësi të bashkëpunimit ose jo midis vendeve.

## BIBLIOGRAFIA

- A. LeRoy Bennett-James K. Oliver, 2006, “ Διεθνείς Οργανισμοί. Αρχές και Προβλήματα”, Botimet Gutenberg, Athens
- Ansari Javed, “ The Political Economy of International Economic Organization”, Boulder CO: Lynne Rinner, 1986
- Gerard J. Mangone (ed), “ UN Administration of Economic and Social Programs”, New York, Columbia University Press, 1996
- Handelman Howard, “ The Challenge of Third World Development”, Uper Saddle River, New York: Prentice-Hall, 1996
- Henk- Jn Brinkman, International Economic Diplomacy at the United Nations, James Muldoon Jr.; Joan Fagot Aviel, Richard Reitano, Earl Sullivan (eds), Multilateral Diplomacy and the United Nations today, Westview press, 2005
- James Barrow (ed), “ The united Nations: Past, Present, and Future”, New York, Free Press, 1972
- K. Holsti, International Politics: A framework for Analysis. Economic Instruments of Policy, Prentice/Hall international, 1974
- Lester R. Brown, “ The Interdependence of Nations”, Headline series, No 212, New York, Foreign Policy Association, October 1972.
- Michael Mastanduno, Economic statecraft, interpedence and national security: Agenda for research. Jean- Mare Blanchard, Edward Mansfield, Norrin Rispman (eds) PoWer and the purse: Economic Statecraft, Interdepence and National security, Frank Cass.
- Peter A. G. Van. Bergeijk, Economic Diplomacy trade and commercial Policy. Possitive and negative sanctions in a neë World order. Erdward Elgar Publishing Limited, 1994
- Rahman Mhfuzur, 2002, “ World economic issues at the United Nations: Half a Century of Debate”, Boston, Botimet Kluwer
- United Nations Statistical Yearbook
- [www.un.org](http://www.un.org)
- [www.oecd.org](http://www.oecd.org)
- [www.undp.org](http://www.undp.org)

---

74 Ibid, 380

## FAKTORET SUBJEKTIVE SI ELEMENT I VRASJES ME PARAMENDIM

**Alketa Elezi**

Mediterranean University of Albania  
info@alketaelezi.com

### ABSTRACT

*Among many important problems in the history of mankind since its beginning until now its crime. Although with all the crime diversity that the society is faced among the ages, one of the most dangerous i terms of consequences is murder, especially those planed. For this purpose i decided to talk about this kind of problem, mainly because for the high social riskiness that this profiled crimes tend to have. In this study case, the specific stands that i have treated the problem in an odd perspective, that of the murderer. The theme of the case is to treat the causes and reasons that push the person to do a criminal act. People are not born criminals, but along their life journey through growth and interactions with the society, every one of them experience different formation. Family, company, school, religion etc., orient and give us different paths, but always in the way that they assimilate within each of us. Primarily objectives are to show some of the of the internal reasons that push people to do these kind of crimes, this not to justify nor to make their standing easier, but especially to highlight these disorders of the individuals personality, to achieve to some point to deterrent the reasons that bring such damaging and dangerous consequences for our society. However that's not forget for a brief moment that although for the lawyer, this subject, is a client, for the prosecutor is an accused, for the judge is an indictee and for the victim (if right) is a criminal. In the area of these definitions for any moment we won't stop thinking that it is a human, and maybe we, the society, life with its problems, made him this way. Maybe they are just people with poor luck, that are raised in problematic ambient and families, that haven't had good relations, and had complexes, experiencing inferiorities and different traumas along their life.*

**Keywords:** *subjective factors, planed murder, personality*

## 1. Kuptimi i faktoreve subjektiv te vrasjeve

Nje nga problemet me serioze te shoqerise njerzore, eshte kriminaliteti ne pergjithesi dhe vrasjet ne vecanti. Ajo qe eshte me shqetesuese eshte se te gjitha keto sjellje te rrezikshme dhe anitshoqerore i kryejn individet ,genie njerzore normale qe dalin ne pune, bejne pazar,kane familje,rrisin dhe edukojne femijet e tyre,qe shkojne ne shkollë, jetojne mes nesh cdo dite, njerez te panjohur apo njerez qe kenni afer dhe eshte ajo qe te trondit me teper, fakti se pse keto njerez ndermarrin nje menyre aq ekstreme per te zgjidhur konflikte te ndryshme ne jete ose ceshtje te caktuara.. Te pakten ne shumicen e rasteve,ne nuk jemi me ne, ne ate moment kur vret nje njeri,cili eshte ai mekanizem brenda nesh qe na dominon ne nje shkalle te tille sa te na beje te mendojme dhe te jemi te bindur se nuk ka rrugezgjidhje tjeter.Ne pergjithesi, dhe eshte e pamohueshme qe synohet te nenvizohen shume faktoret objektive qe ndikojne ne formimin e nje individi si familja , arsimimi,mjedisi shoqeror dhe ambienti social etj qe per mendimin tim japin vetem siperfaqen e asaj ku qendron problemi i vertete dhe rrezikshmeria e tij me e madhe, ose vetem zanafillen , qe do te thote se jo vetern studimi i ketyre faktoreve objektiv eshte shume i rendesishem vecanerisht ndikimi i tyre tek individet por qe te jepet nje tablo me e qarte e ketyre faktoreve duhet te shohim se ku ndikojne me konkretisht. Jane faktoret subjektiv te nje individi ata qe jane ne kontakt me ato objektiv dhe celesi i kesaj ceshtje eshte te shohim se si nderthuren me njeri-tjetrin ne individ te ndryshern dhe se sa eficente e frutdhenese eshte kjo nderthurje,e ne rast te kundert sa destruktive e fatale paraqitet ajo. Prandaj ne literaturen kriminologjike me shume te drejte ekziston bindja se veprimet kriminale ose jo jane pikerisht burim i kesaj nderthurje. Po cfare dhe kush jane faktoret subjektiv?Me faktore subjektiv ne kriminologji duhet te nenkuptohet personaliteti i njeriut dhe komponentet e tij, veprimet kriminale ne pergjithesi dhe ato te vrasjeve meparamendim ne vecanti vijne si rezultat i procesit te nderveprimit, dhe nderthurjen e personalitetit te individeve me mjedisin ne te chin gjendet dhe formohet ky personalitet. Thuhet se ndikimet e faktoreve te jashtern ne sjelljet dhe veprimet e personalitetit varen shume nga vete struktura biologjike dhe psikike e atij individi, sepse jane keto veti biologjike dhe psikike komponente ose perberes me rendesi vendimtare ne jeten e njeriut

### 1.1. Personaliteti, kuptimi dhe vetite e tij

Mbi personalitetin ka nje mori perkufizimesh qe asnjeri nuk mund te hidhet poshte apo te cilesohet me i rendesishem se tjetri, por nga ana tjetere asnjeri nuk mund te konsiderohet si ai qe ka percaktuar me se miri dhe ne menyre te plote konceptin e tij. Nje fenomen i tille deshmon me se miri natyren komplekse dhe relative te personalitetit,pra nuk ekziston nje postulat, perkufizim apo

nje formule brenda te cilit te identifikohet nje koncept i tille. Gordon Allport shqyrtoi rreth 50 perkufizime ne 1961,dhe shume te tjere jane propozuar qe atehere,dhe ja disa prej tyre: Sipas Pettijohn personaliteti eshte nje model i dallueshem dhe i qendrueshem sjelljes dhe i njohjes qe karakterizon pershatjen e nje personi ne jete. Ndersa Singer ne 1984 shihte personalitein Si perberje sjelljesh publike te nje personi qe perfshijne shprehjet verbale dhe joverbale, motivesh personale, mendimesh dhe emocionesh. Mischel ne 1986 perkufizon personalitetin si model te qendrueshm te pergjithshm dhe te dallueshm te sjelljes ne pergjigje te ngjarjeve dhe njerezve perreth. Megjithe larmine e perkufizimeve qe gjejrme mbi personalitetin ne na interson te njohim dhe te studjojme kryesisht personalitetin e njeriut delinkuent ,dhe me konkretisht atij qe vret me paramendim ,pra qe merr nje vendim per te kryer vepren penale te vrasjes ,e pergatit ate ne te shumten e rasteve deri ne detajet me te imtesishme dhe e kryen ate, sepse vete vepra penale eshte nje akt i vetedijshem i nje personi normal me nje personalitet te caktuar.Por duhet te theksohet ne menyre te vazhdueshme se personaliteti ka nje mori formash ne te cilat shfaqet por ate qe ne kerkojme mund ta arrijme duke pare disa ane relativisht te qendrueshme te sjelljes se nje individi.Them sjelljes te nje individi sepse nepermjet sjelljeve te tij ai manifeston deri ne nje fare mase(sepse jo te gjitha sjelljet duhet domosdoshmerisht te kene nje prejardhje te tille) personalitetin e tij. Sepse shume veprime kriminale te ketyre individeve per tu kuptuar me mire duhet ti kalojm imtesisht nepermjet analizes se rrethanave konkrete dhe kryesisht te struktures psikike te tyre.Cilesite tipike te personalitetit te cilat kushtezojne sjelljen e njeriut, shprehen gjithmone ne menyre individuale dhe konkrete.Dhe me cilesi te personalitetit nenkuptojme cilesi psikike,morale,kulturore etj te cilat ne nje fare menyre pasqyrojne dhe kushtet shoqerore ne te cilat ky individ ose subjekt kriminal ka jetuar dhe eshte relacionuar me njerezit e tjere.Keto cilesi jane individuale, diferencohen dhe shfaqen ne menyra te ndryshme per cdo individ, dhe pikerisht si rezultat i ketij ndryshimi paraqiten nje larmi sjelljesh e reagimesh ndaj ndikimeve te faktoreve te jashtem.Me kete mund te dalim ne perfundim se per te njejten ceshtje apo problem persona te ndryshem do te mbajne qendrim te ndryshme ne varesi te asaj se Si secili nga keto individe e percepton nje gje te tille, dhe ne baze te formimit te tij intelektual,kulturor,arsimor percakton zgjidhjen qe ai cmon si me te pershtatshme per rastin konkret. Keshtu qe cdo subjekt krimi ne pergjithesi, ne radhe te pare dhe ajo qe eshte me e rendesishme ,duhet te kihet parasysh se eshte nje qenie njerezore dhe jo nje koncept abstrakt dhe utopik qe perbehet nga ai qe quhet personalitet dhe qe nga menyra se si eshte formuar dhe se si e menaxhon,arrijme te kuptojme pse-ne e veprimeve antiligjore ose te pakten gjejme burimin e tyre. Ndersa ne lidhje me personalitetin duhet te nenvizoj se eshte nje teresi qe perbehet nga

nje sere cilesishe dhe vetish te botes psikike te secilit nga ne qe me konkretisht jane: Temperamenti, karakteri, inteligjenca, emocionet dhe shume veti te tjera .

#### • *Karakteri*

Me karakter kuptohet nje teresi vetish apo cilesish qe tregojne se si vepron individi ndaj vlerave, parimeve dhe rregullave morale dhe etike te shoqerise apo ambjentit te caktuar. Si njeri me karakter te forte paraqitet ai individ qe thote gjithmon te verteten, eshte koherent me veprimet e tij, eshte konsekuent dhe i qendrueshem ne sjelljet dhe veprimet qe ndermerr, persona qe nuk bien ne kompromise dhe qe vleresojne veten pa kaluar ne permasat e egocentrizmit, qe eshte i permbajtur e i durueshem, qe nuk bie pre e instikteve dhe nevojave materiale etj. Nje njeri pa karakter mund te konsiderohet nje njeri me ndergjegje te ulet, ato qe nuk i ka keto veti ose duke u mbeshtetur ne sa thame me siper nuk duan ti kene apo nuk kane pasur mundesi (objektive apo subjektive) qe ti kene. Tendenca eshte qe subjektet kriminal te konsiderohen te tille.

#### • *Temperamenti*

Temperamenti eshte nje veti apo cilesi tjeter e personalitetit qe manifestohet me reagimin e psikikes se njeriut ndaj ngacmimeve dhe nxitjeve te jashtme. Por me temperament nuk nenkuptojme vetem reagim psikik por dhe shpejtesine dhe zgjatjen e ketij reagimi. Ne baze te kesaj eshte arritur ne perfundim nga disa autore qe ky nocion mund trajtohet si mobilizim i pergjithshem i energjise qe disponon individi ne reagimin ndaj mjedisit e rrethanave konkrete. Ne literaturen psikologjike ekzistojne nje serre klasifikimesh mbi personalitetin por akoma sot vazhdon te mbetet ndarja e filozofit grek Hipokrati qe e ndau personalitetin ne kater lloje kryesore: kolerik, sanguin, flegmatik dhe melankolik. Temperamenti kolerik: Tek keto individe karakterisike 'Jane ndjenjat dhe emocionet e forta, intensive me marrjen e shpejte te vendimeve per te kryer dhe ndermarre veprime te ndryshme, Keto veti te ketij lloj temperamenti jane burim i sjelljeve negative dhe te vrazhda qe mund te cojne ne sjellje kriminale, sepse nje tjeter karakteristike e kolerikut eshte se jane kryenece e smirezinj dhe jo rralle pershkohen nga ndernja e hakmarrjes Temperamenti sanguin, eshte karakteristike per ata individe qe gjithashtu pershkohen nga emocione te vrullshme e te forta por ne ndryshim nga koleriket kjo gjendje te sanguinet nuk zgjat shum duke bere keshtu qe te ndryshojne disponim lehte dhe te kalojne nga gjendja e zemerimit ne gezim e hare. Ne literaturen psikologjike kriminale keto momente ne te cilat ato kryejne krime ne gjendje afekti cilesohen si gjendje psikike shpiterore te vecanta Temperamenti flegmatik ky lloj temperamenti eshte padyshim i ndryshem nga te meparshmit sepse individe te tille nuk karakterizohen nga reagime te menjershme apo emocione te forta e te pakontrolluara, perkundrazi emocionet e tyre shfaqen me veshtiresi, reagimet e tyre. Jane te ngadalshme dhe shqetesohen rralle. Persa i perket veprimeve

kriminale ata i kryejne me paramendim dhe shpesh paraqiten si recidivist.

- ***Shprehite dhe prirjet***

Shprehite janë një tjetër veti psikologjike subjektive të individit që krijohen, zhvillohen dhe ndryshojnë në ndikimin e mjedisit shoqëror. Keto shprehje dhe prirje formohen në ndikimin e vazhdueshëm të edukatës, raporteve shoqërore, ekonomike, kulturore e familjare, ku në qoftë se keto ndikime janë të forta dhe të vazhdueshme lënë gjurmë në psikikën e njeriut. Psh duke u rritur në një ambient ku vjedhjet, vrasjet e dukuri të tjera të tilla janë të vazhdueshme e madje dhe pjesë e realitetit, është me se normale që individë të tilla të marrin drejtime të tilla por jo domosdoshmërisht sepse individë në raste të rralla duke parë ambientin që e rrethon mund të lindë edhe dëshira të jetë ndryshe dhe të deshirojë për jetën e tij më të mirë me konstruktive.

- ***Inteligjenca***

Perkufizimi psikologjik i inteligjencës është: aftësi e të menduarit e zgjidhjes së problemeve dhe orientimit në situata të ndryshme, e ndërtimit të koncepteve abstrakte dhe e zgjidhjes së detyrave dhe problemeve që parashtrihen në jetën konkrete të personalitetit. Konsiderohet si aspekt i rëndësishëm i botes shpirtërore të individëve dhe si e tilla ndikon në veprimet dhe sjelljet e tyre. Është evidente që shkalla e inteligjencës ka lidhje me sjelljet kriminale por nuk është vendimtare. Sepse nëse ekzistonte ideja se krimet kryheshin vetëm nga persona me inteligjencë të ulët, praktika ka treguar se nuk është gjithmone kështu, përkundrazi ka pasur raste të personave të arsimuar dhe të përgatitur që kanë kryer krime.

- ***Emocionet***

Një nga përberësit e personalitetit të një individit, por dhe nga me të rrezikshmit nga pikpamja e qëndrueshmërisë dhe racionalitetit janë emocionet. Është me të rrezikshme sepse jo rrallë sjelljet e individëve janë të kushtëzuara dhe nxitura nga shprehjet emocionale që kur kapërcejnë kufijt e kontrollit të arsytuarit çojnë dhe në kryerjen e veprimeve kriminale. Ata çilesohen si ndryshim i aktivitetit dhe gjendjes psikike të një individit.

- ***Motivet***

Përsëri i përket motiveve janë një tjetër element shumë interesant i personalitetit, ato konsiderohen si nxitje ose forca që ndikon në fillimin e sjelljes dhe drejton intensitetin e qëndrueshmërisë e saj tek një individ i caktuar për arritjen e disa qëllimeve. Një këndvështrim analog i sheh motivet si veti e personalitetit që përbehen nga vetedija dhe vullneti që bëjnë që të gjitha aktivitetet e një individit me personalitet normal dhe pa probleme të drejtohen nga keto të dyja si rrjedhim të gjitha sjelljet e tyre të jenë të motivuara. Por nga ana tjetër edhe sjellja kriminale është derivat i shtytjeve të brendshme të motivuara nga interesi, dëshirat etj që përben gjithashtu një proces dhe

veprim te motivuar nga vetedija dhe vullneti. Sic e theksuam me siper nje gje te tille mund ta themi vetem per individ qe nuk vuajne nga crregullime te personalitetit sepse ata konsiderohen si persona me pergjegjesi te kufizuar ose te papergjegjshem fare, por behet fjale per individ qe si qenie te vetedijshme nuk veprojn vetevetiu ne menyre automatike por qe jane te nxitur dhe te shtyre nga procese dhe nevoja te brendshme qe me pas pasqyrohen ne sjellje ose veprime te udhehequra nga motive te ndryshme. Motivet ne kriminologji ndahen ne motive biologjike(primare) ose te lindura dhe ne motive sociale(sekondare) ose te fituara. Keto jane motivet qe lindin qe me lindjen e individit Keto jane nxitje dhe shtytje qe nuk jane te lindura por qe fitohen gjate procesit te zhvillimit, formimit, edukimit te individit ne shoqeri. perfshihen Ndarja qe i behet motiveve jane, motivi i vetepohimit, motivi i agresivitetit, motivi i sigurise dhe motivi material.

## **2. Kuptimi i posacem i vrasjeve me paramendim dhe faktoreve subjektive që ndikojne te kryersit e tyre**

Dikush i cileson si te sernure moral, dikush njerz si gjithë te tjeret .Megjithate ekziston fakti se jetojme ne te njejten bote por e shohim ate nga dy ane dhe kendveshtrime te ndryshme , e pse jo te kunderta. Statistikat tregojne se kriminele potenciale jane te gjithë ata individ qe rriten ne familje problematike, qe nuk frekuentojne shkollat, qe jetojne ne ambiente te rrezikshme ku delinkuenca eshte dominante E te gjitha keto se bashku pastaj perceptohen nga secili nga ne dhe pashmangshmerisht ne ambiente te tilla nuk mund te jene te favorshme per nje formim te shendoshe , per nje botë shpirtore te qete.Por duket se kur flasim per personalitetin jemi pak a shume skeptike se nuk mund te dalim ne konkluzione standart per gdo rrethane, vlen te theksojme se jo gjithmone individ te tille jane domosdoshmerisht te prirur per sjellje delinkuente sepse mbase pikerisht nga ajo qe kane perreth marrin spunto te jene ndryshe dhe te bejne dicka me teper per jeten e tyre. Ashtu si praktika ka deshmuar te kunderten ku dhe familje normale dhe te rregullta per nje arsye a nje tjetër kane pasur elemente delinkuente. Thashe dhe ne hyrje qe kryesisht u fokusuar te vrasjet e me konkretisht te ato me paramendim. Me cka pame me siper nje person , “ideal” i afte per te paramenduar mund te jete nje temperament flegmatik, karakter i dobet, me emoeione te papermbajtura, inteligjence mesatare dhe te larte etj, qe kane nevoje te mbrohen nga padrejtesite. Dhe prandaj vret per te vendosur nje te drejte, qe relacionohet me veshtiresi me ambjentin, qe eshte egocentrik, narcizist, agresiv e pa ndjenja. Duhet te kihet parasysh fakti që eshte shume e rendesishme per te miturit, qe te rriten te qete, ne ambiente te favorshme dhe ne menyre te tille qe faktoret e tyre te brendshem te relacionohen ne menyre te drejte me realitetin, sepse me ane te kesaj arrijne

te ekuilibrohen ne mes tyre, njerezit fitojne imunitet dhe autokontroll ndaj vetes se tyre ne raste konfliktesh, mundohen te reagojne ne menyre civile, dhe evitojne degjenerimin e situatave te ndyshme ne ekstreme.

### **3. Faktoret subjektive te vrasjeve me paramendim sipas tradites zakonore shqiptare**

Persa i perket vrasjeve me paramendim sipas tradites tone zakonore dihet qe jane rregulluar nga ana juridike nga kanunet me konkretisht al i Lek Dukagjinit dhe i Skenderbeut. Duke mos dashur te leme pas dore ate te Laberise apo te krahinave te tjera po shqyrtojme keto te dy duke pasur parasysh rendesine e madhe qe kane pasur por mbi te gjitha per shtrirjen me te madhe si ne hapsire ashtu edhe ne kohe te ndikimit te tyre. Ka shume studime te ndryshme botime libra etj qe studiojne kete plage te shogerise shqiptare qe ne origjinen e saj e fatkeqesisht den i ne ditet tona si ka evoluar ky fenomen. Por interes me te vecante paraqet shqyrtimi se cilat jane arsyet qe come nje njeri te vrase pra cfare jane keto dy momente te rendesishme qe perbejne dhe motivet kryesore te cilesimit nga ana juridike e nje vepre te tine ai i hakmarrjes dhe i gjakmarrjes. Por para se te hyrjne ne detaje te tilla eshte me mire te japim si fillim disa koncepte mbi keto lloj vrasjesh dhe evoluimin e tyre gjate viteve.

#### ***3.1. Kuptimi i vrasjeve per hakmarrje e gjakmarrje***

Nga disa studime nder vite te perkufizimit juridik te vrasjeve per motive hakmarrjeje dhe gjakmarrje nga kode penale te periudhave te ndryshme historike shohim se: Legjislacioni penal shqiptar i viti 1928 nuk kiente dallimin mes termit te hakmarrjes me ate te gjakmarrjes por ajo qe eshte me e rendesishme eshte qe e perfshinte nocionin e paramendimit. Ndersa nga praktika gjyqsore e periudhes se paraclirimit gjakmarrja interpretohet jo si cdo hakmarrje tjeter por vetern per marrjen e gjakut, per nje vrasje te meparshme. Kodet penale te 1952 dhe 1977 perdori vetem termin hakmarrje, nje interpretim i ngushte termit te gjakmarrjes. Vrasjet per gjakmarrje ndryshojne nga ato per hakmarrje dhe vete jane dy nocione te ndryshme. Vrasja per gjakmarrje ne pergjithesi kryhet per te marre gjakun e nje vrasje te meparshme, apo per tentative vrasjeje apo per plagosje te rende apo te lehte, kurse vrasja per hakmarrje behet si shpagim per rrahje , fyerje, dhune e veprime te padrejta te meparshme. Udhezimi i plenumit te gjykates se larte 1981 dhe praktika gjyqsore ka bere kete dallinn, duke i cilesuar vrasjet per hakmarrje ne kuptimin e gjere te fjales si vrasje per shkaqe te dobeta. Autori kosovar Drismet Salihu ka shfaqur mendimin se “ vrasjet nga gjakmarrja duhen konsideruar ato vrasje, qe kryhen per shkak te nje vrasje te meparshme, tetentatives se vrasjes ose bashkryerjes ne vrasje, me kusht qe te jene kryer vetem ndaj kryeresve te ketyre veprave dhe brenda nje periudhe te

caktuar kohe. Doc. Grigor Gjika ka shprehur mendimin se vrasja per hakmarrje eshte ajo qe kryhet per “ armiqesi gjaku. Kete pikepamje ka shprehur edhe Dr. Emid Tedeskini. Ky qendrim i drejte i literatures tone juridike lidhur me kuptimin e hakmarrjes dhe gjakmarrjes, sherben si baze per sqarimin e te gjitha geshtjeve te tjera qe i perkasin asaj. Perkufizimi i ketyre dy koncepteve por mbi te gjitha evidentimi i dallimeve mes tyre eshte shume i rendesishem jo vetern per cilesimin juridik te ketyre veprave penale ,por gjithashtu per motivet e ndryshme qe cojne deni ne vrasje.

#### **4. Faktoret subjektive te vrasjeve me paramendim sipas jurisprudences shqiptare**

Persa i perket vrasjeve me paramendim sipas jurisprudences shqiptare, vrasjet me paramendim ne Kodin Penal te Republikes se Shqiperise eshte parashikuar ne nenin 78, ku thuhet qe:

- a. Vrasja me paramendim denohet me burgim nga pesembedhete den i ne njezete e pese vjet.
- b. Vrasja e kryer per interes, hakmarrje a gjakmarrje denohet me burgim jo me pak se njezet vjet ose me burgim te perjetshem.

Pra mesa shohim, ky nen eshte shume i vaket e mbi te gjitha paragrafi i dyte qe ne nje fare menyre duhet te paraqiste dicka me konkrete se cilet jane efektivisht motivet qe shtyjne nje individ te kryejne nje yelper me nje rrezikshmeri te title shoqerore.

Megjithate deri ne nje fare mase kete “boshllek” eshte munduar ta plotesoje doktrina e se drejtes e cila ka shtuar qe paramendimi si karakteristike kryesore, sic e kemi thene dhe me siper, ka faktin se kalon ne disa faza te caktuara qe shkojne nga momenti kur subjekti ka pesuar shkakun provokues, me castin kur eshte kryer efektivisht vrasja, per vete faktin se nje mendim para se te kthehet ne veprim ne mendjen e njeriut kalon nje interval kohor i caktuar. Por koha ne fjale nuk eshte element i mjaftueshem per te percaktuar paramendimin ne vrasje. Paramendimi duhet te percillet nga “dashja e paramenduar” dhe nga nje motiv i dobet antishoqerore si interesi, hakmarda, gjakmarria, xhelozia etj qe e nxit fajtorin te kryej vrasjen e tjetrit. Gjithashtu dy elemente te rendesishem per vrasjen me paramendim dhe me konkretisht anes subjektive te tij jane gjakftohtesia dhe vendosmeria per te kryer nje veper te tille. Me tej konkretizohet qe, gjithmone sipas teorise te se drejtes penale, qe me vrasje per interes kuptohet vrasja e kryer e nxitur nga motive interesi material si vrasie me pagese, per ndarje pasurie, per konflikte toke, trualli etj. Nga ana subjektive keto lloj vrasjesh nxiten kryesisht nga motive te perfitimit material. Vrasjet per hakmarrje kryhen si shpagim per nje dhune apo veprimi te padrejte psh per shkak te rrahjes, fyerjes etj. Vrasjet per gjakmarrje kryhen per te marre

gjakun e nje te afermi, sipas rregullit kanunor "gjak per gjak". Pra sic e pame ne njefare menyre jane nenvizuar me shume se cilat jane ato motive qe ndikojne ne menyre aq fuqishem sa te shtyjne nje njeri tjetër te vrase. Po te behej nje riklasifikim te ketyre vrasjeve, shume te rrezikshme per nga disproporcioni qe ekziston mes motivit dhe pasojës. I referohem vrasjeve per motive materiale dhe ajo qe eshte me shume tronditese se mbi cfare bazash apo kriteresh mund te percaktohet cmimi real ne vlere monetare i jetes se nje njeriu, qofte ky i mire apo i keq. Prandaj dhe vrasjet me paramendim ne gjirin e llojit te tyre kane nje nenklasifikim, duke u nisur nga mizoria e motiveve qe shtyjne ne vrasje te tilla.

### *Konkluzione dhe rekomandime*

Eshte e veshtire te percaktohen rregulla standarte ne baze te te cilave te arrihet te individualizohen tiparet e nje vrasesi tipik, por nga ana tjetër mund te studiohen ato qe jane me evidente ne nje personalitet te tille. Nje rol shunie te rendesishem dhe domethenes kishte ambienti ku formohen keta individe, ku rriten dhe edukohen, ku fillon procesi i tyre i socializimit dhe i relacionimit me te tjeret dhe me ambjentin perrreth. Pra ajo qe paraqiste rendesi ishte se cfare impakti kishin keta faktore objektive, ne personalitetin e individeve, ne brendesine e secilit nga ne, Si asimiloheshin ne menyre individuale nga cdo njeri. Mbi te gjitha qellimi ishte te viheshin ne dukje momentet kur keto impute nga jashte luanin nje rol negativ, ne pergjithesi per vete natyren e tyre, duke u bere keshtu premise per tu kthyer ne burim sjelljesh kriminale, duke paraqitur rrezik per shoqerine ne pergjithesi por mbi te gjitha per individin konkret ne vecanti. Kane mbetur pa u cituar, ceshtje te tilla si ndikimi i neurozave dhe i psikozave tek subjektet kriminale, po duke dashur te ndalem pak ne kete pike, do te doja te sqaroja se qellimi primar i kesaj teme ka gene te studjoj faktoret e brenshem subjektive, dhe jo ato patologjike. Nje qeshtje tjetër e rendesishme, gjithmone ne aspektin e vrasjeve me paramendim, ose ne rastin konkret do te ishte me mire te themi nje figure krimi tipike e ketyre lloj vrasjesh jane dhe vrasjet ne seri. Subjekte te ketyre krimeve jane "serial killer" ose vrasesit ne seri. Nje nje problem te tille e kam meduar si te papershtatshen, te pakten ne nje kontekst te tille, kjo per faktin se ne Shqiperi nuk eshte nje figure krimi shume e perhapur, gje qe e deshmon dhe praktika gjyqsore. Prandaj jam munduar te trajtoj ato figura krimi me te perhapura dhe karakteristike ne Shqiperi, si vrasjet per gjakmarrje dhe per hakmarrje. Per vete natyren komplekse te psikikes se njeriut duhet te merren masa, qe megjithese te gjithë ne jete perballemi me probleme dhe strese, por Jo te gjithë reagojme ndaj tyre me rrugezgjidhje ekstreme, ata individ qe paraqesin probleme qe nuk kane stabilitet, dhe qe gjithcka per ta eshte kercenim i drejtuar kunder tyre, per ata qe mendojne se jane aq te zote sa te vendosin drejtesi vete e mbi te gjitha per ata per te diet jeta e njeriut nuk eshte gje tjetër vecse nje pengese per tu kapercyer, te reflektojme

per te arritur ne një zgjidhje te genesishme. Studimet kriminologjike paraqesin nje rendesi te madhe, kjo per faktin se nuk jane thjesht kerkime empirike qe mbesin ne kufijte e teorise. Perkundrazi kriminologjia eshte e vetmja shkence qe pasqyron faktoret kriminogjen dhe gjendjen kriminale ne te cilen ndodhet shocieria. Sepse pasqyron ate qe perben fillimin e sjelljes kriminale qe me pas finalizohet ne vrasje, viktime, krimineli.

## BIBLIOGRAFIA

- Psikologjia sociale. Edmond Dragoti. Shtepia botuese "Libri universitar" Tirane 1999
- Psikologjia. Terry.F.Pettijohn (nje hy-e koncize)botimi i dyte. Shtepia botuese»Lillo» Tirane1996
- Psikologjia nnjeksore. Anastas Suli,Ariel Como,Valbona Alikaj. Botim I departamentit te neurologji-neurokirurgji-psikiatrise.Fakulteti mjeksise. Universiteti i Tiranes. Shtypur «Geer» Tirane 2004
- Personaliteti dhe crregullimet e tij. Nazim Shtino, Anita Pilika. Botuar nga instituti i shendetit mendor "Mental" Tirane 2001.
- Streset ne fokus. Piro Lazi(kol) Dr. I shkencave psikologjike. Shtypur «Geer» Shtator 2000 Tirane
- Mendimi juridik shqiptare. Dr.Prof.Ismet Elezi. Shtepia botuese «Albin» Tirane 1999
- Kriminalogjia. Vasilika Hysi Tirane 2005
- Kriminalogji-Penalogji. Jani Papandile, Prof.Asc.Dr Mir Mandro Shtepia botuese "liar" Tirane 2002
- Veshtrim kriminologjik Jani Papandile Shtepia botuese "liar", Tirane 2000
- Kriminalogjia Dr. Ragip Halili Universiteti I Prishtines ,Fakulteti juridik Prishtine 2002
- Mbi kriminologjine Prof. dr. Ismet Elezi
- Criminologia.11 contributo della ricerca alia conoscenza del crimine e della reazione sociale. Tulio Bandini, Umbero Gatti, Maria Id° Marugo, Alfredo Verde. Giuffre editore Milano 1991
- Criminologia Gunther Kaiser, a cura di Elio Moreslli e Carla Blonk Steiner,presentazione di Franco Ferracuti Dott.A Giuffre editore Milano 1985
- Giurisprudenza comentata di diritto penale (volume primo). Delitti contro la persona, contro Il patrlmonio e in materia di stupefacienti. Paolo Pisa. Casa editrice:Dott. Antonio Milani. CEDAM Pad ova 1995.
- Kodi Penal Shqiptar. Viti 1928
- Kodi Penal. Tirane 1995

- Kanuni I Leke Dukagjinit (varianti I Pukes) Xhemal Meci, Shtepia botuese «Cabej» Tirane
- Permbledhje sistematike e zakoneve juridike te vjetra shqiptare Zef Benusi(Studim) Botim i komisionit drejtesi dhe page. Shkoder 2002
- Kanuni I Leke Dukagjinit ( veper postueme). Permbledhje kodifikue nga At.Shljefen Konst Gjecovi OFM Me parathenie te At. Gjergj Fishtes e bibliografi te At. Pashk Bardhit OFM Shtypshkronja Franceskane Shkoder 1933
- Vrasjet per hakmarr dhe per gjakmarrje no Shqiperi. Prof. dr. Ismet Elezi Botim i qendres shqiptare per te drejtat e njeriut. Tirane 2000
- Revista «Pajtimi» (gjashtemujorshe) Sociologjike-Juridike-Kulturore Viti VII Nr 1 Janar-qershor 2004 dhe Nr 2 Korrik-dhjetor 2004 Reviste e fondacionit «Zgjidhja e konflikteve dhe pajtimi mosmarrveshjeve»
- Kanuni I Skenderbeut
- E drejta penale (pjesa e posa-me) Ismet Elezi
- Informacion statistikore per 6mujorin e pare 2002. (ceshtje civile dhe penale) Ministira e Drejtesise, sektori i statistikes se unifikuar dhe teknologjise se informacionit. Tirane 30.09.2002
- Vjetari statistikor 2003. Republika e Shqiperise Ministria e drejtesise Tirane 2004
- Buletini stasisikor 2004 Republika e Shqiperise Ministria e Drejtesise Tirane 2005
- [www.themiscrime.com](http://www.themiscrime.com)
- [www.criminaliustice.civ.ca](http://www.criminaliustice.civ.ca)
- [www.criminalprofilinq.com](http://www.criminalprofilinq.com)

## E DREJTA ZAKONORE DHE PROCESI PENAL

**Ferdinand Elezi**

Court of Appeal, Durrës  
ferdinandelezi@yahoo.com

### ABSTRACT

*In the history of the state and Albanian justice, a special place holds also the customary law and its application in the criminal field. This work is based upon the short existing documentation of the time and the works done by famous authors of law, especially profiled in customary and criminal processes. (Records of initial forms of judgment or procedural rules that are born and have functioned in Albanian territories are few, to us they come as heritage from generation to generation)*

*In this work will be considered notably the evidence gathering, evidence investigation and overall of the criminal process based on customary law, mainly after "Kanuni i Lekë Dukagjinit". In its form factor the Albanian customary law, reflects the progress of many years of social and economic relation of the time which was divided in tribes, baryaks, patriarchies, provinces and principalities. Similar to other societies, the right and Albanian criminal law, has known for a long time progress in relation to society, stage of development of society itself. Absence of government and legislation for a long time, has prevented the creation of social norms or as we call it customary norms which in concrete have existed and functioned in the time, have had the purpose to regulate social relations and solutions of mismanagements like those with criminal profile.*

*The progress history of criminal process according to Albanian customary law, in notable not only for historical importance. Looking over this process it is clear that has been useful in the maintenance of order and rules for the society avoiding self justice and violence.*

**Keywords:** *customary law, crime, Albania*

### Organizimi gjyqsor dhe ndjekja penale

Kriminaliteti ka egzistuar që me lindjen e shtetit, dhe çdo shoqëri në të gjitha etapat e zhvillimit saj, ndaj sjelljeve e veprimeve që vinin në kundërshtim

me interesat e saj, ka reagu ndaj tij dhe ka mbajtur qëndrime sipas kushteve politike, ekonomike dhe sociale që kanë egzistuar në etapa të caktuara të zhvillimit të shoqërisë. Si në cdo shoqëri e drejta dhe e drejta penale shqiptare, ka njohur zhvillime sipas marëdhënieve shoqërore, stadi të zhvillimit të vetë shoqërisë. Mungesa për një kohë të gjatë të pushtetit qëndror dhe të drejtës shkruar (legjislacionit), ka kushtëzuar krijimin e normave të sjelljes apo sikurse i quajmë normave zakonore (dokeve) të cilat në kushtet konkrete që kanë egzistuar dhe funksionuar në atë kohë, kanë patur si qëllim dhe kanë rregulluar mardhëniet shoqërore dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe ato me karakter penal. “E drejta zakonore shqiptare është një e drejtë popullore e pashkruar, e trasmetuar brez pas brezi nga traditat gojore dhe që ka shërbyer për rregullimin e marëdhënies juridike gjatë shekujve në vendin tonë .

Gjatë kësaj periudhe janë aplikuar sipas njësive të organizimit shoqëror e zonave të caktuara të banimit, norma zakonore të cilat janë emërtuar si Kanuni i Lekë Dukagjinit, Skënderbeut, Labërisë etj... Për nga rëndësia, zbatimi më i gjërë, të dhënat më të plota që disponohen , përgjithësisht do të trajtojmë provat dhe procesin e të provuarit sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit. “Studiues vendas dhe të huaj që janë marrë me të drejtën zakonore shqiptare apo me institute të veçanta të saj janë përqëndruar kryesisht në Kanunin e Lekë Dukagjinit, edhe për faktin se Kanuni i Labëris në përmbajtje të tij përputhet me të” .

K.L.Dukagjinit u mbledh dhe u shkrua nga patrioti e shkencëtari i shquar Shtjefën Gjeçovi fillimisht me botimet në revistën “Hylli i dritës” në vitet 1913 deri në vitin 1929. Pas vrasjes së Gjeçovit në vitin 1929 ai u botua në vitin 1933 në Shkodër nga etërit françeskan dhe me parathenie të Atë Gjergj Fishëts. “Ligjet dhe kanunet i atribuohen Lekës, duket qart se ato janë më të hershme sesa shekulli XV, koha kur ai ka jetuar. Leka ka mbledhur ligjet egzistuese, kurse ligjet të tijat mund të jenë vetëm ato që kanë ndryshuar e ndaluar zakonet e vjetra. Ligjet në malet shqiptare ushtrohen e zbatohen nga një kuvend pleqsh. Çdo fis vetqeveriset. Zakonet ndryshojnë sipas krahinës” .

Në K. e L. Dukagjinit njihej si organ gjyqsor Këshilli i Pleqve ose Pleqësia e cila përbëhej nga krerët e fiseve si dhe njerëz të ndershëm të zonës, krahinës. “Në Këshillin e pleqve merrnin pjesë vetëm burra në moshë madhore, sipas mendimit që gratë e të rinjtë nuk mund të pleqnojnë, apo gjykojnë drejt” . Gjykimi kryesisht, nga pleqësia parashikohej vetëm në rastet e kapjeve në flagrancë dhe i dëmtuari nuk kishte të afërm. Për zhvillimin e gjykimit duhej të kishte padi gojore nga i dëmtuari ose përjashtimisht, padia “ex officio” kur autori kapej në flagrancë apo i dëmtuari nuk kishte të afërm .

Pleqësia kishte karakter patriarkal e fisnor ajo gjykonte çështje pa procedurë formale por sipas një riti të trashguar në breza. Pleqësia vihej në levizje vetëm kur ankohej pala e dëmtuar, në këtë rast përfaqësuesi i familjes,

fisit të dëmtuarit. Më së shumti është parashikuar e praktikuar sipas Kanunit të Labëris, ku pleqësia, kryesisht mund të investohej edhe pa kërkesën e të dmtuarit. “Praktika e zbatimit të Kanunit t Labërisë njihte edhe raste kur pleqtë investoheshin vetë për të hetuar e gjykuar një konflikt që sillte pasoja në shkall të gjërë. Kjo veçori e kanunit i jepte karakter pothuajse publik funksionit të gjyqit të pleqve dhe kufizonte të drejtën e disponimit material të konfliktit nga ana e palëve, që ishte tipar kryesor i procesit me karakter akuzator”. Gjykimi që zhvillonte pleqësia ishte i karakterit akuzator, në gjykim të hapur e publik në të cilin dëgjonte atë që akuzon, më pas të akuzuarin si dhe merrte provat mbi bazën e të cilave vendoste. Gjithë ky proces bëhej pa rregulla të përcaktuara ai ishte verbal (i pa shkruar) edhe vendimi nga pleqësia jepej me gojë. Ndaj vendimeve të pleqësis nuk kishte dhe nuk parashikohej mjet ankimi, ai ishte i ekzekutueshëm menjëherë.

Me mjaft rëndësi ishte apostulati në paragafin e 1002 të K.L.Dukagjinit, që “plak mbi plak, gjyq mbi gjyq dhe be mbi be nuk mund të ketë”. Nga kjo thënie gjërsisht e përdorur rrjedhin njëkohësisht elementë mjaft të rëndësishëm të së drejtës zakonore, ai i ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale, mohimi në përgjithsi i institutit të ankimit ndaj vendimit pleqsisë si dhe mbi provat indirekte, dëshminë indirekte dhe vlerësimin e saj. “Karakterit akuzator i procesit pasqyrohej jo vetëm në faktin se ai fillonte me iniciativn e të dëmtuarit por edhe me detyrimin që akuzuesi kishte të drejtën të kryente hetime, të zbulonte autorin dhe të mblidhte provat” .

Sipas Kanunit njihej e drejta e të dëmtuarit për të hetuar personalisht ose me ndihmën e pjestarve të tjerë të familjes, miqve, apo edhe caktuar edhe persona të specializuar (kapucar) për të hetuar rreth personave që kishin shkaktuar veprën penale ndaj tij apo dyshoheshin si të tillë. Kjo e drejt i takonte edhe vetë pleqsisë por që aplikohesh në raste të ralla. E drejta e të dëmtuarit për të kërkuar nga pleqësia zgjidhjen dhe gjykimin e çështjes ishte e lidhur detyrimisht me lëshimin e pengut, apo thënë ndryshe me lënien e një pengu, send me vlerë apo shume në të holla si garanci për gjykimin nga pleqësia. “Në fillim bëhej përpjekje për ta zgjidhur çështjen brenda fisit, katundit, bajrakut. Në qoftëse kjo nuk arrihej, atëhere nga i dëmtuari kërkohesh lëshimi i pengut dhe gjykimi nga pleqësia, ose siç quhet celja e padis. Palës që kërkohesh lëshimin pengut, duhej ti pergjigjej palës tjetër, për ndryshe ishte i detyruar me u mshelë, mbyllur në shtëpi” .

Kapucari ishte person ne përvojë në drejtim të hetimit dhe zbulimit të vërtetës, i njohur si njeri i ndershëm dhe që hetonte, zbulonte e merrte provat rreth akuzës së ngritur nga akuzuesi dhe që në përgjithësi mbetej i fsheftë. Kapucari caktohej nga akuzuesi dhe shpërblehej për veprimtarinë e tij. Shpërblimi i kapucarit paguhej nga i akuzuari nëse ai shpallej fajtor nga

pleqësia, në të kundër paguhej bashkarisht nga i akuzuari dhe akuzuesi, vlera e shpërblimit nuk mund të ishte më e lartë se e dëmit të shkaktuar. “Kapucari ngarkoheshin gjurmues me përvojë , të ndershëm dhe idenditeti i tij mbahej i fshehtë. Kur provat e paraqitura nga kapucari ishin bindëse për gjyqin e pleqve, çështjes i jepej fund dhe i akuzuari ngarkohej me faj” .

Pleqësia zakonisht përbëhej në numër të ndryshëm anëtarësh (zakonisht 12 anëtar) por që varionte edhe sipas rëndësisë së çështjes. Palët në konflikt kishin të drejtën e përzgjedhjes së anëtarëve të pleqësisë. Pleqësia duhej detyrimisht ta zgjidhte çështjen me votat e të gjithë anëtarëve të saj, në mënyrë unanime, në të kundërt vetë ata kërkonin që të merreshin pleq të tjerë për zgjidhjen e çështjes.

Gjykimi i çështjes. Proçesi i gjykimit rezultonte në procedurë formale, i pa dokumentuar në akte shkresore. Fillimisht akuzuesi, i dëmtuari paraqiste provat e veta dhe bënte interpretimin e tij, më pas i jepej fjala të akuzuarit i cili deklaronte qëndrimin e tij para pleqësisë. Nëse nuk pranonte akuzën e bërë jepte provat (nëse kishte) dhe shpjegimet rreth faktit për të cilin ai akuzohej. Pleqësia kur gjykonte çështjen, zgjidhte një kryepleqtar për drejtimin e gjykimit, ajo ulej në formë gjysmë rrethi dhe palët vendoseshin në të dy anët e saj. Vendimin e pleqësisë e deklaronte, shpallte kryepleqtari, vendim ndaj të cilit zakonisht nuk mund të ankoheshe. Bazuar në provat ajo vendoste nëse personi i akuzuar ishte apo jo fajtor dhe sanksionin, dënimin ndaj tij. Ajo gjykonte si çështjet civile edhe ato penale, kryesisht të çështjeve që lidheshin me jetën, dëmtimet trupore, çështjet pasurore, kishës, të martesës etj..Dënimet që jepeshin zakonisht ishin materiale, por aplikoheshin edhe dënime të tilla si përzënia nga fshati, djegja e shtëpisë.

Barrën e provës e kishte ai që akuzonte, akuza apo padia ishte gojore dhe bëhej para pleqësisë. Pleqësia pasi dëgjonte palët vendoste se çfarë provash do të merrte dhe si do të vepronin palët. Meqenëse procedura penale që zhvillonte pleqësia ishte e tipit akuzator, barra e provës i takon paditësit, akuzuesit, i cili me padinë gojore para pleqësisë duhej të paraqiste edhe provat ku e bazonte padin.

Këshilli i pleqve në përfundim të gjykimit largonte palët dhe personat e tjerë dhe fillonte diskutimin e brendëshëm (i cili ngjason me diskutimin e gjyqtarëve në dhomën e këshillimit) për marrjen e vendimit. Ky proçes mund të vazhdonte me orë të tëra, pleqtë mund të ripyenin dëshmitarët, ekspertët, të këshilloheshin me pleq të tjerë etj, deri në arritjen e një konkluzioni, vendimi të drejtë të pranuar nga të gjithë anëtarët e këshillit.

Duhet nënvizuar fakti që në të drejtën tonë zakonore, në të tre kanunet, konstatohen rregulla gati të njëjta për mjetet e kërkimit provave, për provat, marrjen e vlerësimit e tyre si dhe në tërësi për proçesin e të provuarit. “Në të

drejtën tonë zakonore konstatohen qartë tiparet dhe origjinaliteti i saj shqiptarë, me gjithë ndikimet e pashmangshme të së drejtës zakonore të huaj”.

### Llojet e provave penale në të drejtën zakonore

Si prova që përdoreshin nga ana e pleqësisë, sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit njiheshin; pohimi i të akuzuarit, dëshmia e dëshmitarit, kapja në flagrancë, mendimi ekspertit, njohja e sendeve, sendet e shkresat.

1. **pohimi i të akuzuarit.** Pohimi i të akuzuarit konsiderohej si provë nga ana e pleqësisë se akuza e ngritur nga akuzuesi qëndron, ajo në përgjithësi nuk verifikonte saktësinë e pohimit, në momentin që ajo bëhej nga i akuzuari ajo e shpallte atë fajtor dhe vendoste sanksionin ndaj tij. “Nga ana e pleqësisë pohimi i plotë apo i pjesëshëm i të akuzuarit ishte provë e plotë e cila i jepte fund procesit duke e konsideruar faktin të provuar”. Përrjashtim nga ky rregull ishte kur nga provat e tjera rezultonte se ishte një person tjetër autori dhe pohimi i të akuzuarit bëhej me qëllim fshehjen e autorësisë së një personi tjetër. “Praktika e zbatimit të kanunit ka njohur raste kur vetë i dëmtuari nuk ishte i bindur në vërtetësinë e pohimit të akuzuarit për të shmangur nga përgjegjësia personin më të aftë të familjes, apo kur ishte i shtyrë apo i paguar nga dikush tjetër”. Në këto raste pleqësia e merrte pohimin e të akuzuarit me rezervë. Në raste kur nuk kishte pohim të pandehurit, apo kapje të tij në flagrancë, nga ana e pleqësisë i kërkohet të akuzuarit të betohej para pleqësisë dhe më pas kalohej në dëgjimin e provave. Betimi i të akuzuarit ishte një akt solemn i cili në këto raste vlerësohej nga pleqësia, ai mund të shoqërohej me betimin edhe të njerëzve të tjerë të njohur të akuzuarit. “Në gjyqet para pleqve, burri i paditur për krim duhet të betohet mbi gur për pafajësinë e vet e ta flakë (hedhë) atë në sy të gjykatësve, pleqve”. Nga ana e pleqësisë ndaj të akuzuarit nuk mund të përdorej asnjë lloj shtërngimi fizik apo torturë për të marrë pohimin nga i akuzuari, pavarësisht rëndësisë çështjes dhe provave që kishte pleqësia. Në rastet kur akuzuesi nuk bindej mbi vërtetësinë e thënieve apo deklarimeve të akuzuarit para pleqësisë e drejta zakonore parashikonte porotën, benë e përbashkët të një numri të caktuar personash, betarësh, burrash (jo më pak se 4 dhe jo me shumë se 24) të cilët bënin benë para pleqësisë dhe pastronin nga çdo dyshim të akuzuarin mbi vërtetësinë e thënieve të tij. Këta persona, “porotikët” caktoheshin nga pleqësia dhe i akuzuari ndër njerëzit më të njohur dhe më të ndershëm. Në rastet kur i akuzuari bënte pohime të plota dhe të sinqërta para pleqësisë dhe të dëmtuarit, kjo vlerësohej shumë si nga pleqësia ashtu edhe nga i dëmtuari, duke ulur mjaft masën e dënimit, shpërblimit apo llojin e tij.

2. **dëshmia e dëshmitarit.** Kjo provë lidhej drejtpërdrejtë me institutin e besës apo benë e atij që dëshmonte para pleqësisë. Në të tre kanunet beja zinte

vend qendror, rregullat dhe zgjidhjet në lidhje me bënë kanë qënë të njëlojta . Beja bëhej në mënyrë individuale nga personi përpara se të jepte shpjegimet para pleqësisë, dëshminë apo njohuritë e tij. Ajo bëhej si nga dëshmitari, nga akuzuesi, i akuzuari, eksperti etj.. Gjeçovi ka përkufizuar se "Beja e shqiptarit ka dy punë parasysh a) i nënshtrohet perëndisë, në dëshmi të së vërtetës b) i nënshtrohet randimit të ndëshkimit të përjetshme të gjobës së vonshme kah kanuja. Pleqësia e konsideronte si provë çdo dëshmitar mashkull në moshë madhore, pa të meta psikike e fizike, i cilit nuk e kishte humbur nderin publik. Dëshmitari në këtë rast dëshmonte për atë që kishte parë apo dëgjuar mbi fjalën e tij të nderit duke bërë be sipas një formule dhe ceremonie të caktuar. "Në procedurë të pleqësisë, kur i qaset betimit, beja e ka forcën e provës së plotë, e cila e zgjidh çështjen konkrete". Ai nuk kishte detyrimin të paraqitej para pleqësisë e të dëshmojë, por nëse ai dëshmon dhe rezulton se dëshmia e tij është e rreme ai njollosej si "rrens" dhe humbte nderin publik. Dëshminë e dëshmitarit si provë, kishte të drejtë ta kërkonte akuzuesi dhe i akuzuari, por mund të vendoste ta mirrte kryesisht edhe vetë pleqësia, e pa ndërvarur kjo nga pëlqimi i palëve. "Dëshmitari nëse pranonte të dëshmonte ishte i detyruar të dëshmonte të vërtetën që dinte, kishte parë apo konstatuar, ai dëshmonte mbi fjalën e tij të nderit" Dëshmitari dëshmonte para pleqve pa prani të personave të tjerë me përjashtim të rasteve kur kërkonte vetë ta jepte dëshminë në prani të palëve, publikisht. Në rastet kur dëshmitari e kishte të pamundur të paraqitej para pleqësisë ishte parashikuar që pleqësia të shkonte dhe ta dëgjonte atë atje ku ai ndodhej. Pleqësia administronte në formën e dëshmisë me betim edhe shpjegimet e dhëna nga ana e kapucarit i cili shpjegimet e tij i shoqëronte edhe me prova në lidhje me fajësinë e të akuzuarit. Në cilësinë e dëshmitarit nga pleqësia dëgjohej edhe dëshmia e ndjekësit të gjurmëve dhe kapucarit. Ata shpjegonin nën be çfarë kishte zbuluar, konstatuar dhe çfarë provash, gjurmësh të autorit kishte gjetur etj..

3. **kapja në flagrancë.** Kapja në flagrancë e autorit të veprës penale konsiderohej si provë e plotë nga ana e pleqësisë dhe nuk kishte nevojë për hetime e prova të tjera. Këto ishin rastet kur i dëmtuari apo persona të tjerë kapnin autorin gjatë kryerjes veprës ose menjëherë mbas saj. Ata kishin të drejtë ta lidhnin duke i privuar lirinë e ta dorëzonin në autoritetet përkatëse. Kjo provë vlerësohej si provë e plotë, ajo shoqërohej edhe me dëshmitë e personave të cilët e kishin kapur autorin në flagrancë. Gati me të njëjtën vlerë provuese konsiderohej edhe rasti kur një dëshmitar dëshmonte para pleqësisë në be se kishte parë autorin duke kryer krimin, por që nuk kishte mundur ta kapte atë në flagrancë për arsye të ndryshme. "Kur autori kapej në flagrancë nuk kishte vend për hetime të mëtejshme. Në këtë rast i dëmtuari kishte të drejtë ta lidhte fajtorin dhe t'ia dorëzonte pleqve, të cilët vepronin sipas kanunit" .

Për tu siguruar mbi saktësinë e thënieve të palëve, pleqtë edhe më pas mund të thërrisnin dhe të ripyeshnin palët për të dhënë shpjegime të tjera. Është e kuptueshme se në kushtet e kohës nuk mund të flitet për procesverbale ose vendime të shkruara.

**4. mendimi i ekspertit.** Ekspertimi si provë merrej nga ana e pleqësisë në ratet kur duhej të përcaktohej vlera e dëmit shkaktuar nga vepra penale apo për njohuri të tjera të fituara nga individi, mjeshtëria në punë apo eksperiencia jetësore. Dëmi, pasoja në këto raste mund të ishte materiale (vlera e bagëtive të helmuara, e shtëpisë djegur ...) ose fizike, në përcaktimin e dëmtimeve trupore tek të dëmtuarit. Ekspertët jepnin mendimin e tyre para pleqësisë e jepnin me gojë, zakonisht pa praninë e palëve apo personave të tjerë. Në K.L.Dukagjinit paragrafi 935, 936 është parashikuar ekspertimi në rastet e humbjes së fëmijës nga gruaja shtatzënë e për më tepër edhe për seksin e fëmijës humbur, ku dhe dënimi, dëmshpërblimi ishte i ndryshëm. "Praktika ka njohur rastin e një eksperti popullorë për zbulimin e autorëve të vjedhjeve, kryesiht bagëtisë në baze të ndjekjes së gjurmëve të vjedhësve dhe bagetive të vjedhura". Ekspertët që caktonte pleqësia ishin persona të cilët në bazë të eksperiencës tyre përcaktonte vlerën e dëmit shkaktuar. Për ekspertët parashikoheshin të njëjtat rregulla si për dëshmitarët, ata nuk ishin të detyruar ta kryenin këtë detyrë, por nëse e kryenin duhej ta bënin me drejtësi. Në botimin e K.L.Dukagjinit trajtohet edhe një rast, çështje e cila është zgjidhur nga këshilli i pleqve në bazë të parashikimeve të kanunit. Veprimet e kryera nga këshilli i pleqve për zgjidhjen e çështjes janë mjaft domethënëse, ato përbajnë elementë të një ekspertimi mjekoligjor dhe sidomos të një eksperimenti gjyqësor. "Në K.L.Dukagjit bëhet fjalë edhe për një rast "mjeko ligjorë" të ekspertimit të një gruaje e cila kishte humbur fëmijën për shkak të qitjes me armë" .

**5. njohja e sendit.** Njohja si provë përdorej nga pleqësia për të provuar pronësinë e një sendi ose të një vepre penale që lidhej me atë send, i cili mund të ishte një armë e ftohtë, zjarri, send i vjedhur etj... Në këto raste personi që e posedonte duhej detyrimisht të shpjegonte burimin e marrjes tij. Nëse ai nuk e provonte si e kishte marrë, fituar, apo nga persona të tjerë, përgjegjësia i takonte atij dhe sendi i kthehej pronarit. Kjo provë lidhej e plotësohej edhe me njoftime të tjera, dëshmitë e dëshmitarëve që kishin njohuri të mëparëshme mbi sendin, objektin dhe kujt i përkiste etj.. Këtë institut e gjejmë edhe në Kodin e Hamurabit në nenet 9-11 në të cilin poseduesi i sendit në konflikt ishte i detyruar të provonte origjinën e posedimit të sendit.

**6. sendet dhe shkresat.** Sendet si prova mund të përdreshin kur ato i përkisnin personit të akuzuar për të provuar kryerjen nga ai të veprës penale ose së paku praninë e tij në vendin e ndodhjes ngjarjes. Të tilla mund të ishin sende që diheheshin nga persona të tjere se kujt i përkisnin. (Veshjet e ndryshme,

opingat, jeleku, arma etj..) Këto sende i dorëzoheshin pleqësisë e cila i vlerësonte ato si prova duke pyetur për to edhe personat që i kishin gjetur ato. Shkresa si provë ka qënë mjaft e rrallë kjo për shkak të analfabetizmit theksuar si dhe faktit që në atë periudhë njerëzit i kryenin punët pa asnjë formalitet. Në rastet e konflikteve, nga ana e pleqësisë ato përdoreshin si prova. “Në gjykimin e pleqve, si rregull nuk kishte marrje provash publikisht. Prova si dëgjimi i thënieve të dëshmitarëve, pyetja e ekspertëve etj, nuk merreshin gjatë gjykimit publikisht” .

### **Mjetet e kërkimit provës në të dr. zakonore**

Si mjete për kërkimin e provave në K.L.Dukagjinit, njiheshin; këqyerja e vendit ngjarjes, këqyerja e dëmit dhe e të dëmtuarit, ndjekja e gjurmëve dhe vëzhgimi i fshehtë.

**1. këqyerja e vendit ngjarjes.** Si mjet për kërkimin e provës, ajo bëhej nga ana e pleqësisë e cila për ta kuptuar më mirë se si kishte ndodhur ngjarja, shkonte vetë në vendin ku kishte ndodhur dhe e këqyerte atë. Zakonisht përdorej në ato raste kur palët kishin kundërshtime rreth mënyrës se si kishte ndodhur ngjarja. Në rastet kur pleqësia donte të krijonte përfytyrim të qartë mbi vendin ku kishte ndodhur ngjarja ajo e kryete vetë këtë veprim duke këqyruar vendin e krimin, shtëpinë e djegur, bagëtinë e helmuar etj, Kjo në rastet kur palët mbanin qëndrim të ndryshëm për vendin e ndodhjes e veprës.

**2. këqyerja e dëmit dhe e të dëmtuarit.** Pleqësia për të konstatuar shkallën e dëmtimit të shkakuar, duke u ndihmuar edhe nga një person me përvojë në këtë drejtim, këqyerte në mënyrë të drejtpërdrejt personin e dëmtuar apo të plagosur. Kryesisht ky mjet kërkimi prove bëhej nga individë, ekspertë me njohuri në fushën apo objektin që këqyrej, verifikohej apo përllogaritej si dëm apo dëmtim. Pleqësia mund të shkonte vetë në vendin e ngjarjes, në vendin e dëmit apo atje ku ishte i dëmtuari. Ajo mund të këqyrte një shtëpi të djegur, bagëtitë e helmuara, personin e plagosur etj..

**3. ndjekja e gjurmëve.** Si mjet për kërkimin e provave, ndjekja e gjurmëve përdorej kryesisht në rastet e vjedhjeve të ndryshme, të bagëtisë, mallit, prerjes së druve në pyllin e tjetrit, plagosjes, vrasjes etj.. Këtë mjet prove mund ta përdorte pleqësia duke dalë vetë për të parë e ndjekur gjurmët, i dëmtuari vetë ose persona të ngarkuar prej tij. Ky mjet prove konsistonte në ndjekjen e gjurmëve të autorëve nga vendi ku kishte ndodhur vrasja apo vjedhja deri në vendin që ato të çonin. Në rast se gjurmët të çonin në një lagje apo fshat (pa mundur të çonin në shtëpinë e autorit) atëherë përgjigjej fshati ku përfundonin gjurmët. Ky mjet kërkimi prove njihet dhe parashikohet në të tre kanunet . Ndjekja e gjurmëve përdorej edhe nga ana e personave të caktuar nga i dëmtuari, të cilët për shkak të eksperiencë që kishin në këtë drejtim zbulonin

autorin dhe siguronin edhe sende apo prova materiale. Në këtë rast akzuesi kërkonte nga pleqësia të dëgjohej dëshmia e ndjekësit të gjurmëve. Edhe i dëmtuari apo kapucari mund ta aplikonte këtë mjet kërkimi prove.

**4. vëzhgimi i fshehtë.** Si mjet për kërkimin e provës zakonisht përdorej nga kapucari i cili si person i specializuar në këtë drejtim vëzhgonte në mënyrë të fshehtë për të zbuluar autorin e veprës, për të gjendur sendet e vjedhura apo prova materiale. Për të kryer vëzhgimin e fshehtë atë e ndihmonte fakti që zakonisht idenditeti i kapucarit nuk dihej. Vëzhgim të fshehtë mund të bënte edhe vetë i dëmtuari.

Konstatohet se e drejta zakonore shqiptare e përbërë nga Kanunin e Lekë Dukagjinit , Kanuni i Labërisë, Kanuni i Skënderbeut e kanune të tjera me fushë veprimi më të kufizuar, në aspektin procedural penal kanë gati parashikime të njëjta, ato përbëhen nga të njëjtat parime dhe institute themelore, çka provon idenditetin e saj shqiptarë. “Këto norma juridike (ndonëse në shumicën e tyre të pa shkruara) të vendosura nga pleqtë jo vetëm janë trashëguar brez pas brezi, por ato kanë evoluar në raport me kushtet historike, ekonomike e shoqërore. Edrejta zakonore nuk është veçori vetëm e popullit tonë por edhe popujve të tjerë të Europës e më gjërë”.

E drejta zakonore vazhdoi të zbatohet edhe mbas pushtimit turk, ndonëse nga pushtuesi filloi organizimi dhe funksionimi i të drejtës shariatit, si pjesë e së drejtës islame. Gjatë kësaj periudhe dhe sidomos në një pjesë të konsiderueshme të trojeve shqiptare, mosmarrëveshjet e ndryshme si dhe ato të karakterit penal, zgjidheshin sipas të drejtës zakonore. “Në kohën e perandorisë Turke, në një pjesë të krahinave shqiptare vazhdoi funksionimi i të drejtës zakonore, ato kishin autonomi lokale apo siç mund ta quajmë ndryshe, vetqeverisje lokale, brenda perandorisë turke, nën sovranitetin e lartë të Sulltanit”. Në këto kushte vazhdoi të zbatohet e drejta zakonore shqiptare për konfliktet midis pjesëtarëve të zonave të caktuara dhe gjykimin e konflikteve vazhdonte ta bënte pleqësia. “Ishte e natyrshme që përpara ligjit të zyrtë turk të shariatit, shqiptarët ti riktheheshin kanunit të tyre mijëvjeçar ashtu siç qe, shkëmb i pagdhendur mirë, i përgjakshëm vërtet, por dinjitoz në trajtimin e tij”.

Në përfundim duhet thënë se referuar nivelit mjaft të ulët të zhvillimit të mardhënieve shoqërore, kushteve të vështira sociale e ekonomike, mungesës së plotë të shteti dhe të legjisllacionit, e drejta zakonore shqiptare, ka luajtur rol të pazëvendësueshën në drejtim të parandalimit dhe uljen së kriminalitetit, uljen në shkallë të konsiderueshme të nivelit të dhunës dhe arbitraritetit.

## BIBLIOGRAFIA

- Kanuni i Lekë Dukagjinit, Tiranë, botim i vitit 1989.
- Shtjefën Gjeçovi “Kanuni i Lekë Dukagjinit” botim i vitit 1933
- Historia e shteti dhe së drejtës në Shqipëri, botime të vitit 1994 dhe 2011, grup autorësh.
- Prof. Dr Ismet Elezi, “Historiki i zhvillimit të legjislacionit penal në Shqipëri”, “E drejta zakonore e labëris në planin krahasues”, botime të vitit 1994, 1997.
- Prof. Dr. Aleks Luarasi “E drejta zakonore shqiptare” botim i vitit 1994.
- Doc. Bashkim Çuberi, “Mjekësia Ligjore”, botim i vitit 1981.
- Edit’h Durhan “Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për shqipërinë dhe shqiptarët”, botim i vitit 1990.
- Doc. Koço Nova “E drejta Zakonore Shqiptare” botim i vitit 1989.
- Doc. Koço Nona “Procedura penale, pjesa përgjithshme” botim i vitit 1966.
- Dr. Ejup Sahiti “Procedura penale në të drejtën zakonore” “Argumenti në procedurën penale” botime të vitit 1999.
- Pal Doçi, “Mënyra e zgjidhjes çështjeve sipas kanunit”, botim i viti 1968 n revistën Drejtësia Popullore Nr 4.
- Revista Drejtësia Popullore botime t viteve 1959 deri n vitin 1987.
- Revista juridike shkencore, Drejtësia, Jeta Juridike, Justicia, Federalisti, Rilindja.

# DIPLOMACIA KINEZE, BALLKANI DHE PERSPEKTIVA SHQIPTARE

**Dritan Hoti**

Mediterranean University of Albania  
dritanhoti@hotmail.com

## ABSTRACT

*In the first steps of its presence in the Balkans, China built the basis of cooperation with three communist leaders who distinguished themselves with their refractory attitude to Russian, communist dictator of Albania, Enver Hoxha, that in Romania, Ceausescu and Tito of Yugoslavia, with the strategic aim Chinese alternative building as competing against Moscow's leadership within the communist world.*

*Post-Cold War world was marked by the collapse of ideological conflicts, though the latter never constitute a barrier for China. Physiognomy of the post-Cold War world, the current, indicates the emergence of new great powers in the new international system, within which the United States still hold a dominant position superpower, which between them and intended to rival China, especially balances in fragile regions, like the Balkans.*

*Exactly, triggering anti-American alliance influenced China knitting with Serbia, and its position along the Kosovo crisis, which in light of Chinese diplomacy is seen as a strategic partner for the region selected, the result of which, separately agreements Multiple economic background, was the signing of a memorandum in March this year, which provides Chinese language learning Serbian children, starting with the following elementary schools including all levels of study.*

*The essence of the new Chinese strategy consists in spreading its influence over Balkans through increased trade exchanges, investment in the energy sector, infrastructure, and political alliances embryonic capillaries extending its entirety region. Before the recent summit in Belgrade between China, represented by its prime minister, Li Keqiang, and the Balkans, Balkans geographical location*

*inspire new strategy in the region, which relies on the expansion and acceleration of linking China with western parts Europe targeted promotion of its economic activities.*

**Keywords:** China. Foreign policy, Balkans, diplomacy

“Quand la Chine s’éveillera, le monde tremblera” (Kur Kina të zgjohet, bota do të dridhet). Bonaparti i madh, autori i shprehjes në fjalë, e aktivizonte imagjinatën e tij përputhshmërisht me thelbin e aksionit të tij politik e ushtarak, finaliteti i të cilit kishte rezultuar, rrënimi i Europës në emër të legjitimitetit të revolucionit francez.

Historia na dëshmon se kombet e mëdha në momentet e fuqisë së tyre kanë synuar e tentuar konvertimin e normave, standardeve të tyre në universalizëm, nëpërmjet praktikave autentike. Pikërisht Franca e Napoleonit ia doli ta shndërronte Europën në një entitet të vetëm politik nën sundimin e saj, me shtrirje prej brigjeve të Niemenit e deri në gjirin e Biscaye-s.

Falimenti i kësaj përpjekjeje kishte të bënte me mospërputhjen e superstrukturave materiale të revolucionit francez me fundamentet e tij morale. Evropa napoleoniane ishte e çimentuar kështu jo nga një marrëdhënie e një barasvlefshmërie principesh, por nga ushtrimi i forcës. Synimi për universalizëm i Ruisë cariste e mandej i Bashkimit Sovjetik, i mishëruar në perandorinë multietnike përgjatë historisë së saj, i detyrohej forcës së ashpër<sup>1</sup>.

Aleatët e Ruisë llogariteshin të paktë përtej rrezes së ushtrive të saj. Tradita dhe si rrjedhojë mendësia kineze si produkt i saj është plotësisht e ndryshme. Prudencia dhe pragmatizmi metodik karakterizojnë rrugëtimin e Kinës përgjatë historisë botërore. E mbrujtur me bindjen se qytetërimi, veçantia e saj është unike, por jo-universale, Kina konsideronte gjithçka që nuk kishte të bënte me qytetërimin kinez, duke filluar nga fqinjët e deri në atë që emërtohet si Perëndim, si barbarë. Kur epoka e re moderne u paralajmërua nepermjet shoqerive sipermarrese, te cilat kerkonin lavdine dhe mireqenien duke eksploruar hapësira te pazbuluara pertje tyre, Evropa e atehershme dhe Kina ndermoren njekohesisht aventura eksploruese. Ndersa, fuqite evropiane u nisen ne kete rrugetim prej nje kontinenti ne te cilin autoritetet sovrane rivalizonin njera me tjetren secila monarki sponsorizoi nje eksplorim te gjere naval me shpresen e arritjes se nje rezultati superior tregtar e strategjik perkundrejt rivaleve. Kesodore anijet portugeze, angleze, hollandeze u shfaqen ne brigjet e Indise, kurse po anglezet e spanjolllet udhetuan gjethashtu ne drejtim te hemisferit perëndimor duke shenjuar per me teper startimin e e epokes se

3-shekujve te influences dominuese te Evropes nee ceshtjet boterore, duke i cvendosur keshtu marredheniet nderkombetare nga nje praktike rajonale, sic ishte deri atehere, ne nje sfond gjeografik global. Anijet kineze nderkohë me të avancuara teknologjikisht, ndërmoren udhëtime eksplorimi duke mbërritur ne Azine Jug-lindore, Indinë si dhe ne brigjet lindore te Afrikës. Ndryshe nga praktikat evropiane, kinezët nuk u orvatën kurrsesi as ti bashkëngjisnin territorit të tyre as te dominonin

1. Kissinger Henry: Les années de Renouveau, p. 125, Fayard, Paris 2000 apo kontrollonin vendet e zbuluara, perkundrazi aplikuan nje sistem shkembimi me dinjitetet lokale dhe sollen ne shtepine e tyre se bashku me ta kuriozitate kulturore dhe zoologjike<sup>2</sup>. Kina asnjëherë nuk ka rivendikuar pranimin, përhapjen e normave, vlerave të saj, me një fjalë konvertimin e tyre në universalizëm, madje në momente vendimtare për ruajtjen e eksepcionalizmit të saj, elitat politike kineze nuk kanë ngurruar të neutralizojnë faktorët që rrezikonin ta njehsonin atë me kulturën universale. I tillë ishte revolucioni kulturor i iniciuar nga Mao Ce-Dung-u apo reagimi ndaj lëvizjes studentore në Tien Amen 1989, prej Ten Ciao Pin-it.

Ja pra sesi filozofia e diplomacia kineze nuk predikon imponimin apo intervencionin, por fleksibilitetin, përfitimin e ndërsjelltë ekonomik prej ku burojnë pozita avantazhuese taktike. Tokë e rivaliteteve të fuqive historike europiane, Kina e njohu Ballkan në vitet '70 të shekullit të kaluar. Largësia gjeografike si dhe mungesa e interesave të drejtpërdrejta, në një botë të ndryshme nga ajo e jona e për rrjedhojë mungesa e interesave të drejtpërdrejta apo indirekte, ishin motivet e mospranisë kineze në juglindje të Evropës<sup>3</sup>. Në hapat e parë të prezencës se saj në Ballkan, Kina ndërtoi raporte bashkëpunimi me tre liderë komunistë që spikasin me refraktarizmin e tyre ndaj Rusisë komuniste, diktatorin e Shqipërisë, Enver Hoxhën, atë të Rumanisë, Çausheskun si dhe Titon e Jugosllavisë, me synim strategjik ndërtimin e alternativës kineze si rivalizuese përkundrejt lidërshpimit të Moskës përbrenda botës komuniste<sup>4</sup>. Bota e pasluftës së ftohtë u shënjua nga rënia e konflikteve ideologjike, ndonëse kjo e fundit asnjëherë nuk përbënte ndonjë barrierë për Kinën. Fizionomia e botës së pasluftës së ftohtë, pra asaj aktuale, dëshmon emergjencën e fuqive të reja të mëdha në sistemin e ri nderkombëtar, përbrenda të cilit Shtetet e Bashkuara ende zotërojnë pozitën e superfuqisë dominuese, të cilat dhe ndërmjet tyre Kina synojnë ta rivalizojnë, sidomos në rajone të ekuilibrave të brishtë, i tillë Ballkani. Pikërisht, refleksi anti-amerikan influençoi thurjen e aleancës së Kinës me Serbinë, si dhe qëndrimin e saj përgjatë krizës së Kosovës, e cila në optikën e diplomacisë kineze shihet si një partner i përzgjedhur strategjik për rajonin, rrjedhojë e të cilit, veçmas marrëveshjeve të shumëfishta me sfond ekonomik, ishte firmosja e një memorandumit bashkëpunimi në mars të këtij

viti, që parashikon mësimin e gjuhës kineze për fëmijët serbë, duke nisur me shkollat fillore e në vazhdim duke përfshirë të gjitha hallkat e studimit. Thelbi i strategjisë së re kineze për Ballkanin konsiston në përhapjen e influencës së saj nëpërmjet shkëmbimeve tregtare në rritje, investimeve në sektorin e energjisë, infrastrukturës, si dhe aleancave politike embrionale duke shtrirë kapilarët e saj në tërësinë e rajonit. Përpara samitit të fundit në Beograd ndërmjet Kinës, të përfaqësuar nga kryeministri i saj, Li Keqiang, dhe vendeve të Ballkanit, vendndodhja gjeografike e Ballkanit frymëzonte strategjinë e re në rajon, e cila mbështetet në zgjerimin dhe përshpejtimin e ndërlidhjes së Kinës me pjesë perëndimore të Evropës me objektiv promovimin e aktiviteteve të saj ekonomike.

2. Kissinger Henry: World Worder, p18, Penguin Press, New York 2014

3. Hoti Dritan: Kina në Ballkan, Gazeta-Mapo, 22-dhjetor 2014

4. Poulain loic: China's New Balkan Strategy, CSIS, center for stratetig Studies, Volume1, Number2, August 2011

Ja pra sesi dhe për çfarë do të shërbejë ngritja e një rrjeti të gjerë infrastrukture, i përbërë nga porte, hekurudha, autostrada. Kështu si pikënisje e këtij rrjeti mund të shërbejnë portet e Greqisë në të cilat Kina po investon, ai i Pireut, Selanikut<sup>5</sup>, duke shfaqur interesa në përfshirjen e porteve shqiptare, i tillë ai i Shëngjinit e duke mbërritur në Tivar në Mal të Zi; duke kaluar mandej tek rrjeti hekurudhor që lidh Beogradin me Budapestin, e parashikuar të jetë funksionale në vitin 2017 me një kosto prej 1,5 miliardë eurosh.

Ndërsa për Malin e Zi është miratuar ndërtimi i pjesës së parë të autostradës me drejtim veriun e vendit, nëpërmjet një investimi kinez në formën e një kredie prej 690 milionë eurosh, në Maqedoni kompanitë kineze janë që prej një viti duke ndërtuar autostradën midis Ohrit e Kërçovës, e cila vlerësohet 175 milionë euro, apo siç edhe cilësohet nga autoritet maqedonase “ si investimi më i madh në infrastrukturë në 50 vitet e fundit”. Duke u shtrire ne Rumani ku vellimi I bizneseve dhe investimeve kineze arrin ne 2,6 miliarde euro, ne Kroaci ne 1,1 miliarde euro, ndersa ne Bullgari edhe me pak, ne ne 630 milione euro. Siopas te dhenave te rregjistruara, 454 aktivitete ekonomiko-tregtare sic thuhet ndryshe biznese kinese veprojne ne territorin e Kosoves, megjithese Kina per motive gjeopolitike refuzon te pranoje pavarsine e kesaj te fundit.

Me Turqine shtetin-komb trashigimtar i perandorise otomane, ne stadin aktual ku ndodhet,e rimekembur ekonomikisht, shtuate qe inkurajon ndjektjen e interesave te pavarura me piketa, ne Ballkan, Lindjen e Mesme, Azine Qendrorre e deri-diku ne Afriken Veriore, me nje fjale perimetri ku dikur shtrihet perandoria e sulltaneve.Pikerisht perkundrejt Ballkanit, Turqia ka elaboruar nje platforme te nje politike te jashtme multidimensionale, ekonomike e politike

njekohesisht, duke shenjuar kesisoj rritjen progresive te pranise e volumit te saj ekonomik pothuajse ne teresine e rajonit tone. Rrethanat e siperpermendura e tok me to statusie nepermjet se cilit Turqia peshohet e perceptohet ne Ballkan dhe me gjere, e kane stimuluar Kinene qe kooperimin ekonomiko-politik me Turqine ta ushtroje mbi bazat e nje reciprociteti te mirefillte. Ja pra per cfare kane sherbyer vizitat e ndersjellta e ish-kryeministrit, presidentit aktual turk Erdoan si dhe shtetareve me te larte Kines ne kryeqytetet respektive, Pekine Anakara. 10 miliardë dollarë është shuma që udhëheqja kineze ka bërë gati për rajonin. Globalizimi lejoi tronditjen deri-diku të rolit të shteti-komb, por pa rrëzuar atë, përkundrazi tendencat e reja në sistemin aktual ndërkombëtar të prodhuara nga kriza e fundit, ajo e Ukrainës, si konsekuencë e saj marrëdhëniet Rusi-perëndim që shënjuan edhe rikthimin e hakmarrjeve historike në apogjeun e globalizimit, shteti-komb mbetet projektuesi i diplomacisë si dhe piketave e platformave ekonomike të një vendi. Në këtë logjikë, platformat e piketat ekonomike të Kinës në Ballkan do të përkojnë dhe do t'i nënvendoset pikësëpari synimit gjeostrategjik e suksesit te saj diplomatik në këtë rajon. Axhenda kineze për Shqipërinë parashikon ndërtimin e rrugës së Arbrit nëpërmjet një kredie të financuar prej " Chinese Exim Bank", politika e investimeve për Shqipërinë tenton të zgjerohet edhe në sektorin energjetik, interesit për portet si dhe pasurite minerale etj. Në vigjilje të takimit të Beogradit kryeministri kinez, Li Keqinang u shpreh: "Miqësia me Shqipërinë është si puna e verës, sa e vjetër, është aq edhe më e mirë"<sup>6</sup>.

5. Zeneli Valbona: China's Balkan Gamble, The Diplomate, 15/12/2014

6. Gazeta-Koha Jonë, 16/12/2014

Investimet, shkëmbimet e qenësishme ekonomike nuk duhen qëmtuar kurrsesi me sy dyshues, ato kurdoherë si në të shkuarën, por edhe më shumë në tashmen prodhojnë zhvillim dhe përfitim të ndërsjellë. Stepja, hezitimi përkundrajt tyre inkurajon shpeshherë frenimin, bllokimin, tok me të humbjen e mundësisë.

Ngritja e vazhdueshme e Kinës e bashkë me të hapësirat e dhuruara, do të shoqërohen me rritjen e kërkesës për investime duke përfshirë këtë radhë edhe sektorët strategjikë të vendit, sidomos për vendet e vogla me parametrat e Shqipërisë, e cila do të mund të konvertohej në një influencë diktuese për ekuilibrat ekonomikë të vendit, si dhe në një interferencë gjeopolitike sipas stilit kinez në një moment të caktuar, të ngjashme me prirjet e praktikat aktuale në marrëdhëniet ndërmjet shteteve.

U takon elitave politike të një vendi, cilado qofshin ato, që të paqtojnë mundësitë e përfitimit ekonomik me objektivat madhore kombëtare, të tilla aspiratat e kombit shqiptar me orientimet e duhura gjeostrategjike, të ndërlydhura me këto të fundit, duke shtruar pyetjet e mëtejshme: bashkëpunimet

dhe investimet në ekonomi duhen përcaktuar simetrikisht me masën e interferencës së ndërvarjes ekonomike me imperativat kombëtarë.

Për këto, elitat në fjalë nuk duhet që shanset e ofruara nga joshja ekonomike të konsiderohen si një përfitim i një aktualiteti imediat, por duhet të jenë të pajisura me perspektivë historike apo vizion afatgjatë, i cili në të shumtën e rasteve, në historinë 100-vjeçare të shtetit shqiptar, ka munguar për arsye të shumëfishta.

## **BIBLIOGRAFIA**

- Hoti Dritan : Kina në Ballkan, Gazeta-Mapo 22-dhjetor 2014
- Kissinger Henry: Les annees de renouveau, Fayard, Paris 2000.
- Kissinger Henry:World Worder, Penguin Press, New York 2014
- Poulain Loic: China's New Balkan Strategy, CSIS, Center for stratetgi Studies, Volume 1, Number 2, August 2011.
- Zeneli Valbona: China's Balkan Gamble, The Diplomat, 15/12/2914
- Gazeta-Koha Jonë, 16/12/2014

# KEQKUPTIMET ME DEMOKRACINË EDHE PAS 25 VITESH TRANZICION DEMOKRATIK SHOQËRIA SHQIPTARE KA KEQKUPTIME SERIOZE ME DEMOKRACINË

Përparim Kabo

Mediterranean University of Albania

perparim.kabo@umsh.edu.al

## ABSTRACT

*There is no difference between political opposition to civil society opponent. ... Civil Society should get self cured according to the principle "civil society to civil society" with the major objectives the creation of "civil community of law" as a community where the relationship is based on awareness of legal education. The failure to implement the universal principle of equality before the law, the culture of impunity, misunderstanding of one's obligations, have created the consequence that "Democracy through Law" does not work. Still the behavior that we have of an individual, a community and political parties, is that they see the democracy and the law as being separated. Misunderstandings with democracy and freedom have created illusions about humanity and human state ... The principle "I am taxed to be represent" is omitted. The state and the authorities avoid the concern that should set up a healthy, active, courageous and a challengercivil society. Democracy in Albania needs to cure the "crisis of representation", so that our country can finally come out from the syndrome of "double monocracy" and build up political pluralism and coexistence associated with the normal political dialogue. It is a reality that hurts all of us but the "regimes of today", in almost all former communist east countries, not yet resemble as an open society. Rather they look like more totalitarian regimes that failed; as long as "opposing gets smashed" or gets shut down, and the separation of powers is considered as a "rivalry contradictory interests."*

**Keywords:** "Political opposition and civil society opponent", "civil community of law", "separation of democracy from law", "crisis of representation", "I am taxed

*so I am represented”, syndrome of “double monocarcy”, Today regimes in the former Communist East countries...*

Me vitin 2015 mbushet një çerek shekulli në rrugën e transformimit demokratik të vendit tonë. Kjo kohë është e mjaftueshme për të analizuar gjendjen e demokracisë në Shqipëri për të evidentuar se cilat janë keqkuptimet me të. Le të shikojmë si funksionojnë dhe dilogojnë shoqëria civile dhe shteti.

Po të rishohim në ekranin e kujtesës se si ishte shoqëria në perjudhën e diktaturës, ku individit si institucion nuk ekzistonte, njeriu dhe shoqëria ishin të njësuar dhe strehuar tek shteti totalitar në krye të të cilit ishte udhëheqja dhe udhëheqësi; është e qartë përse edhe si term “shoqëria civile” ose nuk njihet, ose ishte herezi, ose ishte diçka që nuk kishte lidhje me historinë tonë unike të vetizolimit. Në hyrje të viteve 90-të ne kishim dëshirën dhe vullnetin të ndryshonim, detyrimin dhe përgjegjësinë ndaj historisë dhe brezave; ndaj na duhej edhe modeli cili erdhi nga jashtë me organizime si Fondacioni për Shoqërinë e Hapur, apo Rotary International Club. Shoqëria civile në Shqipëri ka një histori të saj, suksesi dhe dështimesh, përgjegjësie dhe detyrimesh. Në vijueshmëri do duhet të daravitet megjulla në keqkuptimin e vendit dhe rolit të shoqërisë civile na raport me shtetin dhe me tregun. Vetëm kështu nuk do të ngatërohet si edhe ndodh, opozita politike me oponencën civile. E para, është çështje pushtetit dhe rotacionit politik. E dyta, është e lidhur me shqetësimin e shoqërisë civile që shteti dhe institucionet përfaqësuese të kuptojnë me vetëdije dhe të ushtrojnë funksionin e “shërbenjësit publik”. Shoqëria civile nuk duhet ta shohi si armik sipërmarrjen dhe tregun, por si gjenerues të zhvillimit ekonomik, dhe njëherësh nuk duhet as edhe të shëndrohet në mënyrë mjerane në një shërbëtoare pa padinjitet ndaj oligarkisë, thjesht për disa fonde që mund të sigurojë prej saj. Brenda shoqërisë civile antroporeligjioni ka pësuar ndryshime të ndjeshme, ku spikasim ndërimit besimit për shkak konvertimi për shqiptarë që jetojnë brenda dhe jashtë vendit.

Ka edhe një rikonvertim brenda vet besimit si edhe ndodh me një grupim besimtarësh të besimit islam që janë larguar nga konfesionit tradicional dhe janë përfshirë në sekte të mbyllura fundamentale dhe okulte. Ajo që shqetëson është keqkuptimi. Me që shoqëria dhe shteti janë sekularë si pa u vënë re anashkalohet që feja nuk është e pavarur nga kushtetushmëria dhe ligji. Mungon një analizë serioze e thelluar dhe e dokumentuar që edhe nëse besimtarë fanatikë nuk dalin hapur kundër sekularitetit dhe autoritetit të ligjit, të mbahet në vëmendje sesa indiferentë janë ata ndaj këtij autoriteti? Nëse individët besimtarë nuk udhëhiqen nga ligji atëherë ata udhëhiqen nga principe fetare

të cilët i shikojnë si ligje dhe botëkuptim. Rendi civil në këto rrethana vjenë i interferuar nga një rend religjioz që dëmton dhe karakterin laik të shtetit.

Nëse pas një kohe relativisht të konsiderueshme më në fund u zbulua dhe ndëshkua veprimtaria që nën petkun fetar kryente veprimtari antiligjore, kjo tregon se brenda shoqërisë civile organizime të tilla si është ai fetar, kishin qenë jashtë shikimit të vëmendshëm të shoqërisë civile. Në këtë trinom dialugues shoqëria civile nga njëra anë: dheshteti- tregu-religjion nga ana tjetër, do të duhet të projektohet aktiviteti i shoqërisë civile ndaj shtetit që ai të mos dehumanizohet; ndaj tregut me qëllim që ai të mos lejojë që oligarkia të kontrollojë shtetin dhe sërish ky të rezultojë i dehumanizuar, duke u shëndruar thjesht në shërbëtor të kapitalit dhe jo si “public servant” i qytetratit. Gjithashtu shoqëria civile ndaj religjionit i cili me besimtarët e vet nuk duhet kurrësesi të nëpërkëmbi sekularitetin e shtetit dhe shoqërisë, qoftë edhe me indiferentizëm, sepse në këto rrethana shtresa apo grupime të caktuar dëmtojnë homogjenitetin në rendin civil të shoqërisë dhe zbatimin e ligjit kudo. Përball këtyre detyrimeve shoqëria civile duhet të vetkurohet sipas parimit “shoqëria civile për shoqërinë civile” me objektivat madhorë krijimin e “komunitetit civil të ligjit” si një bashkësi ku marrdhënia bazohet në vetëdije e edukat ligjore, që nga ajo e bashëkjetesës qytetare ku parimi universal është barazia para ligjit; deri tek kuptimi i vetëdijshëm mbi detyrimet. Kështu do duhej të krijohet morali i ligjit dhe autoriteti i tij në një shoqëri demokratike. Nëse sot kemi shifra të larta të moskorrektesës së qytetarëve ndaj detyrimeve gjithëvarësh, që në thelb shprehin edhe marrdhënie ligjore, civile, apo administrative, pa hyrë në detaje; do duhet të themi, se shoqëria civile në tërësi dhe operatorët e saj të përhershëm apo me kohë të pjesshme; nuk e kanë kryer si duhet dhe deri në përmbyllje detyrimi punën e tyre. Duhet kurrësesi njeriu dhe shoqëria që të kuptojë dhe zbatojë detyrimet që burrojnë prej asaj që në hyrje të viteve 90-të u emërtua nga Komisioni Venecias si “Demokracia përmes ligjit”. Fatkeqësisht ende kemi sjellje individuale, komunitare, apo partiake, ku demokracia shihet veç, dhe ligji shihet veç.

Demokracia instrumentalizohet si populizëm dhe reagim pa motiv e dobi mbarëshoqërore. Institucionet shtetërore më shumë se në një rast shfaqentëgjunjëzuar dhe lutës ndaj informalëve, dhe jotë predispozuar dhe mbështetës ndaj qytetarëve formalë. Ka zell për të ligjëruar të paligjëshmen dhe braktisje ose shtyrje në kohë të përmbushjes së interesave të qytetare që lidhen me detyrimet ligjore.

Ndërsa në të njëjtën kohë ligji parashtrohet nga politika dhe ligjbërësit si një çelës që shtrëngon situatën dhe do të mund të parandalojë shkeljet dhe kriminalitetin, fal hartimit të ligjeve që rrisin ngarkesën e detyrimeve apo vitet e heqjes së lirisë në rastet penale. Ka edhe një sjellje tjetër, ribërja e ligjeve nga

e para pa provuar deri në fund zbatimin e ligjit ekzistues së paku në një hark kohorë 10 vjeçar. Nuk kuptohet ose nënçmohet fakti që ligji është një materie juridike por dhe një materie juridike- institucionale. Të fillosh nga e para me ligjin dhe për pasojë dhe me institucionet do të thotë ti japësh ligjit një fuqi prapavepruese dhe ta rrisjellësh shoqërinë artificialisht në një pikë fillimi. Ose udhëtimi ligjor institucional të ketë trajtën e rrugëtimit mes pikave zero sa herë ka rotacion në pushtet. Ky lloj posedimi i ligjit dhe ligjshmërisë e sjell shtetin në identitetin e shtetit regjim ku udhëheqja e komandon atë. Në perjudhën e tranzicionit në Shqipëri ose ka raste kur ligji amendohet aq shumë sa që humbë identitetin fillestar, ose bëhet zero dhe zevendësohet me një ligj të ri, ose aprovohet dhe nuk zbatohet dhe pas disa vjetësh kemi kthim pas duke e tkuruar hapsirën e lirisë apo demokracisë që kishim menduar në krye të herës se ky ligj do të sillte.

Edhe pse u mbushën 25 vite ende as është kuptuar qartazi dhe as është punuar në drejtimin e duhur që të funksionojë shteti ligjor pa të cilin nuk mund të kemi demokraci funksionale. "Sundimi ligjit duhet të jetë pikënisja, sepse prej tij varen funksionet normale të një shoqërie të disiplinuar por se duhet gjithë po aq kjo shoqëri të karakterizohet nga një ekonomi funksionale (ekonomi me balance positive sepse shoqëria e sotme globale po paguan çmimin e pabarazisë, shiko librin e Josph Stiglitz "The price of inequality"), nga një sistem të drejtësisë të panashëm, të pavaruar dhe të pa korruptuar ku edhe punonjësit e saj ndëshkohen nga ligji kur e shkelin atë (John Lock-Traktati dytë mbi qeverisjen), system real të lirisë politike me bashkëjtesë politike dhe rotacion që mbështetet tek "institutional continuity", dhe jo nga ribërja e korpusit ligjor sa herë që një forcë politike vjen rishtazi në pushtet. Një sjellje e tillë dëmton rëndë dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë dhe zbatimin e detyrimeve që burojnë nga marrëveshjet apo memorandumet ndërkombëtare. Dhe së fundi, për nga rradha dhe jo nga rëndësia, një shoqëri që karakterizohet nga besueshmëria publike tek policia dhe gjykata. (që duhet të kenë profesionalizëm, të jenë jo të korruptuara, dhe të jenë efçente).

Po t'i përthyejmë këta mentalitete në filozofin e sjelljes, do duhet t'i lexojmë. Keqkuptimet me demokracinë, lirinë, dhe të drejtat e njeriut e kanë dëmtuar shoqërinë dhe shtetin, sepse kanë krijuar iluzione mbi humanizmin dhe shtetin human, thjesht; po qe se organet shtetërore tolerojnë informalitetin dhe mospagesën e detyrimeve nga ana e qytetarëve, ai është shteti dhe pushteti "HUMAN". Kështu parimi jam "i taksuar ndaj jam i përfaqësuar" anashkalohet. Shteti, e pushtetet i shmangen shqetësimit që do të krijonte një shoqëri civile e shëndetëshme, aktive, kurajoze dhe sfidante ndaj arogancës apo indiferentizmit, mungesës së transparencës dhe informalitetit korruptiv shtetëror. Qytetari thjesht pret nga shteti, nga qeveria, nga udhëheqësi, apo

cilido që ka post jo respektimin e së drejtave por thjesht një “vënie dore në zemër”.

Keqkuptimet më shtrëngimin ligjor e shkëpusin shtetin nga detyrimet si “Public Servant” duke braktisur detyrat parandaluese përmes politikave të zhvillimit. Qartazi. Nëse shteti e lejon që gjëndja të vij në raste ekstreme edhe si grumbullim gradual i neglizhuar, dhe pastaj të mendojë, se po të rritet dënimi në ekstreme, atëhere të tjerët do të tremben dhe nuk do ta bëjnë më po atë akt kriminal, apo diçka të ngjashme, kjo sjellje nuk bën sens; nuk ka të bëjë me humanizmin e shtetit. E gjithë kjo do të thotë që, shteti nuk e di se ç’po ndodh me shoqërinë që ai drejton dhe ndodhet përball një realiteti të faktit të kryer. Ja një shëmbull me ndjeshmëri të lartë. Nëse krimi deri ai me marrje jete, kryhet nga mosha të reja dhe shumë te reja, shumica të lindur dhe të rritur në këta vite të transformimit demokratik, atëhere cili është reflektimi që do të duhet të bëjë shteti? Arsimimi, edukimi, familja, trainimi sportiv, motivimi i kohës së lirë, filozofia e sjelljes, jeta në natyrë, dialogimi mes brezave, edukimi artistik që nga fëmijëria, mbajtja larg nga vesi, shmangia e deforimit që vjen nga goditja e butë e medias ç’orientuese, braktisja e librit, anashkalimi i punës në komunitet, mosmbajtja e një raporti edukues moral me religjionin, etj e etj, nuk kanë funksionuar si duhet në shoqëri. Është vendi që me ndjenjë përgjegjësie të pyesim të gjithë operatorët e shoqërisë civile të cilët mbulojnë një problematikë të tillë. Cila është përgjegjësia juaj? Të pyesim dhe shtetin, cila është përgjegjësia jote? Porse edhe çdo individ do duhet të pyesi veten, sa dhe si kam ndihmuar unë veten time dhe shoqërinë që të mendojë si një shoqëri e lirisë, sipas parimit liberaldemokrat, “në fillim rregulli pastaj liria”. Kjo është problematika e hapur e rinovimit si shoqëri dhe si shtet në kuadrin e asaj që njihet si “Demokratizimi i Demokracisë”.

Rinovimi shoqërisë civile tashmë është imperativ. Autoriteti i tipit pushtetor tek shumë operatorë të shoqërisë civile do duhet të marrë fund. Më shkoqur. Nëse në politikë “x” person do të qëndronte 25 vite në krye të një posti, një realitet i tillë do të thoshte që ende politika dhe mentaliteti politik është i vjetër, ka mbetur si atavizëm nga rregjimi totalitar dhe duhet korrigjuar, duke i hapur rrugë qarkullimit të elitave. Po nëse në një Institut, fjala vjenë të Medias psh, si operator me shumë përgjegjësi në shoqërinë civile, i njëjti individ qëndron mbi 20 vite në drejtimin e tij, ky lloj pushteti brenda shoqërisë civile si e ka emrin? Po jap unë një version, pa u nxituar dhe duke drejtmenduar. Ky quhet “pushtet personal” brenda shoqërisë civile. Po partnerët ndërkombëtarë rezidentë në Shqipëri dhe ata jashtë vendit, a nuk e shohin këtë realitet kur vijojnë të lëvrojnë fonde për operatorë të tillë të shoqërisë civile. Jemi të shqetësuar sepse në vitet e fundit ka ndodhur që OJF hapur të shpërfaqen si aleate dhe megafon me një parti politike, dhe simotra e saj me një parti tjetër.

Një palë ngre në qiell punën e pozitës së rradhës, të tjerat nxijnë punën e saj dhe i bëjnë fresk mendimit zyrtar të opozitës politike të rradhës. Kulmi ndodhi kur individë të shoqërisë civile, organizatën e kthyhen në parti politike dhe nga partia kërcyen në pushtete. Do bënte sens që pas një aktiviteti të gjatë politik si edhe ndodhë në botën e civilizuar, kur individit largohet nga jeta politike aktive, me qëllim që eksperiencia dhe bagazhi të mos shkonin dëm, të ndërtonin aktivitet si operatorë të shoqërisë civile. Ç'ka ndodhur në Shqipëri, s'ka lidhje me kuptimin dhe rolin e shoqërisë civile në sistemin e demokracisë funksionale. Për rrjedhojë, krejt pa sens gjejmë mënyra veprimi dhe sjellje të OJF-ve, bazuar në mentalitetin e shtetit, si edhe takojmë qëndrime shtetërore si të jenë operatorë të shoqërisë civile. S'ka deformim më të thellë kur shoqëria civile dhe operatorët e saj, imitojnë shtetin dhe shtetarët. Inops, potentem dum vult imitari, perit-I dobëti shkatëron veten nëse kërkon të imitojë të fuqishmin. Dalja nga kjo gjendje është një tjetër detyrim për rinovimin e shoqërisë civile në vendin tone që do të ndihmonte në shëndoshjen e demokracisë. Kurimi i krizës së përfaqësimit, është një detyre imediate për shoqërinë civile, në mënyrë që vendi ynë të dali më në fund nga modeli i "monokracisë dyfishe" dhe të ndërtojë pluralizmin politik shoqëruar me bashkëjetesë dhe dialog politik normal. Përfaqësimi duhet parë në aspektin politik (të zgjedhurit dhe të emëruarit) por se edhe në aspektin e mbrojtjes së të drejtave që lidhen me pasuritë kombëtare dhe pronat publike, deri tek prona private. Aktualisht flitet për atë që quhet "Mallkimi i burimeve" që "i referohet prirjes së vendeve të pasura me burime natyrore që të kenë si mallkim qeveri të korrupuara...kështu që populli është dhe më i varfër dhe ka një jetë më të mjeruar se në vendet me të cilat natyra nuk ka qenë dhe aq bujare. Kini parasysh Kongon, Sudanin, Sierra Leonen apo Liberinë." (George Soros, Leksionet në Universitetin e Europës Qëndrore, botimi shqip, faqe 88-89, botuesi, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare) Edhe Shqipëria ka burime minierare dhe hidrokarburesh porse është e mallkuar prej tyre, sepse nuk ka transparencë se çfarë ndodh, pa çka se atje shfrytëzohet puna e fëmijëve dhe grave dhe ka ndeshje deri me armë. Asnjë organizatë joqeveritare tek ne nuk është bërë partnere me "Global Witness", që vepron si OJF me moton: "Botojeni atë që paguani". "Ideja ishte që kompanitë të nxirrnin në shesh pagesat që u bëjnë qeverive të ndryshme...dhe populli t'u kërkonte llogari qeverive për paratë që kishin marrë." (po aty faqe 89)

Qeveria britanike krijoi nismën për "Transparencë të Industrive Nxjerrëse" e cila bashkoi qeveri, kompani, dhe shoqërinë civile në përpjekje për të vendosur standarte ndërkombëtare transparence që do të zbatoheshin si ndaj kompanive ashtu edhe ndaj qeverive"...qeveritë kanë detyrimin të bëjnë publike shumat që marrin. Në Shqipëri as që ekziston një klimë e tillë dhe as që shtrohet se sjellja ndaj burimeve është çështje e përfaqësimit si kusht

për të harmonizuar marrëdhëniet mes kapitalizmit me demokracinë. Nëse organizimi politik dhe ai ekonomik nuk përputhen atëhere kemi një realitet të thyer dhe kundërvënës, ku kapitalizmi drejtohet nga të tjerë parime dhe demokracia është e rrezikuar prej tij, sepse përfaqësuesit në të gjithë nivelet janë nën peshën e interesit ekonomik dhe jo nën detyrimin për ti shërbyer qytetarit. Harrohet me qëllim se “sipas konceptit modern të sovranitetit, burimet natyrore të një vendi i përkasin popullit të atij vendi, porse qeveritë, për të cilat supozohet se përfaqësojnë popullin, i vënë interesat e veta mbi interesat e popullit që përfaqësojnë, si dhe futen në gjithfarë praktikash korrupsioni.” (po aty faqe 90) Është një realitet që na dhemb por se “rregjimet e sotëme”, pothuaj në të gjithë ish-lindjen komuniste, nuk ngjajnë ende plotësisht me shoqërinë e hapur. Ato të sjellin në mendje më shumë rregjimet që u rëzuan bashkë me “Murin e Berlinit”; sa kohë që oponenca shtypet ose mbytet, dhe ndarja e pushteteve trajtohet si rivalitet kontradiktor interesash. Një situatë e tillë na bën të mendojmë thellë dhe me preokupim, duke pyetur: Ku është shoqëria civile sot në vitin 2015-të, dhe cilat janë përgjegjësitë saj? Le të shohim më nga afër një histori kontributesh dhe suksesi tek Rotary Club, tek Fondacioni Soros, dhe rruga do të duket jo aq e gjatë, jo aq e mbjellur me vështirësi. Shëmbulli pozitiv është modeli, respektimi tij është lindja e një shëmbulli të ri. Ne kemi nevojë për të! Vitaliteti shoqërisë civile vitalizon humanizmin e shtetit dhe lartëson individin në misionin e tij si operatori bazë i një shoqërie demokratike. Mos harrojmë atë që thonin latinët.

Audentes fortuna juvat.-fati ndihmon ata që guxojnë.

## Bibliografia

- Komisioni Venecias, “Demokracia përmes ligjit.”
- Përparim Kabo, “Autoritarizëm në Tranzicion”-Antropologjia Shqiptare përmes Globalizmave
- John Lock, “Traktati dytë mbi qeverisjen”
- Joseph Stiglitz, “The Price of Inequality”
- Benjamin R. Barber, “Jihad vs. McWorld”
- Anthony Giddens, “The Third Way: The Renewal of Social Democracy”
- Fareed Zakaria, “The FUTURE of FREEDOM”
- George Soros, “Leksionet e Soros në Universitetin e EUROPËS QENDRORE”.

## ANGAZHIMI NDËRKOMBËTAR NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT

Luljeta Kodra

Mediterranean University of Albania

luljeta.kodra@umsh.edu.al

### ABSTRACT

*The whole course of events since the emergence of the Islamic State and the criminal actions that accompanied its foundation, as well as the engagement of international community forces in the fight against ISIS, have raised some important questions dealing with international law.*

*Does the right of the international community to use force and the implementation of the "Responsibility to Protect" doctrine can be put into question in the situation when ISIS continues to conduct war crimes in order to achieve his illegal goals in the fight for a caliphate in the region? Are the well-known international laws on the right of creating new states respected? Does a caliphate fit within the existing political-legal structure of the international community today?*

*The danger that ISIS represents transcends the boundaries of the region where it operates and raises the necessity of an effective solution to curb the negative consequences of its activity. Against the situation created by the rapid expansion of the Islamic State in Iraq and Syria, mobilization of large numbers of foreign fighters with diverse backgrounds and with different experiences that influenced the expansion and entrenchment of the phenomenon, the Western partners have expressed the opinion that ISIS should be considered as a common threat and must be fought with common tools.*

**Key words:** *International community, foreign fighters, ISIS, responsibility to protect, international law.*

## HYRJE

Situata aktuale e krijuar nga shfaqja dhe veprimet konkrete të organizatës së përcaktuar tashmë si organizata më e rrezikshme terroriste përbën një shqetësim global, për faktin se rrezikshmëria që kjo organizatë paraqet i kapërcen kufijtë e rajonit ku ajo vepron kryesisht. Rreziku që vjen nga ISIS është gjithnjë e më i pranishëm për shumë faktorë, që lidhen së pari me aftësitë e kësaj organizate që përbën një nga grupet terroriste më të afta në aspektin e përgatitjes strategjike dhe taktike, që është shumë e përgatitur dhe e trajnuar ushtarakisht dhe që ka një ideologji krejt të qartë.

Kjo organizatë e ka origjinën tek organizata famëkeqe e Al-Kaedës, e cila në kohën e suksesit të aktivitetit të saj, kishte pushtetin qeverisës në bashkëpunim me talebanët mbi pjesën më të madhe të Afganistanit. (Coleman, 2014, 3) Historia e kësaj organizate tregon se ajo ka ekzistuar që në fillim të viteve '90, duke vepruar nën emra të ndryshëm dhe nën maska të ndryshme për realizimin e misionëve të saj mizore, që kanë tejkaluar edhe mizoritë, organizimin dhe kontrollin efektiv të territoreve ku ajo vepron, krahasuar me paraardhësen e saj Al-Kaedën.

ISIS e ka bazën e saj në Siri, ku kontrollon zona të mëdha. Ajo gjeti në këtë rajon një mjedis të përshtatshëm për t'u krijuar, duke filluar me një shtet si Iraku me probleme të shumta në përbërjen e tij, me një shtet si Siria që qeveriset që prej viteve '70 nga një klikë ushtarakësh që përfaqësojnë një minimum të popullsisë, me Libanin fqinj që është i pastabilizuar për shkak të luftës civile që vazhdon prej disa dekadash. Ky rajon, për shkak të problemeve që ka, ofron një territor shumë pjellor për lindjen e grupimeve terroriste, radikale dhe ekstremiste, një prej të cilave ishte edhe ISIS.

ISIS, kjo organizatë terroriste që kohët e fundit e ka quajtur veten thjesht "shtet islamik" dhe është drejtuar nga një ushtarak si Al-Baghdadi, ka treguar shumë herë tashmë qëllimet e saj barbare, duke postuar video me prerje kokash dhe duke kërcënuar vazhdimisht. (Mullen, 2014, 6) Historia e ISIS është e mbushur me imazhe të gazetarëve dhe punonjësve të organizatave humanitare perëndimore me koka të prera, qindra forca irakiene të sigurisë të torturuara dhe të ekzekutuara, shumë fatkeqësi civile dhe shumë të plagosur, mijëra kristianë që largohen nga paniku pasi iu është dhënë ultimatumit të largohen, të konvertohen në muslimanë, ose të paguajnë një taksë, në të kundërt ata rrezikojnë të eliminohen, pëdhunime dhe ekzekutime veçanërisht të atyre që kundërshtojnë ISIS dhe ideologjinë e saj.

Historia e ISIS është historia e asaj se si terrorizmi modern ka evoluar nga një ideal fetar dhe politik në një kult vdekjeje. Deri vonë, sulmet e ISIS

përqëndroheshin në Siri, ku kontrollonin territore të mëdha, burime natyrore dhe armësh, por aktivistët dhe armatimi i ISIS filluan të kalojnë kufirin e Irakut. Në 10 qershor 2014 ekstremistët Suni morën Mosulin, qytetin e dytë më të madh të Irakut (Coleman, 2014, 5). Këta militantë Suni që e quajtën veten “shtet islamik” IS, tani kërcënojnë të pushtojnë Irakun dhe Sirinë. Numri i tyre është rritur shumë dhe rreth gjysma janë luftues të huaj. Sipas burimeve të CIA-s, numri i luftuesve të ISIS i kalon 200.000.<sup>75</sup> Mes tyre fatkeqësisht ka edhe shqiptarë, që kanë shkuar t’u bashkëngjiten radhëve të kësaj organizate pas predikimeve keqdashëse të elementëve ekstremistë që qëllimisht përdorin injorancën, mungesën e kulturës fetare dhe varfërinë për të bindur shumë njerëz që t’i bashkohen një xihadi, i cili vetëm po merr më qafë individë dhe familje të tëra. Nga studime të CIA-s, bëhet e ditur se mbi 148 shqiptarë kanë shkuar të luftojnë në Siri, nga dhjetori 2013 deri në tetor 2014.<sup>76</sup> Nga burime të ndryshme bëhet e ditur se numri i shqiptarëve mund të jetë deri në disa qindra, por ende nuk ka një shifër të përafërt zyrtare.

Një tjetër shkak kryesor i indoktrinimit dhe përfshirjes së shqiptarëve në aktivitete të tilla siç është rasti i luftuesve të huaj në Siri dhe Irak, është ndikimi që organizatat ndërkombëtare të “mbështetura në fe”, ushtrojnë në “bashkësitë” fetare, duke shfrytëzuar varfërinë dhe kushtet e tjera sociale të shqiptarëve. (Blumi, 2005, 21) Aktivitetet fetare të shumë organizatave të ndryshme “bamirëse”, të organizatave që ofrojnë pagesa të ndryshme krijojnë konflikte të brendshme dhe dëmtojnë vlerat e vërteta të fesë e të besimit, sepse njerëzit në këtë mënyrë udhëhiqen nga premtime për të holla, punë, arsim dhe identitet të ri.

Organizata e ISIS ka gjithashtu qëllime të gjera ndërkombëtare. Ajo ndihmohet në arritjen e qëllimeve të saj nga burimet e shumta financiare që janë më të bollshme se të cilësdo organizatë tjetër terroriste që historia ka njohur, nga përdorimi efektiv i medias alternative dhe rrjeteve sociale. (Nguyen, 2014, 11) Këto janë arsyt kryesore që e bëjnë ISIS sot një nga kërcënimet më prezente jo vetëm për rajonin, por edhe për mbarë globin.

Shqetësues është edhe fakti se gjysma e aktivistëve të organizatës vijnë nga vendet europiane dhe muxhahedinë të tjerë, të cilët mund të kthehen në burim terrorizmi dhe në vendet e origjinës, si dhe që po rritet numri i fëmijëve të rekrutuar që po përdoren si ushtarë.

75 [www.independent.co.uk](http://www.independent.co.uk) › News › World › Middle East

76 [www.washingtonpost.com](http://www.washingtonpost.com), Oct 14, 2014

## Fenomeni i luftuesve të huaj

Termi dhe fenomeni i luftuesve të huaj u bënë të njohura pas sulmeve të 11 shtatorit kundër SHBA, për shkak të prezencës së luftuesve të huaj në radhët e talebanëve dhe al-Qaedës në Afganistan. Gjithsesi ai ishte një fenomen i njohur që në luftën civile spanjolle 1948, në luftën në Afganistan që pasoi pushtimin sovjetik të 1989, në konfliktin e Bosnjës në 1990, në luftën e Irakut në 2003 pas ndërhyrjes së udhëhequr nga SHBA etj, për shkak se të gjitha këto luftëra tërhoqën një numër të konsiderueshëm luftuesish të huaj. Somalia dhe Jemeni ishin gjithashtu destinacione të rëndësishme për luftuesit e huaj pas vitit 2000. Siria ka tërhequr më shumë luftues të huaj europianë se të gjitha konfliktet e tjera të armatosura që kanë ndodhur pas viteve 1990.<sup>77</sup>

Sipas të dhënave, shumë individë kanë lënë vendet e tyre për të marrë pjesë në konflikte të armatosura jashtë, megjithatë luftuesit e huaj nuk janë vetëm fenomen musliman. Numri i madh i luftuesve të huaj ka ndikuar si një faktor që ka luajtur rol në zgjerimin dhe rrënjosjen e fenomenit. Prejardhja e këtyre luftuesve të huaj është shumë diverse. Disa janë me eksperiencën e frontit të luftës në beteja të tjera xhihadiste, por shumë vullnetarë të rinj nuk kanë eksperiencë të tilla. Raporte të ndryshme tregojnë se ato që udhëtuan për në Siri, ishin të implikuar më parë në aktivitete kriminale, në disa raste krime të një natyre ekstreme.

Luftuesit e huaj fillimisht u përfshinë në rrjetet terroriste, kryesisht në al-Qaedën dhe për këtë arsye u konsideruan si një kërcënim i madh terrorist pasi të ktheheshin në shtetin kombas të të cilit ishin, ose në shtetin e rezidencës së tyre. U konsideruan kërcënim terrorist për faktin se këta luftues të huaj me eksperiencë në përdorimin e armëve dhe eksplozivëve mund të planifikonin dhe zbatonin akte terroriste kur të ktheheshin në vendet e origjinës, ose mund të krijonin celula të reja terroriste, të rekrutonin anëtarë të rinj, ose të siguronin fonde për akte ose lëvizje të tjera terroriste. Diversiteti dhe numri i luftuesve të huaj rrit potencialin e rrezikut terrorist që paraqitet në kthimin e tyre. Shpërndarja e tyre gjeografike krijon gjithashtu mundësi për krijimin e një rrjeti të aktiviteteve terroriste përmes Europës.

Çfarë do kuptojmë në fakt me luftues të huaj? Termi luftues të huaj është kuptuar në mënyra të ndryshme. Sipas një studiuesi, luftuesit e huaj përbëjnë kategorinë e një aktori të ndërmjetëm, të pozicionuar ndërmjet rebelëve lokalë nga njëra anë dhe terroristëve ndërkombëtar nga ana tjetër. (Malet, 2010, 5)

Autori David Malet i përkufizon luftuesit e huaj si 'joqytetarë të shteteve

<sup>77</sup> Foreign Fighters under International Law, Geneva Academy of International Humanitarian Law and Human Rights, October 2014, p.5

në konflikt”, të cilët i bashkohen kryengritjes gjatë luftës civile dhe që nuk motivohen nga përfitime materiale.

Thomas Hegghammer jep një përkufizim të përafërt, kur i paraqet luftuesit e huaj si individë që i bashkohen një kryengritjeje jashtë dhe që kanë motivim kryesor ideologjik ose fetar dhe jo financiar. (Hegghammer, 2011, 53)

Qendra ndërkombëtare për kundërterrorizmin, konkludoi që shtetësia e luftuesve të huaj nuk përbën një kriter të saktë për t’i përkufizuar ata, sepse në shumë raste, këto luftues mund të jenë qytetarë europianë, por që për nga prejardhja e tyre mund t’i përkasin një gjenerate emigrantësh. (Cilluffo, 2010, 3)

Hegghammer propozon katër kritere për përkufizimin e luftueve të huaj, në mënyrë që ata të dalloheshin nga llojet e tjerë të aktorëve të dhunshëm që kapërcejnë kufijtë e shtetit të tyre. Sipas tij, luftuesit e huaj janë ata individë që:

1. I janë bashkuar një kryengritjeje si pjesëmarrës në të.
2. Nuk janë shtetas të shtetit në konflikt.
3. Nuk kanë lidhje me ndonjë organizatë ushtarake zyrtare.
4. Nuk paguhen.

Bazuar në këto përkufizime të ndryshme mund të konkludojmë se një luftues i huaj është një individ që largohet nga vendi i tij i banimit ose i origjinës, për t’iu bashkuar një grupi të armatosur joshtetëror, në një konflikt të armatosur jashtë dhe i cili motivohet kryesisht nga ideologjia, besimi ose lidhjet e tjera të ndryshme. Në raste të veçanta luftuesit e huaj mund të paguhen, por pagesa nuk është motivi kryesor i tyre i luftës.

Është fakt se pjesa më e madhe e luftueve të huaj janë aktivë në konfliktet jondërkombëtare. Vetëm në raste të ralla luftuesit e huaj angazhohen në konflikte ndërkombëtare siç është rasti i angazhimit të luftuesve të huaj muslimanë në konfliktin ndërkombëtar që pasoi pushtimin sovjetik të Afganistanit. Afganistani dhe Iraku, pas ndërhyrjeve të udhëhequra nga SHBA në këto shtete, përbëjnë shembuj të tjerë të angazhimit të luftuesve të huaj në konfliktet ndërkombëtare.

Një tjetër çështje e debatueshme që lidhet me statusin juridik të luftuesve të huaj është ajo nëse luftuesit e huaj ngjajnë me mercenarët në disa aspekte. A mund të konsiderohen luftuesit e huaj si mercenarë, sipas normave të së drejtës ndërkombëtare humanitare?

Aktet ndërkombëtare përmbajnë përkufizime të ndryshme për mercenarët. Këto akte i përkufizojnë mercenarët si individë që marrin pjesë drejtpërdrejtë në konflikt, por nuk kanë kombësinë e asnjërës prej palëve të konfliktit të armatosur ndërkombëtar në fjalë, nuk janë rezidentë të territorit të kontrolluar nga njëra palë ose pjesëtarë të forcave të armatosura të njëjës palë. Për më tepër, mercenarët motivohen për të marrë pjesë në veprime luftarake

të nxitur kryesisht nga dëshira për përfitime personale, ndryshe nga individët që motivohen në radhë të parë nga ideologjia ose besimi. Mercenarët nuk gëzojnë statusin e luftuesit ose të robit të luftës sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare. Bazuar në këto përkufizime, luftuesit e huaj nuk mund të përkufizohen si mercenarë sipas të drejtës ndërkombëtare.

### **Diplomacia ndërkombëtare lidhur me kërcënimin ISIS**

Për shkak të situatës së krijuar nga veprimet terroriste të ISIS dhe mendimit të gjithëpranuar mbi rrezikshmërinë që paraqet kjo organizatë, partnerët perëndimorë (SHBA, Britani e Madhe, Gjermani, Francë, Itali e të tjerë), kanë shprehur mendimin se ISIS duhet konsideruar si një kërcënim i përbashkët. Ata kanë shprehur gjithashtu vullnetin për t'iu kundërvënë asaj me masa konkrete dhe për ta luftuar me mjete të përbashkëta. Si masa konkrete janë konsideruar propozimet për ndryshime në legjislacionin e brendshëm penal të shteteve, gjurmimi dhe penalizimin e financuesve të organizatës, krijimi i partneriteteve të përshtatshme për të luftuar këtë kërcënim të përbashkët dhe për të fuqizuar kurdët, duke shkuar deri te mundësia e ndërhyrjes ushtarake, e cila ka qenë fillimisht sporadike dhe nga ajri.

Organizata të shumta si: Lidhja Arabe, Bashkimi European, Organizata e Kombeve të Bashkuara etj, e kanë cilësuar ISIS si një kërcënim për komunitetin ndërkombëtar dhe kanë ranë dakord "të sigurojnë që keqbërësit të sillen para drejtësisë". (Mullen, 2014, 10)

Organizma të ndryshme të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Komisionerin e Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, si dhe shumë organizata joqeveritare kanë raportuar se Shteti Islamik ka kryer shkelje të mëdha dhe sistematike të të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtave të njeriut në zonat që ky shtet kontrollon, si në Siri ashtu edhe në Irak.

Kundër situatës së mobilizimit të luftuesve të huaj dhe kërcënimin terrorist që e shoqëron, si dhe zgjerimit të shpejtë të shtetit islamik në Irak dhe Siri, në 15 gusht 2014, Këshilli i Sigurimit adoptoi Rezolutën Nr.2170. Ajo dënonte aktet terroriste të shtetit islamik dhe ideologjinë ekstremiste të dhunës që përdor ky shtet, si dhe shkeljet e vazhdueshme të mëdha dhe të shumëpërhapura të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe duke u bazuar në kapitullin VII të Kartës i dikton detyra të rëndësishme shteteve.<sup>78</sup>

Drejtues të shteteve të ndryshme kanë reaguar ndaj situatës së sulmeve të shumëpërhapura dhe sistematike të drejtuara kundër një popullsie civile, për shkak të përkatësisë së saj etnike ose bindjeve fetare, duke thënë se ata që janë përgjegjës duhet të mbajnë përgjegjësi. (Hulse, 2014, 15)

<sup>78</sup> Security Council, Resolution 2170 (2014), 15 August 2014, [www.un.org/press/en/2014/sc11520.doc.htm](http://www.un.org/press/en/2014/sc11520.doc.htm)

Presidenti Barack Obama i kërkoi Kongresit, në 11 shkurt 2015, që të autorizonte formalisht përdorimin e forcës së armatosur në luftë kundër ISIS. Obama shpjegon se ka kërkuar që t'i jepet e drejta për të autorizuar operacione të luftës në tokë në rrethana të kufizuara, përfshirë edhe operacionet e shpëtimit dhe të forcave speciale në mënyrë që të ndër marrë aksione ushtarake kundër udhëheqjes së organizatës, si dhe për t'i treguar botës se ne jemi të bashkuar në këtë mision. I ashtuquajturit Shtet Islamik ka pohuar Obama paraqet kërcënim për njerëzit dhe stabilitetin në Siri, Irak dhe më gjerë në Lindjen e Mesme, si dhe për sigurinë kombëtare të SHBA. (Acosta, 2015, 2)

Qeveria franceze ka pohuar se është e vendosur që të ndër marrë çdo masë të nevojshme kundër ISIS, përfshirë edhe mbështetjen ushtarake, në përputhje me nevojat e shprehura nga autoritetet e Irakut, në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe pa rrezikuar sigurinë civile. Presidenti francez Hollande ka deklaruar se “nuk kanë kohë për të humbur” në përpjekjet ndërkombëtare kundër ISIS.<sup>79</sup>

Britania gjithashtu ka rënë dakord që të ndihmojë forcat kurde, të mbështesë qeverinë e Irakut, të vazhdojë zbatimin e ndihmës humanitare dhe të koordinojë në Kombet e Bashkuara luftën kundër ISIS.

Kancelarja gjermane Angela Merkel ka mbështetur vendimin e qeverisë së saj për t'iu dërguar armë kurdëve që luftojnë militantët e shtetit islamik në Irak, duke thënë në parlament se ky grup paraqet një kërcënim të madh për sigurinë në Gjermani dhe Europë. Sipas saj destabilizimi i një rajoni të gjerë ndikon edhe mbi Gjermaninë dhe Europën. Në këtë situatë aktuale krize, armët gjermane po shpërndahen me qëllim që të influencohet kriza, të ndihmohet një partner dhe të parandalohet një rrezik. Gjermania, sipas kancelares Merkel ka përgjegjësi të ndërhyjë për të parandaluar një katastrofë humanitare në Irak, për shkak të evidencës së spastrimit etnik që po bëjnë luftuesit e Shtetit Islamik dhe është e përgjegjshme për rrezikun e kësaj mbështetjeje që po jep. Përkundër mendimit se armët mund të përfundojnë në duart e xhihadistëve dhe se për shkak të mbështetjes që po jep Gjermania mund të bëhet shënjestër e tyre, Merkel ka pohuar se një rrezik akut vjen nga ISIS në qoftë se ne nuk shpërndajmë armë. (Barkin, 2014, 4)

Shumë kombe kanë rënë dakord që të kontribuojnë në luftën kundër ISIS, i cili kontrollon zona të mëdha në Irakun verior dhe në Siri. Disa kombe kanë ofruar ndihmë në vendosje trupash në tokë, por edhe në operacione të ajrit si□ bëri Franca me fluturimet e rikonicionit mbi Irak. Këtij kontigjenti shtetesh iu shtua kohët e fundit edhe Jordania, pas ekzekutimit të pilotit jordanez të kapur nga ekstremistët e shtetit islamik.

<sup>79</sup> News “World” Middle East, Sep 15, 2014, [www.independent.co.uk](http://www.independent.co.uk) › News › World › Middle East

Edhe Shqipëria ka dhënë kontributin e saj duke ndihmuar qeverinë irakiene nëpërmjet dërgimit të armatimeve dhe municioneve. Shqipëria, që në muajin gusht 2014 ka filluar t'u dërgojë armë kurdëve, nëpërmjet ndihmës së sistemeve perëndimore të transportit ajror dhe madje është përgëzuar nga autoritete të ndryshme perëndimore për furnizimin me armë. (Wordsworth, 2014, 21) Shqipëria gjithashtu ka ndërmarrë masa për të dekurajuar fenomenin e luftuesve të huaj. Ndër këto masa përfshihen edhe ndryshimet që u miratuan në Kodin Penal, ku u përcaktua se: Pjesëmarrja në formacione luftarake, organizata ushtarake ose paraushtarake në një konflikt të armatosur që zhvillohet në territorin e një shteti të huaj ose pjesëmarrja në çdo lloj trajnimit të zhvilluar nga këto struktura, pa qenë shtetas në shtetin e huaj, pa qenë pjesëtar i forcave të armatosura të njëjës prej palëve në konflikt ose misioneve ushtarake zyrtare të forcave të armatosura të një shteti që nuk është palë në konflikt ose misioneve ushtarake zyrtare të një organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.<sup>80</sup>

Të dënueshme u konsideruan edhe nxitja, rekrutimi, organizimi, drejtimi, stërvitja, vënia në dispozicion e pajisjeve, krijimi ose përdorimi i fondeve ose mjeteve të tjera për financimin, mbështetjen materiale të personave, në çdo lloj forme dhe mënyre, për të kryer këtë veprë penale, si dhe thirrja në mënyrë publike me çdo lloj forme, mjeti dhe mënyrë për të kryer veprën penale.

### **Çështjet që ka ngritur krijimi i shtetit islamik dhe aksioni ndërkombëtar kundër tij**

Fuqizimi i organizatës terroriste ISIS, veprimet e saj të shumta kriminale, vendosja e kontrollit efektiv mbi pjesë të konsiderueshme të territorit sirian dhe atij irakien, gjithë rrjedha e ngjarjeve, qëllimet e gjera ndërkombëtare që ajo ka, shfaqja e Kalifatit "një shteti islamik dhe veprimet kriminale që shoqëruan lindjen e këtij shteti, angazhimi i forcave aleate në luftën kundër ISIS, ngritjen disa çështje të rëndësishme në të drejtën ndërkombëtare.

Së pari, dihet tashmë që pasja e një "shteti" përbën një objektiv shumë të rëndësishëm për ISIS si dhe që Abu Bakr al-Baghdadi, ka njoftuar krijimin e këtij shteti islamik, të quajtur kalifat. (Coleman, 2014, 5). Çështja e parë që shtroi njoftimi për krijimin e këtij shteti është ajo e mënyrës së formimit të tij, si u krijua ky shtet. A janë respektuar normat e mirënjohura ndërkombëtare mbi mënyrat e ligjshme të krijimit të shteteve të reja? Pas krijimit të një shteti një fazë tjetër e rëndësishme nga pikëpamja e të drejtës ndërkombëtare është ajo e njohjes ndërkombëtare të këtij shteti. (Puto, 2012, 130). Çfarë nënkupton në të vërtetë njohja ndërkombëtare e shtetit? A vendos ajo për ekzistencën e shtetit, apo është më tepër një proces diplomatik? A përbën njohja e shtetit një kërkesë

80 Jul 31, 2014 - Kuvendi. Ligj. Nr. 98/2014, [www.parlament.al](http://www.parlament.al)

të zakonshme për të siguruar respektimin e vlerave dhe normave të të drejtave njerëzore, apo është një proces që siguron se shtetet e krijuara rishtazi do të ekzistojnë në harmoni me komunitetin ndërkombëtar?

Është e qartë nga pikëpamja teorike se një kalifat përfaqëson një shtet sovran të të gjithë besimit musliman, që drejtohet nga një kalif mbi bazën e ligjit islamik, të quajtur ndryshe “sherihati”. Po çfarë nënkupton kjo për kushtet e sotme? A mund të përshtatet kalifati brenda strukturës ekzistuese politiko-ligjore të komunitetit të sotëm ndërkombëtar? Për më tepër, mund të ngremë pyetjen se a mundet që një shtet që imponon një rregjim joligjor, që injoron të drejtat e njeriut dhe kryen shkelje të mëdha e sistematike të këtyre të drejtave në emër të një besimi të shtrembëruar, që vazhdon të kërcënojë me veprimet e tij rendin ligjor ndërkombëtar, ta konsiderojë veten “të ligjshëm”?

Një tjetër çështje e rëndësishme që ngrihet në kushtet kur ISIS vazhdon të kryejë krime lufte dhe me qëllim po kërcënon dhe vret civilë, po përre grupet minoritare dhe po rekruton luftues të huaj nga të gjitha anët e botës, po rekruton gjithashtu ushtarë fëmijë, për të arritur qëllimet e tij të paligjshme në luftën për një kalifat në rajon, është çështja e të drejtës së përdorimit të forcës dhe e zbatimit të “Përgjegjësisë për të Mbrojtur”.

A është e nevojshme në kushtet aktuale dhe aktivitetit të vazhdueshëm terrorist të kësaj organizate si dhe të rrezikut gjithnjë e më serioz e global që ajo paraqet, që të kërkohet një mbështetje ligjore për zbatimin e “Përgjegjësisë për të Mbrojtur” në Irak? (Ferguson, 2014, 20)

Doktrina e “Përgjegjësisë për të Mbrojtur”, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në vitin 2005, parashikon se shteti vetë duhet të mbrojë civilët e tij nga krime si genocidi, spastrimi etnik, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit dhe në rast se shteti nuk është në gjendje, ose nuk ka vullnet ta bëjë këtë, atëherë lind përgjegjësia e komunitetit ndërkombëtar të ndërhyjë për të mbrojtur ata që po çënohen.<sup>81</sup>

Përgjegjësia për të Mbrojtur është më shumë se ndërhyrje ushtarake. Ajo përfshin parandalimin e konflikteve, ndërtimin e paqes pas konflikteve dhe diplomacinë. (Evans, 2001, 33)

Në kushtet e sotme, në këtë fazë të zhvillimit të ngjarjeve në Siri dhe Irak, dhe në këtë fazë të përpjekjeve të ISIS për të shtrirë aktivitetin e saj më gjerë se rajoni ku vepron më fuqishëm, komuniteti ndërkombëtar ka mundësi dhe detyrim të merret me këtë çështje përpara se të jetë tepër vonë. Megjithëse disa pretendojnë dhe besojnë se është shumë herët të zbatohet parimi i fundit i

81 Resolution 60/1”, United Nations General Assembly, October 24, 2005,

[http://unstats.un.org/unsd/mdg/Resources/Attach/Indicators/ares60\\_1\\_2005summit\\_eng.pdf](http://unstats.un.org/unsd/mdg/Resources/Attach/Indicators/ares60_1_2005summit_eng.pdf).

doktrinës së “Përgjegjesisë për të Mbrojtur”, që është ai i ndërhyrjes ushtarake, gjithsesi nuk është shpejt të diskutohet parimi si një i tërë, veçanërisht aspekti i tij i parandalimit të përkeqësimit të situatës. (Hulse, 2014, 4)

Është krejt i arsyeshëm pretendimi i krijuesve të doktrinës së “Përgjegjesisë për të Mbrojtur” që kjo doktrinë duhet përdorur me shumë kujdes sepse ekziston një rrezik ekstrem në qoftë se doktrina keqpërdoret. Bashkohem plotësisht me idenë se keqpërdorimi i kësaj doktrine rrezikon të dëmtojë aftësinë e komunitetit ndërkombëtar për të zbatuar çfarëdolloj ndërhyrje të ligjshme dhe për arsye krejt humanitare. Një keqpërdorim flagrant nuk përbën rrezik vetëm për sovranitetin e shtetit ku ndërhyhet, por edhe për të ardhmen legjitime të vetë parimit.

Një tjetër çështje ka të bëjë me faktin e angazhimit të SHBA dhe të shumë shteteve të tjera që nënkupton aleatët e SHBA-së në situatën e krijuar nga veprimet e ISIS në Siri dhe Irak. Pikëpyetja që ngrihet mbështetet mbi faktin e njohur se rregjimi sirian është përgjegjës për krime barbare të panumurta kundër popullsisë së tij. Në rrjedhën e ngjarjeve, në mënyrën se si SHBA janë angazhuar dhe po mbështesin në mënyrë aktive këtë lloj rregjimi në Siri si dhe në shkallën e kësaj mbështetjeje, lind pyetja e rreziqeve potenciale me të cilat mund të shoqërohet kjo ndërhyrje amerikane. Pavarësisht se ndërhyrja amerikane bëhet me një qëllim të qartë që të zbatohet “Përgjegjësia për të Mbrojtur”, dhe se aksioni i saj drejtohet kundër fuqisë së ISIS duke synuar dobësimin e kësaj organizate dhe ndihmën ndaj popullsisë civile të prekur nga veprimet e ISIS, në një farë mënyre kjo ndërhyrje mbështet rregjimin sirian. (Bellamy, 2014, 40)

Pra ndodh që rregjimi sirian po merr mbështetje nga mënyra se si amerikanët po bashkëpunojnë me këtë rregjim në luftë kundër ISIS dhe nga mënyra se si po lejohet angazhimi i forcave të shumta siriane, gjë që mund të forcojë pozitat e këtij rregjimi që në një të ardhme të afërt të jetë në gjendje dhe i lirë të angazhojë burime më të mëdha në fushatën e tij kundër Ushtrisë së Lirë Siriane.

Ky rrezik dhe kjo pikëpyetje në fakt qëndron, por për momentin është e justifikueshme për faktin se rreziku më i madh i momentit është ISIS dhe për të luftuar këtë të keqe të madhe duhen bashkuar forcat dhe duhen bërë aleanca të përkohshme. Kjo nënkupton se në realitetin e vështirë ku ndodhemi aktualisht për shkak të kërcënimit që paraqet ISIS për civilët, dhe për mbarë botën si dhe për shkak të domosdoshmërisë që paraqet nevoja e mbrojtjes së popullsisë nga genocidi dhe barbarizmat e tjera masive, interesat e koalicionit të udhëhequr nga SHBA duhen parë si të bashkërenduara me interesat e qeverisë siriane.

Një tjetër çështje që ka shkaktuar debat kohët e fundit është ajo nëse lufta kundër xhihadit nënkupton luftë kundër varfërisë?

Zëdhënësja amerikane e Departamentit të Shtetit Marie Harf ka deklaruar kohët e fundit se të luftosh grupin terrorist ISIS nënkupton së pari që të fokusohesh tek shkaqet që e kanë shkaktuar këtë fenomen, siç janë kushtet ekonomike të cilat bëjnë që një musliman ta ketë më të lehtë të rrëmbejë armët sesa të fillojë një biznes. Nisur nga ky pohim, Jay Sekulow Kryetar i Këshillit të Qendrës Amerikane për Ligj dhe Drejtësi ka ngritur versionin e tij duke thënë se: Tashmë ne e dimë se pse xhihadistët po ushtrojnë pushtetin e tyre në Lindjen e Mesme duke prepë koka dhe duke djegur të gjallë këdo që i kundështon. Kjo ndodhka për faktin se është shumë e vështirë të hapësh një biznes në Siri.

Në fakt pamundësia e hapjes së biznesit është shumë larg natyrës së armikut tonë të përbashkët. Nuk ka asnjë lidhje të dukshme ndërmjet varfërisë dhe terrorit xhihadist. Kjo për shumë arsye. Dihet tashmë se terroristët po vijnë në ISIS edhe nga vende perëndimore, vende në të cilat është më e lehtë të hapësh një biznes sesa të rrëmbesh armët. Franca, Gjermania dhe Britania janë ndër kombet më të pasura në botë. Më shumë muslimanë britanikë janë raportuar që po luftojnë për ISIS sesa i janë bashkuar ndonjëherë vullnetarisht ushtrisë britanike.

Për më tepër terroristët më famëkeq janë shpesh të pasur dhe vijnë nga backgrounde të arsimuar. Osama Bin Laden vjen nga një familje e pasur. Mohamed Atta-njëri prej drejtuesve kryesor të sulmeve të 11 shtatorit kundër SHBA – ishte arkitekt. Drejtuesi i ISIS Abu Bakr al-Baghdadi ka mbrojtur tituj shkencor në Universitetin e Bagdatit. Xhihadistët janë motivuar nga bindjet fetare jo nga varfëria.

Sipas Graeme Wood (Wood, 2015, 3) situata e shkaktuar nga xhihadistët është sa absurde aq dhe tragjike. Xhihadistët janë njerëz që për qëllime politike përdorin një maskë fetare mesjetare në mënyrë që t'i përshtaten Shtetit Islamik. Në fakt çdo gjë që ky grup po bën nuk ka sens. Ata thjesht po përpiqen të kthejnë botën shumë shekuj prapa.

Në librin e tij "Rilindja e ISIS, një kërcënim që ne nuk mund ta injorojmë", Jay Sekulow argumenton se përgjigjja e duhur ndaj xhihadistëve është përdorimi i forcës për t'i mposhtur ata.

Në fakt ne u perballëm me paraardhësen e ISIS në Irak Al-Qaeda dhe e mundëm atë. Al Qaeda në Irak u mund deri në atë shkallë sa që e kishte të pamundur që të kërcënonte më qeverinë e Irakut. Për shkak të tërheqjes së trupave amerikane nga Iraku, Al Qaeda e Irakut mori zhvillim të ri në Siri në formën e ISIS, dhe pastaj u rishpërnda nëpër Irak duke shkaktuar këtë krizë gjeopolitike me të cilën po përballemi sot. Lufta jonë kundër ISIS është një luftë e vërtetë dhe jo një luftë kundër varfërisë ose një luftë politike korrekte ndaj ekstremistëve. Në një luftë të vërtetë duhet luftuar derisa armiku të dorëzohet ose të pushojë luftën. (Sekulow, 2015, 1)

## Përdorimi i ligjshëm i forcës kundër terrorizmit

Fushatat ajrore kundër të ashtuquajturit shtet islamik në Siri, goditjet e pozicioneve të ndryshme të ISIS në Siri dhe Irak, që kanë pasuar aksionet kriminale të prerjes së kokave dhe krime të tjera të kryera nga militantët islamikë në këto zona, kanë ngritur pikëpyetje të ndryshme. Këto pikëpyetje kanë të bëjnë me faktin nëse e drejta ndërkombëtare e quan të ligjshme ndërhyrjen ushtarake në një shtet tjetër të një shteti ose grupi shtetesh që nuk janë pjesë e konfliktit.

Duke komentuar sulmet ajrore në Siri dhe në Irak, disa pretendojnë se janë sulme të paligjshme, për shkak se nuk janë autorizuar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dhe sepse nuk janë akte vetëmbrojtëse duke qenë se ISIS nuk paraqet kërcënim për SHBA ose shtetet e tjera aleate të saj.

Por, nuk ka dyshim se destabilizimi i një rajoni të gjerë ndikon mbi të gjitha shtetet aq më tepër që gjysma e aktivistëve të organizatës vijnë nga vendet europiane dhe përbëjnë kërcënim për burime të tjera terrorizmi kur të kthehen në vendet e origjinës. Në momentin që terroristët fuqizohen aq shumë saqë marrin kontrollin mbi një territor kaq të gjerë siç ka ndodhur në Siri dhe në Irak, për t'i dhënë vetes së tyre dhe ekstremistëve të tjerë një bazë për aktet e tyre terroriste, atëhere preken interesat e përgjithshme të sigurisë botërore. Duke arsyetuar në këtë mënyrë mund të themi që, mungesa e një kërcënimi direkt ndaj SHBA ose ndaj aleatëve të saj nuk e bën të paligjshme ndërhyrjen e tyre, e cila merr në këtë rast formën e një ndërhyrjeje vetëmbrojtëse, sepse veprimet kundër ISIS në Irak dhe Siri janë kryesisht një përgjigje mbrojtëse ndaj agresionit të armatosur të kësaj organizate. (Bellamy, 2014, 12)

Për më tepër, po të nisemi fillimisht nga rasti i Irakut, qeveria e Irakut ka të drejtë të përdorë forcën për të mbrojtur veten nga sulmet e ISIS, por edhe shtetet e tjera kanë të drejtë të asistojnë. E drejta e vetëmbrojtjes është sanksionuar në nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Ky nen garanton të drejtën e brendshme të shtetit për vetëmbrojtje individuale ose kolektive që nënkupton se shteti që nuk ka mundësi të mbrohet vetë mund të kërkojë asistencë të armatosur nga shtetet e tjera.

Faktikisht Iraku ka ndërmarrë masa për të luftuar ISIS brenda territorit të tij dhe si një shtet sovran ka të drejtë gjithashtu të kërkojë asistencë nga shtetet e tjera. (Nguyen, 2014, 55) Ndërhyrja nga ana e shteteve të tjera nuk përbën cënim të integritetit territorial të Irakut dhe as cënim të pavarësisë politike të këtij shteti sepse lideri i rajonit kurdistan të Irakut ka pohuar se ata mirëpresin çdo lloj ndërhyrje nga jashtë në luftë kundër ISIS dhe ka kërkuar gjithashtu që të intensifikohen goditjet ajrore të SHBA.

Përdorimi i forcës në territorin e shtetit të Irakut ose të Sirisë, pa pëlqimin e qeverive të shteteve përkatëse, në pamje të parë do të cënonte integritetin territorial të këtyre shteteve dhe do të shkelte nenin 2(4) të Kartës së Kombeve të Bashkuar mbi rregullat e përdorimit të forcës sipas Kombeve të Bashkuara. Pra, është e qartë që ligjërisht duhet të kërkohet pëlqimi nga qeveritë irakiene dhe siriane përpara se të ndërmerren aksione në territorin e tyre shtetëror.

Në rastin e kapaciteteve që ka Siria si shtet dhe në kushtet e përkeqësuar atje për shkak të veprimeve ekstremiste ndaj popullsisë, mund të themi që Sirisë aktualisht i mungon aftësia për t'u përballur dhe për më tepër për të shpërbërë organizatën terroriste ISIS. Normalisht duke qenë se Siria nuk ka aftësi të luftojë vetëm kundër ISIS, çdo refuzim nga ana e saj për ndërhyrje nga jashtë do të ishte i paarsyeshëm dhe nevoja për aksion ndërkombëtar e pashmangshme. (Nguyen, 2014, 57) Por, faktikisht nga pohimet e qeverisë siriane dhe nga veprimet e saj rezultojnë që misioni kundër ISIS gëzon pëlqimin e kësaj qeverie. Qeveria siriane jo vetëm që ka ofruar pëlqimin zyrtarisht, por ajo gjithashtu ka bashkëpunuar me drejtuesit e SHBA, duke vënë në dispozicion mbrojtjen e saj ajrore në zonat përkatëse ku janë kryer dhe po kryhen operacionet. (Bellamy, 2014, 12)

Detyrimi sipas të drejtës ndërkombëtare që ndërhyrjet në një shtet tjetër, qoftë edhe në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve të këtyre shteteve, duhet të jenë të ligjshme nga pikëpamja e të drejtës ndërkombëtare ka nxitur debatin mbi një tjetër çështje që lidhet me rastet konkrete të luftës në Siri dhe Irak kundër ISIS.

Kur krerët e shteteve ose më mirë të themi politikëbërësit diskutojnë dhe vendosin mbi mënyrat e mundshme sipas tyre të zgjidhjes së problemeve që shkaktohen nga organizata terroriste ISIS, ata duhet të mbajnë parasysh se zgjidhja politike duhet detyrimisht të jetë në përputhje me rregullat ligjore të njohura dhe të pranura tashmë në të gjithë botën. Në këtë kuptim ata duhet të mbajnë parasysh faktin se kur orientojnë përdorimin e forcës në aksionin ushtarak kundër ISIS në Irak dhe në Siri, duhet të jenë të sigurt që ky zbatim force gjen mbështetje ligjore të arsyeshme. Thënë ndryshe, duhet të jenë të bindur se kur autorizojnë ndërhyrjen e armatosur si formë të zgjidhjes së konfliktit, kjo zgjidhje mbështetet në rregullat e duhura ligjore ndërkombëtare.<sup>82</sup>

Karta e Kombeve të Bashkuara parashikon në nenin 51 të saj se: "Asnjë dispozitë e kësaj Karte nuk mund të pengojë të drejtën e vetëmbrojtjes individuale ose kolektive kur ndodh një sulm". Por, që të zbatohet e drejta e vetëmbrojtjes duhet të ekzistojë një sulm aktual ose i afërt kundër një shteti,

82 [JURIST - The Use of Force Against ISIS](http://www.jurist.org/hotline/2014), Jul 3, 2014, [jurist.org/hotline/2014](http://www.jurist.org/hotline/2014)

duhet gjithashtu që kundërpërgjigja e armatosur ndaj këtij sulmi të jetë e domosdoshme dhe proporcionale me vetë sulmin.<sup>83</sup>

Lidhur me këtë përcaktim ligjor ndërkombëtar, pyetja e parë që mund të ngremë në rastin e konfliktit me ISIS dhe veprimet terroriste të organizatës në Irak dhe Siri është, nëse kemi të bëjmë me një sulm që siç theksuam më lart duhet të jetë sulm në vazhdim ose në rrezik potencial. Kjo quhet një përgjigje e ezauruar sepse është provuar tashmë se ISIS ka kryer dhe vazhdon të kryejë sulme. Pra, domosdoshmëria e kundërpërgjigjes ndaj sulmeve terroriste të ISIS buron nga fakti se një sulm po ndodh, prandaj është e nevojshme dhe e domosdoshme për Irakun dhe aleatët e tij që të kenë të drejtë të përdorin forcën. Kuptohet deri në këtë pikë është një kundërpërgjigje e ligjshme, për më tepër në rastin aktual një përpjekje për të zgjidhur çështjen në mënyrë paqësore do t'i jepte mundësi ISIS të konsolidonte përpjekjet e saj dhe të përgatiste sulme të tjera.

Përsa i përket kërkesës tjetër ligjore ndërkombëtare sipas të cilës çdo kundërpërgjigje mbrojtëse duhet të jetë proporcionale, në kushte normale të zbatimit të së drejtës ndërkombëtare, sulmet ajrore kundër bazave, asetëve dhe personelit të ISIS brenda territorit sirian dhe atij irakien nuk duhet të jenë jashtë proporcioneve të sulmeve të ISIS. (Nguyen, 2014, 44)

Objektivi i aksionit duhet të jetë i arsyeshëm dhe aksioni vetë nuk duhet të shkojë përtej asaj çfarë është e nevojshme për të arritur objektivin me qëllimin e arsyeshëm të zvogëlimit të aftësive të ISIS. Ndërsa në qoftë se do ta shohim në aspektin e zhvillimeve aktuale ose nevojave të ndryshimit në disa raste të normave ndërkombëtare, do të isha e mendimit që kundërpërgjigja ndaj ISIS duhet të jetë në proporcione të tilla që të arrijë çrrënjosjen e fenomenit dhe jo vetëm dobësimin e kapaciteteve të organizatës.

### **Konkluzione**

Luftuesit e huaj janë individë që largohen nga vendi i tyre i banimit ose i origjinës, për t'iu bashkuar një grupi të armatosur joshtetëror, në një konflikt të armatosur jashtë dhe që kryesisht motivohen nga ideologjia ose besimi. Në raste të veçanta luftuesit e huaj mund të paguhen, por pagesa nuk është motivi i tyre kryesor.

Kur drejtuesit e shteteve vendosin mbi mënyrat e mundshme të zgjidhjes së problemeve që shkaktohen nga organizata terroriste ISIS, ata duhet të mbajnë parasysh që zgjidhja duhet të mbështetet në rregullat ligjore ndërkombëtare të njohura dhe të pranuar tashmë në të gjithë botën.

Duke qenë se terroristët janë fuqizuar aq shumë sa që kanë marrë kontrollin mbi një territor kaq të gjerë në Siri dhe në Irak, duke i krijuar vetes së tyre dhe

83 Paper Chapter VII: Action with Respect to Threats to the Peace, Breaches of the Peace, and Acts of Aggression, article 51, <http://www.un.org> )

ekstremistëve të tjerë një bazë për akte terroriste, mund të pretendojmë se janë prekur interesat e përgjithshme të sigurisë botërore.

Në këtë fazë të përpjekjeve të ISIS për të shtrirë aktivitetin e saj më gjerë se rajoni ku vepron më fuqishëm, komuniteti ndërkombëtar ka mundësi dhe detyrim të merret me këtë çështje përpara se të jetë tepër vonë.

Një shtet që imponon një rregjim joligjor, që injoron të drejtat e njeriut dhe kryen shkelje të mëdha e sistematike të këtyre të drejtave në emër të një besimi të shtrembëruar në fakt, që vazhdon të kërcënojë me veprimet e tij rendin ligjor ndërkombëtar, nuk mund të konsiderohet si shtet i “të ligshëm”.

Megjithëse mund të pretendohet dhe besohet se është shumë herët të zbatohet parimi i fundit i doktrinës së “Përgjegjesisë për të Mbrojtur”, që është ai i ndërhyrjes ushtarake, gjithsesi nuk është shpejt të diskutohet parimi si një i tërë, veçanërisht aspekti i tij i parandalimit të përkeqësimit të situatës.

Ndërhyrja e zbatuar nga SHBA dhe aleatët e saj nuk mund të konsiderohet e paligjshme, sepse ajo është një përgjigje mbrojtëse ndaj agresionit të armatosur të organizatës terroriste.

Përdorimi i forcës në territorin e shtetit të Irakut ose të Sirisë, nuk përbën shkelje të së drejtës ndërkombëtare për faktin se Iraku dhe Siria si shtete sovraane kanë të drejtë të vetëmbrohen dhe kanë gjithashtu të drejtë të kërkojnë asistencë nga shtetet e tjera në formën e vetëmbrojtjes kolektive të lejuar nga Karta e Kombeve të Bashkuara.

Në realitetin e vështirë ku ndodhemi aktualisht për shkak të kërcënimit që paraqet ISIS për civilët, dhe për mbarë botën si dhe për shkak të domosdoshmërisë që paraqet nevoja e mbrojtjes së popullsisë nga genocidi dhe barbarizmat e tjera masive, interesat e koalicionit të udhëhequr nga SHBA duhen parë si të bashkërenduara me interesat e qeverisë siriane.

Bashkëpunimi i koalicionit të udhëhequr nga SHBA me qeverinë siriane e cila është në fakt përgjegjëse për krime barbare të panumurta të kryera kundër popullsisë së saj, për momentin është i justifikueshëm për faktin se rreziku më i madh i momentit është ISIS dhe për të luftuar këtë të keqe të madhe duhen bashkuar forcat dhe duhen bërë aleanca të përkohshme.

Në qoftë se do ta shohim kundërpërgjigjen ndaj ISIS në aspektin e zhvillimeve aktuale ose nevojave të ndryshimit në disa raste të normave ndërkombëtare, ajo duhet të jetë në proporcione të tilla që të arrijë çrrënjosjen e fenomenit dhe jo vetëm dobësimin e kapaciteteve të organizatës.

Një nga shkaqet kryesore të indoktrinimit dhe përfshirjes së shqiptarëve në aktivitete të tilla siç është rasti i luftuesve të huaj në Siri dhe Irak, është ndikimi që organizatat ndërkombëtare të “mbështetura në fe”, ushtrojnë në “bashkësitë” fetare. Aktivitetet fetare të shumë organizatave të ndryshme “bamirëse”, të organizatave që ofrojnë pagesa të ndryshme krijojnë konflikte

të brendshme dhe dëmtojnë vlerat e vërteta të fesë e të besimit, sepse njerëzit në këtë mënyrë udhëhiqen nga premtime për të holla, punë, arsim dhe identitet të ri.

Një zgjidhje efektive për të frenuar pasojat negative të veprimtarisë së këtyre organizatave, do të ishte vendosja e një rregjimi kontrolli ndaj tyre, si dhe organizimi i një kontrolli të rreptë kufitar që do të parandalonte filtrimin e individëve të padëshiruar në vend, duke qenë se ata mund të bëjnë propagandë ndaj asaj pjese të popullsisë e cila për shkak të mungesës së arsimit dhe kulturës mund të preket më shpejt nga këto ndikime.

Forcimi i organizatave vendore fetare, dhe nxitja e ribotimit të shumë teksteve fetare, mund të ndihmojë në zbutjen e pasojave të predikuesve të dëmshëm dhe do të nxiste promovimin e vlerave të vërteta të bashkësive fetare që mbështeten në trashëgiminë reale islame duke lënë mënjanë shtrembërimet e qëllimshme që po mundohen t'i bëjnë kësaj trashëgimie.

## Bibliografia

- Acosta Jim, Obama ISIS fight request sent to Congress, February 2015, [www.cnn.com/2015/02/11/politics/isis](http://www.cnn.com/2015/02/11/politics/isis)
- Bellamy, A. (2014). *Legality, Legitimacy, and Human Protection: International Intervention Against ISIS in Syria*, [theglobalobservatory.org](http://theglobalobservatory.org)
- Blumi Isa, *Are the Taliban coming to the Balkans?*, Prishtina, June 2005
- Charter of the United Nations | International Court of Justice, [www.icjci.org/documents/index.php](http://www.icjci.org/documents/index.php)
- Coleman, A. (2014). *The Islamic State and international law: an ideological rollercoaster?*, Rochester, NY : Social Science Research Network.
- D. Malet 'Why Foreign Fighters? Historical Perspectives and Solutions', *Orbis Journal of Foreign Affairs*, Vol. 54, No. 1 (Winter 2010)
- F. J. Cilluffo, J. B. Cozzens, and M. Ranstorp, *Foreign Fighters: Trends, Trajectories & Conflict Zones*, Homeland Security Policy Institute, George Washington University, 2010.
- Ferguson, T. (2014). *State Sovereignty and the Responsibility to Protect*, Chandler-Gilbert Community College, MUNFW 65<sup>th</sup> Session Sixth Committee
- *Foreign Fighters under International Law*, Geneva Academy of International Humanitarian Law and Human Rights, October 2014
- Gareth Evans, "The Responsibility to Protect: Ending Mass Atrocity Crimes Once and For All," 8 August 2009, Kindle Location 526, Brookings Institution Press.

- Graeme Wood, What ISIS Really Wants, February 2015, [www.theatlantic.com](http://www.theatlantic.com)  
<http://unstats.un.org/unsd/mdg/Resources/Attach/Indicators/ares>
- Hulse, C. (2014). The "Responsibility to Protect" Is Buried in Iraq, <http://fpif.org>
- Kuvendi. *Ligj. Nr. 98/2014*, Jul 31, 2014 - [www.parlament.al](http://www.parlament.al)
- News › World › Middle East, [www.independent.co.uk](http://www.independent.co.uk)
- Nguyen, Th. (2014). Measures to Eliminate International Terrorism, Mesa Community College, MUNFW 65<sup>th</sup> Session, Sixth Committee
- Resolution 60/1", United Nations General Assembly, October 24, 2005,
- Secretary-General's Report A/63/677", United Nations General Assembly, January 12, 2009,
- Security Council Resolution 1973", United Nations Security Council, March 17, 2011,
- Security Council Resolution 2042", United Nations Security Council, April 14, 2012, <http://www.securitycouncilreport.org>
- Security Council, Resolution 2170 (2014), 15 August 2014, [www.un.org/press/en/2014/sc11520.doc.htm](http://www.un.org/press/en/2014/sc11520.doc.htm)
- Sekulow Jay, (Chief Counsel of the American Center for Law and Justice), It's a War Against Jihad Not Poverty, February 2015, [www.foxnews.com](http://www.foxnews.com)
- T. Hegghammer, 'The Rise of Muslim Foreign Fighters' 2011

# STUDIM PËR VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË PARIMEVEBAZË TË TRASHËGIMISE ZGJEDHORE EUROPIANE NË LEGJISLACIONI ZGJEDHOR SHQIPTAR

Andon Kume

“Alexander Moisiu” University, Durrës, Albania  
Andon.kume@gmail.com

## ABSTRACT

*The five basic principles of the European Electoral Heritage are generally reflected and implemented in the Albanian electoral legislation.*

*In order to raise up the level of implementation of these principles and the compliance of the Albanian electoral legislation with the standards laid down in international documents and recommendations of different international bodies operating in human rights and elections, legislative middle-term developments can take in consideration issues targeting (i) the implementation of the principle of equality of voting power, (ii) the freedom of choice for electoral alliances and the reduction of their impact in converting votes into seats in bodies for which elections are conducted, (iii) enhancing practical opportunities for the exercise of the right to vote for immigrants and for voters with physical disabilities, (iv) voting in mobile ballot boxes, (v) transparency and increased control on sources of fund raising of electoral subjects, (vi) improving the system of addressing and reviewing the complaints by including also the District Courts and the Constitutional Court.*

**Key words:** *Principles, electoral heritage, Europe, legislation, electoral code, Albania*

## HYRJE

Në Kodin e Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias [1] përcaktohet se për hartimin e një legjislacioni zgjedhor që do të

shërbejë për të krijuar bazën juridike për zgjedhje të lira, të ndershme dhe demokratike, është e nevojshme që në të, të pasqyrohen pesë parimet bazë të Trashëgimisë Elektorale Europiane-*votimi universal, i barabartë, i lirë, i fshehtë dhe i drejtëpërdrejtë*. Në Shqipëri, pas ndryshimeve në sistemin politik të filluara në vitet 90-të, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për hartimin e një legjislacioni zgjedhor në të cilin këto parime të pasqyrohen në mënyrën më të mirë të mundëshme. Si vend anëtar i KE-së në përpjekjet për të zhvilluar këtë legjislacion, Shqipëria ka patur asistencën teknike të përhershme edhe të institucioneve të specializuara ndërkombëtare si Komisioni i Venecies dhe OSBE/ODIHR [3,4].

Studimi i paraqitur ka për qëllim të analizojë dhe të vlerësojë nivelin e pasqyrimin të parimeve të trashëgimisë zgjedhore europiane në legjislacionin zgjedhor aktual të Shqipërisë.

### **Pesë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane dhe legjislacioni zgjedhor shqiptar.**

Në trashëgiminë zgjedhore europiane *votimi universal, i barabartë, i lirë, i fshehtë dhe i drejtëpërdrejtë* përcaktohen si parimet bazë. Niveli i pasqyrimin të tyre në legjislacion, masa e respektimit dhe zbatimit të tyre në praktikën zgjedhore, janë indikatorët kryesorë që përdoren për të gjykuar për nivelin e plotësimit të standarteve demokratike në proceset zgjedhore. Pasqyrimi i këtyre parimeve dhe krijimi i kushteve për zbatimin sa më të plotë dhe efektiv të tyre, kërkon që ato të trajtohen në të gjithë piramidën legjislative të vendit, nga Kushtetuta dhe deri në aktet normative, udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

### **Medota e studimit**

Për të gjykuar dhe vlerësuar nivelin e pasqyrimin të parimeve bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane në legjislacionin zgjedhor do të përdoret analiza krahasuese. Analiza do të bëhet duke patur parasysh:

- (i) përmbajtjen dhe kërkesën/at që shprehen në parimin përkatës të trashëgimisë zgjedhore europiane
- (ii) rekomandimet e dhëna nga institucionet ndërkombëtare të specializuara, si Komisioni i Venecies e OSBE/ODIHR, në lidhje me instrumentat legjislativ që mund të përdoren për pasqyrimin e parimit në legjislacionin kombëtar
- (iii) zgjidhjet legjislative të realizuara në legjislacionin aktual shqiptar
- (iv) analizën krahasuese për gjykimin mbi nivelin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me kërkesat parimeve bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane.

## REZULTATET

Rezultatet kryesore të analizës së legjislacionit shqiptar me qëllim vlerësimin e nivelit të pasqyrimin të parimeve bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane në të, në mënyrë të përmbledhur trajtohen në vazhdim.

### I. E drejta universale për pjesëmarrje në zgjedhje (Univesal suffrage)

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Neni 45 përcaktohet se “Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet”. E drejta për të zgjedhur dhe për t`u zgjedhur nuk kushtëzohet prej përkatësisë etnike. Shtetasi shqiptar nuk kufizohet në të drejtën për të zgjedhur dhe për t`u zgjedhur prej vendbanimit të tij, në Shqipëri ose jashtë saj. Kushti i vetëm që sjell parashkrimin e të drejtës për të votuar përcaktohet në Kodin zgjedhor (neni 44)<sup>841</sup>. Të drejtën për t`u zgjedhur, në parim, e kanë të gjithë shtetasit shqiptar që gëzojnë të drejtën për të votuar. Ndërkohë për t`u regjistruar si kandidat për t`u zgjedhur, Kodi zgjedhor parashikon plotësimin e disa kushteve. Ndër to mund të përmenden, detyrimi për paraqitjen e dokumentacionit për mbështetjen paraprake të kandidatit, kushtet që lidhen me vendbanimin e shtetasit kandidat si dhe kushtet që kufizojnë të drejtën për tu zgjedhur, si pasojë e papajtueshmërisë së saj me detyra ose profesione që ushtron kandidati, të cilat janë të shprehura në Kushtetutën e Shqipërisë<sup>852</sup>

Në Kodin zgjedhor [2] përcaktohet se për të ushtruar të drejtën për të zgjedhur, është e domosdoshme që shtetasi të jetë i regjistruar në Listën e zgjedhësve. Edhe në rastin kur e drejta për të votuar një shtetasi i jepet me një

84 <sup>1</sup>Kodi zgjedhori R. Shqipërisë. Ligji nr.74/2012, datë 19.07.2012. Neni 44. Kriteret për përfshirjen e zgjedhësit në listat e zgjedhësve

c) të mos jetë shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar;

85 <sup>2</sup>Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 109

3. Të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendorë dhe si kryetar bashkie ose komune e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse  
Neni 69

1. Nuk mund të kandidojnë e as të zgjidhen deputetë, pa hequr dorë nga detyra:

- a) gjyqtarët, prokurorët;
- b) ushtarakët e shërbimit aktiv;
- c) punonjësit e policisë dhe të sigurimit kombëtar;
- ç) përfaqësuesit diplomatikë;
- d) kryetarët e bashkive dhe të komunave, si dhe prefektët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre;
- dh) kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve;
- e) Presidenti i Republikës dhe funksionarët e lartë të administratës shtetërore të parashikuar nga ligji.

2. Mandati i fituar në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni është i pavlefshëm.

vendim gjyqësor, përpara se ai ta ushtroje këtë të drejtë, insitucioni përkatës që administron listën e zgjedhësve duhet ta pasqyrojë këtë fakt në listën e zgjedhësve të njësisë zgjedhore përkatëse. Çështjeve legislative që lidhen me hartimin dhe përditësimin e Listës së zgjedhësve dhe me vendbanimin e shtetasit kanë qënë dhe vazhdojnë të mbeten ndër më të debatuarat. Për to është dashur të shpenzohen energji të konsiderueshme dhe të aktivizohen investime domethënëse, të tilla si investimet për implementimin e projektit për hartimin e Regjistrimit elektronik të shtetasve të Shqipërisë.

## II. Zgjedhje të barabarta

Për plotësimin e këtij parimi dhe nëpërputhje me kërkesat e sistemit zgjedhor propocional rajonal që zbatohet në Shqipëri për zgjedhjet parlamentare, nënenin 105 (pika 3) të Kodit zgjedhor përcaktohet se çdo zgjedhës voton me një fletë votimi. Në rastin e zgjedhjeve për organet e pushtetit lokal, zgjedhësi voton me dy fletë votimi dhe në rastin e bashkisë së Tiranës, zgjedhësi voton me katër fletë votimi. Për të mundur fuqi të barabartë për votën në legjislacion është parashikuar që mandatet midis zonave të ndryshme zgjedhore të shpërndahen në mënyrë të balancuar, duke marr parasysh një prej kriterëve: numrin e popullatës (përfshirë edhe minorenët), numrin e zgjedhësve të regjistruar, numrin e votuesve faktik ose kombinime të këtyre numrave. Në Kushtetutën e Shqipërisë (Neni 64) përcaktohet se Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem propocional, me zona zgjedhore shumemërore. Zona zgjedhore shumemërore përputhet me ndarjet administrative të një prej niveleve të organizimit administrativo-territorial të vendit. Për shpërndarjen e mandateve midis zonave zgjedhore, në Kodin zgjedhor përcaktohen kriteret dhe procedurat llogaritëse që duhen të ndiqen. Analiza e kësaj dispozite tregon se, kriteri i përdorur për ndarjen e numrit të mandateve, në kushtet e Shqipërisë, sjell shmangie nga parimi i barazisë së votës. Në zonat zgjedhore në rajonet veri lindore të Shqipërisë, ku numëri i zgjedhësve është relativisht i vogël dhe raporti- *numër i përgjithshëm i shtetasve me vendbanim në zonën përkatëse zgjedhore / numër zgjedhësish* është relativisht i madh, fuqia e votës në keto zona ndryshon dukshëm nga ajo e votave në zonat e tjera të vendit.

Përlllogaritja e mandateve që fitojnë subjektet zgjedhore (Neni 162), e cila, në përputhje me dispozitën përkatëse, bëhet duke përdorur formulën *D'hond* dhe ndarja e mandateve brenda koalicioneve, (neni 163), formula *SantEgue*, ndikojnë negativisht në fuqinë e votës. Kjo mënyrë përlllogaritje, penalizon partitë që nuk janë pjesë e koalicioneve por garojnë si subjekt më vehte. Kodi zgjedhor duhet t'ju sigurojë shance të barabarta si partive politike edhe kandidatëve. Kjo kërkon që autoritetet shtetërore të mbajne qëndrim

asnjëanës, veçanërisht lidhur me (i) fushatën zgjedhore, (ii) mbulimin nga media, veçanërisht nga media publike dhe (iii) financimet publike të partive dhe fushatave. Për plotësimin e këtyre kërkesave në Kodin zgjedhor janë vendosur një numër i konsiderueshëm dispozitash (Neni 76, 80, 81, 84, 86, 87, 88, 89, 91, 92). Ndërkohë, është për tu theksuar, se në praktikën zgjedhore të zhvilluar në Shqipëri, diferencat midis këtyre kërkesave ligjore dhe nivelit të respektimit të tyre prej autoriteteve shtetërore, partive politike dhe aktorëve të tjerë, që marrin pjesë në një proces zgjedhor, janë të mëdha. Keto praktika kanë treguar se vullneti politik për zbatimin e dispozitave të mësipërme është në nivel të ulët ose shpesh herëmburgon.

Në legjislacionin shqiptar lejohet krijimi i partive politike që përfaqësojnë pakicat kombëtare. Keto parti trajohen në të njëjtën mënyrë si edhe të gjithë partitë e tjera politike. Ky legjislacion nuk detyron deklarinimin për përkatësinë në një pakicë kombëtare. Në kuadrin nënligjor, udhëzime të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, parashikohen detyrime për organizimin dhe zhvillimin e fushatave informuese, edukuese dhe sensibilizuese për komunitetet e pakicave kombëtare për pjesëmarrjen në proceset zgjedhore.

Në Kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë përfaqësimi gjinor është objekt i dispozitës që parashikon përfaqësimin gjinor në listën e kandidatëve, e vendosur për herë të parë me ligjin No. 10019, datë 29.12.2008 dhe e ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012. Megjithë këtë duhet thënë se, pavarësisht se mundësitë ligjore për përfaqësimin gjinor ekzistojnë, në praktikë partitë politike, duke shfrytëzuar hapsirën që shoqëron dispozitat përkatëse, e kanë anashkaluar këtë kërkesë, duke e zbatuar vetëm formalisht, pa efekt në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

### III. Zgjedhje të lira

Ligjvënsi shqiptar është kujdesur që në Kodin Zgjedhor, të përmbahen dispozita të cilat të bëjnë të mundur respektimin e këtij parimi. Në plotësim të tij veprojnë edhe dispozita të ndryshme, të shprehura në legjislacionin shqiptar, si në Kodin Civil, Kodin Penal, Paketën e ligjeve për Gjendjen Civile dhe Regjistrin Themelor të Shtetasve, Udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve etj.

Kodi zgjedhor parashikon të drejtën e çdo subjekti zgjedhor për të bërë propogandë zgjedhore (Neni 78, pika 1). Për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në median publike por edhe në atë private, dispozitat e Kodit zgjedhor janë në përputhje me standartet e kërkuara në Kodin e Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore.

Dispozita sipas të cilave duhet të hartohet lista e zgjedhësve, Pjesa III, Kreu I, neni 44 - neni 57, parashikojnë detyrimin e organeve që hartojnë keto

lista, për të informuar zgjedhësit<sup>863</sup> si dhe subjektet zgjedhore<sup>874</sup>.

Kodi zgjedhor ka parashikuar penalitetet në rastet e mos respektimit të dispozitave që kushtëzojnë barazinë e subjekteve zgjedhore për fushatë elektorale, paanshmërinë në pasqyrimin mediatik të kësaj fushate, financimin e partive politike etj. (Neni 84, pika 9, Neni 171, pika 3, Neni 172, Neni 173, Neni 174).

Në parimet e trashëgimise zgjedhore europiane përcaktohet që, në cdo rast, zgjedhësi duhet të jetë i lirë për të shprehur vullnetin e tij. Për të plotësuar këtë kërkesë në Kodin zgjedhor dhe udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve parashikohen procedura ligjore të cilat mundësojnë një proces votimit të thjeshtë, fleta e votimit konceptohet në një format të kuptueshëm për zgjedhësit (mënyra se si votohet me të, në çdo proces zgjedhor ka qënë pjesë e fushatës informuese të zhvilluar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve). Për votuesit në spitale, në burg, në reparte ushtarake, Kodi zgjedhor parashikon ngritjen e qëndrave të posacme të votimit (Neni 59, Neni 60. Në Nenin 108, janë të përcaktuara rregulla strikte që synojnë të bëjnë realisht të mundur ushtrimin e të drejtës së votës për votuesit me aftësi të kufizuara fizike. Legjislacioni shqiptar nuk parashikon votimin me kuti të lëvizëshme, votimin me postë dhe votimin elektronik.

Plotësimi i kushteve për të luftuar mashtrimin zgjedhor është një ndër çështjet që i është kushtuar vëmendje e vazhdueshme në të gjitha proceset legjislative që kanë paraprirë zgjedhjet në Shqipëri. Ndër faktorët që e kanë nxitur dhe e kanë mbajtur gjallë shqetësimin që lidhet me këtë çështje është mungesa e madhe e besimit reciprok midis partive politike. Kjo ka bërë që, në përgjithësi, në trajtimin kësaj çështje gjatë hartimit të legjislacionit zgjedhor, shqetësimi më i madh të ketë qënë hartimi i “rregullave të lojës” që do të bënin të mundur kontrollin reciprok midis palëve se ndertimin e rregullave të nevojshme për proces zgjedhor në perputhje me standartet. Në

<sup>863</sup> Kodi Zgjedhor. Neni 52 Njoftimi me shkrim i zgjedhësve

1. Brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhësve, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 51., kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore.

2. Lajmërimi me shkrim përmban qendrën e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve të qendrës së tij të votimit

<sup>874</sup> Kodi Zgjedhor Neni 60 Vënia e listave të zgjedhësve dhe ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në dispozicion të subjekteve zgjedhore dhe publikut

1. Listat e zgjedhësve dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhorë vihen në dispozicion të subjekteve zgjedhore ose, sipas rastit, partive politike, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

plotesim të këtij synimi, në jo pak raste partitë politike, neëveçanti dy partitë e mëdha PD e PS, nuk kane nguruar që të realizojne zgjidhje ligjore që kanë qënë vetëm pasojë e kompromisit politik, për arritjen e të cilit nuk eshte nguruar as anashkalimi dhe/ose as mos respektimi i kërkesave kushtetuese.

Për të rritur transparencën në procesin e vleresimit dhe numërimit të votave, si ndër kushtet për zbatimin e parimit *zgjedhje të lira*, në Kodin zgjedhor parashikohet edhe përdorimi i teknikës elektronike mbështetëse. Kodi zgjedhor parashikon penalitete për të gjithë ata që ndërhyjnë në procesin e administrimit të votës dhe ndëshkon antarët e administratës zgjedhore, në rast tëshkeljes së procedurave ligjore të parashikuar në të. Pavarësisht, nga këto zgjidhje ligjore, të cilat janë në përputhje me Kodine Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, në ndonjë rast ato janë të sforcuara ose edhe të mbingarkuara.

#### **IV. Votim i fshehtë**

Në legjislacionin shqiptar është përcaktuar: “Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë... Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës” (Ligji nr. 74/2012, datë 19.07.2012, Kodi Zgjedhor, neni 3, pika 2). Për të garantuar këtë në Kod janë parashikuar procedura të detajuara, sipas të cilave duhet të votojë zgjedhësi (Neni 105, Neni 106). Këto procedura janë garanci ligjore për plotësimin e kërkesave të shprehura në dispozitën e mësipërme ligjore (Neni 3, pika 2).

Votimi familjar dhe kontrolli i votës janë të ndaluara. (Neni 105, Neni 106). Megjithë këtë, duhet të theksohet se midis këtij legjislacioni dhe zbatimit të tij ka diferenca të ndjeshme, të rrjedhura prej një tërësie komplekse faktorësh me natyrë sociale, historike, të kulturës, traditës, psikologjise shoqërore, ekonomike dhe të zhvillimit demokratik të shoqërisë.

#### **V. Votim i drejtpërdrejtë**

Legjislacioni shqiptar parashikon vetëm votim të drejtpërdrejt si për Parlamentin e Shqipërisë, ashtu edhe për organet e pushtetit lokal.

#### **VI. Periodiciteti i zgjedhjeve**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton që zgjedhjet e përgjithëshme parlamentare, si rregull të zhvillohen një herë në katër vjetë. Pas ndryshimeve të bëra në Kushtetutë, me ligjin Nr. 9675, datë 13.1.2007 edhe zgjedhjet për organete pushtetit lokal zhvillohen, si rregull, një herë në katër vjetë.

#### **Për përmirësime të mundëshme në legjislacionin zgjedhor.**

Zhvillimi i legjislacionit zgjedhor në përputhje me parimete trashëgimisë

zgjedhore europiane kërkon si parakusht ekzistencën e një terreni legjislativ qëbënë të mundur respektimin e të drejtave themelore të njeriu si, liria e shprehjes dhe e shtypit, liria e qarkullimit brënda vendit, liria e grumbullimit dhe liria e bashkimit ose organizimit për qëllime politik, duke përfshirë krijimin e partive politike. Kushtetuta e Shqipërisë i garanton të gjitha këto liri. Për rrjedhojë edhe mundësitë për përmirësime nëlegjislacionin zgjedhor janë reale. Mbështetur në përvojën legjislative të derisotme, duke synuar përafrimin sa më të mirë dhe efektiv të këtij legjislacioni me parimet e trashëgimisë zgjedhore europiane dhe me dokumentat e tjerë ndërkombëtar, ndër përmirësimet e mundëshme që mund të konsiderohen për t'u trajtuar, mund të renditen:

- (i) Zgjedhjet te organizohen nga nje organ i paanshëm  
Në legjislacionin aktual zgjedhor e gjithë piramida e administratës zgjedhore, prej KQZ e deri në KQV e GNV, ndërtohet mbi bazën e parimit të përfaqësimit dhe balancimit politik. Në kontekstin legjislativ, në parim, një zgjidhje e tillë nuk i kundërvihet dhe as nuk e ndalon zhvillimin e aktivitetit, përgjegjësi dhe detyrave të kesaj administrate në funksion të respektimit dhe plotesimit të kërkesave te ligjit. Por, në praktikë nuk janë të rralla vendimarrjet mbi bazën e përkatësive politike të antarëve tëkësaj administrate. Problemet qëgjeneron një sjellje e tillë janë të njohura. Për rrjedhojëështë nevojë e kohës që të trajtohet opsioni sipas të cilit e gjithë administrata zgjedhore të rekrutohet, formohet dhe të zhvilloje aktivitetin e saj në bazë të të njëjtave parime, rregulla dhe proceduara që zbatohen në rastin e administratës publike. Natyrisht, në një rast të tillë, për cdo subjekt elektoral duhet të parashkohet e drejta për të patur vezhgues në secilin prej niveleve tëkësaj administrate.
- (ii) Administrata zgjedhore duhet të jetë e qëndrueshme  
Është e domosdoshme që të rishikohen dispozitat në Kodin Zgjedhor që i japin të drejtën subjekteve qëpropozojnë antarët në komisionet zgjedhore për të patur“ dorë të lirë” për t'i shkarkuar ata sipas dëshirës.
- (iii) vendimarrja në komisionet zgjedhore duhet të bëhet me shumicë të cilësuar ose konsensus.
- (iv) parimi dhe menytrat e llogaritjes për të caktuar numrin e mandateve në cdo njësi zgjedhore duhet të rishikohen me objektiv zbatimin sa më të plotë tëparimit të barazisë në fuqinë e votës. Në plotësim të këtij parimi, është e nevojshme të rishikohen edhe dispozitat që përcaktojnë krijimin e koalicioneve parazgjedhore dhe zvogëlimin e efektit të tyre në fuqinë konvertuese të votës në vënde në organin për të cilin kryhen zgjedhjet

- (v) Legjislacioni duhet të garantojë një sistem të efektshëm apelimi Kodi zgjedhor parashikon që apelimet mund të bëhen në komisionet zgjedhore të nivelit të dytë (KZAZ/KZQV) si dhe në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve. Vendimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve mund të ankimohen në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë. Ky Kolegj është organi më i lartë gjykues e vendimmarrës për çështjet zgjedhore në Shqipëri. Vendimet e të cilit janë përfundimtare dhe të detyrueshëm për zbatim. Për të paqyruar në legjislacion zgjedhor, në menyre sa më te plotë dhe shtruese kërkesat e Kodit të Praktikës së Mirënj Çështjet Zgjedhore, si thekson edhe Misioni i Vëzhguesve Ndërkombëtar (Raport Përfundimtar, Zgjedhjet, 2013), në Kodin zgjedhor duhet të përpunohen më tej dispozitat, me synim që:
- Të garantoohen më mirë të drejtat e të gjitha palëve të interesuara për të paraqitur ankesa administrative kundër vendimeve dhe veprimeve të komisioneve zgjedhore, veprimeve të parregullta gjatë fushatës, parregullsive në ditën e zgjedhjeve si dhe rezultateve.
  - Të shkurtrohet afati për gjykimin e çështjeve parazgjedhore nga Kolegji, mundësimi të së drejtës për ankim gjyqësor, si dhe publikimit të të gjitha vendimeve të Kolegjit Zgjedhor.
  - Të trajtohet mundësia që Gjykata Kushtetuese të mos refuzojë në mënyrë të papërshtatshme juridiksionin për rishikimin e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor dhe të vendimeve të parlamentit për shkeljen e garancive kushtetuese të procesit të rregullt ligjor;
  - Në kod të parashikohen afate të përshpejtuara për paraqitjen dhe gjykimin e kërkesave që kanë lidhje me zgjedhjet në Gjykatën Kushtetuese.
  - Të konsiderohet mundësia për përfshirjen në gjykimin e ankimeve ndaj vendimeve të komisioneve të nivelit të dytë, të gjykatës së faktit.

## PËRFUNDIME

Në legjislacioni zgjedhor shqiptar, në përgjithësi janë të pasqyruar dhe të materializuar pesë parime bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane.

Për të rritur më shumë nivelin e zbatimit të këtyre parimeve dhe përpuethshmërinë e legjislacionit zgjedhor shqiptar me standartet e percaktuara në dokumentat ndërkombëtare dhe rekomandimet e organizmave të ndryshëm ndërkombëtare që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe zgjedhjeve, në periudhën afate mesme mund të konsiderohen zhvillime në legjislacion, të cilat të targetojnë çështje që janë të lidhura me:

- (i) zbatimin e parimi të barazisë në fuqinë e votës,
- (ii) lirinë e zgjedhjes për aleanca parazgjedhore dhe zvogëlimin e efektit të tyre në fuqinë konvertuese të votës në vënde në organin për të cilën kryhen zgjedhjet,
- (iii) rritjen e mundësive praktike për ushtrimin e të drejtës për të votuar për emigrantët dhe për votuesit me aftësi të kufizuara fizike,
- (iv) votimin në kuti të lëvizëshme,
- (v) transparencën dhe rritjen e kontrollin për burimin e finacimeve të subjekteve zgjedhore,
- (vi) përmirësimin e sistemit të ankimimit dhe shqyrtimit të tyre duke trajtur mundësinë e përfshirjes në të edhe të Gjykatave të Faktit dhe Gjykatës Kushtetuese.

## BIBLIOGRAFIA

- Kodit i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore. Opinioni nr. 190/2002. CDL-AD (2002) 23rev. Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias). Këshilli i Europës. Venecia, 18-19 Tetor 2002
- Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. L i g j Nr. 10 019, datë 29.12.2008. Azhornuar me ligjin nr. Nr. 74/2012
- Joint opinion on amendments to the Electoral Code of the Republic of Albania. Opinion 435 / 2007. CDL-EL(2007)018. the Venice Commission and the OSCE/ODIHR. Strasbourg/Warsaw, 5 July 2007
- Joint opinion on the Electoral Code of the Republic of Albania. Opinion No. 513 / 2009. CDL-AD(2009)002. Adopted by the Venice Commission at its 78th plenary session (Venice, 13-14 March 2009. Strasbourg/Warsaw, 13 March 2009

# KRIMI I VAZHDUAR NE TE DREJTEN PENALE ITALIANE

**Arben Prifti**

Mediterranean University of Albania  
arbenprifti@umsh.edu.al

## ABSTRACT

*The main goal of this paper is the collection, processing, and display on a single and consistent research, the opinions and the most important treatment related to the institution of criminal law which is Continuous Crime. This paper introduces the subject not only as a selection of simple ideas received from the most famous lawyers of Italian criminal law, but to offer critical comments, in an attempt to seek and explain what may look like problematic aspects, highlighting various points of dispute, which represents the object of the institute concerned.*

**Keywords:** *Continuous crime, criminal law, Italian criminal law*

*Motivi qe me frymezoi dhe me nxitu te trajtoj kete teme qendron ne faktin se, duke qene se Kodi Penal i Republikes se Shqiperise ne kronologjine, historine dhe evolucionin e tij ne periudha dhe etapa te ndryshme ka patur per baze dhe reference Kodin Penal italian, mendova qe sjellja e mendimit juridik te juristeve me me fame italiane per institutin e "kriminal vazhduar", nepermjet menyres dhe stilit te punes time individuale, te behet pjese e doktrines dhe literatures juridike ne te drejten penale shqiptare. Mungesa dhe trajtimet e pakta teorike e doktrinale te institutit te kriminal vazhduar nga juriste shqiptare ne te drejten penale shqiptare, perben dhe sjell nga ana tjeter nje risi te ketij punimi si vlere e shtuar ne plotesim te boshllekut teorik, doktrinal, e jurisprudence ne literaturen tone juridike.*

Mendoj se ky punim modest do t'ju sherbeje sadopak lexuesve dhe juristeve ne fushen e se drejtes penale, por ne veçanti studenteve te fakulteteve te drejtesise qe do ta kene kete literature ne biblioteken e tyre te pasur.

Nga ana tjeter, une jam i hapur te mirkuptoj çdo vrejte, sugjerim dhe mendim te vlefshem cilesor nga te gjithë ata kolege dhe profesore te te drejtes penale, miq dhe dashamires qe do te kene ne dore kete punim.

Punimi shkencor me **temë** “*Krimi vazhdues në të drejtën penale italiane*”, është hartuar në tre pjesë.

Në pjesën e parë, që titullohet “Koncepti, orgjina dhe roli i krimit vazhdues” trajtohen këto nëntema: 1. Studime historike mbi krimin e vazhduar; 2. Krimi vazhdues në Kodin Penal italian te vitit 1930; 3. Ndryshimi i institutit të krimit vazhdues, pas reformës të vitit 1974;

Në pjesën e dytë, që titullohet “Krimi vazhdues, elementët përbrës, problemet pas reformës të vitit 1974, Kodi i Ri i Procedurës Penale i vitit 1988 dhe zbatimi i institutit te krimit vazhdues nën efektin e vendimit”, trajtohen këto nëntema:

-Veprimet dhe mosveprimevet e shumta; -Shkeljet e shumta te dispozitave te njejta ose te ndryshme te ligjit; -Krimi i vazhduar apo vazhdim i krimeve? -Qellimi i njeje kriminal; -Lidhja e njeje ne aspektin objektiv, subjektiv dhe teoria eklektike (e shumeanshme); -Ceshtja e gjykuar dhe krimi i vazhduar; -Diskutime mbi formen e institutit ne percaktimin e shkeljes me te rende pas vendimit te denimit; -Orientimi i Gjykates se Larte te 1986 dhe nderhyrja e Gjykates Kushtetuese 1987; -Neni 671 k.p.p ne kodin e ri te procedures penale te 1988 (Zbatimi i vazhdimit te krimeve nen efektin e vendimit); -Koordinimi lidhur me percaktimet e gjyqtarit ne njohjen e ceshtjes, kompetent;

Në pjesën e tretë me temë “Amnistia dhe parashkrimi në krimin vazhdues”, trajtohen temat: -Zbatimi i amnistise ne krimin e vazhduar; -Krimi i vazhduar dhe parashkrimi.

Punimi shkencor mbyllet me vëzhgimet përmbyllëse dhe bibliografinë.

### 1.1. STUDIME HISTORIKE MBI KRIMIN E VAZHDUAR.

Trajtimi i kesaj nenteme sjell ne vemendje mendimet e dy juristeve te famshem italiane te asaj periudhe Bartolo dhe Farinacio. I pari theksonte se krimet qe kane qellim te njeje, duhet te denohen si nje krim i vetem. Ndersa, juristi tjeter kthen parimet baze mbi te cilat bazohet instituti i krimit vazhdues. Sipas tij, vjedhja e shume sendeve ne kohe te ndryshme duhet te konsiderohet

si nje vjedhje e vetme, duke vendosur kriterin e kontekstit kronologjik. Ne fakt, vjedhjet e shumta edhe pse kane ndodhur ne kohe dhe vende te ndryshme, mund te konsiderohen te grupuar ose te bashkuar si nje krim i vetem, kur ekziston *elementi i vazhdimet kohor*.

Nga keto permbledhje te shkurtra dallohet qarte se juristet qe ne kohet me te hershme, megjithe konceptet e kufizuara juridike, kerkonin te krijonin kategori logjike-konceptimi me vete, ne te cilat mund te sillen raste te veçanta krimesh me karakteristika te veçanta, te tilla sa mund te justifikojne trajtimin me te bute ne vendosjen e denimeve dhe te sanksioneve penale.

Neni 81 i Kodit Penal italian dhe dispozitat e tjera normative te se drejtes ne fuqi e gjejne arsytimin e tyre ne kerkesat e dala gjate zhvillimit historik te se drejtes penale ne kete vend dhe jo vetem ne te drejten pozitive te diteve te sotme, sepse ky institut dhe keto kerkesa e kane prejardhjen qe ne kohet me te hershme.

*Instituti i krimit te vazhduar* ne te drejten penale italiane ka lindur nga njohesit e mire te ligjit, te cilet kerkonin te zbusnin rreptesine e tepruar te disa prej ligjeve dhe normave juridike penale, persa i perket perseritjes se krimit te njejte (mjafton te kujtojme qe per nje vjedhje te perseritur tre here mund te jepej denimi me vdekje). Nuk eshte per t'u habitur nese hapat e para te institutit te krimit te vazhduar permenden ne studimet e hershme te komentuesve, ne permbledhjet e statuteve bashkiake, per te arritur me pas ne disiplinat me konsekuente te kodifikimeve te diteve te sotme.

Me ndryshimet historike eshte e qarte se zgjidhjet teknike, te ofruara nga ligjvenes te ndryshem, ishin te ndryshme. Kjo kuptohet duke gjykuar ambientin kulturor dhe ideologjik, ne te cilin ato jane zhvilluar dhe trajtuar.

Per shembull, komentuesit e trajtimeve te teksteve te te drejtes penale, kerkonin te zgjeronin kuptimin e veprimit te vetem dhe te krimit te vetem, sesa te njihnin si figure me vete te vepres penale krimin e

*Karakteristika e vecante* e krimit te vazhduar caktohet ne fakt nga rrethana qe krimet e ndryshme te kryera, nga subjekti veprues, *shfaqin qellim te njejte kriminal*. Sipas doktrines te besimit, kjo tregon nje vlere negative te pergjithshme me te vogel<sup>(88)</sup>, e cila justifikon zbatimin e denimit me te lehte.

Megjithate, *arsyetime* i institutit te krimit vazhduar duhet te rindertohet ne kuptimin i tij ligjor, lidhur me masen e vleres negative juridike, nga e cila varet madhesia e denimit qe do te jepet<sup>(89)</sup>. Ligjvnesi, nepermjet zgjedhjes te thjeshte te politikes kriminale, mendon se subjekti veprues, i cili kryen krime te shumta te bashkuara nga lidhja e vazhdimet, denohet me pak se ai qe shkel

88 () ZAGREBELSKY, Krimi i vazhduar, 1996, fq.1.

89 () RAMACCI, Zhvillimi i te drejtes penale, II ed., Torino, 2001, fq.499.

ligjin ne rastet e tjera. Ne kete rast, ai e mendon te arsyeshem zbatimin e trajtimit me te bute, ne krahasim me konkurimin material e te nevojshem te krimeve.

## 1.2 KRIMI I VAZHDUAR SIPAS KODIT TE VITIT 1930.

Ne kete veshtrim te pergjithshem te zhvilluar per krimin e vazhduar eshte me interes te shqyrtohet, ate qe ishte shkenca origjinale e parashikuar ne Kodin Rocco. Ne tekstin origjinal te Kodit 1930, ne nenin 81 te kodit penal thuhej:

(Paragrafi 1) “ ... Ai, qe me nje veprim ose mosveprim te vetem, shkel dispozitat e ndryshme te ligjit ose kryen me shume shkelje te dispozites se njejte te ligjit denohet ne perputhje me nenet e meparshme...” (nenet 71-80 te kodit penal 1930)

Nga kjo norme ligjore, dallohet qarte barazia lidhur me sanksionet qe zbatohen nga disiplina si ne rastin e konkurimit material te normes juridike, ashtu dhe ne konkurimin formal, me ndryshimin e vetem qe rasti i pare i takon shkeljeve te shumta te normave penale te kryera nga veprimet ose mosveprimet e shumta, ndersa rasti i dyte i takon shkeljeve te shumta te kryera nga nje veprim ose mosveprim i njejte dhe i vetem.

Norma juridike, mbi te gjitha persa i perket elemetit te dyte qe karakterizon institutin e krimit vazhduar, ka qene burim i interpretimeve te shumta dhe te perpunuara ne perberje te teorise dhe te jurisprudences, te cilat ne interpretimin e shprehjes, “ ...dispozita e njejte e ligjit...” mbronin qendrimet e meposhtme:

Teoria e besimit sakteson me shume, se *çdo krim ka nje objekt te vetin te percaktuar qarte dhe eshte pikerisht kjo qe e dallon nje krim nga nje tjetër*. Me fjale te tjera, natyra e ndryshme e objekteve te demtuara nepermjet krimeve te veçanta dallon normat e veçanta sipas sanksioneve penale <sup>(90)</sup>, edhe pse i njeiti objekt mund te jete demtuar pak a shume rende.

Nga keto gjykime, duket qarte se çdo akuze ka objektin e vet juridik sipas parimit, qe krimi i vazhduar eshte krijuar nga demtimet e shumta te pasurise ose interesave juridike te njejta, duke shkelur shume here normat e njejta juridike. Duke e marre si pike referimi, arrihet ne perfundimin e njohjes se vazhdimet te krimit edhe ne rastet, ku shkeljet kane rendesi te ndryshme, sepse i nenshtrohen neneve te ndryshme te ligjit.

Nga ky kendveshtrim, persa i perket *tentatives* nuk ka dyshim se ajo, duke perbere nje krim te plote me strukturen e saj, ndikon ne objektin juridik te krimit te kryer. Neni 56 kodit penal italian, duke qene nje norme e pergjithshme, nuk mund te zbatohet veçse se bashku me normen e posaçme akuzuese, e

---

90 () ROCCO, Objekti i krimit dhe i mbrojtjes juridike penale, Torino, 1913, fq.555.

cila vendos persa i takon nje fakti te caktuar <sup>(91)</sup>. Prandaj, nuk diskutohet se objekti i te mires juridike te mbrojtur, ne rastin e tentatives, eshte i njejte me krimin e vazhduar me dallimin e vetem qe: ne rastin e pare veprimi i personit nuk demton te miren ose interesat qe mbrohen nga norma, duke realizuar nje situatë te thjeshte rreziku, ne rastin e dyte realizohet demtimi i te mires juridike te parathene <sup>(92)</sup>.

Lidhur me rrethanat e krimit, nuk ka dyshim qe ato tregojne objektivitetin e plote te krimit. Elemente te tille ne fakt mund te mungojne, por nga mungesa e tyre te mos cenohet ekzistenca e vete krimit <sup>(93)</sup>. Me fjale te tjera, rrethanat kane nje rol te rendesishem ne rendimin ose lehtesimin e denimit te parashikuar per krimin, i cili eshte teresisht i dukshem edhe ne mungese te rrethanave te tilla, pikerisht te rastesishme. Duke mbetur jashte elementeve perbereres te krimit, eshte e qarte se elementet e rastesishem nuk jane te afte te ndryshojne objektivitetin juridik te krimit-baze <sup>(94)</sup>.

Nga nje veshtrim i shpejte i jurisprudences se kohes, permendet nje orientim i qendrueshem, sipas te cilit theksohet se, me shprehjen "...dispozita e njejte e ligjit..." nuk duhet te kuptohet "neni i njejte i ligjit", por duhet te kuptohet "norma e njejte akuzuese", qe perfshin normat e pergjithshme dhe te veçanta, te cilat rendojne ose lehtesojne krimin e parashikuar ne te <sup>(95)</sup>. Perkundrazi p.sh. jurisprudenca theksonte papranueshmerine e vazhdimit midis rasteve te ndryshme te falsifikimit te dokumentave, sepse...

Ne kete kuptim, **Gjykata Penale** ne vendimin e saj arsyeton:

"...Qellimi i njejte duhet te kuptohet ne drejtim te shkeljes se normes te njejte akuzuese, qe perfshin te gjitha normat, te cilat, ne lidhje me ate, kane karakter plotesues dhe dallojne vetem nga shtrirja dhe rendesia qe ato kane. Per kete arsye vazhdimi nuk shfaqet, kur akuzat jane thelbesisht te ndryshme edhe pse te te njejtes natyre. Rrjedh se, duke ekzistuar krimi i falsifikimit per te eliminuar nje figure te veçante te vete krimit dhe duke mos patur karakter plotesues ne krimin e falsifikimit material per ndryshim, midis dy krimeve nuk mund te mendohet vazhdimesia..."<sup>(96)</sup>.

91 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.445.

92 () LEONE, Krimi i zakonshem., cit., fq.236.

93 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.409.

94 () LEONE, Krimi i zakonshem, cit., fq. 238.

95 () Gj.L., III, 19 nentor 1953, Gjyk.Pen., 1955, fq.294.

96 () Gj.L.VI, 13 Janar 1967, Gjyk.Pen., 1967, fq.1137.

### 1.3 Ndryshimi i krimit te vazhduar pas reformes te vitit 1974

Me ndryshimin e nenit 81 te kodit penal, nga reforma e vitit 1974, ligjvenesit vendos disiplinen shkencore te konkurimit juridik formal te krimeve, d.m.th. *per shkeljet e shumta te normave juridike nga nje veprim ose mosveprim i vetem*. Nje disipline shkencore e tille ishte zbatuar me perpara, ne tekstin origjinal te kodit te vitit 1930, vetem per krimin e vazhduar.

Nga keto vezhgime dallohet qarte se ligjvenesit me ane te ketij ndryshimi ka zgjeruar disiplinen e konkurimit juridik.

Ndryshimi i disiplines shkencore te krimit te vazhduar ka hapur interpretime te reja, sepse ligjvenesit parashikon ne sistemin tone pozitiv rastin e shfaqjes se institutit te krimit te vazhduar, jo vetem per shkeljet e njejta homogjene, por edhe per ato vepra te ndryshme heterogjene. Me fjale te tjera, ligjvenesit i 1974 e zgjeron perdorimin e institutit, jo vetem ne rastin e shkeljes te "...dispozites se njejte te ligjit...", por edhe ne rastin e shkeljeve te "...dispozitave te ndryshme te ligjit...". Interpretimi i nenit 81, paragrafi 2 kodit penal:

**(Krimi i vazhduar)** "...Te njejtit denim i nenshtrohet personi qe me veprime ose mosveprime te shumta, per realizimin e qellimit te njejte kriminal, kryhen edhe ne kohe te ndryshme shkelje te shumta te dispozitave te njejta ose te ndryshme te ligjit..."

Pas ketij ndryshimi nuk eshte me e arsyeshme paraqitja e krimit te vazhduar si nje rast i jashtezakonshem, ne krahasim me konkurimin formal, si dhe veç kesaj nuk mund te mendohet, nen driten e ketij studimi, se konkurimi material, perben rregullin e pergjithshem te disiplines shkencore te konkurimit te krimeve <sup>(97)</sup>. Ne fakt nga disiplina shkencore ne fuqi del se *tipari dallues i krimit te vazhduar caktohet nga rrethana, qe krimet e ndryshme te kryera nga subjekti veprues shfaqin nje qellim te njejte kriminal, i cili pas shtimit te shkeljeve te ndryshme heterogjene, eshte elementi i vetem themelor, mbi te cilin bazohet i gjithe instituti i vazhdimit*.

Perpara ndryshimi te vitit 1974, instituti i krimit vazhdues shfaqej vetem per shkeljet e dispozites se njejte te ligjit (sipas llojit te shkeljes behej fjale si p.sh. per vjedhje te vazhdueshme, vrasje e vazhdueshme, grabitje me dhune e vazhdueshme). Sot lidhja e vazhdimit te vepres penale mund te bashkoje krime thellesisht te ndryshme midis tyre, p.sh. nje vjedhje, nje grabitje dhe nje vrasje <sup>(98)</sup>.

Elementi i qellimit te njejte kriminal, sipas nje orientimi te qarte dhe mbeshtetes te doktrines penale, shpjegon dhe legjitimon zgjedhjen e trajtimit

97 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.498.

98 () PAGLIARO, Parimet e te drejtes penale, VIII ed., Milano, 2003, fq.604.

me te bute te normes sanksionuese, ne krahasim me konkurimin material e te nevojshem te krimeve <sup>(99)</sup>.

Arsyeja qe ka shtyre ligjvenesin e vitit 1974 te zgjeroje disiplinën shkencore te krimit vazhdues duhet kerkuar, siç ka pranuar doktrina e besimit, ne nevojen per te kapercyer ndarjen artificiale te fakteve te veçanta ligjore te krimit.

Ne fakt, gjate pervojes juridike, jurisprudenca eshte ndodhur shpesh perpara ngjarjeve kriminale, mbartese te nje qellimi te perbashket, por jo te pranueshem per figuren e krimit te vazhduar, sepse perbenin skema te ndryshme te krimit <sup>(100)</sup>.

Siç mund te kuptohet nga krahasimi i tekstit te vjeter dhe te ri te kodit penal, reforma ka vene ne dukje nje forme te re dhe te ndryshme te institutit, duke zbutur ashpersine e konkurimit material e te nevojshem ne rastin e krimeve te ndryshme heterogjene <sup>(101)</sup> me zbatimin e institutit te krimit vazhdues edhe ne rastin e shkeljeve te shumta te dispozitave te ndryshme te ligjit, me kusht qe te ekzistojë elementi i “qellimit te njejte kriminal”. Pas reformes, kjo ka nje rendesi themelore per shfaqjen ne menyre figurative te “fijes se kuqe, e cila qep” se bashku krimet e veçanta ne vazhdim <sup>(102)</sup>.

### **Shkeljet e shumta te dispozitave te njejte ose te ndryshme te ligjit**

Kushti i dyte i krimit te vazhduar eshte shkelja e dispozitave te shumta te ligjit. Ligjvenesin pranon shfaqjen e institutit, kur ndodhin krime te ndryshme, pa marre parasysh se krimet e ndryshme kane “ karakteristika themelore te perbashketa”, si dhe per krime krejt te ndryshem midis tyre <sup>(103)</sup>.

Ligjvenesin e 1974 ndryshoi tekstin e meparshem, (i cili kerkonte “...shkelje te shumta te dispozites se njejte te ligjit...”) duke zgjeruar disiplinën e krimit te vazhduar edhe ne rastin e shkeljeve te dispozitave te ndryshme te ligjit. Nga ky ndryshim eshte e lehte te kuptohet, si element i vetem (i kerkuar), pse krime te shumta te kryera nga nje subjekt i vetem perbejne vazhdimesi krimesh, ***eshte elementi i qellimit te njejte kriminal***, i cili mbeshtet dhe shpjegon vleresimin e perbashket per krimin e vazhduar nga ligji penal <sup>(104)</sup>.

99 () ZAGREBELSKY, Krimi i vazhduar, cit., fq.1

100 () VASSALLI, Reforma penale, cit., fq.60.

101 () ANTOLISEI, Manual i se drejtes penale, VII ed., L.CONTI, Milano, 2003, fq.531.

102 () RAMACCI, Zhvillimi, cit., fq.502.

103 () FIANDACA-MUSCO, E drejta penale, cit., fq.604.

104 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.502.

Me qellim qe te perdoret ky institut, per disiplinen ne fuqi eshte e mjaftueshme prova, qe subjekti veprues te kete kryer shkëljen e dispozitave te shumta te ligjit, per nje qellim te vetem kriminal te perbashket ne te gjitha krimet e kryera.

## 2.1. Qellimi i njejte kriminal.

Sipas reformes se 1974, kerkesa per nje *qellim* te njejte kriminal perben elementin e vetem dhe te vertete, qe dallon krimin e vazhduar. Ky koncept perfaqeson temen me delikate te ketij instituti, sepse ligjvenesi, per te realizuar bashkimin, kerkon kete element si kusht te domosdoshem te formes se vazhdimit.

Qellimi i njejte kriminal perfaqeson elementin e bashkimit, fijen qe lidh ne bashkime te ligjshme krimet e veçanta te kryera edhe ne kohe te ndryshme, secili prej tyre eshte vete i persosur ne strukturen e tij tipike <sup>(105)</sup>. Sigurisht do te ishte e gabuar te thuhej qe me kete duhet ose mund te kuptohet mashtrimi i krimeve te veçante, per arsye se krimet e veçante te bashkuar ne lidhjen e vazhdimit jane ne menyre te pavarur te plote. Nga keto vezhgime mund te arrihet ne perfundimin e metejshem, duke pare se krimi i vazhduar ka nevoje per nje projektim te fundit, te realizueshem nepermjet nje sere krimesh me dashje, se vetem kryerja me dashje mund t'i pergjigjet ketij projektimi <sup>(106)</sup>. Nga keto studime arrihet ne menyre te heshtur te perjashtohet rasti i vazhdimit ne *krimet nga pakujdesia*, sepse ne keto krime ngjarja e demshme ose e rrezikshme nuk eshte parashikuar ose nuk eshte dashur edhe pse e parashikuar <sup>(107)</sup>. Nga kjo papajtuesmeri strukturale, midis planit dhe mungeses se deshires ne krimet nga pakujdesia, del se normat mbi vazhdimin rezultojne te zbatueshem vetem ne krimet me dashje <sup>(108)</sup>.

*i-) Lidhja e njejte ne aspektin subjektiv, objektiv dhe teoria eklektike (e shumeanshme).*

Perpara reformes se 1974 nje pjese e doktrines penale mbronte idene se qellimi i njejte kriminal nxirrej nga **objektiviteti** i fakteve, sepse shkëljet e shumta te njeta homogjene kishin vlere te njejte me perseritjen e te njejtij lloj te sjelljes kriminale ne kushte te ngjashme <sup>(109)</sup>. Shembulli tipik eshte ai i

105 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.502.

106 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.505.

107 () LEONE, Krimi i zakonshem., cit., fq.304.

108 () FIANDACA-MUSCO, E drejta penale, cit., fq.606.

109 () COPPI, Krimi i vazhduar dhe vepra e gjykuar, Napoli, 1969.

arketarit, i cili vjedh here pas here para nga arka. Nga ky shembull eshte e lehte te kuptohet se si nga perseritja e veprimit te njejte dallohet bashkimi i qellimit.

Megjithate, nuk mungonin orientimet ne aspektin **subjektiv**, sipas te cileve per te identifikuar qellimin kriminal do te mjaftonte qe ngjarjet e vecanta te krimeve te ndryshme te risillen ne momentin e vetem, ne te cilin fajtori ka kryer nje krim <sup>(110)</sup>.

Me ndryshimin e 1974, shtrirja e vazhdimit edhe per shkeljet e ndryshme heterogjene, vendosi zhdukjen e nje elementi te rendesishem.

Perpara reformes ne drejtesi, elementi i shkeljeve te njejta homogjene perbente pa dyshim nje element te fuqishem bashkues, duke perforcuar nga ana objektive qellimin kriminal. Me reformen, e lindur nga kerkesa per te kaluar kufijte e vendosur per formen e institutit nga nje jurisprudence e ngurte dhe e ashper, qe identifikonte shkeljet e ligjit me cilesine e krimit dhe perjashtonte zbatimin e vazhdimit, kur behej fjale per shkelje te shumta te ngjashme <sup>(111)</sup>, u arrit ne shtrirjen e institutit te shkeljeve te shumta edhe ne dispozitat e ndryshme te ligjit. Si perfundim qellimi i njejte kriminal mbeti elementi i vetem themelor i institutit.

Ky modifikim ka sjelle eliminimin e elementit te qarte te objektivitetit, i cili ishte shkelja e dispozites se njejte te ligjit dhe ka orientuar teorine dhe doktrinen penale mbizoteruese te shpjegoje konceptin e "...qellimit te njejte kriminal..." nga ana subjektive. Me fjale te tjera, studimi i elementit te "...qellimit te njejte kriminal..." ekziston, nen nje kendveshtrim psikologjik, ne zbulimin nese ekziston te pakten nje lidhje ne paraqitjen e krimeve te ndryshem, qe mund te jene midis tyre edhe plotesisht te ndryshem.

Nje pamje tjetër, ne krahasim me teorine subjektive lidhur me temen ne fjale, eshte paraqitur nga nje doktrine tjetër, e cila ka fokusuar si pikenisje formen e institutit edhe ne rastin e krimeve te ndryshme heterogjene, te cilet me vete nuk tregojne nje ulje te denimit te vepruesit sic ndodh ne rastin e krimeve te njejta homogjene <sup>(112)</sup>.

Kjo doktrine, mendon se atje ku behet fjale per shkelje te ndryshme heterogjene elementi i "...qellimit te njejte..." duhet te qendroje ne nje plan veprimesh te hartuar jo me vone se kryerja e krimit te pare dhe te perfshije te gjitha shkeljet (koncepti subjektiv i qellimit kriminal). Perkundrazi kur behet fjale per shkelje te njejta homogjene, elementi mbeshtetes i "...qellimit te njejte kriminal..." mund te marre formen subjektive te planit mbrojtës, ashtu dhe formen objektive te paraqitjes se fakteve te njejta <sup>(113)</sup>. Sipas kesaj pikpamje

110 () LEONE, Krimi i zakonshem, cit., fq.286.

111 G.J.L.VI, 9 Janar 1967, ne gj.p., 1967, III, 1283.

112 () PAGLIARO, Parimet., cit., fq.606.

113 () PAGLIARO, Parimet., cit., fq.607.

(teoria eklektike e shumeanshme), interpretuesit i paraqitet mundesia te kerkoje elementin bashkues, qellimin e njeje kriminal si ne aspektin psikologjik, ashtu dhe nepermjet hetimeve mbi faktet dhe mbi pajtueshmerine e tyre te mundshme ne perputhje me bashkimin e tyre.

Nje teze e tille, siç ka theksuar ekzaktesisht doktrina penale, duhet te jete mbeshetur ne nenin 671 te kodit te procedures penale, i cili legjitimon gjyqtarin e ekzekutimit te vendimit te zbatoje disiplinen e krimit te vazhduar. Organi gjykues, per te vendosur nese ekzistojne kushtet paraprake per zbatimin e institutit te krimit vazhdues, duhet te tregojte kujdes nga perfundimet provuese qe dalin nga vendimet e paapelueshme, te cilet duhet te shfaqin nga ana objektive qellimin e perbashket qe i bashkon <sup>(114)</sup>

## 2.2. Ceshtja e gjykuar dhe krimi i vazhduar.

Problem ne doktrinen dhe jurisprudencen italiane, kane qene marredheniet midis institutit te krimit te vazhduar, neni 81, paragrafi 2 kodit penal, dhe institutit te vendimit te ceshtjes se gjykuar, neni 90 kodi te procedures penale., i mbajtur gjithmone si elementi baze i sigurimit te se drejtes, sipas parimit te paprekshmerise se vendimit te ceshtjes se gjykuar.

Nje orientim i qarte ishte, (eshte edhe sot), ne lidhje me rastin, ne te cilin shkelja me e rende gjykohet me vendim perfundimtar. Ne te tilla raste denimi-baze i vendosur nga gjyqtari i pare, me qellim vleresimin e denimit nga neni 81, paragrafi 2 kodit penal, nuk ndryshohet ne rastin e shkeljeve te reja me pak te renda, pas vendimit te paapelueshem <sup>(115)</sup>.

Per shkak te ketyre shqyrtimeve nuk supozohet nje konflikt i mundshem me parimin e paprekshmerise te vazhdimit, per arsye se pezullimi i vendimit ne keto raste nuk cenohet ne thelb <sup>(116)</sup>.

### *i-) Diskutime mbi formen e institutit ne percaktimin e shkeljes me te rende pas vendimit te denimit*

Doktrina juridike penale pas 1974, duke iu referuar normes ne fuqi, ka zberthyer tezen, sipas te ciles disiplina e diktuar nga neni 81 k.penal zbatohet, edhe kur gjate permbushjes se qellimit kriminal, eshte i pranishem vendimi perfundimtar i denimit, duke patur parasysh se fakti i rastesishem i lidhur me procedimet pasardhese, ne rastin e perjashtimit te regjimit te vazhdimit per shkeljet me te renda ne krahasim me vendimin e paapelueshem, do te ishte ne

114 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.504.

115 () Gj.L, I, 17 Mars 1982, R. p., 1983, fq.538.

116 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.507.

kundershtim me parimin e barazise dhe te arsyetimit<sup>(117)</sup>, duke dalluar nje te mete te ligjshmerise kushtetuese nga neni 3 Kusht., sepse do te trajtoheshin pa arsye ne menyra te ndryshme, situata te barabarta.

Ne fakt, autori i shkeljeve te shumta te ligjit penal, te kryera per te perbushur qellimin e njeje kriminal, i nenshtrohej bashkimit material te denimeve ose bashkimit juridik te parashikuar ne nenin 81 kodit penal, nese ishte gjykuar me pare me vendim te parevokueshem krimi me pak i rende (qe do te bente te pamundur, sipas kriterit te parashikuar nga orientimi i jurisprudences, caktimin e denimit te pergjithshem) ose krimi me i rende (qe do te pranonte vendimin e parashikuar) <sup>(118)</sup>.

#### **2.4. Neni 671 i kodit te procedures penale ne kodin e ri te procedures penale te vitit 1988 (Zbatimi i vazhdimit te krimeve nen efektin e vendimit)**

Arritur ne kete pike te kesaj teze, eshte me interes te shqyrtohet ajo qe ka qene nderhyrja zgjidhese e ligjvenesit, persa i takon argumentit, ndoshta i njohur me polemikat e gjata dhe te ashpra ne doktrine dhe jurisprudence, per me teper me referimin e qarte te Gjykates Kushtetuese:

“...futja ne sistem e normave te procesit, te ngjashme me ato qe jane ne fuqi lidhur me bashkimin ose konkurimin e krimeve, per te rregulluar ne fazen ekzekutive te vendimit “pabarazine” shfaqur nga ekzistenca e disa shkeljeve, te fshehura...” <sup>(119)</sup>

Per nje paraqitje më të drejte dhe te plotë, duhet theksuar, gjithashtu, se si Raporti i Projektit te Pare Paraprak te kodit te procedures (theksojme se ky projekt nuk u miratua) krahasonte, me ane te nenit 632 te Projekektit Paraprak mbi vazhdimin e krimeve, nga njera ane synimin per te thjeshtuar procesin, duke ndaluar bashkimin e akuzave, nga ana tjeter thelbin e nje instituti ate te vazhdimit <sup>(120)</sup>, duke percaktuar ne vendim menyren me te pershtatshme per te rifituar vazhdimin, duke vendosur hetimin e ekzistences se kushteve paraprake te vazhdimit para paprekshmerise te vendimeve ose dekreteve te shumta penale te paapaelueshme <sup>(121)</sup>.

Me nenin 671 te kodit te procedures penale ligjvenesit pozitiv ka zgjidhur perfundimisht lidhjen e diskutueshme midis ceshtjes se gjykuar dhe kimit te vazhduar (dhe ceshtjen pasuese te percaktimit te shkeljes me te rende pas vendimit te denimit). Per kete arsye vihet ne dukje, se si ne fuqi te ligjit te

117 () GAITO, Gj.L.10 Mars 1977, ne J. it., 1977, II, fq.376.

118 () LOZZI, Leksione te procedures penale, VI. ed., Milano, 2004, fq.760.

119 () 9 Prill 1987, n.115, gj.p., 1987, fq.1491.

120 () COSSEDDU, Vazhdimi ne krim., cit., fq.26.

121 () GAITO, Bashkimi, formal dhe krimi i vazhduar., cit.,fq.994.

meparshem te procesit, jurisprudenca e kohes vazhdimisht e quante te papranueshme kerkesen per te njohur lidhjen e vazhdimit ne fazen ekzekutive te vendimit.

## 2.5. Koordinimi me percaktimet e gjyqtarit te njohjes te ceshtjes.

Kodi i ri i procedures penale ka sjelle nje sere gjykimesh brenda doktrines, lidhur me koordinimin midis pushtetit te gjyqtarit te ekzekutimit te vendimit te parashikuar nga ligjvenesit dhe percaktimeve te kryera nga gjyqtari i njohjes se ceshtjes.

Problemi i pare ka te beje me kriteret e percaktimit perseri te denimit. Doktrina dhe jurisprudenca pajtohen me tezen, sipas se ciles: shkelja me e rende nuk percaktohet ne baze te denimit me te rende, por nga shkaku i denimit te parevokueshem per secilin pej krimeve <sup>(122)</sup>.

Me fjale te tjera, vazhdimi mund te perdoret vetem kur ekzistojne shume denime, per te cilat nuk eshte bere kerkesa per kompromis nga neni 444 kodit penal, sepse nga ligjvenesit pretendohet se trajtimet sanksionuese nuk jane te njejte ne rastet e kompromisit ne krahasim me proceset e tjera, ne te cilat miratimi nuk eshte arritur ose nuk ishte pranuar vezhgimi kritik i teorise, sipas te cilit nuk ka kuptim te dallohen krimet per te cilet denimi eshte zbatuar me kerkesa te paleve, nga krimet e tjera: nese per krimet e para kerkohet nje trajtim sanksionues jo i njejte, edhe per krimet e percaktuar me *gjykim te shkurtuar* ndodh e njejta gje, por vazhdimi nuk eshte pranuar ( pa nje arsye te vlefshme) vetem duke iu referuar bashkimit te denimeve te krimeve per te cilet eshte bere kompromis me krimet e tjera <sup>(123)</sup>.

Nga ky interpretim dallohet se ligjvenesit ka dashur te tregojne se duhet miratimi i te dy paleve, qe disiplina e vazhdimit te mund te perdoret edhe per rastet e vendimeve ne zbatim te denimit me kerkesa te paleve, ne perpjekje per te shmangur rrezikun, qe denimi i dhene me kompromis, ne nje proces te meparshem, mund te hiqet ne menyre te njeanshme pa pelqimin e organit hetimor, nen efektin e ekzekutimit te vendimit. Prandaj prokurori, ne perputhje te plote me strategjite gjyqesore, nese eshte e nevojshme, mund te refuzoje miratimin duke ndjekur drejtimet e vendosura me nismen e vet, brenda kuadrit te pergjithshem te politikes kriminale <sup>(124)</sup>. Megjithate, nese gjyqtari e gjykon si te padrejte refuzimin e miratimit nga ana e prokurorit, mund te procedoje me shtimin e denimit sipas vazhdimit, por gjithmone qe shuma e pergjithshme te mos kaloje masen e treguar ne nenin 444 te kodit te procedures penale (ose te

122 () ANTOLISEI, Manuali., cit., fq.536.

123 () GAITO, Bashkimi formal dhe krimi i vazhduar., cit., fq.1004.

124 () GAITO, Bashkimi formal dhe krimi i vazhduar., cit., fq.1003.

dy viteve te burgimit ose te arrestimit, vetem ose te bashkuar me denimin me gjobe).

Gjithashtu, eshte e nevojshme te shyrtohet, se gjyqtari i ekzekutimit te vendimit nuk detyrohet nga kerkesa e thjeshte dhe e njekohshme e paleve, por verifikon konkretisht nese ekzistojne kushtet paraprake te kerkuara nga sistemi, qe mund te zbatoje disiplinën e krimit te vazhduar, si dhe vec kesaj nuk mund te perjashtohet nga gjykimi papajtuesmeria e denimit te treguar nga palet ne lidhje me parimin e riedukimit te fajtorit, te deklaruar ne nenin 27 paragrafi 3, te Kushtetutes <sup>(125)</sup>.

### 3.1.Zbatimi i amnistise ne krimin e vazhduar

Nje ceshtje tjeter, ne lidhje me krimin e vazhduar, jane edhe marredheniet me amnistine. Pyetja qe i behej interpretuesit ishte: A eshte e lidhur amnistia me krimin e vazhduar, me gjithë rritjen e mases se denimeve si rezultat i vazhdimit? Eshte e qarte se problemi ishte perqendruar ne rastin ku shkeljet e vecanta te ligjit kerkojne denim te vecante, keshtu qe amnistia mund te zbatohet, ndersa ne krimin e vazhduar shkeljet te vecanta denohen me nje denim te vetem. Doktrina trajtonte problemin nese duhet te merrte parasysh denimin e parashikuar per rastet e vecanta apo ate qe dilte nga bashkimi i krimeve dhe nese mund te zbatohet apo jo amnistia ne krimin e vazhduar <sup>(126)</sup>.

Ne mungese te nje dispozite te sakte ne kod, qe te rregulloje marredheniet midis amnistise dhe krimit te vazhduar, zgjidhja per kete problem u gjet nepermjet *studimit te natyres juridike te krimit te vazhduar*. Sic eshte pare edhe ne zhvillimin e tezes, doktrina preferon te flase per vazhdim te krimeve. Sipas kesaj teorie krimi i vazhduar do te ishte vetem nje simulim legjislativ, sepse "... qellimi i njejte kriminal..." nuk eshte nje mashtrim i perbashket, por vetem nje deshire abstrakte, dhe sic theksonte nje filozof i famshem, "te duash ne menyre abstrakte nuk eshte te duash me te vertete" (CROCE). Nese cdo krim i vecante duhet te mbeshtetet nga mashtrimi perkates <sup>(127)</sup> si deshire qe perkrah veprimet e vecanta, bashkimi i tyre mund te ndodhe nepermjet simulimit te ligjit <sup>(128)</sup>. Prandaj krimi eshte unik me qellim dhenien e denimit, por eshte gjithashtu i perbere nga objektiva te shumta krimesh <sup>(129)</sup>.

125 () LOZZI, Leksione., cit., fq.765.

126 () SANTAMARIA, Zbatimi i amnistise ne krimin e vazhduar, Shkrime te se drejtes penale, Milano, 1996, fq.422.

127 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.502.

128 () SANTAMARIA, Zbatimi i amnistise ne krimin e vazhduar., cit., fq.424.

129 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.506.

Nga keto gjykime dallohet se efektet e vazhdimit, atje ku ligji hesht, jane karakteristikat e krimeve te shumta <sup>(130)</sup>. Si perfundim disiplina e parashikuar ne nenin 151, paragrafi 2 kodit penal, qe rregullon raportet midis amnistise dhe bashkimit te krimeve, eshte i pajtueshem edhe ne rastin e krimit te vazhduar, i menduar si nje forme e vecante bashkimi.

Neni 151, paragrafi 2 kodit penal percakton:

“...ne bashkimin e disa veprave penale, amnistia zbatohet ne krimet e vecanta, per te cilet eshte dhene...”

### 3.2.Krimi i vazhduar dhe parashkrimi

Ligjvenesit vlereson krimin e vazhduar ne raport me *parashkrimin*, i cili fillon nga dita ne te cilen pushon vazhdimi i veprave penale<sup>(131)</sup>. Megjithate ai merr parasysh ndarjen e krimit te vazhduar ne krime te vecanta, sepse koha e nevojshme per te parashkruar eshte ajo e parashikuar per krimet e vecanta vazhdimisht <sup>(132)</sup>, prandaj per te caktuar kohen e nevojshme per te parashkruar veprën, zbatohet regjimi i bashkimit te krimeve. Me kete ide pajtohet edhe jurisprudenca.

Ne kete kuptim, **Gjykata Penale** ne vendimin e saj arsyeton:

“...pandashmeria e krimit te vazhduar mbrohet vetem me qellim fillimin e parashkrimit dhe jo per te percaktuar kohen e nevojshme per te parashkruar...” <sup>(133)</sup>

Neni 158 kodit penal percakton se:

“...parashkrimi fillon...per krimin e vazhduar...nga dita ne te cilen pushon vazhdimi...”

Nga norma dallohet qarte se nese parashkrimi fillon nga momenti i kryerjes se krimit, krimi i vazhduar shfaqet si i bashkuar, duke e zberthyer situaten ne dem te te pandehurit. Por nese vleresimi ligjor, “i bashkuar” apo “i shumte”, i krimit te vazhduar varet nga *riedukimi i fajtorit*, rregulli i parashikuar nga neni 158 kodit penal do te perbente nje shkelje te ketij parimi.

Me fjale te tjera, ligjvenesit vlereson krimin e vazhduar si nje krim te vetem me qellim parashkrimit, sepse mendon se momenti i pushimit te vazhdimit paraqet momentin e fundit ne te cilin subjekti shfaq nje sjellje qe objektivisht tregon ndjekjen e nje plani kriminal. Prandaj eshte e arsyeshme qe parashkrimi te filloje pikerisht nga shfaqja e fundit e marre nga faktet dhe jo nga orientimi

130 () PAGLIARO, Parimet., cit., fq.613.

131 () PAGLIARO, Parimet., cit., fq.614-615.

132 () RAMACCI, Zhvillimi., fq.506.

133 () Gj.L.I, 10 Tetor 1981, gj.p.1982, fq.479.

psikologjik i subjektit, sepse “vullneti shpirtëror nuk mund të vendoset në kontakt të drejtperdrejtë me realitetin”<sup>(134)</sup>

## VEPRA PENALE VAZHDOESE NE TE DREJTEN PENALE SHQIPTARE

Në të drejtën penale shqiptare është trajtuar instituti i krimit vazhdues në kohë dhe periudha të ndryshme nga autore dhe juriste të së drejtës penale. Në legjislacionin tone penal nuk ka patur dispozita të shprehur për veprën penale vazhduese, por në doktrinë dhe nga rastet e praktikës gjyqësore është trajtuar dhe pasqyruar kuptimi i vepres penale vazhduese.

Në këtë kuptim, doktrina jone penale ka dhënë këtë perkufizim për veprën penale vazhduese:

“Vepra penale vazhduese quhen veprat shoqërisht të rrezikshme që përbehen nga dy ose më shumë veprime të njëllojta kriminale dhe që kryhen për të realizuar të njëjtin mendim kriminal”.

Vepra penale vazhduese lidhet me *cilesimin ligjor të vepres* që ka kryer autori dhe me individualizimin e denimit që do të zbatohen ndaj tij.

Juristi i njohur Shefqet Muci në punimin e tij “Vepra penale vazhduese” në botimin “Drejtësia Popullore” 4, 1983. e perkufizon si më poshtë krimin vazhdues:

“Me *veper penale vazhduese kuptohet* kryerja ose moskryerja e dy apo më shumë veprimeve kriminale të njëllojta, me qëllim që të zbatohet një mendim i vetëm kriminal i autorit të tyre”.

Në *teorinë e të drejtës penale* janë shfaqur mendime të kundërta lidhur me natyrën juridike të vepres penale vazhduese.

## VEZHGIMET PERMBYLLESE

Në perfundim, lidhur me krimin e vazhduar, është me interes të theksohet se me reformën e vitit 1974 qëllimi kryesor i ligjvënësimit ishte zbutja e ashpërsisë të tepruar të drejtësisë së Gjykatës së Lartë, për të kufizuar zbatimin e krimit të vazhduar. Kjo arsye ka shtyrë ligjvënësin të zgjerojë rastet e formës të krimit të vazhduar edhe në rastet e shkeljeve të ndryshme heterogjene, për të shmangur ndarjen e rasteve ligjore, të cilët ishin përberës të skemave të ndryshme të ligjit dhe krimi i vazhduar nuk zbatohet<sup>(135)</sup>.

Më gjithë risinë e sjelle në të drejtën positive nga reforma e 1974, jurisprudenca, të paktën për një dhjetëvjeçar, kundër qëllimit të ligjvënësimit (qëllim i perforcuar në mënyrë të qartë me reformën e 1974), ka vendosur

134 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.510.

135 () VASSALLI, Reforma., cit., fq.60.

megjithate kufij rreth zbatimit te vazhdimit ne rastet ku eshte dhene vendimi mbi ngjarjet e vazhdimit te nje rendesie me te vogel ne krahasim me ate ose ata qe jane akoma nen gjykim.

Disiplina e sotme e institutit te krimit vazhdues ka sjelle pervec "...qellimit te njeje kriminal..." edhe kushtin e nje "plani te pergjithshem mbrojtës". Kjo teze megjithese eshte e argumentuar shtron disa pyetje:

Mbi cilat kritere nxirret nje plan i tille mbrojtës?

Si kuptohet orientimi psikologjik i subjektit veprues pa asnje verifikim te fakteve, te cilet mund te tregojne radhen e veprimeve qe pasqyrojne deshiren e tij?

Me ane te nje analize te kujdesshme doktrina ka theksuar se faktet e shumta mund te vleresohen si te bashkuar, kur vendimi i pare mund te shpjegoje faktet e vecanta te krimit te vleresuar ne bashkimin e tyre: shpjegimi eshte i pakundershtueshem, kur secili prej tyre eshte i nevojshem per realizimin e qellimit, me krimet e vecanta, qe krahasohen me endjen e nje mozaiku, te pershtatur ne nje menyre te tille qe bashkohen midis tyre <sup>(136)</sup>.

Nga keto vezhgime dallohet se orientimi psikologjik i subjektit veprues eshte i pamjaftueshem per te treguar nje lidhje te ngushte midis krimeve te ndryshme.

Me fjale te tjera, nje lidhje e tille midis krimeve te ndryshme, mund te kuptohet nga analiza e kontekstit te vete krimeve, te cilet per sqarimin e njeri-tjetrit sjellin formen e qellimit, qe lidh dhe justifikon veprimin, qe e ka shtyre fajtorin.

Si perfundim, pervec nje plani fillestar (qe te kuptohet qellimi kriminal) eshte i domosdoshem ballafaqimi i fakteve, per te nxjerre keshtu nga nderlidhja e tyre reciproke ekzistencen e qellimit kriminal si forca terheqese per te gjitha krimet.

Me reformen e vitit 1974, per te zbuluar ne "...qellimin e njeje kriminal..." elementin e vetem strukturor mbi te cilin bazohet krimi i vazhduar, theksohet tendenca e gjyqtareve per te njohur ekzistencen e qellimit kriminal edhe ne rastin kur kjo ekzistence eshte shume e paqarte, ne lidhje me situaten ku do te ishte ne diskutim figura e zakonshme e krimit.

Ky orientim, ne driten e parimeve te pergjithshme qe frymezohet e drejta penale, mund te vendoset ne jurisprudencen gjithmone e me te perhapur, qe priret te shmange zbatimin e disiplines se bashkimit te krimeve dhe te regjimit te tij teper sanksionues (per te cilin eshte parashikuar rritja e denimit deri ne pesefish). Nga ky kendveshtrim mund te shpjegohet (ne driten e parimeve te permendura me siper) kerkesa gjithnje e me e madhe e gjyqtareve per ekzistencen e qellimit te njeje kriminal, duke sjelle nje perdorim te shtremberuar

136 () RAMACCI, Zhvillimi., cit., fq.510.

te institutit te krimit te vazhduar, me nje prirje gjithnje e me te madhe drejt nje regjimi ndeshkues me te bute. E gjitha kjo eshte bere me e lehte nga mungesa e normave mbi disiplinen e krimit te vazhduar, kufijte e te cilit ne lidhje me institutin e bashkimit te krimeve jane shume te paqendrueshem. Kushti i “qellimit te njejte kriminal” nuk mjafton per t’i bere kufijte me te qendrueshem.

Ne kete pamje, ne driten e parimeve te pergjithshme te se drejtes penale, mund te behet pyetja:

A nuk do te ishte me e arsyeshme te shfuqizohej figura e krimit te vazhduar me shtrirjen e zbatimit te disiplines se bashkimit juridik edhe ne rastet e bashkimit te krimeve?

Pergjigjja positive e kesaj pyetjeje nuk do te shmangte pyetjet e tjera:

Brenda kufijve te politikes kriminale, a do te ishte i arsyeshem zbatimi i regjimit sanksionues te njejte per te gjitha rastet e bashkimit te krimeve?

Por, nese do te ishte keshtu, krimi i vazhduar, i cili tregon nje vlere negative te pergjithshme me te vogel, nuk do te dallohej ne krahasim me rastet e tjera bashkimit te krimeve?

A nuk do te ishte me e pershtatshme qe ligjvenesit te percaktonte kriteret me shtrenguese per krimin e vazhduar?

Persa i takon aneve te procesit, “kodi i ri i procedures penale i vitit 1988” ka marre udhezimet e Gjykates Kushtetuese, per te rregulluar ne fazen e ekzekutimit te vendimit pabarazine e shkaktuar nga ekzistenca e disa shkeljeve te fshehura, pjeserisht te shfrytezuara te vazhdimit <sup>(137)</sup>.

Per t’i besuar nje institut kaq delikat gjyqtarit te ekzekutimit te vendimit, pyetje te tjera mund te behen sidomos persa i perket marredhenieve midis gjyqtareve te ndryshem. Megjithese, sic u pa, doktrina u ka bere nje interpretim te gjere ceshtjeve me problematike, ne driten e parimeve te pergjithshme te se drejtes penale, mund te ishte e arsyeshme nderhyrja e ligjvenesit, ne sigurimin e te drejtes, per te treguar per shembull:

Cilat jane rastet, ne te cilat gjyqtari i njohjes se ceshtjes, duhet te perjashtoje disiplinen e vazhdimit?

Ceshtja e diskutueshme nese gjyqtari i ekzekutimit te vendimit mund ose jo te percaktoje nga e para denimin baze, mund te jete nje teme ku mund te nderhyhet.

E keqja qe vjen nga zbatimi i nenit 81 te kodit penal, ne rastin e kompromisit ose jo per denime te krimeve, krijon situata dalluese te padrejta, qe mund te jene objekt i nje analize te kujdesshme nga ligjvenesit.

Ne rastin e amnistise: n.q.se kjo do te zbatohet per krimin me te rende nen efektin e vendimit gjate ekzekutimit, ne kete rast do te behet fjale per amnisti

137 () Gjykata Kushtetuese, 9 Prill 1987, nr.115, gj.p.1987, fq.1491

te gabuar, e cila duke nderhyre pas nje vendimi te parevokueshem, le pasojat e denimit penal, keshtu qe per krimin me pak te rende dhe per denimin e parashikuar per te, do te zbatohet koeficienti i caktuar per krimin me te rende (tashme te amnistuar). Nese do te ishte keshtu, meqenese gjykatesi i ekzekutimit te vendimit nuk mund te rivleresoje pershtatshmerine e denimit, nuk do te ekzistonte nje corientim midis denimit qe ngelet dhe parimit te riedukimit te fajtorit te shpallur ne nenin 27, pragrafi 3, te Kushtetutes. A nuk do te ishte me e arsyeshme qe ligjvenesi te zgjeronte fuqite e gjyqtarit te ekzekutimit te vendimit duke i lejuar te nderhyje, jo vetem per te zbatuar disiplinën e krimit te vazhduar, por edhe per te vleresuar pershtatshmerine e denimit ne driten e parimit kushtetues te pohuar me siper?

Persa i perket marredhenieve midis krimit te vazhduar dhe parashkrimit, ne driten e parimeve te pergjithshme te se drejtes penale, mund te theksohet se shkelja e mundshme e parimit te *riedukimit te fajtori* mund te justifikohet me vete strukturen e krimit te vazhduar per arsye se, nese do te konsideroheshin si shumice krimet e ndryshme vazhdimisht kushti i "...qellimit te njejte kriminal..." mund te humbte kuptimin (keshtu qe i gjithe instututi do te ishte pak i qarte), sepse krimet e kryera me perpara mund te parashkruheshin me veshtiresite pasuese per te identifikuar qellimin e njejte kriminal, qe mund te kuptohet nga shqyrtimi i perbashket i fakteve te ndryshem, te cilet duhet te regojne qarte realizimin e qellimit. Nga ky perfundim shtrohet pyetja:

Si mund te nxirret "...qellimi i njejte kriminal...", kur disa prej fakteve, te parashikuar nga ligji si krime, nuk jane me krime pse jane te parashkruar?

Si perfundim, ne vija te pergjithshme sigurisht mund te deklarohet se instituti i krimit te vazhduar ka qene gjithmone nje institut sa i rendesishem, po aq edhe problematik.

Megjithese ka qene objekti i reformave te ndryshme, qe kane te bejne jo vetem me te drejten themelore, por edhe me procesin, instituti ka qene dhe vazhdon te jete burim i orientimeve te shumta, per me teper te kundert brenda doktrines, i interpretimeve here te njejte dhe here te ndryshem midis jurisprudences *se mire* dhe asaj te Gjykates se Larte ose midis jurisprudences te vete Kolegjeve te kesaj te fundit.

Nga pjesa me e rendesishme e doktrines, vete teoria positive mendohet si e pamjaftueshme, per te zgjidhur perfundimisht problemet e shumta qe paraqet instituti <sup>(138)</sup>.

Instituti i krimit te vazhduar na ben deshmitare te ndryshimeve te vazhdueshme te bera nga ligjvenesi, shpesh ne menyre te crregullt dhe jo koherente, me dy kodet, duke shkaktuar nje crregullim ne te gjithe sistemin penal.

138 () Me kete gjykim pajtohet shumica e autoreve te permendur.

Reformat e ndryshme, te kryera per te permbushur kerkesat e ndryshme dhe midis tyre te kunderta, theksojne se krimi i vazhduar, por ndoshta i gjithë sistemi penal, eshte kthyer ne nje grumbull normash midis tyre pak te koordinuara, qe per te zgjidhur disa ceshtje hapin patjeter te tjera, duke krijuar nje sistem penal gjithnje e me shume te copetuar, qe te jep imazhin e nje xhakete te vjeter me shume arne.

Nje jurist i shquar shprehej se eshte e vertete qe: "...shkenca juridike nga vete natyren e saj eshte e trazuar, e ekspozuar para historise dhe kushteve te jetes, qe ne cdo moment vene ne diskutim postulatet mbi te cilat mbeshetet. Brenda disa kufijve, ne kete ndodhet dicka fiziologjike, ne kuptimin qe zhvillimi natyror i jetes sociale pasqyrohet patjeter ne drejtesi, duke kerkuar forma te reja, qe te pershtaten me kete zhvillim, ne lidhje me interesat qe shfaqen dhe shkelen duke kerkuar mbrojtjen e tyre..."<sup>(139)</sup>, por ligjvenesit ka detyrim te koordinoje keto kerkesa ne menyre efektive per te siguruar parimet, qe duhet te perbejne bazen e saj.

Ne fund mund te arrihet me te vertete ne perfundimin se nderhyrja e ligjvenesit eshte vendimtare ne permiresimin dhe koordinimin e kerkesave me karakter themelor dhe per me teper qe i perkasin procesit, prej te cilave instituti i vazhdimit frymezohet dhe rregullohet.

## BIBLIOGRAFI

- AMBROSETTI E.M., Problemet ekzistuese per krimin e vazhduar, Nga 1974 deri ne kodin e ri te procedures penale, Padova, 1991.
- ANTOLISEI F., Manuali i te drejtes penale, VII ed., L.CONTI, Milano, 2003.
- COPPI F., Krimi i vazhduar dhe ceshtja e gjykuar, Napoli, 1969.
- COPPI F., Krimi i vazhduar dhe ceshtja e gjykuar: percaktimi i shkeljes me te rende pas vendimit dhe caktimi i ri denimit-baze, ne Drejtesine pozitive, 1990.
- COSSEDDU A., Vazhdimi ne krim dhe ceshtja e gjykuar perballe zgjedhjeve te k.p.p. 1988, ne te drejten penale., 1990.
- FERRI, Parimet e se drejtes kriminale, Torino, 1913.
- FIANDACA G.-MUSCO E., E drejta penale, III ed., Bologna, 1995.
- GAITO A., Bashkimi formal dhe krimi i vazhduar ne fazen e ekzekutimit te vendimit penal, 1989.
- LEONE G., Krimi i zakonshem, i vazhduar, i perhershëm, Napoli, 1933.
- LI VECCHI G., Krimi me i rende se ai tashme i gjykuar dhe zbatimi i vazhdimit, 1988.
- LOZZI G., Leksione te procedures penale, VI ed., Milano, 2004.

---

139 () SATTA, Monologje dhe takime te nje juristi, Padova, 1968, fq.148.

- MANTOVANI, E drejta penale, Padova, 1988.
- PAGLIARO A., Parimet e se drejtes penale, VIII ed., Milano, 2003.
- RAMACCI F., Zhvillimi i te drejtes penale, II ed., Torino, 2001.
- RISTORI R., Krimi i vazhduar, Padova, 1988.
- ROCCO A., Objekti i krimit dhe i mbrojtjes juridike penale, Torino, 1913.
- SANTAMARIA D., Zbatimi i amnistise ne krimin e vazhduar, Shkrime te se drejtes penale, Milano, 1996.
- SATTA S., Monologjet dhe takimet e nje juristi, Padova, 1968.
- VASSALLI G., Reforma e te drejtes penale te 1974, Milano, 1975.
- ZAGREBELSKY V., Krimi i vazhduar, 1996
- Udhezim I Plenumit te Gjykates se Larte nr.1, date 10.01.1966.
- Shefqet Muci, "Vepra Penale Vazhduese" ne botimin Drejtesia Popullore 4/1983.
- Vendimi Unifikues nr.284 date 06.10.2000, te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte.
- Aranit Cela, E drejta penale e R.P.S.Sh. e vitit 1982.
- Udhezimi i Plenumit te Gjykates se Larte nr.8, date 05.11.1982 "Mbi pervetesimin e pasurise socialiste".

# PROJEKSIONI I TRANZICIONIT DREJT KONSTITUCIONALIZMIT EUROPIAN, NË BALLKANIN PERËNDIMOR.

Redi Shtino

Mediterranean University of Albania  
redishtino@umsh.edu.al

## ABSTRACT

*It is not enough to write or approve a Constitution, in order to have one, in its purest sense. This happens, if we put the sign of equality between the constitution and constitutionalism: the latter is a phenomenon that characterizes Western constitutional system and especially the European ones. The Western Balkans despite the fact that is a constitutional space surrounded by the European Union, it seems that is still far away from achieving this ultimate objective. About two and a half decades were required to understand the direction, while it is still difficult to assess the real distance of this target. This journey, resulted with more unknowns than expected. Today to the internal factors that negatively influenced the constitutional progress are also added those external ones. The not very optimistic economic prospective of the region, as well as the old continent itself, due to global developments, cannot adversely affect the legitimate ambitions of the young generation. Common European space cannot be designed only as a common market, but as a de facto and de jure guarantor of constitutionalization.*

**Keywords:** constitutionalism, EU, Albania, South East Europe

## 1. TRANZICIONI

Kur flasim për tranzicionin si fenomen nuk mund të mos theksojmë që në fillim kompleksitetin e elementeve të tij përbërës dhe fazave përkatëse, të kushtëzuar nga faktorë të njohur e të panjohur, të pritshëm apo surprizë.

Përkufizimet shumëngjyrëshe mbi tranzicionin janë të njohura dhe gati të mbikonsumuara. Në thelb, fenomeni mund të reduktohet me parashikimin e një rrugëtimi drejt një rezultati final, i cili presupozon përkufizimin e një distance të caktuar: një segment që në mënyrë hipotetike përbëhet teknikisht nga një distancë virtuale, vështirësisht e matëshme. Për fat, apo jo, teorikisht, ky nuk është rasti i vendeve të Ballkanit Perëndimor, finishi i tranzicionit ekonomiko-juridik i të cilit ka qënë dhe mbetet qartësisht i identifikueshem: Bashkimi Europian. Lundrimi i këtij segmenti kushtëzohet, mbi të gjitha, nga shpejtësia me të cilën veprojnë aktorët e këtij procesi dinamik dhe nga përshtatshmëria e modeleve që janë huazuar për këtë qëllim.

Me fundin e luftës së ftohtë aksioma finale e sforcos gjigande të betejës së heshtur ishte përpara syve të të gjithëve – lufta ndërmjet dy kampeve ishte humbur apo fituar në fushën ekonomike dhe jo në atë ushtarake apo politike, sic mund të ishte imagjinuar në skenarët klasik, të fillimeve të saj. Lufta në dhe për tregje zëvendësoi për herë të parë, në historinë e zhvillimit human, konfliktin ushtarak. Perëndimi, nga ky moment, luftërat e mijëvjeçarit të tretë, në territoret e tij, duket se do të zhvillojë ekskluzivisht në këtë fushë.

Rekuperimi i kontrasteve ekonomike e më pas i atyre politike e sociale ishte konteksti i përgjithshëm në të cilin u hodhën hapat e para drejt një periudhe tranzicioni që do të kishte një datë të sigurt fillimi, por jo mbarimi. Vullneti kushtetues lindor u orientua në favor të parimeve liberale për të kënaqur aspiratat ekonomike sipas modelit triumfues perëndimor. Rrugëtimi në fjalë do të varej mbi të gjitha nga konteksti lokal i implementimit të tij. Gjendja ekonomike, në të cilën vëndet ndodheshin në fillim të tranzicionit dhe që më shumë se kushdo reflekton atë politike dhe kulturore, ishte indikator i kryesor i predispozicionit ndaj suksesit.

Deri në atë periudhë ishte vënë re se cikli i tranzicionit kushtetues ndesh përgjithësisht, në momentin e kapërcimeve të mëdha, me huazimin e sistemeve të huaja të importuara por edhe me hibridizimin e dy sistemeve.

Mbi fazat e tranzicionit ka vlerësime doktrinare të ndryshme por përgjithësisht ato ndahen në: a) fazën e parë të thyerjes; b) fazën e dytë të përpjekjes për ngritjen e institucioneve; c) konsolidimin institucional; d) materializimin faktik të konstitucionalizmit;

Edhe pse tranzicioni ekonomik, nga sistemi i ekonomisë së centralizuar e të planifikuar në atë të tregut të lire, rezulton në rajonpothuajse i përfunduar, nuk mund të mbështetet i njëjti mendim në lëmin juridik e për më tepër në atë të realizimit të demokracive kushtetuese në rajon.

Kur i referohemi më specifikisht tranzicionit kushtetues të vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt Konstitucionalizmit, duhe të bëjmë kujdes për të mos ngatërruar tranzicionin kushtetues me kushtetutat tranzitore. Tranzicioni

kushtetues nuk ndesh apo fillon domosdoshmërisht me Kushtetuta tranzitore apo provizore. Keto të fundit janë shprehje e një faze përgatitore në kërkim të legjitimitetit dhe zhvillimit të kapacitetit tekniko-juridik, të cilat duhet të qëndrojnë në themelet e Kushtetutave definitive dhe që do të mbartin në vetëvete të gjithë elementët e ndryshimit dhe të thyerjs me sistemin e mëparshëm. Termi i tranzicionit kushtetuese është përdorur gjerësisht për të nënvizuar kalimin nga sistemi monist autoritaro-totalitar në sistemin pluralisto-garantist. Tranzicioni kushtetues mund të përfshijë ndryshime që ndikojnë formën e Shtetit dhe të Qeverisë dhe që parashikojnë (jo detyrimisht) përdorimin e kushtetutave të reja. Por mund të ketë edhe tranzicione kushtetuese që materializohen me revizionime të kushtetutes, apo që nuk parashikojnë ndryshime formale të tekstit kushtetues (**Giuseppe de Vergottini**).

Kjo në teori pasi në praktik sidomos në rastin e Ballkanit perëndimor, ku thyerjet me të kaluarën apo ndryshimet territoriale kanë qënë të prekshme, kemi asistuar në ndryshime radikale të territoreve dhe të Kushtetutave: në aspektin formal dhe atë material. Në fakt kalimi nga sistemi institucional autoritaro-totalitar në atë demokratik do të thote ndryshim i formës së Shtetit.

Nga shpërbërja e kampit socialist dhe rënia e ideologjisë socio-komuniste, shtetet e aleancës në fjalë dolën me zhvillime jo të njëtrajtëshme, në rajon, zhvillimet e tyre pararendëse luhateshin nga autoritarizmi (rasti i RFSJ-se) deri në totalitarizëm (rasti i RPSSH). Ndryshimet ndërmjet tyre ishin indikatorët më imediat të distancës reale apo të presupozuar dhe vështrësive që duhet të përballeshin për materializimin e konstitucionalizmit (kusht kryesore për aderimin në BE).

Kushtet pararendëse të fillimit të periudhës së tranzicionit; karakteristikat specifike ekonomike, shoqërore, kulturele dhe fetare të Shteteve të vecanta, ishin elemente kryesore që do të përcaktonin shpejtësinë e lundrimit drejt ujrave komunitare. Mbi të gjitha, më e rëndësishmja do të rezultonte thyerja e vullnetëshme me vazhdimësi kulturore-politike të sistemi të mëparshëm dhe kapaciteti i menaxhimit të saj.

Sigurisht ky proces (konsolidimi i Konstitucionalizmit), të cilit në territorin e tij të origjinës i janë dashur shekuj për tu konsoliduar, nuk mund të materializohet me shpejtësinë e dekadave në një ambient të huaj e aq më tepër me të kaluar të ndryshme.

Njohja me shtetin e së drejtës dhe koha e nevojëshme për ta kuptuar e më pas zbatuar (gjithnjë nëq do të ekzistonte vullneti për ta zbatuar dhe jo kapërcyer apo shmangur) do të kishin për koeficient katalizues nivelin e zhvillimit socio-ekonomik përkates.

Hyrja në fuqi e një Kushtetute nuk do të thote materializim i menjëhershëm i vlerave që ajo mbart. Përcjellja e sistemit të vlerave në fjalë kushtëzohet

domosdoshmërisht nga rezistenca që ajo do të ndeshi në habitatin e kulturës politiko-sociale. Shënjat e kompleksitetit të këtij fenomeni dhe të shkallës së veshtirësisë me të cilën do të ndeshet praktikisht në terren, mund të vihen re që gjatë procesit të haritimit të tij. Kontrastet gjatë fazave hartuese të Kushtetutave janë indikatorët më të hershëm të tyre. Pra faktorët e aftë të kushtëzojnë perfeksionimin e tranzicionit dhe konsensusin ndaj tij janë përgjithësisht: natyra e regjimit pararendës, sistemi i tij ekonomik, instrumentat e përdorur për tranzicionin dhe modeli-target final.

Edhe pse pjesa dërrmuese e doktrinave më në zë, kur trajtojnë tranzicionin drejt konstitucionalizmit, i referohen ekskluzivisht elementeve normativ të fenomenit, do preferoja të ndaloja edhemi ata ekonomik, të vlerësuar personalisht si shumë të rëndësishëm dhe deciziv nëpjekien e kultures së duhur, në mbeshtetje të ndryshimeve të dëshiruara apo të kërkuara. Hapsira dhe koha në dispozicion nuk e mundësojnë, në këtë rast.

## 2. KONSTITUCIONALIZMI

I jam referuar konsitucionalizmit, deri tani, si një term univok me një simbologji të vecantë. Por ndoshta është me vënd të specifikohen pa u thelluar, karakteristikat e tij dalluese. Kur flasim për Konstitucionalizëm, në përfundim, i referohemi përgjithësisht shkollës së mendimit kushtetues që materializohet me revolucionin francez dhe që njohu majat e tij më të larta me zhvillimet e mëtejshme të mbas luftës së dytë botërore. Me të kuptohet ideologjia liberale që qëndron në themel të zhvillimit politik, shoqëror dhe institucional që ka karakterizuar procesin e zhvillimit historik përfundimor në shekujt e shkuar: tërësia e parimeve që vlerësohen si model i sistemeve kushtetuese dhe bazohen mbi një rrjet të artikulluar garancish të cilat sigurojnë legjitimitetin e ushtrimit të pushtetit dhe ndarjen e tij, si dhe një regjim të përfeksionuar të drejtash që përfshinë dhe mbrojtien e tyre. (**Giuseppe de Vergottini**). Ashtu sic ndodh edhe me fushat e tjera të shkencave humane, kur një fenomeni evolutiv i vihet një emer pa shjtelime të mëtejshme gramatikore (dmth: mbiemra, epitete, etj) dhe përdoret në mënyrë referenciale e metaforike *majestatis*, me fenomenin në fjalë kuptohet shkalla më e lartë e zhvillimeve në këtë fushë, të njohur nga njeriu. Kjo është marrdhënia e Kushtetutave me Konstitucionalizmin. Në të kaluarën socio-komuniste të gjitha Shtetet e Ballkanit Përfundimor kanë njohur Kushtetuta që nuk kanë qënë pjesë e familjes së Konstitucionalizmit. Ka patur dhe ka Kushtetuta që qëndrojnë jashtë Konstitucionalizmit të gjitha ato herë kur Kushtetutat në fjalë nuk sigurojnë mbrojtje efektive të të drejtave të shtetasve të tyre, ndarje të pushteteve dhe legjitimim real të tyre. Përveç legjitimitimit teorik të

kushtetutave në kahun e Konstitucionalizmit, ekziston edhe ai faktit me burim sovran (popullin) i cili presupozon vullnetin e tij mbështetës, qëedhe një herë nënkupton pjekien e kapacitetit vlerësues të sovranit, e bazuar në eksperiencën jetësore.

Emblematik në këtë kuadër dhe shprehës i fortë i simptomatologjisë së gradës së zhvillimit tranzicional kushtetues mbeten mardhëniet ndërmjet pushteteve dhe ndarja e tyre. Sindroma e shprehur e modeleve autoritare-totalitare, kishte për format dhe karakterizohej nga parimi i “centralizimit demokratik” (funksioni i kundërt i ndarjes së pushteteve) i cili ushqente superioritetin e partisë ndaj institucioneve kushtetuese. Do qëndrojmë në mënyrë të vecantë, në vazhdim, në këtë fushëpasi për shkak të hapsirës dhe kohës në dispozicion bëhet pamundur, trajtimi i të gjithë elementeve tregues të realizimit të objektivave, në rrugëtimin e tranzicionit kushtetues.

### 3. BALLKANI PERËNDIMOR

Në procesin e tranzicionit një element shumë i rëndësishëm është pjekja e vullnetit dhe kapacitetit të brendshëm për realizimin e ndryshimeve dhe thyerjen me të kaluarën. Pra sensibiliteti i duhur mbi nevojën e ndryshimit. Por jo gjithmon të duash do të thotë të dish. Kusht për këtë të fundit përgjithësisht është njohja graduale dhe jo e menjëherëshme me modelin e dëshiruar dhe target të ndryshimeve. Politika vetëizoluese socio-komuniste, që me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë njohu majëne saj më të lartë, nuk e mundësonte këtë përshkallëzim njohës. Kjo ishte një sindromë nga e cila vuajti i gjithë kampi lindor dhe jo më pak Ballkani Perëndimor. Izolimi kishte pikërisht këtë qëllim: eklipsimin e modelit alternativ që blloku perëndimor ofronte. Ky element përbën detyrimisht një ndër faktorët fillestar të klasifikimit të shkallës së vështirësive që Shtetet në fjalë do tëndeshnin, për shkak të të kaluarës së tyre. Në këto kushte mospërputhja e elementeve të vullnetit për ndryshim, me kapacitetin real të brendshëm (kombëtar), e krahasuar me atë të jashtëm referencial (ndërkombëtar), përbëri deficencën e parë funksionale. Duke mbajtur parasysh sa më sipër mund të dallojmë rastet në të cilat vullneti dhe kapaciteti i brendshëm ka qenë i mjaftueshëm për futjen e parimeve kushtetuese liberale dhe ato në të cilat ndërhyrja ndërkombëtare ka rezultuar vendimtare në imponimin e parimeve të reja. Eksperiencat e Ballkanit Perëndimor janë shumë domethënëse në këtë aspekt. Sigurisht që elementi i izolimit apo i hapjes do të influenconte në ruajtjen apo ndryshimin e mentalitetit dhe kulturës institucionale të trashëguar. Kjo gjithmon në rastet kur ekzistonte një e tillë.

Në Ballkan momenti i thyerjes u identifikua me dy mënyra, të cilat shpesh ndodhën njëkohësisht: me kushtetuta të reja dhe shtete të rinj (sic ishte rasti i ish-RFSJ ku u humb legjitimiteti i shtetit federal pararendës dhe i sistemit kushtetues përkatës)

Sipas rasteve vakumi insitucional i krijuar në momentin e ndryshimit kushtëzoi spektrin e nivelit të ndërhyrjes nga jashtë, i cili shkoi nga forma më e thjeshtë e asistences deri ne imponimin total “të kushtetutave të dhuruara”.

Mund ta fillojmë me rastin e Shqipërisë e cila procesin e demokratizimit institucional nëpërmjet kushtetutës e nisi me iniciativën dhe nën presionin ndërkombëtar, e udhëhequr teknikisht nga Komisioni i Venecias.

Kosova i njohu parimet liberale nëpërmjet UMNIKU-t dhe kushtetutës së famshme provizore “*Constitutional Framework for Provisional Self Government*”, të vendosur nga Përfaqësuesi i Posacëm/Lartë i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, në vitin 2001.

Në Maqedoni, mbas Kushtetutës së vitit 1991 e cila materializoi shkëputjen nga ish-RFSJ, kriza e konfliktit etnik ndërmjet popullsisë shqiptare dhe asaj maqedonase, kushtëzoi ndërhyrjen ndërkombëtare e cila nëpërmjet të famshmit *Framework Agreement* të vitit 2001, realizoi amendimet e nevojshme kushtetuese për njohjen e garancive ndaj minorancës shqiptare.

Ndërsa rasti i Bosnies është ai në të cilin faktori ndërkombëtar njohu shkallën më të lartë të ndërhyrjes. Traktati ndërkombëtar i *Dayton*-ës i vitit 1995 shërbeu si nyje lidhëse për shpalljen e Kushtetutës Bosniake. Ajo vendosi një strukturë federative të imponuar ekskluzivisht nga faktori ndërkombëtar.

Në rastet konkrete, kushtetutat e “dhuruara nga faktori ndërkombëtar” duhet të ishin *ipso facto* ato ideale, të pajisura me parashikimet më avangard, që mbajnë parasysh zhvillimet kulturore tërësore, pararendëse dhe aktuale. Nuk ishte as kjo mundësia e shumëpritur.

Ti komunikosh një subjekti rezultatin e një ekuacioni me shumë të panjohura nuk do të thotë ti mësosh atij mënyrën se si ai zgjidhet. Mesa duket, këtë mund ta mësoj vetëm eksperiencia e jetuar në vetën e parë shumë. Pjekia e fenomenit, pra, mund të vij vetëm nga brënda e jo nga jashtë dhe sigurisht jo për arsye të pjekies së njohurive juridike të teknikienëve apo për shkak të laboratorëve më të mirë kushtetues. Fenomeni rezulton multidimensional dhe tërësisht ndërveprues në fushat e tij përbërëse.

Klasifikimi në tre blloqe i realizuar nga doktrina europiane, lidhur me qasjen ndaj konstitucionalizmin europian, tëvëndeve tëeuropës qëndrore dhe lindore, ndihmon për të kuptuar më mirë elementet deciziv të fenomenit tëtranzicionit kushtetues së formës së shtetit dhe procesin që e karakterizon.

Në grupin e parë bëjn pjesë : Polonia, Hungaria, Cekia dhe Sllovakia;  
Grupi i dytë përbëhet nga: Estonia, Lituania, Rumania dhe Bullgaria;

Ndërsa në grupin e tretë bëjnë pjesë: ish vëndete e RFSJ-së dhe Shqipëria; Në grupin e parë forma pararendëse e shtetit dhe kultura përkatëse ekonomike, juridike dhe sociale bën të mundur mbylljen e periudhës së tranzicionit kushtetues institucional në një periudhë më të shkurtër në krahasim me vëndet e tjera të ish kampit lindor. Pikërisht për shkak të karakteristikave lokale të sapo përmëndura, guida e faktorit ndërkombëtar gjatë dinamikave të tranzicionit rezultoi më efikase dhe e frytëshme.

Grupi i dytë edhe pse nën të njëjtin nivel vëmëndje të Komunitetit ndërkombëtar nuk arriti të pjekë të njëjtat rezultate. Faktori lokal pati një nivel të ndryshëm reagimi.

Duke ju referuar Ballkanit Perëndimor, nën këtë aspekt, nuk mund të mos bëjmë ndarjen e madhe, që i referohet karakteristikave dalluese të tranzicionit kushtetues, ndërmjet atij shqiptar dhe atij të ish shteteve të RFSJ-së. Karakteristikat e qasjeve të tyre me konstitucionalizmin janë të ndryshme, për shkak të problematikave të ndryshme të hasura mbas thyerjes me sistemin e shkuar.

Përsa i përket grupit të tretë doktrinat më të sipkatuara të Konstitucionalizmit të krahasur europian, duke mbajtur një pozicionim të ndryshëm dhe më optimist për Sllovenin dhe Kroacin, janë dakort mbi faktin se procesi i tranzicionit demokratik kushtetues është ende në fazën e tij të konsolidimit dhe ende larg mbylljes së tij.

Nga ndarja e mësipërme rezulton qartë se specificitetet kulturore të vëndeve të vecanta, karakteristikat e tyre dhe influencat e ndryshme, janë faktorët përcaktues të nivelit të shpejtësisë me të cilin fenomeni konsumohet.

Vetë ekzistenca e një modeli demokratiko/kushtetues europian dhe perspektiva e integritimit në të, përbëjnë më shumë se një problem në vetvete, pasi kërkojnë (këto të fundit) që Shtetet në tranzicion të përvetësojnë në një hark kohor shumë të shkurtër kultura dhe institucione të cilat në Shtetet e Europës "së vjetër", janë afirmuar dhe kanë evoluar në kohë, në menyrë graduale e duke u korrigjuar dhe rishikuar disa herë në funksion të rezultateve që ofronin.

Në një kontekst me karakteristika të tilla, tranzicioni në Europën qëndrore dhe lindore, u paraqit si një laborator i vërtet kushtetues, në të cilin shtetet me shpejtësi dhe intensitete të ndryshme sipas dinamikave të vëndeve të vecanta në tranzicion, kërkuar (dhe vazhdojnë të kërkojnë) të projektojnë dhe të realizojnë sipërmarrje kushtetuese të cilat vëndet e kontinentit të vjetër i kishin eksperimentuar dhe realizuar përgjatë më shumë se dy shekujve, me mbështetjen e një mendimi politik të artikuluar dhe duke reflektuar tradita parlamentare që kanë partur fillësën e tyre në mesjetën e lartë (herëshme).

Rezultatet finale të këtyre dinamikavevaren, pra, vetëm nga nivelet përkatëse të pjekurisë demokratike dhe kushtetuese të arritura në fazën

pararendëse të thyerjes me komunizmin dhe me institucionet ekonomike socialiste (**Sivlio Gambino**).

Në vullnetin propulsiv për të përqaftuar me ngut modelin liberalo-perëndimor influençoi ndër të tjera edhe qëllimi për të përmbushur parametrat e vendosur për hyrjen në organizmat ndërkombëtar që më shumë se gjithëshka tjetër ishin të afta të certifikonin dhe dëshmonin "ndryshimin", duke legjitimuar triumfalisht klasën politike që në atë moment ndodhej në timondhe që përgjithësisht ishte lënë në detyrë nga funksionarët e regjimit të shkuar. Në këtë kuadër sipërmarrja për formatimin e kushtetutave sipas modelit liberal jo detyrimisht duhet të përkonte me mundësinë e një zbatimi konkret të tyre.

Garantizmi në letër nuk mundësoi përhapjen e kulturës së të drejtave, të njohura dhe efektivisht të zbatuara nga Shteti, në dekadën e parë. Subjekt ky i fundit i cili deri dje ishte aktori kryesor i kufizimit dhe shtypjes së të drejtave themelore, duke filluar nga ajo e lirisë së pronës private, lirisë së fjalës, etj. Kultura e të drejtave ishte inekzistente, ajo ishte fshirë nga dekadat e dhunës psikologjike. Në shumicën e vëndeve ish-socialiste vazhdonte të mbijetonte klima kulturore e mëparëshme e favorizuar kjo edhe nga ruajtja e kontrollit politik të klasës drejtuese të sistemit të shkuar.

Mund të thuhet me bindje se premisat ishin të tilla që mundësonin ose mbështesnin tendencat për njëleximin autoritar të kushtetutave të reja ose e thën ndryshe për një modernizim përshtatës të autoritarizmit ndaj rrethanave të reja të tranzicionit. Kjo ishte edhe më lehtësisht e realizueshme, në rastet, kur zgjedhja e modelit target të tranzicionit vinte apo imponohej nga jashtë dhe jo nga brënda.

Thyerja ndodhi *de jure* dhe jo edhe *de facto*!

Përshtatja rezultoi formale ndaj parimeve të reja të sanksionuara në Kushtetutat e erës demokratike, të mbushuara me preambula dhe deklarime garantiste funksionale ndaj lirive themelore individuale dhe kolektive dhe me një ndjeshmëri të lartë ndaj parimeve universale të së drejtës ndërkombëtare dhe kartave botërisht të njohura në këtë fushë.

Tendenca drejt Presidencializmit në rajon ishte një indikator tjetër kompulsiv, i heshtur, i qasjes së ruajtjes së autoritarizmit modern, post-komunist në Ballkanin Perëndimor. Fenomeni në fjalëdo ishte një temë interesante referimi e aftë për të artikuluar e vetme trendet e para post-komuniste, por sic është parashtruar më sipër, vëmendja do të shkoje në deficitet strukturore reale dhe faktike të ndarjes së pushteteve, ku refletohen mbi të gjitha disfunksionet e gjyqësorit.

Reforma e gjyqësorit është njëelement i reformës kushtetuese i cili merr një rëndësi të vecantë në fazën ndërmjet ngritjes së institucioneve dhe konsolidimit të tyre. Ky moment i vlerësuar si ndër më delikatët e të gjithë ndryshimeve

institucionale funksionale është i aftë më shumë se të tjerët të tregojë nivelin e metabolizimit social dhe institucionale të reformës dhe në vecanti mbarëvajtjen e procesit të tranzicionit.

Pavarësisht vecorive lokale, analiza e reformave të gjyqsorit në tranzicionin kushtetues të Ballkanit Perëndimor paraqet disa makro karakteristika të përbashkëta, si për shëmbull: ndërhyrja ndërkombetare kostante dhe sektoriale (me tendence reformimin kodistik), predispozicioni për dhënien e zgjidhjeve efikase në "laborator", pa mbajtur parasysh kontekstin specifik lokal dhe kapacitetin e tij reagues.

Ndërhyrjet jo homogjene dhe tendeca e theksuar për të korrigjuar "në letër" devijimet funksionale të lidhura me përqëndrimin e pushtetit krijuan konfuzion normativ. Kultura inegzistuese e ndarjes së pushteteve dhe mbetjet normative të sistemit të shkuar krijuan shpesh rezultate kontradiktore (**Francesco Palermo**).

Ndërhyrja ndërkombetare krijoi shpesh blloqe të mëdha normative, brënda zyrave të mbyllura, nga ekspertët perëndimor, të cilët shpesh mjaftoheshin me një transplant të thjeshtë të modeleve normative të vendeve nga të cilat vinin, që kishin një probabilitet të ulët funksioni rregullator në terren për shkak të kontekstit të ndryshëm ekonomik, social dhe kulturor.

Pra problemi thelbësor nuk ishte mungesa e normave dhe as kapaciteti i tyre teknik, sesa përputhshmëria e tyre me kapacitetin përthithës të kulturës insitucionale.

Ankthi dhe nxitimi i komuniteti ndërkombëtar për të stabilizuar shpejt rajonin dhe për të shkurtuar periudhën e tranzicionit pati efekte kolaterale negative në nivel imunitar edhe në fushën e reformave të gjyqsorit (**Jens Woelk**).

Në këtë aspekt do të mbetet emblematike shprehja e Përfaqësuesit të Lartë të OKB-së, në Bosnie, Lord-it Ashdown : *"Më mirë të bëhen gjërat me ngut, sesa të bëhen në mënyrë perfekte"*.

Problemet më të prekshme dhe imediate u rregjistruarn në:

- fushën e pavarësisë dhe autonomisë së gjyqsorit;
- fushën e influencës ndërhyrëse të ekzekutivit;
- pavarësisë nga politika;
- emërimin, promovimin dhe shkarkimin të magjistratëve;
- përgjegjësisë profesionale dhe disiplinore;
- imunitetin e magjistratëve;
- pavarësinë ekonomike;
- besimin e qytetarëve ndaj sistemit të drejtësisë; etj.

Mospërputhja ndërmjet të dëshiruarës (në letër) dhe të realizuarës (në terren) në nivelin kushtetues, sidomos në hallkën më të rëndësishme të ndarjes së pushteteve, në pavarësinë dhe autonominë e gjyqsorit, krijoji plagën më të

rëndë sociale të Ballkanit Perëndimor në dy dekadat e fundit: korrupsionin e sistemit të drejtësis dhe një kriminalitet të theksuar.

#### 4. KONKLUZIONE.

Kultura institucionale totalitare njohu si shkallë të parë të zbutjes së saj, atë institucionale autoritare. Prej këtij momenti procesi i evoluimit institucional rezultoi më i vështirë. Stacioni i rradhës mbas autoritarizmit, një formë hibride ndërmjet kësaj të fundit dhe institucionalizmit demokratiko-konstitucionalist sektorial, në Ballkanin Perëndimor, rezultoi më i preferuari!

Kjo fazë e tranzicionit kushtetues rezulton më e gjata dhe me elementë ende të pranishëm: i quajtur ndryshe konstitucionalizmi i fasadës. Tranzicioni kushtetues në Ballkanin Perëndimor vuri përballë dy faqe të të njëjtës medalje: Konstitucionalizmin *de facto* dhe atë *de jure*.

Lindja i lakmoi perëndimit mirëqenien duke i nënvlerësuar funksionet rregullatore sociale që e kishin mundësuar atë dhe që qëndronin në themel të saj. Kjo garë për t'ju afruar standarteve perëndimore duke mos kuptuar, mospërfillur, mosvlerësuar elementët që e kishin ngritur (ndër to me kryesori: konstitucionalizmi) tregoi distancën kulturore ende të thellë që qëndron ndërmjet dy realiteteve.

Kriza ekonomike që ka mbështjellë hapësirën europiane më shumë dëme se në fushën ekonomike pritet të sjellë në atë vështirësisht të rekuperueshme të hapësirës të drejtave dhe garancive, të cilat dhe pse po trajtohen në nivel normativ dytësor janë të afta të thyjen kollonat mbajtëse të tempullit të demokracisë së kontinentit të vjetër.

Ndërkohë që vëndet e ballkanit perëndimor, të fundit në listën e tëftuarve në tryezën e hapsirës së përbashkët europiane (për arsye të pasqyruara më sipër), nxitojnë të përmbushin "në letër" detyrimet për aderimin e shumë kërkuar, për të dalë në këtë mënyrë "gjithmonë në letër" nga tuneli i tranzicionit, vetë BE-ja dhe vëndet anëtare për shkak të krizës dhe dinamikave globalizuese janë duke zbehur dita ditës shkëlqimin e forcës së tyre garantiste-konstitucionaliste. Jo detyrimisht në fushat e trajtuara më sipër. Me këtë trend, ka probabilitet të lartë që vëndet e mbetura jashtë, të arrijnë më shpejt finishin BE, jo sepse të afta për tëridrejtuar në momentin e fundit aksin e devijuar tëkonstitucionalizmit dhe të shtetit të së drejtës, por sepse është vetë BE-ja ajo që po ul stekën e parametrave të saj të sipërpërmëndur, e detyruar nga rrethana që gjithnjë e më shume duket se nuk do të jenëkalimtare, ashtu sic të gjithë në kontinent, besoj se shpresojnë.

Fizionomia e strukturave mbikombëtare (BE) duket se kërkon gjithnjë e më shumë një Kushtetute pa Shtetin si referues të parë dhe funksional. Lënda e

parë e konsumit të këtij mekanizmi rezulton pikërisht sovraniteti.

Mbetet vështirësisht e shjegueshme gjithë kjo ngutje që karakterizon sot zhvillimet planetare. Personalisht vlerësoj se konsumizmi si “besimi i madh i shoqërisë postmoderne” nuk mjafton për ti dhënë njëjustifikim racional prirjeve aktuale.

#### BIBLIOGRAFIA:

- **Ajani**, Le fonti non scritte nel diritto dei Paesi socialisti, Milano, 1985;
- **Ajani, Monateri**, Casi e Materiali di Diritto Comparato, Giappichelli, 1998;
- **Ajani** (a cura di),Casi e Materiali di Sistemi Giuridici Comparati, Giappichelli, 2001;
- **Andò**, Il declino della neutralità nell’attuale fase del costituzionalismo europeo, Padova, 2002;
- **Barany, Volgyes**,The Legacies of Communism in Eastern Europe, Baltimore-London, 1995;
- **Bardusco, Furlan & Co**,Costituzioni Comparete, Giappichelli, Torino, 2013;
- **Bartole**, Riforme costituzionali nell’Europa centro-orientale, Bologna, 1993
- **Bartole,Grilli di Cortona** (a cura di), Transizione e consolidamento democratico nell’Europa centro-orientale. Torino, 1998;
- **Baylis**, Presidents versus Prime Ministers: Shaping Executive Authority in Eastern Europe, in “World Politics”, 1996;
- **Berti**, Democrazia, pluralismo e sistema economico (le Costituzioni e l’Unione Europea), in “Jus”, 1997;
- **Beetham**, Conditions for Democratic Consolidation, 1994.
- **Bidegaray**, Réflexions sur la notion de transition démocratique en Europe - centrale et orientale, in “Pouvoirs”, 1993 ;
- **Biscaretti Di Ruffia, Ganino**, Costituzioni straniere contemporane. Le Costituzioni di sette Stati di recente ristrutturazione, Milano, 1996;
- **Bockenforde**, Il potere costituente del popolo: un concetto limite del diritto costituzionale, in AA. VV. (a cura di **Zagrebelsky, Portinaro, Luther**), Il futuro della Costituzione, Torino, 1996;
- **Botoucharova, Djerov**, “Fondamenti costituzionali e legislativi del periodo post-comunista nella Repubblica di Bulgaria”, in Quaderni costituzionali, 1992;
- **Bryant, Mokrzycki**,The new great transformation? Change and continuity in East Central Europe, London-New York, 1994;
- **Brzezinski**, Costituzionalismo e transizioni democratiche. Ascesa e caduta del comunismo nel XX secolo, 1989, La grande scacchiera, Milano, 1998;
- **Calamo, Carli, Di Plinio, Toniatti**,(a cura di)I Balcani occidentali. Le costituzioni della transizione,2008;

- **Camerlengo**, Contributo ad una teoria del diritto costituzionale cosmopolitico, Milano, 2004;
- **Carducci** (a cura), Il Costituzionalismo Parallelo delle Nuove Democrazie, Giuffrè, Milano, 1999;
- **Cassese, Guarino**, Dallo Stato monoclasse alla globalizzazione, Milano, 2000;
- **Ceterchi**, «Les problèmes institutionnels de la transition en Roumanie», in Reo, *ét comp. Est-Ouest*, 1992;
- **Cuccodoro**, Incognita di una transizione costituzionale, Lacaita Editore, 1994;
- **De Fiores**, L'Italia ripudia la guerra? La Costituzione di fronte al nuovo ordine globale, Roma, 2002;
- **De Vergottini**, Le transizioni costituzionali, Bologna, 1998;
- **De Vergottini**, Diritto costituzionale comparato, Padova;
- **Di Palma**, Le transizioni democratiche in Europa Orientale. Una prospettiva futura, in "Rivista italiana di scienza politica", XX, 1990;
- **Dimani**, Le Costituzioni Economiche dei Balcani Occidentali, CEDAM, 2009;
- **Dobry**, «Les transitions démocratiques. Regards sur l'état de la 'transitologie'», *Revue française de science politique*, 2000;
- **Elster**, Constitutionalism in Eastern Europe: An Introduction, in "The University of Chicago Law Review", 1991;
- **Fejto**, La fine delle democrazie popolari. I: Europa orientale dopo la rivoluzione del 1989, Milano, 1994;
- **Gambino** (a cura di), Democrazia e forme di governo. Modelli stranieri e riforma costituzionale, Rimini, 1997;
- **Gambino** (a cura di), Europa e Balcani: Stati, culture, nazioni, Padova, 2001;
- **Gambino**, Il diritto costituzionale europeo: principi strutturali e diritti fondamentali, in AA. VV. (a cura di **Gambino**), Costituzione italiana e diritto comunitario, Milano, 2002;
- **Gambino** (a cura di), Costituzionalismo europeo e transizioni costituzionali, Milano, 2003;
- **Gambino**, Diritto costituzionale comparato ed europeo, Milano, 2004;
- **Ganino**, Democrazia e diritti nelle costituzioni dei paesi dell'Europa orientale, in **Ganino, Venturini** (a cura di), L'Europa di domani: verso l'allargamento dell'Unione, Milano, 2001;
- **Gelard**, Rapport de synthèse, in **Milacic** (a cura di), La démocratie constitutionnelle en Europe centrale et orientale et perspectives, Bruxelles, 1999;
- **Gouaud**, Recherches sur le phénomène de transition démocratique, in "Revue du droit public", 1991;
- **Grilli di Cortona** (a cura di), Transizione e consolidamento democratico nell'Europa centro-orientale. Elites, istituzioni e partiti, Torino, 1998;
- **Guida** (a cura di), L'atra metà del continente. L'Europa centro orientale dalla formazione degli Stati nazionali all'integrazione europea, Padova, 2003;

- **Holmes**, *Post-communism. An introduction*, Cambridge, 1997;
- **Holmes, Sunstein**, *The Cost of Rights. Why Liberty Depends on Taxes*, New York, 1999, ed. it. con presentazione di **C. Fusaro**, Bologna 2000;
- **Jellamo**, *Il nazionalismo tra la politica e la guerra*, in AA. VV., (a cura di **Gambino**), *Europa e Balcani: stati, culture, nazioni*, Padova, 2001;
- **Jiménez Asensio**, *El constitucionalismo*, Oliati, 2001;
- **Lanchester** (a cura), *Le Costituzioni degli Altri*, Giuffrè, Milano, 2012;
- **Kymlicka, Opalski** (a cura di), *Il pluralismo liberale può essere esportato? Teoria politica occidentale e relazioni etniche nell'Europa dell'Est*, Bologna, 2003;
- **Linz, Stepan**, *I: Europa post-comunista*, Bologna, 2000;
- **Linz, Stepan**, *Transizione e consolidamento democratico*, Bologna, 2000;
- **Manzella**, *L'identità costituzionale europea*, in *Studi in onore di Leopoldo Elia*, vol. II, Milano, 1999;
- **Manzella, Melogran, Paciotti, Rodotà**, *Riscrivere i diritti in Europa*, Bologna, 2001;
- **Massias**, *Droit constitutionnel des Etats d'Europe de l'Est*, Paris, 1999 ;
- **Mezzetti**, *Transizioni costituzionali e consolidamento democratico nell'Europa centro-orientale*, in *I, Le democrazie incerte. Transizioni costituzionali e consolidamento della democrazia in Europa orientale, Africa, America, Latina, Asia*, Torino, 2001;
- **Mezzetti**, *“Teoria e prassi delle transizioni costituzionali e del consolidamento democratico”*, CEDAM, 2003;
- **Milacic**, (a cura), *La démocratie constitutionnelle en Europe centrale et orientale. Bilans et perspectives*, Bruxelles, 1998 ;
- **Milacic**, *Les ambiguïtés du constitutionnalisme post-communiste*, in AA. VV., *Le nouveau constitutionnalisme. Mélanges, en l'honneur de Gérard Conac*, Paris, 2001;
- **Milacic**, *La réinvention de l'Etat: démocratie politique et ordre juridique en Europe centrale et orientale*, Bruxelles, 2003;
- **Montanari, Toniatti, Woelk** (a cura di), *Il pluralismo nella transizione costituzionale dei Balcani: diritti e garanzie*, Trebto, 2010;
- **Morlino**, *«Architectures constitutionnelles et politiques démocratiques en Europe de l'Est»*, *Revue française de science politique*, 2000;
- **Nikolic**, *I sistemi costituzionali dei nuovi stati dell'ex-Iugoslavia*, Torino, Giappichelli, 2002 ;
- **Palici Di Suni, Comba, Cassella** (a cura di), *Le Costituzioni dei paesi della Unione Europea*, Padova, 1999;
- **Petrovié, Russo** (a cura di), *L'altra Europa. L'Europa centrale e i Balcani verso l'Unione Europea*, Edizioni scientifiche italiane, Napoli, 1998;
- **Ponthoreau**, *Droit(s) Constitutionnel(s) Comapré(s)*, *ECONOMICS*, 2010;
- **Prlic**, *Fuga dalla storia. Il paradigma “pace-sviluppo-democrazia” nel post-comunismo e nei dopoguerra dei Balcani*, Clueb, Bologna, 2000;
- **Rinella**, *Le Carte costituzionali quali strumento delle transizioni. L'esperienza dei Paesi dell'Europa centro-orientale*, in **Pegoraro, Rinella**,

- Introduzione al diritto pubblico comparato, Metodologie di ricerca, Torino, 2002;
- **Russo** (a cura), *L'altra Europa? L'Europa centrale e i Balcani verso l'Unione Europea*, Napoli, 1998;
  - **Spadaro**, *Le 'trasformazioni' costituzionali nell'età della transizione*, Torino, 2000;
  - **Stein**, *Post-communist Constitution making: confession of a comparatist*, Firenze, 1992;
  - **Suksi**, "Ondate baltiche? L'evoluzione costituzionale di Estonia, Lettonia e Lituania", in *Quaderni costituzionali*, 1992;
  - **Teotonico**, *Riflessioni sulle transizioni. Contributo allo studio dei mutamenti costituzionali*, in *Rivista AIC*, 3/2014;
  - **Toniatti, Palermo** (a cura di), *Il processo di costituzionalizzazione dell'Unione Europea. Saggi su valori e prescrittività dell'integrazione costituzionale sovranazionale*, Trento, 2004;
  - **Vickers**, *The Albanians: a modern history*, Tauris, London, 1999;
  - **Woelk**, *La transazione costituzionale della Bosnia ed Erzegovina*, Trento, 2008;
  - **Ziccardi, Capaldo** (a cura di), *Democratizzazione all'Est e diritto internazionale*, Napoli, Edizioni scientifiche italiane, 1998;

# SIKUR PARSONS TË VIZITONTE KËTO DITË SHQIPËRINË: DREJTËSIA DHE PROCESI I INTEGRIMIT EUROPIAN TË VENDIT TONË.

Fatmir Zanaj  
University of Tirana  
fzanaj@gmail.com

## ABSTRACT

*Primarily in Europe, in the early decades of the 20th century, and later in the U.S.A. during the 1950s, sociologists boldly approached the phenomena of law and the justice system to examine and understand the place and role of law on the functionality of a liberal democratic society in its evolution into the modern age. From this intellectual effort emerged the science of Sociology of Law. However, in Albania, the development of Sociology of Law, as well as Sociology itself, have progressed entirely different. The lack of traditional sociological studies hindered the extension of sociological study in areas so critical to society, whether it be totalitarian or hybrid democracy, such as law and politics.*

*In this paper I shall attempt to highlight, from the sociological point of view, the role and place of law in Albanian society, which is currently embarked on the process of European integration. The role of law and of the legal profession will be highlighted based on ideas expressed by the great American sociologist, Talcott Parsons. His ideas on integrative latent functions of law in a democratic society and the role of the legal profession in solving problems of stability and of democratic social progress will be highlighted. I will try to analyze the following hypothesis: The present difficulties in law and the legal profession which have affected and continue to affect our country's process of integration into the European Union, are associated with inherited deficiencies of the Albanian legal tradition and the lack of expertise in some segments of the legal profession that is present in our society.*

**Keywords:** EU, Albania, integration

## I

60 vjet më parë, në fillim të viteve 1950-të Talcott Parsons shprehej i pakënaqur me paradoksin e konstatuar prej tij se grupi i rëndësishëm profesional

i juristëve, i avokatëve dhe i profesorëve të së Drejtës, - të famshëm në kohët moderne po aq sa edhe dikur në perandorinë romake, të konsideruar si grupi profesional që përbën avangardën e zhvillimit të shkencës dhe të fushave të ndryshme të praktikës juridike, të arsimit të njerëzve dhe të administrimit nga ana e tyre në mënyrë besnike të traditave legale, - nuk zënë një vend të rëndësishëm në asnjë nga sistemet ideologjike konkurruese të epokës sonë (deri në vitin 1989 qëndronin përballë njëri-tjetrit sistemi kapitalist dhe ai komunist).<sup>140</sup>

Sigurisht, Parsons nuk i vinte në një balancë të dy sistemet e asaj kohe, por në momentet që ai shprehte atë pakënaqësi sociologë të ndryshëm konstatonin disa prirje në shoqërinë amerikane të viteve 40-50 që mund të përbënin një kërcënim për demokracinë. Në një studim të rëndësishëm mbi të ashtuquajturën elitë pushtetore të shoqërisë amerikane të vitin 1956, "Elita e pushtetit", C. Wright Mills argumentonte se tipari kyç i jetës shoqërore amerikane të shekullit të 20-të ishte përqendrimi dhe centralizimi i pushtetit në duart e një numri të vogël grupesh të elitës, ku përfshiheshin elita ekonomike, elita politike dhe ajo ushtarake, ndërsa grupi profesional i juristëve zihej në gojë vetëm në rolin e zbatuesit të thjeshtë të komandave të elitës.

Sikur Parsons të vizitonte këto ditë vendin tonë, përshtypjen e parë të keqe atij do t'i bënte pikërisht ndikimi i madh i politikës mbi sistemin e drejtësisë, politizimi partiak i tij. Talcott Parsons shpaloste një tjetër perspektivë. Duke e konsideruar sistemin shoqëror si një nga katër komponentët primarë të sistemeve të përgjithshëm të veprimit, ai e vendoste sistemin ligjor në fokusin e sistemit shoqëror, ndërsa si fokus të sistemit ligjor ai konsideronte gjykatat, pushtetin gjyqësor. Për Parsons vendi i gjykatave ndodhet në "qendrën e qendrës së komunitetit societal", siç shprehej ai, duke kuptuar me termin "societal" komunitetin e vetëdijshëm për vlerat e përbashkëta. Pavarësisht nga dallimet midis sistemit ligjor kontinental evropian dhe atij amerikan, në një shoqëri demokratike strukturat e sistemit ligjor, - pjesërisht zyrtare e autoritare dhe pjesërisht private, - shtrihen nga zemra në periferinë e shoqërisë, dhe në shumë çështje penetrojnë në strukturat informale të komunitetit societal, duke qenë bazë e fuqishme e integritit të tij.

Sipas mendimit parsonian, këtë rol e luan sistemi ligjor që ka disa karakteristika themelore. Së pari, është një sistem legjitim, i mbështetur në një shoqëri demokratike nga komuniteti societal që krijon kornizën legjitime të tërësisë së hierarkisë së gjykatave, në kuadrin e të cilës partitë, që shqetësohen për mbrojtjen e interesave të tyre, mund të koeporojnë për të përshtatur interesat e tyre respektive në kuadrin e interesave të mbarë shoqërisë. Së dyti,

140 Talcott Parsons, A Sociologist looks at the Legal Profession, në librin Talcott Parsons on Law and Legal System, by A. Javier Treviño, f. 305-306.

është sistemi i gjykatave relativisht të pavarura nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv i qeverisjes. Së treti, është sistemi ku gjykatat përbëjnë një makineri institucionale autonome për zgjidhjen e debateve dhe konflikteve të shumtë të interesave në mbarë shoqërisë. Së katërti, një sistem i tillë ligjor e gjyqësor, përmes funksionit interpretativ dhe sanksionues, vepron si instrument i kontrollit shoqëror, i integritetit dhe i stabilitetit demokratik të shoqërisë.

Juristi, sipas tablosë që vizaton për të Talcott Parsons, edhe është edhe nuk është i varur nga shteti. Ligjet që administron e aplikon ai, miratohen nga organizmat ligjvënës të qeverisjes. Edhe vetë avokati mund të konsiderohet një “zyrtar i gjyqit”, ai e fiton këtë të drejtë dhe mund ta humbasë atë në raportet që krijon me shtetin. Por ai i përket edhe një profesion të pavarur nga autoriteti politik. Edhe vetë gjyqtarët, duke qenë zyrtarë publikë, konsiderohen e trajtohen si një klasë e veçantë me imunitete të posaçme. Madje avokati nuk paguhet direkt nga autoriteti publik, por nga klientët e tij. Shoqatat e tyre nuk janë organe të shtetit, por shoqata private të anëtarëve të tyre themelues, të cilat në Perëndim, sidomos në SHBA, janë shumë të rëndësishme edhe në përgatitjen e kualifikimin e juristëve, të konsideruara si pjesë përbërëse e universiteteve.. Profesion i ligjor është një njësi shoqërore që penetron me punën e vet në kufijtë midis kapaciteteve e të përgjegjësive private dhe publike.<sup>141</sup>Falë monopolit që gëzojnë në interpretimin e ligjit dhe në zgjidhjen e konflikteve gjyqësore, grupi profesional i gjyqtarëve në shoqërinë demokratike me shtet ligjor operon në një hapësirë të konsideruar neutrale që synon të neutralizojë palët e interesuara në konflikt përmes nënkuptimit të distancimit simbolik nga ngjarja reale dhe konvertimit të luftës të drejtpërdrejtë midis palëve në dialogun midis mediatorëve profesionistë. Karakteristikë e sjelljes së profesionistëve të vërtetë në këtë “hapësirë juridike” janë qëndrimet sa asketike dhe njëherësh aristokratike, - shprehje e ndërgjegjësuar e kërkesave për paanësi, - që shpallen të nevojshme dhe vazhdimisht u sillen në kujtesë si model sjelljeje dhe e etikës profesionale atyre kolegëve që e heqin këtë maskë dhe fare hapur futen në allishverishe financiare apo prononcohen për çështje politike. Është ky rrezik që i bën profesionistët e ligjit, si shprehje Parsons të bëhen lehtë “kokë turku” mjaft e përshtatshme për grupe të ndryshme të shoqërisë.<sup>142</sup>

Këtë funksion shoqëror të profesionistëve ligjorë Talcott Parsons e krahason me atë të mjekut në strukturën e shoqërisë. Ashtu si mjeku e përgatit pacientin që të përballet me realitetin e fakteve të sëmundjes së vet, edhe avokati, në pozicionin e tij të pavarur, duke mbrojtur si interesat e klientit edhe ato të “Ligjit”, ndërton mekanizma që zbutin presionet shoqërore e private mbi të, duke qenë kështu njëherësh as thjesht një nëpunës civil në shërbim të

141 Talcott Parsons, A Sociologist looks at the Legal Profession, vep. e cit., f. 308, 312

142 Shih Talcott Parsons, po aty, f. 306.

klientit, ndonëse përfaqëson interesat e tij, as shërbyes i ndonjë grupi tjetër apo i autoritetit publik.<sup>143</sup>

Nëse Parsons do të vizitonte Shqipërinë e ditëve tona, sipas mendimit tim, vlerësimet e tij do të ishin, në disa drejtime shumë pozitive, por në disa të tjerë, - edhe kritike lidhur me vendin dhe rolin e sistemit të së Drejtës në shoqërinë tonë dhe kontributin e saj në integrimin europian të shqiptarëve. Është shumë pozitiv fakti se në kuadrin e reformave të kryera në vendin tonë në sektorin e Drejtësisë, rregullat institucionale që përcaktojnë natyrën e raporteve politikë-drejtësi, - pra rregullat e emërimit në detyrë dhe të kontrollit demokratik mbi gjyqësorin, - përgjithësisht janë hartuar me konsensusin e tërë forcave politike dhe gëzojnë mbështetjen e tyre institucionale. Por, nga ana tjetër, Shqipëria i përket listës së vendeve ish-komuniste të Europës lindore e juglindore dhe shfaq po ato probleme që janë vënë në dukje nga studiuesit europianë në çështjet e hartimit dhe zbatimit të atyre rregullave të emërimit, të promovimit e të shpërblimit të gjyqtarëve, të cilat, në nivele të ndryshme në këto vende, shfaqet ndikimi i mazhorancave politike të radhës në kompozimin e përbërjes së gjykatave të të gjitha shkallëve, evidentohet tendenca për të futur në ato struktura gjyqtarë që nga preferencat e tyre të jenë më pranë kësaj apo asaj mazhorance në fuqi, duke bërë që vendimet e atyre gjykatave të vuajnë shpeshherë nga anshmëria politike.<sup>144</sup>

Pa dashur të mohojmë arritjet e mëdha dhe transformimet e thella që ka pësuar sistemi ligjor në vendin tonë këto 25 vjetët e fundit, raste të ndryshëm në marrëdhëniet politikë-drejtësi dëshmojnë se ende ka probleme, zgjidhja e të cilëve do të forconte më tej sistemin e Drejtësisë të ne dhe do të përshpejtonte hapat në integrimin e Shqipërisë në Europë. Shembuj të ndryshëm nga përvoja e këtyre dy dekadave të fundit, kur në pushtet janë alternuar dy partitë kryesore të vendit, PDSH dhe PSSH, e ilustronjë këtë. Le të përmendim për shembull rastin e sulmeve të ekzekutivit socialist kundër prokurorit të përgjithshëm në vitin 2002, shkarkimin e tij nga detyra prej Kuvendit të Shqipërisë edhe me votat e opozitës së atëhershme demokratike. Ky rast të kujton shkarkimet nga funksionet e larta në sistemin e Drejtësisë të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit nga shumica demokratike në Kuvendin e Shqipërisë, respektivisht në shtator 1992 dhe në shtator 1995. Edhe me i turpshëm ishte shkarkimi i Prokurores së Përgjithshme Ina Rama në fund të nentorit 2012, duke i mohuar asaj edhe përfshirjen e mëtejshme në sistemin e Drejtësisë. Veprime të tilla, që sipas Jurgen Habermasit përbëjnë prirje të "kolonizimit" të fushës të së Drejtës prej politikës, janë të ngjashme me akte

143 Talcott Parsons, A Sociologist looks at the Legal Profession, vep. e cit., f. 314-315.

144 Shih Pedro C. Magalhaes, The Politics of Judicial Reform in Eastern Europe, Comparative Politics, Vol. 32, No. 1 (Oct., 1999), f. 43-62

të tilla në Poloni, Hungari dhe Bullgari, para se këto vende të integroheshin në BE, të kryera prej sjelljes arrogante të mazhorancave të djathta apo të majta, pikërisht ndaj atyre juristëve që gjykohej se nuk mbronin interesat e shumicës parlamentare të radhës.

Nisur nga mendimi parsonsian, mendoj se vendi dhe roli i së Drejtës në kuadrin e integritit evropian të Shqipërisë duhet analizuar nga ky aspekte: së pari, në çfarë niveli përafrohet tradita juridike shqiptare me traditën juridike europiane, dhe së dyti, nga shkalla e zhvillimit të ekspertizës në masën e juristëve të vendit tonë.

Tradita juridike e vendeve të BE-së sot mbështetet si në traditën romake edhe në atë europiane të Mesjetës së vonë, të ripërtërirë në veçanti në universitet italiane të periudhës së Rilindjes, kur në republikat shekullare të kohës juristët ruanin një lloj pavarësie përkundrejt pushtetit politik. Sipas asaj tradite, - që është zhvilluar e pasuruar më tepër në kohët moderne, - juristi, edhe pse në shumë drejtime ishte në shërbim të princërve dhe varej prej tyre, ishte në një farë mase një lloj eksperti i pavarur, dhe doktrinën e kohës mbi ligjin nuk ishin kurrësi thjesht një mënyrë e veçantë e shprehjes së interesave të pushtetit të eprorëve të tij politikë.

Po në Shqipëri çfarë tradite juridike trashëgojmë? A e ndihmon kjo traditë procesin e integritit evropian të Shqipërisë? Unë mendoj se kjo pyetje e fundit merr përgjigje pozitive, pavarësisht nga problemet që ka tradita jonë juridike. Si nga historia jonë e vjetër edhe nga historia moderne, në rast se do të flasim sot për traditë juridike në Shqipëri, duhet të pranojmë se ajo paraqitet e fragmentuar dhe plot dritë-hije. Kjo për arsye se përpjekjet pozitive të bëra gjatë periudhës së monarkisë zogiste ishin të pafuqishme për të shmangur prapambetjen e thellë gjysmë-feudale kulturore e juridike të vendit. Me gjithë hopin e madh formal, të realizuar gjatë tri dekadave të para të regjimit komunist në arsimin juridik dhe krijimin e një plejade të gjerë juristësh brenda vendit, erdhi dekada e reformave ultramajtiste, në vitet 1966-1976, që shënoi përçudnimin e sistemit juridik në Shqipëri, ideologjizimin ekstrem të tij. Që nga viti 1966 në Fakultetin e Drejtësisë u fshi nga kurrikula universitare lënda e së Drejtës Romake. Ideologjizimi ekstrem i sistemit të Drejtësisë u manifestua me futjen e boshtit ideologjik në arsimimin juridik universitar, në likuidimin e avokatisë, në suprimimin e Ministrisë së Drejtësisë, që ishte zemra dhe truri i sistemit të drejtësisë dhe që luante rol të pazëvendësueshëm në procesin e kodifikimit ligjor etj. Në Kushtetutën e vitit 1976 u fiksuan që në kreun e parë nenet se "Shqipëria është vend i diktaturës së proletariatit", se "PPSH është forca e vetme udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë", duke fiksuar këtu nga pikëpamja kushtetuese idenë enveriste se "partia është në komandë" kudo, në çdo sektor të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare. Fetishizimi i rolit të Partisë-

shtet në jetën e vendit bëri që tradita legale shqiptare e krijuar në dy dekadat e fundit te ekzistencës së regjimit komunist të ngjizej nën ndikimin e mentalitetit se “direktiva e partisë qëndron mbi ligjin”, - mentalitet ky që deformonte rëndë edhe praktikën juridike, zbehte rolin e interpretimit gjyqësor dhe dobësonte shumë pozitën e statusin e gjyqtarëve në shoqërinë tonë, në kundërshtim të plotë me teorinë e praktikën demokratike liberale perëndimore të pavarësisë së sistemit ligjor dhe të sundimit të ligjit në shoqëri, apo thënë ndryshe, “the Rule of Law”.

Ndryshe nga regjime të tjerë autoritarë, si ata në Spanjë, në Portugali dhe në Kili në vitet 70-të të shekullit të kaluar, që përfituan nga adoptimi i së Drejtës perëndimore, nga zhvillimi i një arsimi juridik të përparuar dhe nga një nivel i ulët i politizimit të aparatit shtetëror, në vendet komuniste të Europës Lindore e Juglindore aparati gjyqësor ishte tërësisht i politizuar. Erozioni nihilist ligjor i kufijve midis së Drejtës dhe politikës, si dhe nënshtrimi i gjyqtarëve dhe i vendimeve të tyre ndaj direktivave të Partisë, lanë pas një trashëgimi të deformuar kulturore e institucionale juridike.<sup>145</sup> Në atë situatë të ideologjizimit ekstrem, institucionet e Drejtësisë nuk mund të shfaqnin në shoqëritë ish-komuniste në gjithë gjerësinë e vet ato avantazhe që sociologët i konsiderojnë “funsione latente” të institucioneve shoqërore.

Aq e rëndë dhe antidemokratike sipas standardeve perëndimore ishte trashëgimia staliniste në Shqipëri, sa edhe pas pesë vjetëve të përmbysjes së regjimit komunist organizata ndërkombëtare Human Rights Watch në raportin e vet të vitit 1996 mbi Shqipërinë konstaton: “Ende edhe pas pesë vjetëve nuk është zhdukur aq sa do të duhej trashëgimia e sundimit të Enver Hoxhës. Mungesa e plotë e gjykatave të pavarura gjatë regjimit të shkuar komunist, mungesa e mekanizmave të medias së lirë dhe e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, paraqitet si një sfidë e vërtetë për demokracinë e sotme shqiptare. Çfarë është më serioze, ende vazhdon të jetë e rrënjosur te shumë liderë në vend mentaliteti i sistemit njëpartiak: kritikët e kundërshtarët e Partisë Demokratike në pushtet shihen shpesh si kundërshtarë të “demokracisë”. Si rrjedhojë, qytetarët shqiptarë ende vuajnë nga shkelje serioze të të drejtave të njeriut, nga kufizime të lirisë së shprehjes dhe të bashkimit në shoqata, nga manipulimi i sistemit ligjor dhe nga dhuna e policisë”.<sup>146</sup>

Megjithëse procesi i transformimit të sistemit tonë të drejtësisë ka bërë shumë hapa përpara këto 25 vjetët e fundit në drejtim tëndërtimit strukturor dhe të funksionimit të tij, është e natyrshme që të manifestohen edhe mangësi

145 Shih Pedro C. Magalhaes, *The Politics of Judicial Reform in Eastern Europe*, Comparative Politics, Vol. 32, No. 1 (Oct., 1999), f. 45

146 Human Rights in Post Communist Albania, Human Rights Watch 1996. Lexuar në mars 2010 në: <http://www.unhcr.org/cgi-bin/texis/vtx/refworld/rwmain?page=search&amp>

e mosrealizime të përkohshme, që pritet të kapërcehen në muajt e vitet në vazhdim. Të tilla mangësi e dobësi të sistemit tonë të Drejtësisë janë vënë shpesh në dukje edhe prej institucioneve monitoruese ndërkombëtare, që vëzhgojnë me kujdes hapat e hedhura nga vendi ynë në procesin e përafrimit me vlerat, traditat dhe institucionet politike e juridike komunitare dhe të integritit evropian të tij, siç i konstatojmë në progres-raportet e vitit 2009 e 2014 të BE mbi Shqipërinë.

Në Progres-raportin e vitit 2009, ndër të tjera shkruhej: “Kultura e dialogut ndërmjet partive politike u përqësua para zgjedhjeve. Kjo pengoi progresin e reformave në fusha kyçe, siç është gjyqësori. Sesioni i fundit parlamentar nuk arriti të miratonte ligje kyçe për shkak të bojkotit të disa partive politike”; “Përpyekjet e qeverisë për të zvogëluar pavarësinë e gjyqësorit, politizuan debatin për reformën në gjyqësor dhe penguan progresin”; “procedurat e gjykatave mbeten problematike për sa i takon eficiencës dhe transparencës”; “Në përgjithësi, reforma në gjyqësor mbetet në një fazë fillestare. Nuk janë miratuar akte ligjore që janë kyçe për plotësimin e kuadrit ligjor. Sistemi i drejtësisë vazhdon të funksionojë dobët për shkak të mangësive në pavarësi, transparencë dhe eficiencë, që janë prioritete kyçe të Partneritetit Evropian që duhen përmbushur.”<sup>147</sup>

Në traditën juridike dhe sociologjike perëndimore përmirësimi i situatës konfliktuale mes aktorëve politikë të shoqërisë perceptohet si funksioni themelor i ligjit. E Drejta sipas këndvështrimit parsonsian është një mekanizëm integrues. Integrimi ligjor i komunitetit edhe në rrafshin mbikombëtar është një ide e vjetër e përpunuar edhe në këndvështrimin origjinal neofunksionalist të Ernst Haas në fund të viteve 1950-të. Sipas këtij këndvështrimi, përmbajtja e integritit ligjor të komunitetit është në thelb procesi i penetrimit gradual të së Drejtës së BE-së në të Drejtën kombëtare të vendeve anëtare dhe kandidatë të Europës së Bashkuar. Në rastin e Shqipërisë, një aspekti këtij procesi është përafrimi i legjislacionit tonë me *Acquis communautaire*. Sipas studiuesve evropianë ky proces ka dy dimensione kryesore. I pari është dimension i penetrimit formal, shtimi në të Drejtën kombëtare të akteve ligjore të tipit mbikombëtar, si dhe i rasteve kur qytetarët thërresin në ndihmë ligjin evropian në rastet që kanë në shqyrtim në gjykatat e vendit të tyre. Dimension i dytë është ai i penetrimit substancial, i manifestuar si përhapja e zbatimit të ligjit evropian në shumë fusha të jetës kombëtare të qytetarëve të vendeve anëtare e kandidatë të BE-së. Në procesin e integritit ligjor të komunitetit një rol parësor luajnë gjyqtarët. Studiuesit evropianë sjellin si shembull rastin e rolit të madh që luajti Gjykata Evropiane e Drejtësisë (European Court of Justice). Pikërisht

147 RAPORTI I PROGRESIT 2009 PËR SHQIPËRINË, Bruksel, 14.10. 2009, SEC (2009)

në fillim të viteve 1990, - atëherë kur integrimi europian dukej si një proces politikisht i destinuar të vdesë, të paktën kështu dukej nga ato që shkruanin akademikët për të në dy dekadat pararendëse, - një hero i heshtur me punën e vet këmbëngulëse shënoi kthesën e madhe për atë projekt. Ky "hero" ishte European Court of Justice, ishin ata 13 gjyqtarë që punuan pa zhurmë në Luksemburg dhe e transformuan Traktatin e Romës në kushtetutë, që më pas u zëvendësua nga Traktati i Lisbonës. Me këtë veprim ata hodhën bazat ligjore të ekonomisë e shoqërisë politike të integruar europiane.<sup>148</sup>

Kjo është një përvojë mjaft e rëndësishme për t'u studiuar e implementuar edhe nga vendet në rrugën e zhvillimit, siç është edhe Shqipëria. Në kapërcimin e situatave të ngjashme të lidhur me tensionin e acaruar pothuaj permanent midis dy forcave kryesore politike të vendit, sipas sociologëve, rol të madh mund të luajë një gjyqësor i pavarur dhe i konsoliduar profesionalisht, përmes zbatimit të arsyeshëm të ligjit, i konceptuar si instrument i ndryshimit dhe zhvillimit shoqëror.

## II

Sipas vizionit të Parsonsit, zotërimi i ekspertizës, në lidhje të ngushtë me zotërimin e traditës kulturore, shërben si një kriter i vlerësimit të rolit profesional të juristëve. Sepse, "profesionisti i vërtetë është një "ekspert teknik" nga fakti se ai zotëron si traditën dhe zotësitë për përdorimin e saj.<sup>149</sup>

Aktualisht, me gjithë përparimet e mëdha të realizuar në dy dekadat e fundit, niveli i ekspertizës së korpusit të juristëve shqiptarë, - në masën e gjerë të tyre, - është me probleme, me mangësi të ndryshme. hapat e rëndësishme që janë bërë në drejtim të përgatitjes së profesionistëve të vërtetë të ligjit këto dy dekadat e fundit, ende shoqërohen nga mangësi dhe probleme që janë identifikuar e punohet për t'i zgjidhur. Një nga mangësitë që ushtrojnë ndikim është edhe mungesa e studimeve sociologjike (mbi të Drejtën e sistemin e Drejtësisë, FZ), që do të ndihmonin në ndriçimin e faktorëve, ushqyesve dhe sfiduesve të dukurive të ndryshme negative në marrëdhëniet shoqërore, duke veçuar korrupsionin në organet e Drejtësisë etj. Edhe një mangësi e tjetër, - mungesa e studimeve mbi raportet midis të Drejtës dhe politikës, mbi rolin e sistemit ligjor në funksionimin e jetës politike në Shqipëri, por edhe studimet mbi ndikimin e anasjelltë të politikës drejtpërdrejt mbi sistemin e Drejtësisë.

Sociologët europianë, duke folur për rolin e arsyes në zhvillimet e sistemit të Drejtësisë dhe të gjithë marrëdhënieve shoqërore e politike në vendin tonë, e lidhin legjitimitetin e sundimit të shumicës me sundimin e arsyeshëm të saj,

148 Anne-Marie Burley, Walter Mattli, Europe before the Court: A political Theory of Legal integration, International Organization, Vol. 47, No. 1 (Winter 1993), f. 41-76

149 Talcott Parsons, A Sociologist looks at the Legal Profession, vep. e cit., f. 314-315.

duke sjell si burim të kësaj arsyeshmërinë mbështetjen edhe të ekspertiza, te përfundimet që ofrojnë studimet e thelluara sociologjike, duke vënë në dukje faktin se diskutimet mbi ekspertizën dhe mbi pushtetin e ekspertit në mënyrë tipike kanë “implikime politike”.<sup>150</sup> Por mendimi politik që fshihet pas këtyre implikimeve rrallë formulohet qartë dhe shprehet me zë të lartë në shoqërinë shqiptare. Madje, forca të ndryshme shoqërore e politike mbajnë qëndrime të ndryshme, shpesh të kundërta ndaj rolit të ekspertizës dhe të ekspertit në shoqëri.

Nëvitet e diktaturës komunistekemi qenë dëshmitarë të frikës që kishte elita politike sunduese ndaj rolit aktiv të ekspertit (edhe atij ligjor) si dhe të ekspertizës në jetën shoqërore. Kjo frikë nxiti shpërthimin e disa fushatave absurde “të luftës kundër burokratizmit dhe teknokratizmit”, duke e maskuar këtë me teorizimet se gjoja pushteti i dijes, pushteti i ekspertit mund të përbëjë “një kërcënim për demokracinë”, sepse ekspertiza shihej si një lloj prone intelektuale që “u jep atyre që e zotërojnë privilegje e fuqi që nuk mund të kontrollohet plotësisht e me sukses nga populli, i cili nuk i ka aftësitë që ta zotërojë e fitojë atë”.<sup>151</sup>

Cila është kjo “arsye” informale, deformuese, populiste që ushqen shfaqjen e mangësive të tilla në edukimin e profesionistëve të vërtetë të ligjit në vendin tonë edhe tani në shoqërinë pluraliste? Si rrjedhojë e incensisë të së shkuarës, kur marrja e një diplome të shkollës së lartë të siguronte një emërim të sigurtë dhe deri-diku një lloj karriere, edhe në ditët tona rendja pas marrjes së diplomës e mbiquajtur shpeshherë në mënyrë pezhorative “një copë kartoni”, pa marrë dije të thella, të gjera e të qëndrueshme shkencore në fushën e Drejtësisë, - pra pa asimiluar ekspertizën e shëndoshë ligjore, që kombinon njohjen e thellë të traditës dhe të shkencës bashkëkohore juridike, - vazhdon të përbëjë një shqetësim për praktikata e ndjekura në përgatitjen e profesionistëve të së Drejtës në Shqipëri.

Në radhë të parë, ndikim negativ kanë interesat egoiste politike-elektorale. Si rrjedhojë e reformave të thella në sistemin e Drejtësisë pas vitit 1992, u krijua një boshllëk në trupën e gjyqtarëve. Në ato rrethana, vendit i nevojiteshin 300 gjyqtarë, kur në detyrë kishte vetëm 150 prej tyre. Për plotësimin e shpejtë të këtyre vendeve vakante, u përligj organizimi i kursit 6 - muhor të përgatitjes së juristëve në Plazhin e Durrësit në mars të vitit 1993, ku shumica dërrmuese e kursantëve të regjistruar atje ishin nga radhët e ish të persekutuarve, me argumentin se kështu atyre u njihej një e drejtë e mohuar gjatë regjimit komunist. Krahaj kësaj, është një fakt i njohur nga të gjithë se, edhe pse ata më

150 Shih Stephen Turner, What is the Problem with Experts?, Social Studies of Science, Vol. 31, No. 1(Feb., 2001), Sage Publications, f. 123-149

151 Stephen Turner, po aty, f. 123

pas i përfunduan studimet e plota universitare në sistemin e korrespondencës në Fakultetin e Drejtësisë, orientimi i tyre politik përputhej publikisht me të mazhorancës politike të asaj kohe. Organizata Ndërkombëtare Human Rights Watch shprehte atë kohë shqetësimin se, si të emëruar nga partia në pushtet, ka rrezik që besnikëria politike e atyre njerëzve do të dëmtojë paanshmërinë e tyre dhe do t'i hapë rrugë ndërhyrjes së mëtejshme të pushtetit ekzekutiv në sistemin gjyqësor.<sup>152</sup>

Sigurisht, e Drejta dhe politika janë të lidhura ngushtë midis tyre, dhe vetëm në një shoqëri të konsoliduar demokratike mund të krijohen raporte të drejta të autonomisë nga njëra-tjetra. Sociologët e pranojnë se e Drejta funksionon edhe si një maskë për politikën, duke luajtur me këtë rast atë rol që neofunksionalistët parashikojnë për ekonomiksin. Nevoja për një domen, për një fushë që do të rrethonte e amortizonte përplasjen direkte të interesave politike, është shprehur qartas në veprën e Parsonsit dhe të neofunksionalistëve. Kjo fushë nuk mund të ndahet kurrë plotësisht nga sfera politike, por ka aftësinë latente që të krijojë një të ashtuquajtur "buffer zone" në dinamikën e raporteve mes pushteteve në një shoqëri demokratike, ku mund të arrihen ato rezultate që nuk do mund të arriheshin në mjedisin e ashpër të politikës së ditës.<sup>153</sup>

Shqetësimet e vërtetuara si realiste në raportet midis të Drejtës dhe politikës në vendin tonë, përmbahen edhe në progres-raportin e vet mbi Shqipërinë të Komisionit European për vitin 2014, ku konstatohet se në përgjithësi, interesi afatmesëm ishte sakrifikuar shpesh nga interesi afatshkurtër, nga interesat e ngushta politike, se në vend ndihet nevoja e konsolidimit të kulturës demokratike politike. Qëndrime të tilla cenojnë edhe barazinë e qytetarëve para ligjit, ushqejnë korrupsionin dhe kulturën e mosrespektimit rigoroz të ligjit nga vetë ata që i hartojnë, i administrojnë apo i implementojnë ligjet. Kjo dukuri, është cilësuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit si një prirje anti-institucionale<sup>154</sup> për të fituar imunitet përballë procedimit gjyqësor, duke iu shmangur mbrojtjes së qëndrimeve e sjelljes së aktorëve të rëndësishëm politikë në sallën e gjyqit.

Sociologët besojnë se rritja e respektimi i ekspertizës ligjore, forcimi i pavarësisë së gjykatave, do të ndihmonte procesin e de-ideologjizimit e të depolitizimit partiak të mbarë shoqërisë, dhe posaçërisht të qeverisjes dhe të institucioneve të saj. Kundër kësaj prirjeje objektive për një shoqëri demokratike mund të dalin vetëm "partitë totalizuese", siç konsiderohen "partitë që e ndërtojnë ideologjikisht universin përreth tyre, që krijojnë rendin e përvojave

152 Human Rights in Post-Communist Albania, vep. e cit., f. 10-11.

153 Anne-Marie Burley, Walter Mattli, Europe before the Court: A political Theory of Legal integration, International Organization, vep. e cit., f. 44.

154 Shih Albanian Helsinki Committee, Report on Human Rights in Albania (1997-2003), vep. e cit., f. 144.

jetësore dhe të jetës shoqërore të anëtareve (e simpatizantëve të tyre, FZ), dhe që flakin tej kuptimin mbi botën të partive të tjera dhe tërë argumentet që mbështeten në ato botëkuptime”.<sup>155</sup>

Një kuptim i drejtë i rolit të pazëvendësueshëm të ekspertizës dhe të trajnimit profesional të vep. E cit.demokratike të qeverisjes, e cila i jep përgjigje të drejtë raportit midis aplikimit të klientelizmit e militantizmit e partiak, nga njëra anë, apo të meritokracisë, paanshmërisë dhe profesionalizmit juridik, nga ana tjetër në sektorët e Drejtësisë. Siç konstatohet në raportet e faktorëve që monitorojnë procesin e integritetit të vendit tonë në BE te viteve 2008-2009, presionet politike, ndikimet e klientelizmit dhe militantizmit partiak në procesin e ndërtimit të gjykatave dhe të administratës civile dëmtojnë funksionimin normal të strukturës së tyre organizative, pengojnë shfrytëzimin me eficiencë të plotë të reformave pozitive të realizuara në sektorët e Drejtësisë vitet e fundit, ulin kapacitetet gjykuese e interpretative të institucioneve të gjykatave e të prokurorisë, dëmtojnë pavarësinë e gjyqësorit, nxitin shfaqjet e korrupsionit në veprimtarinë e tij, duke e penguar sistemin ligjor të realizojë funksionet e tij integruese shoqërore, funksionet e zgjidhjes së drejtë të konflikteve, të konsolidimit të demokracisë e të sundimit të ligjit, si dhe të përparimit të vendit në rrugën e integritetit europian.

Sociologët theksojnë se trashëgimitë e së shkuarës mund të kenë ende ndikim në proceset politike aktuale, se intensiteti i luftës midis forcave politike lidhur me tentativat e mundshme për të shtrirë kontrollin e tyre mbi sistemin gjyqësor mund të variojë në përputhje me nivelin e politizimit të dikurshëm të gjyqësorit në regjimin e mëparshëm komunist në vend.<sup>156</sup>Nëse kemi këtë “produkt” edhe në vitin 2015, siç tregojnë shenjat e instrumentalizimit politik partiak të ashtuquajturit “rasti Doshi”, atëhere mund të themi se edhe pushteti gjyqësor mund dhe duhet të ndikojë në mënyrë të dyanshme ndaj sferës së politikës, që në këto dy dekada, ka ndërhyrë shpesh në veprimtarinë e gjyqësorit.

Shkalla e pamjaftueshme e rafinimit të kulturës juridike të ligjbërëseve dhe ligjvënësve shqiptarë, rastet e arsimimit të dyshimtë juridik të disa prej tyre të zgjedhur në Kuvend, në komisionin parlamentar të ligjeve, të disa nëpunësve dhe këshilltarëve të administratës së lartë shtetërore që punojnë në sektorët juridike të atyre dikastereve, flasin se ata nuk i ngjajnë aspak mjekut, me të cilin Talkot Parsons krahasonte profesionistët e ligjit, por thjesht i ngjajnë pacientit. Të tillë “pacientë” me nivel të ulët ekspertize juridike kanë

<sup>155</sup> Stephen Turner, What is the Problem with Experts?, vep. e cit., f. 126.

<sup>156</sup> Pedro C. Magalhaes, The Politics of Judicial Reform in Eastern Europe, Comparative Politics, vep., e cit., f. 59.

prodhuar shpesh ligje e akte të tjerë normativë që nuk i kanë rezistuar procesit të rishikimit gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese, e cila që prej vitit 2006 e deri në ditët tona ka rrëzuar e vazhdon të rrëzojë një sërë projektligjesh të Kuvendit dhe vendimesh të ekzekutivit shqiptar.

Meqenëse shoqëria jonë në kuadrin e përpjekjeve për integrimin e plotë në BE lufton që t'i gëzojë në shkallën e duhur avantazhet e lidhura me funksionet latente integruese të profesionit ligjor, me rolin e pazëvendësueshëm të tyre në kultivimin e urtësisë dhe të tolerancës në jetën tonë shoqërore-politike, karakteristikë kjo e kulturës dhe e shoqërive të konsoliduara demokratike, atëherë kërkohet prej të gjithë aktorëve kryesorë të jetës politiko-shoqërore shqiptare të bëjnë kujdes që këta "pacientë" të "shërohen" sa më shpejt nga sëmundjet e diletantizmit dhe të anshmërisë politike, ose ndryshe të mos promovohen nga asnjëra palë për të zënë pozitat kyçe që mbajnë ndonjëherë.

## DISA PËRFUNDIME:

1. Situata e sotme në Shqipëri, në prag të ndryshimeve të mëdha e të pritshme në rrugën e integritit europian të vendit, është ndër të tjera edhe produkt i punës dhe i rolit të profesionit ligjor. Sa më e pavarur dhe sa më profesioniste është veprimtaria e këtij grupi profesional në jetën e shoqërisë, aq më të sigurt janë hapat edhe në procesin e integritit.

2. Pavarësisht nga zhvillimet pozitive, duhet theksuar se kultura e marrëdhënieve politike mes dy partive kryesore të vendit karakterizohet për më shumë se dy dekada rresht nga konflikti dhe tensioni, që në momente të veçantë, - si në mars 1997, - fryhet e derdhet furishëm në rrugë, duke vënë në rrezik funksionimin normal të institucioneve shtetërore. Në progres-raportin e vitit 2014 mbi Shqipërinë, Komisioni Europian vënë dukje se:

"Shqipëria duhet të vazhdojë me energji reformën e gjyqësorit dhe reformën e administratës publike. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duhet të mbeten përparësi kryesore, me përpjekje të qëndrueshme dhe sistematike dhe përforsim konsekuent të legjislacionit për ta luftuar korrupsionin në të gjitha nivelet, si dhe për të luftuar të gjitha llojet e veprimtarive kriminale. Pengesat ekzistuese ndaj hetimeve proaktive dhe efikase duhen eliminuar. Shqipëria duhet të zhvillojë gjithashtu më tej precedentët e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në këto fusha... Që reformat të jenë

të qëndrueshme, do të nevojitet një dialog politik më konstruktiv".<sup>157</sup>

Këshillat e Talcott Parsonsit në këtë rast do të ndihmonin që gjithë shoqëria jonë ta kuptojë se nuk janë vetëm e kryesisht politikanët partiakë ata që vendosin për drejtimin, përmbajtjen e cilësinë e reformës në sistemin e Drejtësisë, por rolin më të rëndësishëm duhet të luajnë vetë juristët profesionistë e të përgjegjshëm për misionin e tyre jetik në sistemin shoqëror demokratik.

## BIBLIOGRAFIA

- Albanian Helsinki Committee, Report on Human Rights in Albania (1997-2003), PEGI, 2005
- Albania 2005 Progress Report, Brussels, 9 November 2005, SEC (2005) 1421
- Burley Anne-Marie, Walter Mattli, *Europe before the Court: A Political Theory of Legal Integration*, International Organization, Vol. 47, No. 1 (Winter 1993).
- Human Rights in Post Communist Albania, Human Rights Watch 1996. Lexuar në mars 2010 në: <http://www.unhcr.org/cgi-bin/texis/vtx/refworld/rwmain?page=search&>
- Magalhaes Pedro C., *The Politics of Judicial Reform in Eastern Europe*, Comparative Politics, Vol. 32, No. 1 (Oct., 1999).
- Parsons Talcott, *A Sociologist looks at the Legal Profession*, Talcott Parsons on Law and Legal System, by A. Javier Treviño, Cambridge Scholars Publishing 2008
- Përfundimet kyçe të Raportit të Progresit 2014 për Shqipërinë, lexuar nga websiti <https://eudelegationalbania.wordpress.com/2014/10/08/perfundimet-kyce-te-raportit-te-progresit-2014-per-shqiperine/>
- RAPORTI I PROGRESIT 2009 PËR SHQIPËRINË, Bruksel, 14.10. 2009, SEC (2009) 1337
- Turner Stephen, *What is the Problem with Experts?*, Social Studies of Science, Vol. 31, No. 1 (feb., 2001), Sage Publications.

---

<sup>157</sup> Përfundimet kyçe të Raportit të Progresit 2014 për Shqipërinë, lexuar nga websiti <https://eudelegationalbania.wordpress.com/2014/10/08/perfundimet-kyce-te-raportit-te-progresit-2014-per-shqiperine/>

## **MARRËVESHJA E TREGTISË SË LIRË NDËRMJET SHBA DHE BE. RËNDËSIA E SAJ PËR VËNDET E BALLKANIT PERËNDIMOR**

**Enian Lamce,**  
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

**Alketa Dumani**  
Universiteti Aleksandër Moisiu

### **ABSTRACT**

*The actual economic and political situation of South Eastern European countries is pretty much dependent. The relations between USA and the EU have a high degree of economic interdependency and close political cooperation based on common values and interests. At the end of WWII the relations between the US and (Western) Europe grew stronger. The decline of the communist block was reflected the US-EU relations too, shifting the focus from security to the economic and political partnership.*

*Despite the fact that this economic relation is the most important in the world in many aspects, it has to be pointed out that the initiatives of regional economic cooperation, the rise of Asian countries (mainly China and India) and its markets as global players in the international arena, as well as the slow economic growth in the US and the EU as a result of the financial crisis have contributed in a decline of the importance of the bilateral relation US-EU not only on an economic level, but also on a political one. Despite the huge volume of the trade on both sides of the Atlantic, in nominal terms the value of these exchanges has declined during the period 2000-2012. The US exports from the US toward the EU have declined steadily from 28% to 17%, while the EU exports toward the US have declined from 22% to 17%. The decrease of trade exchanges between the US and the EU is also a result of the rise of the Chinese exports globally. The total US exports increased four times from 2% to 8%, while the EU exports increased 3 times from 3% to 9%.*

*The signing of the TTIP, besides the economic implications, would not only increase the faith of the American public in their democratic institutions and of the European citizens in the idea of the EU, but would at the same time and more importantly strengthen the political cooperation. In case the agreement is signed*

*and implemented successfully, the economic profit of the EU will amount at circa \$119 billion, while that of the US at circa \$95 billion. A higher level of confidence and stable economic growth in the US and the EU would increase the promotion of Western value through diplomatic and strategic coordination. Reviving both economies through this agreement is crucial to preserve the continuation of the US-EU leadership by keeping the model, norms and standards that they put in place.*

**Keywords:** EU, USA, partnership, South East Europe

### **Historiku i marrëdhënieve tregtare SHBA-BE:**

Marrëdhëniet ndërmjet SHBA-së dhe BE-së karakterizohen nga një shkallë e lartë e ndërvarësisë ekonomike dhe e bashkëpunimit të ngushtë politik, bazuar në vlerat dhe interesat e përbashkëta. Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore fillon forcimi i marrëdhënieve ndërmjet SHBA dhe Europës (Perëndimore). Shtysë këtyre proceseve ju dhanë sidomos Plani Marshall si edhe themelimi i sistemit të Bretton Woods bashkë me ndërtimin e një sërë institucionesh multilaterale si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar si edhe nënshkrimi i marrëveshjeve kuadër si General Agreement on Tariffs and Trade (GATT), sot e njohur si World Trade Organisation (WTO).<sup>158</sup> Motorri i këryre zhvillimeve ishin pa asnjë dyshim SHBA-të, të cilat të udhëhequra nga vlerat dhe interesat e përbashkëta e sidomos nga imperativi i sigurisë, i imponuar nga fillimi i Luftës së Ftohtë, ndërmorrën hapa të qenësishëm për të forcuar dhe kultivuar lidhjet ndërmjet tyre dhe Europës duke përfshirë këtu jo vetëm ato në fushën e sigurisë (NATO), por edhe ato në fushën ekonomike e financiare. Roli dhe kontributi i SHBA-ve në garantimin e sigurisë në Europë, në rindërtimin e saj dhe në promovimin e projektit europian është i pamohueshëm. Rënia e bllokut komunist u reflektua edhe në marrëdhëniet ndërmjet SHBA dhe Komunitetit Europian duke i bërë ato nga një marrëdhënie të diktuar kryesisht nga imperativi i sigurisë, në një marrëdhënie të motivuar nga imperativat ekonomik e politik. Bashkëpunim i ngushtë ekonomiko-politik ngrihet në një nivel tjetër sidomos gjatë viteve 90' me prezantimin e një sërë deklaratash të përbashkëta politike, por ku asnjëra prej tyre nuk u shoqërua me një kuadër ligjor të vecantë duke e bërë zbatimin e tyre jo të detyrueshëm. Gjatë periudhës 1990-2012 tregtia transatlantike e mallrave dhe shërbimeve ndërmjet SHBA dhe BE u trefishua, nga 190 miliard \$ në 645 miliard \$. Për vitin 2013 shënoi një shifër prej \$787 billion.<sup>159</sup> Përsa i përket vlerës së investimeve

158 **Quinlan**, Joseph P. (2003): *Drifting Apart or Growing Together? The Primacy of the Transatlantic Economy.*, f. 7

159 **Hamilton**, Daniel S., ed. (2014): *The Geopolitics of TTIP: Repositioning the Transatlantic*

direkte të SHBA (FDI) në Europë nga \$1.7 miliardë në 1950 ato kapën shifrën e \$612 miliardë në 1999. Ndërsa investimet direkte europiane në SHBA nga \$2.2 miliardë në 1950, arritën në \$640 miliardë në 1999.<sup>160</sup> Me përfundimin e Luftës së Ftohtë elitat politike në të dy krahët e Atlantikut u kapluan nga frika mbi të ardhmen e aleancës transatlantike, pasi me shpërbërjen e BS nuk zhdukej vetëm armiku i përbashkët i SHBA dhe Europës, por bashkë me të humbiste edhe *raison d'être* e vetë aleancës.<sup>161</sup> Frika mbi humbjen e rëndësisë së aleancës transatlantike dhe bashkë me të edhe dobësimin të marrëdhënieve ndërmjet SHBA dhe Evropës mbështetej në dy shqetësime kryesore: nga ana e Europianëve shqetësimi lidhej me faktin që Europa, në mungesë të kërcënimit sovjetik, nuk do të ishte më skena kryesore në të cilën mund të zhvilloheshin ngjarje që mund të kërcënonin interesat jetike të SHBA dhe Europës. Në mungesë të këtij kërcënimi SHBA mund të tërhiqnin trupat e tyre nga Europa duke e braktisur atë. Ky skenar i frikësonte europianët sepse roli i SHBA si garantues i sigurisë europiane ishte thelbësor edhe në lidhje me parandalimin e rinacionalizimit të politikave europiane cka eventualisht mund të vinte në rrezik të gjithë projektin europian. Nga ana tjetër pala amerikane ishte e alarmuar pasi Europa mund të ndërpriste lidhjen e saj 40 vjecare, shumë të ngushtë me SHBA dhe të fokusohet në ngritjen e një "fortress Europe", e cila do të ndiqte rrugën e saj.<sup>162</sup> Këtë shqetësim pala amerikane e shfaqti shumë qartë gjatë fjalimit të sekretarit të Shtetit James Baker më 1989, ku ai bëri thirrje për rigjallërimin e Aleancës Atlantike me qëllim përshtatjen e marrëdhënieve transatlantike me realitetet e reja ndërkombëtare:

*" [...]to work together toëard the New Europe and the New Atlanticism [...] [in order for] trans-Atlantic cooperation to keep pace with European integration and institutional reform. [...] My Friends the changes we see underëay today in the east are a source of grate hope. But a new era brings different concerns for all of us. Some are as old as Europe itself. Others are themselves the neë products of change"*<sup>163</sup>

Me ribashkimin e Gjermanisë dhe përfundimin e Luftës së Ftohtë ishte Administrata Bush ajo, që duke u bazuar në këto shqetësime, ndërmmori hapin e parë në këtë drejtim duke inicuar të ashtuquajturën "Deklarata Transatlantike". Në thelb kjo deklaratë ritheksonte edhe njëherë vazhdimin e angazhimit të përbashkët të bazuar mbi normat, vlerat dhe qëllimet e përbashkëta. Ajo

Relationship for a Changing World, f.X

160 **Quinlan**, Joseph P. (2003): *Drifting Apart or Growing Together? The Primacy of the Transatlantic Economy*, f. 7

161 **Meyer**, Henning (2008): *The framework for advancing transatlantic economic integration. Structural shortcomings in an experimental form of international governance*, f.7

162 Ibid

163 Fjalimi i Sekretarit të Shtetit James Baker në Berlin (12 Dhjetor 1989)

synonte fillimin e ndërtimit të një arkitekture të re transatlantike, e cila duhet të kontribuonte në forcimin dhe progresin e marrëdhënieve ekonomike e politike ndërmjet SHBA dhe vendeve të Komunitetit European (më vonë BE). Një prej rezultateteve të deklaratës ishte edhe institucionalizimi i mekanizmave konsultues. Kjo marrëveshje përfshinte:<sup>164</sup>

- Organizimin e konsultimeve dy herë në vit ndërmjet SHBA dhe Europës të përfaqësuar nga njëra anë nga Presidenti i SHBA dhe nga ana tjetër nga Presidenti i KE dhe nga Presidenti i Komisionit European;
- Konsultime dy herë në vit ndërmjet Ministrave të Jashtëm të Komunitetit European, Komisionit dhe Sekretarit Amerikan të Shtetit;
- Konsultime dy herë në vit ndërmjet Komisionit dhe Qeverisë Amerikane në nivel kabineti;
- Takime në nivel ministerial

Pavarësisht rolit të saj simbolik duhet thënë se kjo deklaratë shënon hapin e parë drejt fillimit të një epoke të re në marrëdhëniet transatlantike, të cilat duhet të shkonin përtej imperativit të sigurisë të diktuar nga Lufta e Ftohtë duke synuar zgjerimin e saj edhe në dimensionin ekonomik, social e politik.<sup>165</sup>

Dinamika dhe ngjarjet e viteve 90' sic ishin intensifikimi i lidhjeve ekonomike dhe i tregtisë ndërkombëtare si edhe konfliktet e shpërthyer në kuadër të shpërbërjes së Jugosllavisë nxorrën në pah problematika të reja, të cilat nuk ishin adresuar në Deklaratën Transatlantike dhe në të njëjtën kohë çënonin marrëdhënien transatlantike. Me qëllim sheshimin e mosmarrëveshjeve të lindura politik-bërës të rëndësishëm nga të dyja anët e Atlantikut ndër të cilët Ministri i Jashtëm Gjerman Klaus Kinkel, Sekretari Britanik për marrëdhëniet me jashtë Malcolm Rifkind, Margaret Thatcher, Kissinger, Komisioneri i Lartë i BE Sir Leon Brittan, Sekretari Amerikan i Shtetit Ēarren Christopher, bënë thirrje për një iniciativë të re serioze<sup>166</sup>. Gjatë Samitit të Madridit në dhjetor 1995 u miratua dhe New Transatlantic Agenda (NTA), e cila nuk ishte gjë tjetër vecse parashtrimi i arkitekturës së re të marrëdhënieve SHBA-BE, ku adresoheshin problemikat që karakterizonin marrëdhënien transatlantike në fusha të ndryshme si ajo politike, ekonomike, sociale si dhe në fushën e sigurisë. NTA percaktoi katër pika bazë mbi të cilat duhej të bazohej avancimi

---

164 Meyer, Henning (2008): The framework for advancing transatlantic economic integration. Structural shortcomings in an experimental form of international governance., f.7

165 Ibid, f.7-8

166 Pollack, M. and Schaffer, G. (2001): Transatlantic Governance in the Global Economy, Rowman & Littlefield Publishers, Inc., Lanham, f. 71

i marrëdhënies transatlantike.<sup>167</sup>

1. Promovimi i paqes, stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit në të gjithë botën

2. Përgjigja efikase ndaj sfidave globale

3. Mbështetja dhe promovimi i zgjerimit të tregtisë globale dhe i lidhjeve ekonomike

4. Ndërtimi i urave në të dy anët e Atlantikut

Dokumenti u shoqërua edhe me një plan veprimi të përbashkët SHBA-BE, ku parashikoheshin fushat specifike të bashkëpunimit sipas kategorive të sipërcituara. Monitorimi i implementimit dhe i problemeve që mund të lindnin gjatë tij iu caktua një grupi të nivelit të lartë si edhe një NTA Task Force, të cilat duhet të raportonin tek drejtuesit respektivë të samiteve që do të mbaheshin.<sup>168</sup>

Në sferën ekonomike NTA bëri të mundur dakordësimin e palëve mbi krijimin e një New Transatlantic Marketplace. Ky treg do të krijohet gradualisht duke minimizuar apo eliminuar barrierat që pengonin qarkullimin e të mirave, shërbimeve dhe kapitalit ndërmjet SHBA dhe BE. Për herë të parë koncepti i krijimit të një tregu të përbashkët transatlantik bëhet pjesë e dokumentit përfundimtar të një samiti. Në planin e përbashkët të veprimit theksi, përta i përket sferës ekonomike vihej tek inkurajimi i progresit në fushën e njohjes së standarteve dhe certifikimeve respektive si edhe në adresimin e barrierave teknike e jo tarifore, të cilat buronin nga proceset rregullatore të ndryshme:

*“ [to] encourage a collaborative approach between the EU and the U.S. in testing and certification procedures by promoting greater compatibility of standards and health and safety related measures”.*<sup>169</sup>

Ndër propozimet e shumta ishte edhe ai i Ministrisë të Jashtëm Gjerman Kinkel mbi krijimin e një Transatlantic Free Trade Agreement (TAFTA), e cila do të shërbente jo vetëm për të rigjallëruar marrëdhëniet ndërmjet SHBA dhe BE, por do të ridimensiononte ekonominë transatlantike përballë ndryshimeve gjithmonë e më të shpejta të ekonomisë botërore.

Nënshkrimi i Mutual Recognition Agreement (MRA) shënon edhe arritjen e suksesit të parë të qenësishëm në fushën e njohjes reciproke të standarteve. Kjo njohje ishte e kufizuar dhe vlente vetëm për disa grupe produktesh si: Telecommunication Equipment; Electromagnetic Compatibility (EMC); Electrical Safety; Recreational Craft; Pharmaceutical Good Manufacturing Practice (GMP); Medical Devices.<sup>170</sup> Hallka më e dobët dhe ajo që penalizoi

167 The New Transatlantic Agenda (1995)

168 **Biscop**, S.(2005): The European Security Strategy: A Global Agenda for Positive Power, f. 125

169 The New Transatlantic Agenda (1995)

170 **Shaffer**, Gregory (2002): Reconciling Trade and Regulatory Goals: The Prospects and

të gjitha këto marrëveshje dhe iniciativa ishte mungesa e vullnetit politik e shfaqur nga të dyja palët. Amerikanët ishin të përqëndruar tek avancimi i marrëveshjeve rajonale të tregtisë së lirë me Meksikën dhe Kanadanë nëpërmjet North American Free Trade Agreement (NAFTA) dhe thellimit të marrëdhënieve ekonomike me Azinë Lindore nëpërmjet Asia Pacific Economic Cooperation (APEC). Europa ndërkohë ishte përqëndruar tek zgjerimi i saj drejt lindjes dhe me zgjerimin e strukturave të saj të brendshme. Nën tryshninë e këtyre sfidave të mëdha politike u duk sikur niveli i institucionalizimit të marrëdhënieve transatlantike si edhe forcimi i themeleve mbi të cilat duhej të ngrihej integrimi i ardhshëm ekonomik transatlantik u lanë pas dore.

### **Rendësia e TTIP: Konteksti dhe rëndësia historike**

Takimi i G8 në Irlandën e Veriut ishte skena ku u prezantua projekti apo më saktë ideja mbi një marrëveshje të mundshme të tregtisë së lirë ndërmjet SHBA-ve dhe BE-së. Megjithatë duhet thënë se bisedimet dhe shkëmbimi i ideve mbi një marrëveshje të këtyre përmasave kishin filluar më heret në vitin 2011 gjatë Samitit SHBA-BE, ku dhe u vendos ngritja e një grupi pune, i cili do të identifikonte rrugët për rigjallërimin e ekonomisë, rritjen e aftësisë konkurruese në tregjet ndërkombëtare si edhe do të mundësonin tejkalimin e frustimit të lindur si pasojë e mungesës së progresit gjatë negociatave mbi tregtinë ndërkombëtare në Doha. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian gjenden në një proces negociatash mbi të ashtuquajturën *Transatlantic Trade and Investment Partnership (TTIP)*, nëpërmjet të cilit synojnë arritjen e një marrëveshjeje të pranueshme për të dyja palët që do të conte në rritjen e tregtisë dhe investimeve ndërmjet dy ekonomive. Negociatat duhet të përmbylleshin në vitin 2014, por si pasojë e mungesës së konsensusit në shumë pika si edhe disa zhvillimeve, si ai përgjimeve në masë nga NSA në Evropë e kanë vështirësuar së tepërmi atmosferën në të cilën po zhvillohen këto negociata. Dy janë objektivat kryesorë të negociatorëve të kësaj marrëveshjeje: 1) heqja e tarifave të mbetura ose taksave të import/eksporti ndërmjet dy zonave, të cilat aktualisht përlllogariten në 4% dhe 2) unifikimi i standarteve rregullator ndërmjet BE dhe SHBA. Pavarësisht mospasjes së një marrëveshjeje të përfunduar, SHBA dhe BE janë partnerë të mëdhenj tregtarë dhe ekonomitë e tyre janë relativisht të mirëintegruara. Të dyja ekonomitë janë më të mëdhatë në botë dhe lidhjet e tyre bilaterale formojnë marrëdhënien ekonomike bilaterale më të rëndësishme.<sup>171</sup> Raportet tregtare transatlantike kanë qenë dhe janë në nivele shumë të larta: ato përbëjnë rreth 50% të prodhimit global bruto dhe një të tretën e volumit të tregtisë botërore. Ekonomia transatlantike gjeneron plot 5 trilion \$ ne vit. Volumi ditor i shërbimeve dhe tregtisë transatlantike është 1,8 miliardë euro. Me këtë veprimtari janë të lidhura rreth 15


---

Limits of New Approaches to Transatlantic Governance through Mutual Recognition and Safe Harbor Agreements, f.40-42

171 **Plummer**, Michael G. (2014): The Transatlantic Trade and Investment Partnership in the Global Context, f.97

milione vende pune.<sup>172</sup> SHBA dhe BE janë dy partnerë shumë të mëdhenj tregtarë jo vetëm në termat e shkëmbimeve tregtare në fushën e mallrave dhe shërbimeve, por edhe në atë të investimeve të huaja direkte.

**Figura 1:** Investimet e huaja direkte në % nga BE dhe drejt BE 2008-2010<sup>173</sup>




Rej Burimi: Eurostat 5 trilion Euro. E njëjta situatë shfaqet edhe me shkëmbimet tregtare të mallrave dhe shërbimeve:

**Figura 2:** Partnerët kryesorë të BE në importin dhe eksportin e mallrave, 2012<sup>174</sup>

### Exports

Burimi: Eurostat

Ashtu sic tregohet edhe në grafik 57.7% (rreth 3/5) e të gjitha eksporteve



të të mirave të BE në 2012 u destinuan për vendet e G20, ku më kryesoret janë


172 **Hamilton**, Daniel S., ed. (2014): The Geopolitics of TTIP: Repositioning the Transatlantic Relationship for a Changing World, f.IX

173 EUROSTAT

174 Ibid.

Source: Eurostat SHBA (17.3%), Kina (8.5%) dhe Rusia (7.3%). Importet e BE sigurohen në masën 60.1% nga vendet e G20, ku Kina zë rreth 16.2%, Rusia 11.9% dhe SHBA 11.5%.<sup>175</sup>

**Figura 3:** Partnerët tregtarë kryesorë anëtarë të G20, 2012



të mëdhenj në botë të të mirave dhe shërbimeve. Megjithëse marrëdhënia ekonomike SHBA-BE, në shumë aspekte është më e rëndësishmja në botë duhet thënë se iniciativat e bashkëpunimit ekonomik rajonal, ngritja e Azisë (sidomos e Kinës dhe Indisë) dhe e tregjeve të saj si lojtarë globalë në arenën ndërkombëtare, si edhe rritja e ngadaltë ekonomike në SHBA dhe BE si pasojë e krizës financiare e kanë reduktuar rëndësinë e marrëdhënies bilaterale ndërmjet SHBA dhe BE jo vetëm në fushën ekonomike, por edhe në atë politike. Bazuar në të dhënat e OECD shkëmbimet tregtare me SHBA, bazuar në vlerën e shtuar, përbëjnë 23% të eksporteve dhe 21% të importeve të BE, ndërsa shkëmbimet tregtare me BE, bazuar në vlerën e shtuar, përbëjnë 29% të eksporteve dhe 27% të importeve.<sup>176</sup> Vetëm kjo e dhënë mjafton për të kuptuar që SHBA dhe BE janë partnerët tregtarë më të rëndësishëm të njeri tjetrit. Pavarësisht sasisë së madhe të shkëmbimeve tregtare ndërmjet dy anëve të Atlantikut, vlen të përmendet fakti se shkëmbimet tregtare gjatë periudhës 2000-2012, në terma nominal, kanë rënë dukshëm:


**Figure 4:** Drejtimi i eksporteve të SHBA dhe BE 2012 dhe 2000 në vendet e përzgjedhura

<sup>175</sup> Ibid.


<sup>176</sup> **Plummer**, Michael G. (2014): The Transatlantic Trade and Investment Partnership in the Global Context, f.101

## US Exports 2012

Burimi: IMF Direction of Trade Statistics



## US Exports 2000




## EU Exports 2012


Burimi: IMF Direction of Trade Statistics

Eksportet nga SHBA në drejtim të BE kanë rënë dukshëm nga 28% në

A. US Exports 2012



B. US Exports 2000



17%, ndërsa eksportet nga EU në drejtim të SHBA kanë rënë nga 22% në 17%. Rënia e shkëmbimeve tregtare ndërmjet SHBA dhe BE i reflekton në një masë jo të vogël edhe rritjen e tregjeve kineze.

Eksportet e SHBA u katërfishuan nga 2% në 8% dhe ato të BE u trefishuan nga 3% në 9%.<sup>177</sup> Gjendur në këtë situatë nënshkrimi i një marrveshjeje tregtare ndërmjet SHBA dhe BE e cila do të rigjallëronte marrdhëniet ekonomike, është shndërruar në një imperativ për të dyja palët.

Heqja tërësisht e barrierave tarifore dhe jo tarifore është një prej objektivave kryesorë të negociatorëve. Barrierat tarifore dhe jo tarifore shkojnë në rreth 4%, shifër kjo shumë e ulët. Bazuar në këtë fakt shumë e shikojnë si jo

177 Ibid.

të domosdoshme një marrveshje të tregtisë së lirë ndërmjet SHBA dhe BE pasi, sipas tyre, benefitet marginale që do të vinin nga TTIP nuk ja vlejné përballë kostove politike që do të sillte kjo marrëveshje.<sup>178</sup> Pavarësisht faktit që tarifat janë të ulta dhe kostot politike që po vijnë si pasojë e negociatave rreth TTIP janë për tu marrë në konsideratë, duhet thënë se një marrveshje transatlantike me tarifa zero do të rriste eksportet me 17% për të dyja entitetet dhe do ti bënte ato 5 herë më të mëdha se eksportet ndërmjet SHBA dhe Koresë së Jugut nën rregullimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet të dyve.<sup>179</sup> Bazuar në një studim të European Centre for International Political Economy, nënshkrimi i TTIP dhe përmbushja e objektivit të parë, pra e heqjes së tarifave të ngelura, do të rriste dukshëm eksportet në të dyja anët. Për eksportet e BE në drejtim të SHBA kjo rritje parashikohet të jetë 7% (rreth \$28 billion) në rast të një “static scenario” dhe 18% (rreth \$69 billion) në rast të një “dynamic scenario”. Ndërsa për eksportet e SHBA në drejtim të BE kjo rritje parashikohet të jetë 8% (rreth \$23 billion) në rast të një “static scenario” dhe 17% (rreth \$53 billion) në rast të një “dynamic scenario”.<sup>180</sup> Rreth 80% e benefiteve që do të vijnë nga arritja e mundshme e kësaj marrëveshjeje lidhen drejtpërdrejt me zhbërjen e masave jo tarifore.<sup>181</sup> Marrveshja në vetëvete është shumë ambicioze dhe synon thellimin e marrëdhënieve ekonomike e politike SHBA – BE<sup>182</sup> dhe një përmirësim apo më mirë të themi një riparim të përgjithshëm të këtyre marrëdhënieve. Në të njëjtën kohë kjo marrëveshje nuk duhet parë si e motivuar vetëm nga interesat ekonomike, por edhe si një përpjekje për të ruajtur dhe ngritur profilin e tyre në arenën ndërkombëtare. SHBA-ja po e humb besimin se BE-ja është zëri i Evropës, për shkak të krizës në Eurozonë, mosreagimit në kohë të BE përballë krizave ndërkombëtare por edhe si pasojë e humbjes së besimit të vetë qytetarëve evropian tek ideja e BE-së. Uashingtoni do të kishte dëshirë që BE-ja të jenë unike, por është skeptik se kjo me të vërtetë do të ndodhë. Në Uashington po shtohet bindja se qendra e pushtetit në Evropë gjendet para së gjithash në Berlin. Prandaj Evropa shihet më shumë si problem dhe jo si partner. Në rezultatet e 2014 Ivory Toëer Survey (2014) duket qartë që një pjesë jo e vogël e studiuesve dhe akademikëve amerikan e shikojnë Azinë të një rëndësie strategjike më të madhe se BE. Rëndësia e saj për SHBA do të

178 Ibid. f.104

179 **Hamilton**, Daniel S., ed. (2014): The Geopolitics of TTIP: Repositioning the Transatlantic Relationship for a Changing World, f.X

180 **Erixon**, Frederik/ **Bauer**, Mathias (2010): A TRANSATLANTIC ZERO AGREEMENT: Estimating the Gains from Transatlantic Free Trade in Goods, f.2

181 AmCham (2014): Building the framework for strengthening the transatlantic partnership, f.22

182 **Dadush**, Uri (2013): Don't Buy the Hype on the Transatlantic Trade Deal <http://carnegieendowment.org/2013/03/18/don-t-buy-hype-on-transatlantic-trade-deal/frd5>

vijë duke u rritur në 20 vitet e ardhshme.<sup>183</sup> Një perceptim të ngjashëm kanë edhe qytetarët e BE për SHBA kur shtrohet çështja e efikasitetit dhe rolit të institucioneve demokratike në mirëmenaxhimin e ekonomisë dhe shmangien e krizave të saj. Stephen Szabo e përcakton këtë situatë si një udhëkryq të rëndësishëm historik, ku edhe si pasojë paaftësisë së evropianëve dhe amerikanëve për të marrë vendime rëndësishme, të përbashkëta, po zvoglohet influenca e Perëndimit dhe po shtohet ajo e shteteve të Paqësorit:

*“That’s the big danger, that we are seeing a serious decline of the West, both North America and Europe. We may be seeing one of these pivot points in history where the shift will move away from the West towards some of the rising powers in the Pacific and elsewhere. So I think we are facing the real prospect that there is going to be a fundamental shift in the balance of power in the world. [...] So we’re losing control over our own fate”.*<sup>184</sup>

Arritja e një marrëveshjeje, në rastin konkret e TTIP, do të rigjallëronte rritjen ekonomike në të dyja anët e Atlantikut duke risjellë jo vetëm besimin e qytetarëve amerikanë tek efikasiteti i institucioneve demokratike dhe atyre evropian tek ideja dhe roli i BE, por në të njëjtën kohë dhe cka është më e rëndësishmja nëpërmjet forcimit të bashkëveprimit ekonomik do të forcohej edhe bashkëveprimi politik, si rezultat i të cilit do të forcohej besimi i Washingtonit tek Europa dhe anasjelltas. Në rast se marrëveshja nënshkruhet dhe implementohet me sukses përfitimi ekonomik i BE do të shkojë në rreth \$119 billion, ndërsa i SHBA rreth \$95 billion.<sup>185</sup> Një konfidencë më e madhe dhe një rritje ekonomike e qëndrueshme në SHBA dhe BE rrit fuqinë e ruajtjes dhe promovimit të vlerave perëndimore, nëpërmjet koordinimit diplomatik e strategjik, edhe në vende të tjera. Rigjallërimi i të dy ekonomive nëpërmjet kësaj marrëveshjeje është thelbësor për vazhdimësinë e lidhshirimit SHBA-BE në botë duke ruajtur modelin, normat dhe standartet e vendosura prej tyre. Tani duhet parë, nëse evropianët janë në gjendje që të jenë partnerë të amerikanëve në ruajtjen e klimës, në Afganistan dhe në sfidat e tjera të rëndësishme në botë. Po ashtu duhet parë, nëse amerikanët janë të aftë të jenë partnerë edhe në kohërat e vështira dhe frustruese. Unifikimi i qëndrimeve të SHBA dhe BE përball sfidave rajonale e globale me karakter ekonomik-politik dhe atyre të sigurisë do të bënte që adresimi i tyre të ishte më i shpejtë dhe më efikas. Akoma më i rëndësishëm bëhet ky bashkëpunim dhe forcimi i pozitave të SHBA dhe BE në arenën ndërkombëtare sidomos në një kohë kur ngritja e të tjerëve (Kinës,

183 Foreign Policy (2015): A survey of America’s top International Relations scholars on foreign-policy research.

184 Deutsche Welle (2011): The trials and tribulations of transatlantic ties

185 **Francois** ed al., (2013): Reducing Transatlantic Barriers to Trade and Investment An Economic Assessment, f.VII

Indisë, Brazilit, dhe Ruisë) shpeshëherë ka shfaqur tendenca për t'iu shmangur rregullave ndërkombëtare ekzistuese duke rrezikuar edhe rregullat bazë të rendit ndërkombëtar. Parë nga ky këndvështrim roli i TTIP në këtë marrëdhënie është shumë i rëndësishëm dhe shkon përtej perfitimit ekonomik.

## BIBLIOGRAFIA

- **Biscop**, S.(2005): The European Security Strategy: A Global Agenda for Positive Power, Ashgate Publishing Limited, Aldershot
- **Shaffer**, Gregory (2002): Reconciling Trade and Regulatory Goals: The Prospects and Limits of New Approaches to Transatlantic Governance through Mutual Recognition and Safe Harbor Agreements, in: Columbia Journal of European Law, Vol. 9, Fall 2002, f. 29-77
- **EUROSTAT** (2014): The EU in the world 2014. A statistical portrait <<http://ec.europa.eu/eurostat/documents/3217494/5786625/KS-EX-14-001-EN.PDF/8642be84-659a-4a3d-a451-1ef26101c78f?version=1.0>>, (23.06.2015)
- **Plummer**, Michael G. (2014): The Transatlantic Trade and Investment Partnership in the Global Context, in: **Hamilton**, Daniel S., ed. (2014): The Geopolitics of TTIP: Repositioning the Transatlantic Relationship for a Changing World, Washington, DC: Center for Transatlantic Relations, f. 97-113
- **Erixon**, Frederik/ **Bauer**, Mathias (2010): A TRANSATLANTIC ZERO AGREEMENT: Estimating the Gains from Transatlantic Free Trade in Goods, ECIPE OCCASIONAL PAPER No. 4/2010, <<http://www.ecipe.org/app/uploads/2014/12/a-transatlantic-zero-agreement-estimating-the-gains-from-transatlantic-free-trade-in-goods.pdf>>, (23.06.2015)
- **AmCham** (2014): Building the framework for strengthening the transatlantic partnership, <http://www.amcham.it/detail.asp?c=1&p=0&id=9111>, (23.06.2015)
- **Dadush**, Uri (2013): Don't Buy the Hype on the Transatlantic Trade Deal <http://carnegieendowment.org/2013/03/18/don-t-buy-hype-on-transatlantic-trade-deal/frd5>, <23.06.2015>
- **Foreign Policy** (2015): A survey of America's top International Relations scholars on foreign-policy research, <<http://foreignpolicy.com/2015/02/03/top-twenty-five-schools-international-relations/>>, (23.06.2015)
- **Francois** ed al., (2013): Reducing Transatlantic Barriers to Trade and Investment An Economic Assessment, [http://trade.ec.europa.eu/doclib/docs/2013/march/tradoc\\_150737.pdf](http://trade.ec.europa.eu/doclib/docs/2013/march/tradoc_150737.pdf), (23.06.2015)

# EUR MEDITERRANEAN

**Nr. 10**  
Qershor 2006

DIPLOMACIA EKONOMIKE. VEPRIMTARIA DHE PRAKTIKAT. DIPLOMACIA EKONOMIKE NE KORNIZEN E OKB .....	50
STUDIM PËR VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË PARIMEVEBAZË TË TRASHËGIMISE ZGJEDHORE EUROPIANE NË LEGJISLACIONI ZGJEDHOR SHQIPTAR .....	113
MARRËVESHJA E TREGTISË SË LIRË NDËRMJET SHBA DHE BE. RËNDËSIA E SAJ PËR VËNDET E BALLKANIT PERËNDIMOR .....	157